



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

PËRPUTHSHMËRIE NË

SPITALIN RAJONAL DURRËS

GUSHT 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Nr.	PërmbatjaFaqe
I.	HYRJA: Auditim Përputhshmërie dhe Rregullshmërie në Spitalin Rajonal Durrës	
a.	Titulli.....	2
b.	Marrësi.....	2
c.	Objektivat dhe qëllimi.....	2
d.	Identifikimi i çështjes.....	2
e.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	2
f.	Përgjegjësitë e audituesve.....	3
g.	Kriteret e vlerësimit.....	3
h.	Standardet e auditimit.....	3
II.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	4
III.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	6-150
1.	Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.....	6
2.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimimi i tyre.....	14
3.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.....	18
4.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	32
5.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.....	37
6.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	52
7.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël.....	100
8.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.....	119
9.	Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	139
10.	Përdorimi i regjistrit mbarëkombëtar të shëndetësisë elektronike.....	148
IV.	KONKLUZIONE.....	170



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1419/1, datë 07/01/2019 “*Auditim përputhshmërie e rregullshmërie të veprimtarisë ekonomiko-financiare*”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.01.2019 deri më datë 29.03.2019, në subjektin Spitali Rajonal Durrës, për periudhën nga 01.01.2015-31.12.2018, u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në Spitalin Rajonal Durrës” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.G., Përgjegjës Grupi
 2. J.Zh., Audituese
 3. A.R., Auditues
 4. M.B., Audituese
 5. B.D., Auditues.
- a) **Titulli:** Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në Spitalin Rajonal Durrës.
- b) **Marrësi:** Spitali Rajonal Durrës.
- c) **Objektivat dhe qëllimi:** Dhënia e opinionit nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.
- d) **Identifikimi i çështjes.** Spitali Rajonal Durrës është i organizuar si person juridik publik, në kuptimin të nenit 25, të Kodit Civil, me qendër në Durrës. Spitali si institucion i shërbimit shëndetësor publik, është jo fitimprurës dhe e ushtron veprimtarinë e tij sipas ligjit bazë të shërbimit shëndetësor, si edhe të ligjit të shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë. Spitali Rajonal Durrës drejtohet nga Bordi i Spitalit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit. Bordi është organi më i lartë ekzekutiv i spitalit. Spitali Rajonal Durrës organizohet dhe funksionon në bazë të Statutit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 23.10.2000 “*Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor*”, i ndryshuar. Organet drejtuese, konsultative dhe komisionet e spitalit janë: **I. Organet drejtuese:** Bordi Drejtues dhe Drejtoria; **II. Organet konsultative:** Komisioni Mjekësor i Spitalit dhe Këshilli Tekniko – Administrativ; **III. Komisionet e spitalit:** Komisioni i Kontrollit të Infeksionit Spitalor, Komisioni i disiplinës për personelin mjek dhe farmacistë, Komisioni i disiplinës për personelin e mesëm dhe sanitarët dhe Komisioni i disiplinës për personelin e administratës, prapavijës.
- e) **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:** Strukturat drejtuese të Spitalit Rajonal Durrës janë përgjegjëse për organizimin e duhur, funksionimin duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të spitalit, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

- f) **Përgjegjësitë e audituesve:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me implementimin e projektit. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.
- g) **Kriteret e vlerësimit.**
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
 - Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
 - Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.
 - Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
 - Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;
 - Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”;
 - Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”, i ndryshuar;
 - VKM nr. 112, datë 22.2.2006 “Për kohën e punës dhe të pushimit në sistemin e shëndetësisë”;
 - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
 - VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”;
 - Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”;
 - Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 559, datë 26.10.2009 “Për aplikimin e tarifave për shërbimet mjekësore”;
 - Urdhri i Ministrit nr. 526, datë “12.10.2009 “Për zbatimin e sistemit të referimit të pacientëve në shërbimin shëndetësor”
 - Statuti dhe Rregullorja e Brendshme e Spitalit;
- h) **Standardet e auditimit** Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Auditimi është kryer mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Planit Vjetor dhe në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1419/1, datë 07/01/2019 “Auditim përputhshmërie e rregullshmërie të veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të miratuar nga Kryetari i KLSH. Auditimi është kryer nga data 14.01.2019 deri në datë 29.03.2019, në subjektin Spitali Rajonal Durrës, për periudhën nga 01.01.2015-31.12.2018, me objekt “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në Spitalin Rajonal Durrës”. Spitali Rajonal Durrës është i organizuar si person juridik publik, në kuptimin të nenit 25, të Kodit Civil, me qendër në Durrës. Spitali si institucion i shërbimit shëndetësor publik, është jo fitimprurës dhe e ushtron veprimtarinë e tij sipas ligjit bazë të shërbimit shëndetësor, si edhe të ligjit të shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë. Spitali Rajonal Durrës drejtohet nga Bordi i Spitalit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit. Bordi është organi më i lartë ekzekutiv i spitalit. Spitali Rajonal Durrës organizohet dhe funksionon në bazë të Statutit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar. Organet drejtuese, konsultative dhe komisionet e spitalit janë: I. Organet drejtuese: Bordi Drejtues dhe Drejtoria; II. Organet konsultative: Komisioni Mjekësor i Spitalit dhe Këshilli Tekniko – Administrativ; III. Komisionet e spitalit: Komisioni i Kontrollit të Infeksionit Spitalor, Komisioni i disiplinës për personelin mjek dhe farmacistë, Komisioni i disiplinës për personelin e mesëm dhe sanitarët dhe Komisioni i disiplinës për personelin e administratës, prapavijës. Auditimi është kryer mbështetur si vijon:
2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:
 - Objekti i këtij auditimi: Rregullshmëria e operacioneve financiare të Spitalit Rajonal Durrës përgjatë periudhës 01.01.2015-31.12.2018. Verifikimi nëse transaksionet janë realizuar në përputhje me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.
 - Qëllimi i auditimit: Dhënia e opinionit, hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.
 - Fushëveprimi: Në auditim janë përfshirë 100% e transaksioneve të Spitalit Rajonal Durrës, të cilat janë audituar me përzgjedhje. Grupi i auditimit nuk pati kufizime gjatë kryerjes së auditimit.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, në vlerën 875,076,950 lekë për tu konsideruar për vitin 2018, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (*u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli*);

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Peshat specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Niveli i materialitetit për vitin 2018, është përlogaritur si vijon:

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës
Paga (600)	468,021,458
Sigurime Shoqërore (601)	75,520,483
Mallra e Shërbime (602)	331,535,009
Total	875,076,950
Materialiteti në %	2%
Materialiteti në vlerë	17,501,539
<i>Kalkulimi i precizionit</i>	
Materialiteti	17,501,539
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	1,750,154
Nëntotali	15,751,385
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%
Vlera e precizionit	14,176,247

Në lidhje me procedurat e prokurimit, Spitali Rajonal Durrës për periudhën 01.01.2015-31.12.2018, ka zhvilluar gjithsej 309 procedura prokurimi me vlerë 1,518,599 mijë lekë. Nga 309 procedura të zhvilluara, 238 procedura (77% të tyre) janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë, si Blerje e Përqendruar dhe/ose Marrëveshje Kuadër, ndërsa 71 procedura janë zhvilluar nga Spitali Durrës. Nga këto procedura janë përzgjedhur për tu audituar, 37 procedura (52% ndaj totalit) prokurimi me vlerë 299,898 mijë lekë. Për procedurat e zhvilluara nga Ministria, grupi i auditimit verifikoi zbatimin e tyre, ndërsa për ato të zhvilluara nga vetë Spitali, u audituan dhe procedurat e prokurimit.



III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

III.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme

Titulli i gjetjes: Realizimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Nga auditimi i mëparshëm nga KLSH janë lënë 19 rekomandime gjithsej, nga këto: 2 masa organizative, 14 masa zhdëmtimi me vlerën 3,179,734 lekë dhe 2 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për **përmirësimin e gjendjes** janë lënë 2 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 2 masa dhe nga këto masa, është zbatuar 1 masë dhe në proces 1 masë.

b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë 14 masa në vlerën 3,179,734 lekë nga të cilat janë pranuar plotësisht 14, nga të pranuarat, janë në proces 13 masa në vlerën 2,936,134 lekë dhe 1 masë në vlerën 243,600 lekë është zbatuar pjesërisht. Janë rekomanduar sipas Kodit të Punës 3 masa disiplinore, prej të cilave janë zbatuar 3 masa disiplinore.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c, ku përcaktohet: *t’u rekomandojë drejtuesve të njësisve të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative.*

Ndikimi/efekti: Zbatimi i plotë i rekomandimeve do të ndikojë në përmirësimin e aktivitetit të Spitalit Rajonal Durrës.

Shkaku: Nisur nga eksperiencia e zbatimit të rekomandimeve nga ky subjekt, konstatohet se rekomandimet nuk janë zbatuar plotësisht.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi: Nga Spitali Rajonal Durrës, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar në proces, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara me shkresën nr. 107/21, datë 04.12.2015, si dhe pas marrjes parasysh të auditimit të zbatimit të rekomandimeve të kryera nga KLSH në vitin 2016, u konstatua se:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Me grup pune të veçantë të studiohen të gjitha nevojat për blerje të vogla si për vitin 2014 dhe për vitin në vazhdim, mbi bazën e kërkesave të të gjitha pavioneve dhe administratës, të hartohet një bilanc duke përcaktuar gjendjen çdo muaj, konsumin mujor dhe ditor, në mënyrë që të hartohet një regjistër i blerjeve të vogla sa më real dhe mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

-SRD, për subjektet që lëshojnë faturat e thjeshta tatimore për shërbimet ose mallrat e ofruara, të marrë konfirmim për formën e tyre juridike në momentin e faturimit dhe të kërkojë shoqërimin e faturave me kuponin tatimor, me qëllim shmangien e efekteve negative fiskale.

Përgjigja e Spitalit Rajonal:

-Nga verifikimi i dokumentacionit për vitin 2015-2018 rekomandimi i mësipërm dhënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është zbatuar.

Rekomandimi është realizuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

2. Zyra Juridike në bashkëpunim me Sektorin e Financës të ndjekin proceset për arkëtimin e shumave të këtyre debitorëve, si dhe të shoqërojnë me informacionet përkatëse për çdo procedurë të kryer lidhur me to.

-Shefi i sektorit të financës me shkresën nr. Extra. Prot, datë 14.11.2016, informon Drejtorin për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e rekomandimeve. Sipas Urdhrit nr. 139, datë 20.01.2016 të titullarit u çelën debitorët për subjektet private në shumën 1,481,818 lekë dhe personeli i SRD në shumën 1,843,609 lekë. Për subjektet janë arkëtuar në shumën 184,804 lekë ndërsa për të gjitha firmat dhe personelin janë çelur kërkesë padi nga juristja pranë gjykatës.

Rekomandimi është në proces.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 1,492,864 lekë**, nga kryetarja e KVO **znj. A.T.**, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

*-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2239, datë 28.12.2015 kërkon zhdëmtimin e dëmit në shumën 1,492,864 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 515, për **I. A. T., 2. A. S. dhe 3. A.D.** Me vendimin nr. 11-2017-1673, datë 07.04.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka rrëzuar kërkesë padinë e SRD-së si të pabazuar në prova dhe ligj. Spitali Rajonal Durrës ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 900, datë 24.04.2017, është në pritje vendimmarrja nga Gjykata. Për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet si në proces.*

Rekomandimi është në proces.

2. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të përlogariten kamat vonesat e subjektit "N." deri në momentin e shlyerjes së tyre, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 152,416 lekë** nga subjekti "N.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

*-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2220, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit në shumën 122,416 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 510, shoqërinë "N." **sh.p.k.** Gjykata e Rrethit Durrës me vendimin nr. 11-2016-5485, datë 30.11.2016, ka rrëzuar pjesërisht kërkesë padinë duke detyruar shoqërinë N. shpk ti paguajë palës paditëse SRD shumën prej 10.000 lekë. Spitali Rajonal Durrës ka bërë ankimimin pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 2517 Prot., datë 14.12.2016. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2017-2799, datë 12.05.2017, ka lënë në fuqi vendimin nr. 1794, datë 30.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 2422 Prot., datë 12.12.2017. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.*

Rekomandimi është në proces.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

3. Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për shpërblimin e dëmit në vlerën prej 176,639 lekë nga **z.N.M., z. H.C. dhe znj. E.M.**

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

*-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2219, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga **Z. H.C., Z. N.M. dhe Znj. E.M.**, në shumën 176,639 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 514. Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Durrës me vendimin nr. 11-2016-5687., datë 09.12.2016 ka bërë rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 2627 Prot., datë 30.12.2016 dhe regjistruar pranë kësaj Gjykate me datë 04.01.2017. Me vendimin nr. 10-2017-2965 datë 18.12.2017 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 2421 Prot., datë 12.12.2017. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.*

Rekomandimi është në proces.

4. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 440,756 lekë** nga subjekti "**K.**", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

*-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2213, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga shoqëria "**K.**" **sh.p.k**, në shumën 440,756 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 511. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 2044 Prot., datë 27.12.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 51 Prot., datë 10.01.2017. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 273/10 Prot., datë 03.04.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1451 Prot., datë 25.05.2018. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.*

Rekomandimi është në proces.

5. Të kërkohet në rrugë (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 34,272 lekë** nga subjekti "**K.**", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

*-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2213, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga shoqëria "**K.**" **sh.p.k**, në shumën 34,272 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 511. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 2044 Prot., datë 27.12.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 51 Prot., datë 10.01.2017. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 273/10 Prot., datë 03.04.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1451 Prot., datë 25.05.2018. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.*

Rekomandimi është në proces.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

6. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 168,402 lekë** nga subjekti "K.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2213, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga shoqëria "K." sh.p.k, në shumën 168,402 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 511. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 2044 Prot., datë 27.12.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 51 Prot., datë 10.01.2017. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 273/10 Prot., datë 03.04.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1451 Prot., datë 25.05.2018. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces.

7. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 66,736 lekë** nga subjekti "K.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2213, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga shoqëria "K." sh.p.k, në shumën 66,736 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 511. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 2044 Prot., datë 27.12.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 51 Prot., datë 10.01.2017. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 273/10 Prot., datë 03.04.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1451 Prot., datë 25.05.2018. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces.

8. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 9,432 lekë**, nga subjekti "K.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2213, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga shoqëria "K." sh.p.k, në shumën 9,432 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 511. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 2044 Prot., datë 27.12.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 51 Prot., datë 10.01.2017. Gjykata e Apelit Durrës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

me vendimin nr. 273/10 Prot., datë 03.04.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1451 Prot., datë 25.05.2018. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces.

9. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 21,011 lekë**, nga subjekti "K.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2213, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga shoqëria "K." sh.p.k, në shumën 21,011 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 511. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 2044 Prot., datë 27.12.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 51 Prot., datë 10.01.2017. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 273/10 Prot., datë 03.04.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1451 Prot., datë 25.05.2018. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces.

10. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 144,900 lekë** nga subjekti "A.B.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2216, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga subjekti "A.B." sh.p.k, në shumën 144,900 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 512. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 11-2017-1477 Prot., datë 30.03.2017 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 774 Prot., datë 11.04.2017. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2018-1864 Prot., datë 13.11.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dërgimin e saj për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Zyra Juridike e Spitalit Rajonal Durrës po përgatit deklaratat e mbrojtjes. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces.

11. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 54,600 lekë** nga subjekti "A.B.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2216, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga subjekti "A.B." sh.p.k, në shumën 54,600 lekë, me likuidim



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 512. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 11-2017-1477 Prot., datë 30.03.2017 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 774 Prot., datë 11.04.2017. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2018-1864 Prot., datë 13.11.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dërgimin e saj për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Zyra Juridike e Spitalit Rajonal Durrës po përgatit deklaratat e mbrojtjes. Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces.

12. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën **243,600 lekë**, nga subjekti "C.", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Përgjigja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2216, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga subjekti "C." sh.p.k, në shumën **243,600 lekë**, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr prot. 513. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me datë 28.06.2016 ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë më vendimin nr. 3796 Prot., datë 02.05.2017 ka vendosur pushimin e çështjes për mosparaqitje të palës paditëse. Është bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë më nr. 1072 Prot., 16.05.2017. Është rihapur për gjykim e njëjta çështje në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me të njëjtën turp gjykues i cili ka dhënë vendimin nr. 3796 Prot., datë 02.05.2017 dhe është dhënë vendimi i dytë për të njëjtën çështje nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me nr. 11650 Prot., 18.12.2017, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të mëparshëm. Gjithashtu edhe në këtë rast arsye e lënies në fuqi të vendimit të mëparshëm është bërë mos prania e juristit të palës paditëse në Gjykatë. Nga ana e zyrës juridike është bërë një informacion mbi arsyet e pushimit të çështjes dhe i është dërguar titullarit me shkresën nr. 2477 Prot., datë 18.12.2017. U konstatua se në të dyja rastet e pushimit të çështjes nga ana e gjykatës është bërë shkak mosprania e juristëve të autorizuar të SRD-së.

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se përfaqësimin e kësaj çështje pranë gjykatës e kishte me autorizim nga titullari z. A.Xh.por juristi i autorizuar nuk është paraqitur në gjykatë. Gjithashtu nga verifikimi i listë prezencës për datën 02.05.2017 u konstatua se z. A.Xh. ka qenë prezent në punë për 8 orë dhe nuk justifikon me asnjë dokumentacion ligjor mos prezencën e tij pranë gjykatës. U konstatua se nga ana e titullarit nuk është marrë asnjë masë kundrejt juristit të autorizuar për përfaqësimin përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë. Për arsyet e lartpërmendura ngarkohet me përgjegjësi juristi z. A.Xh. në bazë të rregullores së funksionimit ekonomiko-financiar të SRD-së, neni 60 pika 2 citohet qartë detyra e specialistit të sektorit Juridik, ku thuhet "Përfaqëson Spitalin Rajonal Durrës në proceset gjyqësore me autorizim të posaçëm të Drejtorit, dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit për çështje të ndryshme ku institucioni është palë apo inicion vetë një proces gjyqësor." Të merren menjëherë masa disiplinore për rastin në fjalë dhe të ngrihet një grup pune ku të evidentohen të gjitha rastet ku SRD ka humbur gjyqet për arsye të kësaj natyre në të cilat nuk janë mbrojtur interesat e Spitalit Rajonal Durrës.

Rekomandimi është zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

13. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 86,707 lekë**, nga ish drejtori i SRD, z. **T.B.** duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2219, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga ish Drejtori z. T.B., në shumën 86,707 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 509. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 1059 Prot., datë 04.07.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 1468 Prot., datë 15.07.2016. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2017-1931 Prot., datë 09.12.2017, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1665 Prot., datë 22.08.2017.

Rekomandimi është në proces.

14. Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 87,399 lekë**, nga ish drejtori i SRD z. **T.B.** duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e Spitalit Rajonal Durrës:

-Rekomandimi është pranuar. Titullari me Urdhrin me nr. Prot. 2219, datë 21.12.2016 kërkon zhdëmtimin e dëmit nga ish Drejtori z. T.B., në shumën 87,399 lekë, me likuidim vullnetar brenda datës 31.01.2016. Me datë 25.02.2016 titullari bën kërkesë-padi me nr. Prot. 509. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 1059 Prot., datë 04.07.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe ligj. SRD ka bërë ankimim pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. 1468 Prot., datë 15.07.2016. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2017-1931 Prot., datë 09.12.2017, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. SRD ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë me nr. 1665 Prot., datë 22.08.2017.

Rekomandimi është në proces.

-Masat shpërblim dëmi përfshirë të gjitha subjektet për të cilat është bërë kërkesë padi në gjykatë për zhdëmtim, detyrimi total është 3,179,734 lekë.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe nenit 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995” Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës, fillimin e procedurave e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga detyra” për punonjësit si më poshtë:

1. Znj. N. P.

Përgjigjja e SR Durrës:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Me Urdhrin nr. 1716 Prot., datë 16.09.2015 është vendosur për znj. N.P., “Largim nga puna”. Për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i ezauruar. **Rekomandimi është realizuar.**

2. Z. E.K.

Përgjigjja e SR Durrës:

-Me Urdhrin nr. 473 Prot., datë 03.03.2015 është vendosur për z. E.K. që ti ndërpriten marrëdhëniet e punës me datë 24.03.2015. Për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i ezauruar. **Rekomandimi është realizuar.**

3. Z. H.C.

Përgjigjja e SR Durrës:

-Me Urdhrin nr. 1470 Prot., datë 13.11.2014 është vendosur zëvendësimi i z. H.Ç. për arsye të daljes në pension dhe zëvendësimin me znj. M.Z. Për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i ezauruar. **Rekomandimi është realizuar.**

Tabela përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve:

Rekomandime	Rekomanduar	Gjendja e zbatimit të rekomandimit			
		Realizuar	Nuk janë realizuar	Në proces	Realizuar pjesërisht
Propozim ndryshim legjislacioni	0	0	0	0	0
Masa Organizative	2	1	0	1	0
Masa Shpërblim Dëmi	14	0	0	14	0
Masa Disiplinore	3	3	0	0	0
Shuma:	19	3	1	15	0



III.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre

1. Titulli i gjetjes: -Nuk ka një akt rregullator për funksionimin e Bordit të SRD, kontratë midis titullarit dhe Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës dhe vendimmarrje e paqartë për shkak të mos pasqyrimit të diskutimit të anëtarëve të Bordit të SRD për vendimet qarkulluese.

Situata: -Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se Bordi i Spitalit Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar pa rregullore në kundërshtim me nenin 12, pika (m) të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr. 237, datë 12.04.2006.

-Për vitin 2015 Bordi i Spitalit në vendimet e tij nuk pasqyron votat e bordit, konkretisht në çdo vendim bordi pasqyrohet firma e Kryetarit të Bordit, por nuk ka gjurmë vendimmarrje të gjithë anëtarëve të Bordit, në kundërshtim me nenin 9 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr. 237, datë 12.04.2006.

-Për periudhën objekt auditimi, nuk konstatohet të ketë një kontratë midis titullarit dhe Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës ku të përcaktohen objektivat specifike dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të SRD në kundërshtim me nenin 13 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, i cili përcaktohet në VKM nr. 237, datë 12.04.2006.

Ndikimi/efekti: Mos pasqyrim i diskutimeve të anëtarëve të Bordit të SRD mbi vendimet e marra sipas çështjeve në shqyrtim.

Kriteri: neni 9, neni 12, neni 13, të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr.237, datë 12.04.2006.

Shkaku: Mungesa e një akti rregullator për funksionimin e Bordit të SRD dhe e kontratës midis titullarit dhe Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës ku të përcaktohen objektivat specifike dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të SRD

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bordi i Spitalit të marrë masa për hartimin e një kontrate me titullarin e SRD, ku të përcaktohen objektivat specifike me detyrat dhe përgjegjësitë midis Bordit Drejtues dhe titullarit të SRD.

-Bordi i Spitalit të marrë masat për hartimin e një rregullore mbi funksionimin e Bordit të Spitalit Rajonal Durrës ku të përcaktohen qartë detyrat, modalitetet e mbledhjeve dhe qartësia e diskutimeve mbi vendimmarrjen e këtij organi kolegjal, në përputhje me statutin e SRD.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Spitali Rajonal Durrës organizohet dhe funksionon në bazë të Statutit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor” të ndryshuar me VKM nr.237, date 12.04.2006 dhe VKM nr.76, datë 19.01.2007. Organet drejtuese, konsultative dhe komisionet e spitalit janë: Organet drejtuese: Bordi Drejtues dhe Drejtoria; Organet konsultative: Komisioni Mjekësor i Spitalit dhe Këshilli Tekniko – Administrativ, Komisionet e spitalit: Komisioni i Kontrollit të Infeksionit Spitalor, Komisioni i disiplinës për personelin mjek dhe farmacistë.,Komisioni i disiplinës për personelin e mesëm dhe sanitarët dhe Komisioni i disiplinës për personelin e administratës, prapavijës.

Bordi i Spitalit është organi më i lartë ekzekutiv, i cili siguron zbatimin e politikave shëndetësore dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë. Mbledhjet e Bordit janë të hapura. Bordi mund të thërrasë në mbledhjet e tij të gjithë drejtuesit e spitalit dhe/ose specialistë, ekspertë të tjerë jashtë spitalit, për çështje të ndryshme.Spitali Rajonal Durrës, e zhvillon



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

veprimtarine e tij mbi bazen e Statutit te miratuar me VKM Nr.560 date 23.10.2000, i ndryshuar me VKM Nr.237 date 12.04.2006 dhe VKM Nr. 76 date 19.01.2007. Bazuar Statutit, organi me i larte vendimmarres i Spitalit Rajonal Durres eshte Bordi Drejtues, i cili perbehet nga 9 anetare (neni 4):

- 1 përfaqësues te Ministrise se Shëndetësisë;
- 1 përfaqësues i DSHP-se Durrës;
- 1 përfaqësues i prefekturës;
- 1 përfaqësues i shoqatës së biznesmenëve Durrës;
- 2 përfaqësues të ISKSH-së;
- 1 përfaqësues i Urdhrit të Mjekut;
- 1 përfaqësues i shoqatës së pacienteve;
- 1 përfaqësues nga sindikata më e përfaqësuar për shëndetësinë në Durrës;

Anëtarët e Bordit Drejtues te Spitalit Rajonal Durres për periudhën 2015-2018 janë:

- Znj.M.Xh. – Drejtor i Pergjithshem i Politikave te Zhvillimit te Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, caktuar me shkresen me nr.6636 prot, date 19.11.2018 te Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale Tirane, rregjistruar me 2835 prot, date 22.11.2018;
- Dr. K. H. – Drejtor i Drejtorise Rajonale te Shendetesise Durres, caktuar me shkresen nr. 110 prot, date 09.01.2014 te Ministrise se Shendetesise Tirane, rregjistruar me nr. 5 prot, date 07.01.2014;
- Znj. L.B. – Drejtor i Drejtorise Rajonale te Shendetesise Durres, caktuar me shkresen nr. 3194 prot, date 28.06.2013 te Ministrise se Shendetesise Tirane, rregjistruar me nr. 649 prot, date 02.07.2013;
- Znj. J. M. – caktuar me shkresen nr. 891/1 prot, date 04.12.2013 te Prefektit te Qarkut Durres, rregjistruar me e nr. 1110 prot, date 27.12.2013;
- Z. B.H.– Përfaqësues i Dhomes së Tregtise, caktuar me shkresen nr. 9 prot, date 24.02.2012 te Dhomes se Tregtise dhe Industrise Durres;
- Znj. A.A. – Zv.Drejtor i Pergjithshem i FSDKSH, caktuar me shkresen me nr.5528/3 prot, date 06.12.2018 te Drejtorise se Sherbimeve Mbeshtetese te FSDKSH Tirane, rregjistruar me 2835/1 prot, date 11.12.2018; (zevendesuar Ildir Themeli-n)
- Z. I.Th. – Drejtor Ekonomik i FSDKSH, caktuar me shkresen nr. 3164/1 prot, date 28.06.2018 te Drejtorise se Pergjithshme te FSDKSH Tirane, rregjistruar me 1680/1 prot, date 29.06.2018;
- Znj. N.P. – Drejtor i Drejtorise Rajonale te FSDKSH Durres, caktuar me shkresen 3209 prot, date 28.06.2016 te Kabinetit te FSDKSH Tirane, komunikuar SRD-se me shkresen me nr. 3562/1 prot, date 04.07.2016 te Drejtorise se Administrimit SPitalor te Ministrise se Shendetesise, rregjistruar me datë 07.07.2016;
- Znj. L.Gj. – Drejtor i Drejtorise Ekonomike ne FSDKSH, caktuar me shkresen nr. 1426 prot date 23.03.2016 te Kabinetit te FSDKSH Tirane, komunikuar SRD-se me shkresen me nr.3562/1 prot, date 04.07.2016 te Drejtorise se Administrimit Spitalor te Ministrise se Shendetesise, regjistruar me date 07.07.2016;
- Z. A.D.– Drejtor i Drejtorise Rajonale te FSDKSH Durres, caktuar me shkresen nr. 153/1 prot, date 13.01.2014 te Drejtorise se Administrimit SPitalor te Ministrise se Shendetesise, rregjistruar me nr. 45 prot, date 14.01.2014;
- Z. A.V. – Drejtor i Drejtorise se Kujdesit Paresor te FSDKSH Tirane, caktuar me shkresen nr. 153/1 prot, date 13.01.2014 të Drejtorisë se Administrimit Spitalor të Ministrise se Shendetesise, regjistruar me nr. 45 prot, date 14.01.2014;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

- Z.S.M.– Preident i Keshillit te UM, caktuar me shkresen nr. --- prot, datë 14.12.2009 te Këshillit Rajonal të Urdherit të Mjekut Durrës;
- Znj.E.H. –Presidente e Urdhrit të Mjekut, caktuar me shkresën nr.37, date 24.07.2015 regjistruar me shkresën nr.1342, date 29.07.2015;
- Z. P.K.– Nenkryetar i Shoqates se Pacienteve, caktuar me shkresen nr. 1/4 prot, date 12.12.2009 te Ministrise se Shendetësisë Tiranë;
- Dr. I.A. – Kryetar i Keshillit Sindikal të Spitalit Durrës, caktuar me shkresën nr. 11 prot, datë 10.01.2014 të Federatës së Sindikatave te Shëndetësisë së Shqiperisë, rregjistruar me tonën me nr. 59 prot, datë 20.01.2014;
- P.M. –Përfaqësues i Ministrisë se Shendetesise, regjistruar me shkresën nr.3194, date 28.06.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë, regjistruar me shkresën nr.649, date 02.07.2013;
- A.N.- Përfaqësues i sindikatës së punëmarrësve (nuk ka gjurmë shkresore në SRD, për caktimin e këtij anëtari).

Gjatë vitit 2015 janë mbajtur 4 mbledhje te Bordit Drejtues dhe janë marrë gjithsej 33 vendime.

Gjatë vitit 2016 janë mbajtur 4 mbledhje të Bordit Drejtues dhe janë marrë gjithsej 22 vendime dhe 8 vendime qarkulluese.

Gjatë vitit 2017 është mbajtur 1 mbledhje e Bordit Drejtues dhe janë marrë 13 vendime dhe 8 vendime qarkulluese.

Gjate vitit 2018 janë mbajtur 4 mbledhje te Bordit Drejtues dhe janë marrë gjithsej 40 vendime dhe 8 vendime qarkulluese.

Mangësi dhe shkelje e akteve ligjore dhe nënligjore:

-Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se Bordi i Spitalit Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar pa rregullore në kundërshtim me nenin 12, pika (m) të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr.237, datë 12.04.2006;

-Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, për vitin 2015 Bordi i Spitalit në vendimet e tij nuk pasqyron votat e bordit, konkretisht në çdo vendim bordi pasqyrohet firma e Kryetarit të Bordit, por nuk ka gjurmë vendimmarrje të gjithë anëtarëve të Bordit, në kundërshtim me nenin 9 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr.237, datë 12.04.2006;

-Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, për periudhën objekt auditimi 2015-2018, nuk konstatohet të ketë një kontratë midis titullarit dhe Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës ku të përcaktohen objektivat specifike dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të SRD në kundërshtim me nenin 13 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, i cili përcaktohet në VKM nr.237, datë 12.04.2006.

Urdhrat e nxjerra nga Titullarët e Spitalit Rajonal Durrës, për periudhën objekt auditimi

Për vitin 2015

Për vitin 2015, është konstatuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, titullari i Spitalit Rajonal Durrës për rregullimin e veprimtarisë funksionale të SRD ka nxjerrë rreth **80 urdhra**, që konsistojnë në punësime, procedura prokurimi, mbarëvajtje ose organizim i punës në pavionet e spitalit, zbatimi i rekomandimeve nga FSDKSH, ISHP dhe KLSH etj.

Për vitin 2016



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Për vitin 2016, është konstatuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, titullari i Spitalit Rajonal Durrës për rregullimin e veprimtarisë funksionale të SRD ka nxjerrë rreth **27 urdhra**, që konsistojnë në punësime, procedura prokurimi, mbarëvajtje ose organizim i punës në pavionet e spitalit, zbatimi i rekomandimeve nga FSDKSH, ISHP dhe KLSH etj.

Për vitin 2017

Për vitin 2017, është konstatuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, titullari i Spitalit Rajonal Durrës për rregullimin e veprimtarisë funksionale të SRD ka nxjerrë rreth **46 urdhra**, që konsistojnë në punësime, procedura prokurimi, mbarëvajtje ose organizim i punës në pavionet e spitalit, zbatimi i rekomandimeve nga FSDKSH, ISHP dhe KLSH etj.

Për vitin 2018

Për vitin 2018, është konstatuar se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, titullari i Spitalit Rajonal Durrës për rregullimin e veprimtarisë funksionale të SRD ka nxjerrë rreth **55 urdhra**, që konsistojnë në punësime, procedura prokurimi, mbarëvajtje ose organizim i punës në pavionet e spitalit, ngritje grupe pune për monitorimin e zbatimit të kontratave të qerasë, zbatimi i rekomandimeve nga FSDKSH, ISHP dhe KLSH etj.

Përsa më sipër u mbajt Akt konstatimi me nr. 5, datë 29.03.2019 protokolluar në SRD me nr. 639, datë 29.03.2019.



III.3. Mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative

III.3.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative

1. Titulli i gjetjes: Lidhje kontrate pa procedurë prokurimi

Situata: Nga auditimi i praktikave me bankë u konstatuan dy raste të përfitimit të shërbimeve nga operatorë ekonomik privat, të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 4 “Fusha e zbatimit”, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Saktësisht:

a) Ish Drejtori i SRD ka nënshkruar një Aktmarrëveshje në datën 24.01.2014 me “Datech” SHPK për shtimin e afatit me 1 vit të kontratës fillestare me nr. 88/1 prot, datë 24.01.2013 me objekt “Për shërbimin e mirëmbajtjes, asistencës dhe upgrade të sistemit software financiar (AF2000) për periudhën 3 mujore 25 tetor 2014 – 24 janar 2015”. Vlera **456,000 lekë** përbën përdorim **pa ekonomicitet** të fondeve, për arsye se ky shërbim duhet të ishte realizuar nëpërmjet një procedure prokurimi.

b) Spitali Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi ka përfituar shërbim ndaj A. për përdorimin e telefonave fiks. Në total SRD ka paguar për këtë shërbim vlerën 2,477,920 lekë në favor të OE A. Për këtë nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Pagesa për këtë shërbim kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik. Vlera totale **2,477,920 përbën përdorim pa ekonomicitet, efikasitet dhe eficiencë** të fondeve nga SRD.

Kriteri: Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Përdorim pa ekonomicitet në vlerën 456,000 lekë.

Shkaku: Lidhje kontrate pa zhvilluar procedurë prokurimi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtori i Spitalit, të marrë masa për evidentimin e të gjitha rasteve të cilat janë objekt i ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi. Sipas rastit, kur është e mundur të marrë masa për ndalimin e marrjes së shërbimit duke iu nënshtruar procedurës së prokurimit.

2. Titulli i gjetjes: Mungesa në dokumentacionin e plotë vërtetues.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave me bankë për muajt mars, gusht dhe dhjetor, të viteve 2015 – 2018, u konstatuan 3 raste të cilat nuk disponojnë dokumentacionin e plotë justifikues, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *Më hollësisht si më poshtë vijon:*

-Për vitet 2016-2017 janë kryer tërheqje të shpeshta për pagesa ndaj dhuruesve të gjakut, si dhe tërheqje për mbulimin e shpenzimeve të transportit të të sëmurëve me dializë, por bashkëlidhur mandatat nuk është dokumentacioni i nevojshëm justifikues.

-Në praktikën e likuidimit të pagesave ndaj OE për kontratën me objekt: “Blerje oksigjeni gas për SRD”, u konstatua se mungon kërkesa e Autoritetit Kontraktor për lëvrimin e mallit, duke mos dhënë siguri mbi zbatimin me korrektësi të kontratës nga operatori ekonomik, në kundërshtim me nenin 18.3 të kontratës të furnizimit ku citohet se lëvrimi do të bëhet me kërkesë të AK.

-Në datën 06.03.2017, është akorduar pagesë në vlerën bruto 57,860 lekë për punonjësen S.K. Nga të cilat vlera neto 50,338 lekë dhe tatim në burim 7,522 lekë. Për këtë shpërblim nuk konstatohet të jenë mbajtur sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu për këtë pagesë nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kriteri: Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Mangësi në gjurmën e auditimit.

Shkaku: Mungesa e dokumentacionit të plotë justifikues.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masa që në të ardhmen praktikat e likuidimeve të plotësohen me dokumentacionin e plotë justifikues me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme në kryerjen me korrektësi të transaksioneve.

3. Titulli i gjetjes: Kamatëvonesa me pasojë efekt financiar negativ.

Situata: Spitali Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi është penalizuar me kamatë për pagesën me vonesë të faturës së Ujësjellës Kanalizimeve në vlerën 533,484 lekë. Për këto kamatëvonesa nuk ka asnjë relacion shpjegues për arsyen e pagesës me vonesë që kanë detyruar institucionin të paguajë kamat vonesa në favor të UKD. Vlera **533,484 lekë përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e SRD.

Kriteri: Afati i pagesave të faturave të ujësjellës kanalizimeve

Ndikimi/efekti: Efekt financiar negativ në vlerën 533,484 lekë.

Shkaku: Pagesa me vonesë të faturave të ujit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës në vijimësi të marrë masa për pagesën e faturave të ujit brenda datës 25 të çdo muaji me qëllim shmangien e akumulimit të kamatëvonesave e si rrjedhim shtimin e detyrimeve të Spitalit Rajonal Durrës.

4. Titulli i gjetjes: Në 4 raste, konstatohet se Nëpunësi zbatues është njëkohësisht pjesë e KVO, njësi prokurimi apo komision për përcaktimin e fondit limit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Përgjegjësja e Financës, njëkohësisht nëpunëse zbatuese në Spitalin Rajonal Durrës, gjatë periudhës objekt auditimi ka qenë pjesë e komisioneve të vlerësimit të ofertave, njësi prokurimi apo komision për përcaktimin e fondit limit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti:

Shkaku: Vendosja e nëpunësit zbatues/përgjegjësës së financës në grupet e punës të përcaktuara më sipër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Titullari i Spitalit Rajonal Durrës në vijimësi të mos vendosë nëpunësin zbatues/përgjegjësën e financës në komisione të vlerësimit të ofertave, njësi prokurimi, komisione të përcaktimit të fondit limit si dhe në çdo grup pune i cili më pas është objekt i verifikimit nga vetë përgjegjësi i financës. Ky veprim do të shërbejë për uljen e riskut e mungesës së kontrollit mbi transaksionet e Spitalit Rajonal Durrës, si dhe për dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi kontrollin vertikal.

5. Titulli i gjetjes: Penalitet i pa mbajtur

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje aksesorë dhe riparim aparaturash mjekësore në lote për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratës nr. 1502/18 prot, datë 13.11.2017, lidhur me OE B.A.SHPK konstatohet se, shërbimi është realizuar me 7 ditë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

me vonesë, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej 132,492 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit.

Për mos evidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mban përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim.

Kriteri: Kontrata e lidhur ndërmjet palëve, DST.

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik në vlerën **132,492** lekë.

Shkaku: Vonesa në realizimin e kontratës

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **132,492 lekë** nga operatori ekonomik “B.A. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

6. Titulli i gjetjes: Penalitet i pa mbajtur

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje aksesorë dhe riparim aparaturash mjekësore në lote për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratës nr. 1502/13 prot, datë 09.11.2017, lidhur me OE F. SHPK, konstatohet se, dorëzimi i mallrave është realizuar me 27 ditë, 20 ditë dhe 13 ditë me vonesë në varësi të dorëzimeve, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej 243,368 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit nga SRD.

Për mos evidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mban përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim.

Kriteri: Kontrata e lidhur ndërmjet palëve, DST.

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik në vlerën **243,368** lekë.

Shkaku: Vonesa në realizimin e kontratës

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **243,368 lekë** nga operatori ekonomik “F. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

7. Titulli i gjetjes: Penalitet i pa mbajtur

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje medikamente mjekësore për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratës nr. 989/2 prot, kontratës nr. 992/2 prot, dhe kontratës nr. 787/3 prot, datë 08.05.2017, lidhur me OE E. SHPK, konstatohet se, dorëzimi i mallrave është realizuar me vonesë, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej 117,465 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit nga SRD. Për këtë mbanë përgjegjësi A.M. në cilësinë e shefes së farmacisë.

Kriteri: Kontrata e lidhur ndërmjet palëve, DST.

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik në vlerën **117,465** lekë.

Shkaku: Vonesa në realizimin e kontratës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **117,465 lekë** nga operatori ekonomik “E. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

8. Titulli i gjetjes: Penalitet i pa mbajtur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje medikamente mjekësore për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratës nr. 991/4 prot, dhe kontratës nr. 815/3 prot, datë 09.05.2017, lidhur me OE A. SHPK, konstatohet se, dorëzimi i mallrave është realizuar me vonesë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 48,079 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit nga SRD. Për këtë mbanë përgjegjësi A.M. në cilësinë e shefes së farmacisë.

Kriteri: Kontrata e lidhur ndërmjet palëve, DST.

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik në vlerën **48,079** lekë.

Shkaku: Vonesa në realizimin e kontratës

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **48,079 lekë** nga operatori ekonomik “A. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua si më poshtë vijon:

2015

Me vendim nr. 03 me nr. 218 prot, datë 29.01.2015 të Bordit Drejtues është miratuar zëri “Shpenzime operative” për vitin 2015 në vlerën 271,800,000 lekë.

Me vendim nr. 10 me nr. 1596 prot, datë 04.09.2015 të Bordit Drejtues është miratuar rialokimi i fondeve në zërin 602.

Me shkresën nr. 04 prot, datë 05.01.2016 të ish Drejtorit të SRD i është dërguar Fondit të Sigurimeve të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor realizimi i buxhetit për vitin 2015.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur:

Në lekë

Nr.	Buxheti	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600	410,000,000	0	404,699,559	99
601	68,200,000		67,390,314	99
602	296,226,885	308,226,885	280,820,526	95
	774,426,885		752,910,400	97

Burimi: SRD

Të ardhura dytësore 2015

Në lekë

Nr.	Të ardhura dytësore	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600	0	0	0	
601	0		0	
602	47,275,574		40,091,148	84.80
	47,275,574		40,091,148	84.80

Burimi: SRD

Nga sa më sipër kontatohet se niveli i realizimit të buxhetit nga ana e Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2015 është në një nivel mjaft të lartë. Saktësisht për klasat 600 dhe 601 ka një realizim prej 99%, për klasën 602 ka një realizim prej 95%, diferencë e cila ka ardhur si pasojë e përfitimit nga marrja e ofertave më të ulëta në krahasim me fondin limit në procedurat e prokurimit. Nuk paraqitet e njëjta situatë në lidhje me të ardhurat dytësore, e cila ka një realizim prej 84.8% kundrejt parashikimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

2016

Bordi Drejtues ka miratuar me Vendim nr. 02/1 me nr 177/1 prot, datë 27.01.2016, ka miratuar zërin “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore” me vlera përkatësisht për Sigurime Shoqërore 63,000,000 lekë dhe Sigurime Shëndetësore 7,000,000 lekë.

Me Vendimin nr. Vendim nr. 02 me nr 177 prot, datë 27.01.2016, ka miratuar zërin “Paga e Shtesa” saktësisht: Paga personel i përhershëm 418,000,000 lekë, Paga personel i përkohshëm 700,000 lekë dhe shpërblime 1,300,000 lekë.

Me Vendimin nr. Vendim nr. 02/2 me nr 177/2 prot, datë 27.01.2016, ka miratuar zërin 602 “Shpenzime operative” në vlerën 280,000,000 lekë.

Gjatë vitit ka patur rialokime të fondeve brenda zërit 602, pa e tejkaluar vlerën e miratuar për këtë zë. Pakësimet kanë ardhur si pasojë e kursimit të fondeve nga procedurat e prokurimit, ndërsa shpenzimet janë justifikuar si të paparashikuara.

Me shkresën nr. 45 prot, datë 09.01.2017 të ish Drejtorit të SRD i është dërguar Fondit të Sigurimeve të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor realizimi i buxhetit për vitin 2016.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur:

Në lekë

Nr.	Buxheti	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600	420,000,000		403,776,764	96
601	70,000,000		67,628,291	97
602	353,089,724		272,846,878	77
	843,089,724		744,251,933	88

Burimi: SRD

Të ardhura dytësore 2016

Në lekë

Nr.	Të ardhura dytësore	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600				
601				
602	40,460,000		36,004,079	88.99
	40,460,000		36,004,079	88.99

Burimi: SRD

Nga sa më sipër kontatohet se niveli i realizimit të buxhetit nga ana e Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2016 është në një nivel mjaft të lartë për klasat 600 dhe 601, ose e shprehur në përqindje respektivisht 96% dhe 97%, diferencë e cila ka ardhur si pasojë e përfitimit nga marrja e ofertave më të ulëta në krahasim me fondin limit në procedurat e prokurimit. Nuk paraqitet e njëjta situatë në lidhje me të ardhurat dytësore, e cila ka një realizim prej 88.9% kundrejt parashikimit.

2017

Bordi Drejtues ka miratuar me Vendim nr. 01 me nr 454 prot, datë 27.02.2017, me objekt miratimin e buxhetit për vitin 2018” ka miratuar zërin 602 “Shpenzime operative” në vlerën 298,000,000 lekë.

Me Vendimin nr. Vendim nr. 02 me nr 455 prot, datë 27.02.2017, ka miratuar zërin “Paga e Shtesa” saktësisht: Paga personel i përhershëm 421,300,000 lekë, Paga personel i përkohshëm 6.700.000 lekë dhe shpërblime 2,000,000 lekë.

Me Vendimin nr. Vendim nr. 03 me nr 456 prot, datë 27.02.2017 ka miratuar zërin “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore” me vlera përkatësisht për Sigurime Shoqërore dhe Sigurime Shëndetësore 72,000,000 lekë.

Gjatë vitit 2017 ka patur teprica te cilat jane fatura te palikujduara si edhe te mbartura si efekt i teprices nga realizimi ne 3-mujorin e fundit te vitit te disa procedurave si tenderi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

lavanderisë, tenderi i shërbimit të rojeve gjithashtu filluar shërbimi me vonese i tenderit të mirmbajtjes së aparaturave, vonesa për miratimin e buxhetit përben problem në mosrealizimin e procedurave për plotësimin e nevojave me medikamente deri në mes të muajit prill.

Faturat nuk janë likuuar pasi u paraqitën në llogari më datën 31.12.2017.

Me shkresën nr. 130 prot, datë 15.01.2018 të ish Drejtorit të SRD i është dërguar Fondit të Sigurimeve të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor realizimi i buxhetit për vitin 2019.

Në lekë

Nr.	Buxheti	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600	430,000,000		416,066,640	96.76
601	72,000,000		66,881,106	92.89
602	397,239,631		312,568,477	78.69
	899,239,631		795,516,223	88.47

Burimi: SRD

Të ardhura dytësore 2017

Në lekë

Nr.	Të ardhura dytësore	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600	2,500,000		1,742,490	70
601				
602	64,093,589		43,882,492	68
231	3,500,000		3,075,666	88
	70,093,589		45,624,982	65

Burimi: SRD

Nga sa më sipër kontatohet se niveli i realizimit të buxhetit nga ana e Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2017 është në një nivel mjaft të lartë për klasat 600 dhe 601, ose e shprehur në përqindje respektivisht 96.76% dhe 92.89%, diferencë e cila ka ardhur si pasojë e përfitimit nga marrja e ofertave më të ulëta në krahasim me fondin limit në procedurat e prokurimit. Nuk paraqitet e njëjta situatë në lidhje me të ardhurat dytësore, e cila ka një realizim prej 65% kundrejt parashikimit, si dhe klasa 602 e cila ka një realizim prej 78.69%.

2018

Bordi Drejtues ka miratuar me Vendim nr. 01 me nr 774/1 prot, datë 19.03.2018, me objekt miratimin e buxhetit për vitin 2018” ka miratuar zërin “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore” me vlera përkatësisht për Sigurime Shoqërore dhe Sigurime Shëndetësore 79,000,000 lekë.

Me Vendimin nr. Vendim nr. 01 me nr 774/1 prot, datë 19.03.2018, ka miratuar zërin “Paga e Shtesa” saktësisht: Paga personel i përhershëm 474,700,000 lekë, Paga personel i përkohshëm 4300.000 lekë dhe shpërblime 2,000,000 lekë.

Me Vendimin nr. Vendim nr. 01/2 me nr 774/1 prot, datë 19.03.2018, ka miratuar zërin 602 “Shpenzime operative” në vlerën 298,000,000 lekë.

Gjatë vitit ka patur rialokime të fondeve nga zëri 600 dhe 601 tek 602, pa e tejkaluar vlerën e miratuar për këtë zë. Pakësimet kanë ardhur si pasojë e kursimit të fondeve nga procedurat e prokurimit, ndërsa shpenzimet janë justifikuar si të paparashikuara.

Me shkresën nr. 2449 prot, datë 28.09.2018 informacion mbi nevojat për mbulimin e medikamenteve drjetruar titullarit të SRD e cila u miratuar nga Bordi Drejtues me nr. 2450 prot, datë 28/09/2018. Titullari i SRD me shkresën nr.2456 datë 01/10/2018 bëri kërkesë për rialokim fondesh nga buxheti i vitit 2018 dërguar Fondit të Sigurimeve të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor. Miratimi erdhi me nr.4560/1 prot, datë 17/10/2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Në lekë

Nr.	Buxheti	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600	481,000,000	469,000,000	468,021,458	100
601	79,000,000	78,500,000	75,520,483	96
602	298,000,000	344,401,406	331,535,009	96
	858,000,000	891,901,406	875,076,950	98

Burimi: SRD

Të ardhura dytësore

Nr.	Te ardhura dytesore	Ndryshime/Rialokime	Realizime	%
600	3,100,000	0	2,041,956	66
601	0		0	
602	67,868,607		60,064,912	88.50
231	15,500,000		1,309,000	8.45
	86,468,607		63,415,868	73.34

Burimi: SRD

Nga sa më sipër kontatohet se niveli i realizimit të buxhetit nga ana e Spitalit Rajonal Durrës për vitin 2018 është në një nivel mjaft të lartë për klasat 600, 601 dhe 602, ose e shprehur në përqindje respektivisht 100% dhe 96%, diferencë e cila ka ardhur si pasojë e përfitimit nga marrja e ofertave më të ulëta në krahasim me fondin limit në procedurat e prokurimit. Nuk paraqitet e njëjta situatë në lidhje me të ardhurat dytësore, e cila ka një realizim prej 73.34% kundrejt parashikimit.

Nga auditimi i veprimeve me bankë u kosntatua:

1. SRD ka lidhur kontratë të drejtëpërdrejtë me operatorin ekonomik “D.” shpk, veprim në kundërshtim me Nenin 4 “Fusha e zbatimit” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Më hollësisht:

Me kërkesën për likuidim datë 05.03.2015 të ish-shefit të sektorit të financës A. S., miratuar nga zv/Drejtori Ekonomik A.P., miratohet likuidimi i pagesës së faturës tatimore nr. 03, datë 30.01.2015 të operatorit ekonomik “D.” shpk, me vlerë 114,000 lekë me TVSH “Për shërbimin e mirëmbajtjes, asistencës dhe upgrade të sistemit softëare financiar (AF2000) për periudhën 3 mujore 25 tetor 2014 – 24 janar 2015”. Si dokumentacion justifikues i pagesës është “Aktmarrëveshja” me nr. 11 prot, datë 24.01.2014 ndërmjet ish Drejtorit të SRD dhe përfaqësuesit të OE “D.” shpk, ku citohet shtimi i afatit me 1 vit të kontratës fillestare me nr. 88/1 prot, datë 24.01.2013. Ish Drejtori i SRD A.F., ka kërkuar ripërsëritjen e kontratës me urdhrin nr. 46 datë 14.01.2014. Ky urdhër, si dhe zbatimi i tij është në kundërshtim me Nenin 4 “Fusha e zbatimit” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ky shërbim duhet të ishte realizuar nëpërmjet një procedure prokurimi. **Vlera 456,000 lekë përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve.**

2. Spitali Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi ka përfituar shërbim ndaj A. për përdorimin e telefonave fiks. Në total SRD ka paguar për këtë shërbim vlerën 2,477,920 lekë në favor të OE A. Nga auditimi u konstatua se, për këtë shërbim nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi, për më tepër nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Pagesa për këtë shërbim kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik. Vlera totale **2,477,920 përbën përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efience të fondeve nga SRD.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

3. Nga auditimi i veprimeve me bankë për vitin 2016-2017 u konstatua se janë kryer tërheqje të shpeshta për pagesa ndaj dhuruesve të gjakut, si dhe tërheqje për mbulimin e shpenzimeve të transportit të të sëmurëve me dializë, por bashkëlidhur mandatit nuk është dokumentacioni i nevojshëm justifikues, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

4. Nga auditimi i praktikave të likuidimit të pagesave ndaj OE për kontratën me objekt: “Blerje oksigjeni gas për SRD”, u konstatua se mungon kërkesa e Autoritetit Kontraktor për lëvrimin e mallit, duke mos dhënë siguri mbi zbatimin me korrektësi të kontratës nga operatori ekonomik, në kundërshtim me nenin 18.3 të kontratës të furnizimit ku citohet se lëvrimi do të bëhet me kërkesë të AK.

5. -Nga auditimi i likuidimit të pagave të punonjësve për muajin shkurt 2017, u konstatua se nuk janë mbajtur sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pagesave shtesë për rojet e punonjësve të qëndrave shëndetësore që kryhen brenda shërbimit të pediatriisë, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar.

Në këtë rast janë paguar 11 punonjës në vlerën 30,934 lekë neto, ose 36,392 lekë bruto. Tatimi në burim 5,458 lekë.

(Më tej kjo problematikë është detajuar tek auditimi i pagave dhe shpërblimeve)

-Në datën 06.03.2017, me kërkesën për likuidim të kryer nga ish-shefja e sektorit të financës, bazuar në urdhrin nr. 2606/1 prot, datë 23.02.2017 të Titullarit të SRD, është akorduar pagesa për punonjësën S.K., në vlerën neto 50,338 lekë. Paga bruto 57,860 lekë dhe tatim në burim 7,522 lekë. Konstatohet se për këtë pagesë nuk janë mbajtur sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar.

Për këtë pagesë nuk janë konstatuar dokumenta justifikues bashkëlidhur.

Në lidhje me observacionin e ardhur me nr. 1247 prot, datë 26.06.2019 (SRD), protokolluar me nr. 1419/5 prot datë 01.07.2019 (KLSH), sqarojmë se:

Në observacion listohen dokumentat të cilat janë bashkëlidhur urdhër pagesës. Sqarojmë se referuar Udhëzimit 30, dokumentacioni bashkëlidhur nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar plotësisht transkaksionin e kryer. Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

6. Spitali Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi është penalizuar me kamatë për pagesën me vonesë të faturës së Ujësjellës Kanalizimeve në vlerën 533,484 lekë. Për këto kamatvonesa nuk ka asnjë relacion shpjegues për arsyen e pagesës me vonesë që kanë detyruar institucionin të paguajë kamat vonesa në favor të UKD. **Vlera 533,484 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e SRD.**

7. Me shkresën nr. 2554 prot, datë 26.12.2017 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës për këtë periudhë, është kërkuar miratimi i shpenzimeve nga të ardhurat dytësore për pagesën e detyrimit principal të TVSH për vitet 2011-2014, në vlerën 5,648,971 lekë. Konstatohet se për këtë detyrim është akumuluar gjatë viteve gjobë dhe interes në vlerën 2,572,728 lekë, e cila është falur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Nga komunikimi me përfaqësuesit aktual të SRD, nuk ka informacion të saktë mbi këtë situatë pasi janë vite të hershme (2011-2014). Para likuidimit përfundimtar të këtij detyrimi, pagesat e bëra shkonin për likuidimin e këtyre detyrimeve, duke krijuar një situatë të çrregullt të pagesës së TVSH. Ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se pagesa e TVSH gjatë viteve object auditimi është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

kryer në mënyrë të rregullt, dhe kjo situatë ka ardhur si pasojë e detyrimeve të viteve 2011-2014. Gjithsesi fakti se ky detyrim është paguar në vitin 2017, ka ndikuar negativisht në buxhetin e SRD për këtë vit.

8. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1502/18 prot, datë 13.11.2017 me objekt “Blerje aksesore dhe riparim aparaturash mjekësore në lote për Spitalin Rajonal Durrës”, u konstatua se nga ana e operatorit ekonomik “B.A.shpk” nuk është zbatuar afati 7 ditor i realizimit të kontratës. Referuar faturës tatimore nr. 83 datë 11.12.2017 të dorëzuar nga OE, kontrata është realizuar 21 ditë me vonesë. Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet. Për pasojë vlera e penalitetit **132,492 lekë përbën dëm ekonomik** për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE “B.A.shpk”. Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mban përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim.

9. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 1502/13 prot, datë 09.11.2017 me objekt “Blerje aksesore dhe riparim aparaturash mjekësore në lote për Spitalin Rajonal Durrës”, u konstatua se nga ana e operatorit ekonomik “F. shpk” nuk është zbatuar afati 7 ditor, 2 dhe 3 njavor (sipas zërave) i realizimit të kontratës. Referuar faturës tatimore nr. 847-851 datë 13.12.2017 të dorëzuar nga OE, kontrata është realizuar 27 ditë me vonesë, 20 ditë me vonesë dhe 13 ditë me vonesë. Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet. Për pasojë vlera e penalitetit e përlloritur nga grupi i auditimit **243,368 lekë përbën dëm ekonomik** për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE “F. shpk”. Për mosevidentimin e vonesave në zbatimin e kontratës mban përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim.

10. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 989/2 prot, kontratës nr. 992/2 prot, kontratës nr. 787/3 prot, datë 08.05.2017 me objekt “Blerje medikamente mjekësore për Spitalin Rajonal Durrës”, u konstatua se nga ana e operatorit ekonomik “E.shpk” nuk është zbatuar afati i realizimit të kontratës. Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet. Për pasojë vlera e penalitetit **117,465 lekë përbën dëm ekonomik** për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE “E.shpk”. Për këtë mban përgjegjësi A.M. në cilësinë e shifes së farmacisë.

11. Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 991/4 prot, dhe kontratës nr. 815/3 prot, datë 09.05.2017 me objekt “Blerje medikamente mjekësore për Spitalin Rajonal Durrës”, u konstatua se nga ana e operatorit ekonomik “A. shpk” nuk është zbatuar afati i realizimit të kontratës. Për këtë vonesë nga ana e SRD nuk është mbajtur penalitet. Për pasojë vlera e penalitetit **48,079 lekë përbën dëm ekonomik** për SRD si penalitet i pambajtur, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE “A. shpk”. Për këtë mban përgjegjësi A.M. në cilësinë e shifes së farmacisë.

12. Nga auditimi u konstatua se Spitali Rajonal Durrës ka lidhur kontratën me nr. 1536/7 prot, datë 08.06.2018 në vlerën 660,000 lekë pa TVSH me objekt “Shërbim evadimi mbetje urbane për Spitalin Rajonal Durrës”. Gjithashtu u konstatua se SRD nuk paguan taksën e bashkisë në lidhje me këtë shërbim.

Për këtë situatë, nga ana e SRD nuk rezulton të jetë bërë asnjë analizë në lidhje me mundësinë e ofrimit të këtij shërbimi nga Bashkia Durrës, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

13. Në 4 raste u konstatuar se Përgjegjësja e Financës është caktuar pjesë e grupeve të procedurave të prokurimit (KVO, njësi prokurimi ose përcaktim fondi limit) si dhe pjesë e komisionit për ndjekjen e objekteve me qera, veprime në kundërshtim me ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

III.3.2. Mbi ligjmërinë e shpenzimeve të karburantit

1. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në konsumit të karburantit.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me konsumin e karburantit për Gjeneratorin e Kirurgjisë për vitet periudhën 01.01.2015-31.12.2018, u konstatua se normativa e konsumit të karburantit për gjeneratorin e kirurgjisë, për vitet 2015-2017, është 48.6 lt/orë punë, ndërsa për vitin 2018, është 27.4, vlerë e cila është në përputhje me normativën e parashikuar në katalogun e gjeneratorit.

Përlllogaritja e normativës në kundërshtim me katalogun, ka sjellë një **rritje të pa argumentuar të sasisë** së karburantit të konsumuar për këtë gjenerator me **4,770 litra naftë**, e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale **788,773.6 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD.**

Gjithashtu, sipas Relacionit nr. 316, datë 30.01.2018, të Degës Teknike, në bashkëpunim me O. SHA, ka përcaktuar se për vitin 2017, koha reale e ndërprerjes së energjisë elektrike është 33 orë, dhe jo 90 orë sa është pasqyruar në pasqyrat e konsumit vjetor të karburantit. Për pasojë është rritur në mënyrë të pa argumentuar koha e punës së gjeneratorit me 57 orë, dhe natyrshëm dhe sasia e konsumuar të karburantit **me 2,770.2 litra naftë**, e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale **478,413.5 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD.**

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 26, e cila përcakton se: "*Dokument financiar*" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative", si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36, e cila përcakton se: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundesine për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve*".

Ndikimi/Efekti: Mos pasqyrim i saktë i sasisë së karburantit të konsumuar me pasojë dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën **1,267,187.10 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në menaxhimin e konsumit të karburantit për gjeneratorin e Kirurgjisë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

2. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në konsumit të karburantit.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me konsumin e karburantit për Gjeneratorin e Maternitetit për vitet periudhën 01.01.2015-31.12.2018, u konstatua se normativa e konsumit të karburantit për gjeneratorin e maternitetit, për vitet 2015-2018, ka pësuar ndryshime çdo vit, duke filluar nga normativa më e lartë 47 lt/orë punë dhe deri te normativa më e ulët në 32.7 lt/orë punë. Kjo nënkupton një përlllogaritje jo të saktë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

të kryer nga ana e grupeve të punës përkatëse, duke e rritur në mënyrë të pa argumentuar këtë normativë.

Grupi i auditimit në këtë rast ka marrë për bazë normativën e vitit 2016, e cila është normativa më e ulët e përlogaritur. Në rast rilllogaritje të konsumit real të periudhës 2015-2018, duke përdorur normativën e vitit 2016, konstatohet se ka një **rritje të pa argumentuar të sasisë** së karburantit të konsumuar për këtë gjenerator me **714.3 litra naftë**, e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale **111,564 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD.**

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 26, e cila përcakton se: "*Dokument financiar*" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative", si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36, e cila përcakton se: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ate të mashtrimeve*".

Ndikimi/Efekti: Mos pasqyrim i saktë i sasisë së karburantit të konsumuar me pasojë dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën **111,564 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në menaxhimin e konsumit të karburantit për gjeneratorin e Kirurgjisë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Me anë të Urdhrave të ndryshëm, titullari i AK ka ngritur grupet e kontrollit të konsumit të karburantit, sipas viteve të mëposhtme:

Për vitin 2016, komisioni është ngritur me Urdhrin nr. 972, datë 10.05.2016;

Për vitin 2017, komisioni është ngritur me Urdhrin nr. 389, datë 20.02.2017;

Për vitin 2018, komisioni është ngritur me Urdhrin nr. 07, datë 12.01.2018.

Menaxhimi i karburantit të gjeneratorëve deri më datë 14.02.2018, kryhej nga z. Haxhi Osmani me detyrë teknik deri më datë 23.05.2016 dhe shofer për periudhën 23.05.2016 e në vazhdim. Ndërsa pas datës 14.02.2018, me anë të Urdhrit të titullarit nr. 18, datë 09.02.2018, administrimi i karburantit i kalon Degës Teknike.

Gjeneratori i Kirurgjisë

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me konsumin e karburantit për Gjeneratorin e Kirurgjisë për vitet periudhën 01.01.2015-31.12.2018, u konstatua se konsumi vjetor dhe normativa përkatëse janë sipas tabelës së mëposhtme:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Viti	Orët e Punës	Normativa	Konsumi vjetor
2015	52	48.6	2,527.2
2016	83	48.6	4,033.8
2017	90	48.6	4,374.0
2018	17	27.4	465.8
Shuma			11,400.8

Siç vërehet dhe nga tabela e mësipërme, normativa e konsumit të karburantit për gjeneratorin e kirurgjisë, për vitet 2015-2017, është 48.6 lt/orë punë, ndërsa për vitin 2018, është 27.4, vlerë e cila është në përputhje me normativën e parashikuar në katalogun e gjeneratorit.

Përlllogaritja e normativës në kundërshtim me katalogun, ka sjellë një **rritje të pa argumentuar të sasisë** së karburantit të konsumuar për këtë gjenerator me **4,770 litra naftë**, (11.400.8 lt – {242 orë * 27.4 lt/orë}) e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale **788,773.6 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD.**

Gjithashtu, sipas Relacionit nr. 316, datë 30.01.2018, të Degës Teknike, në bashkëpunim me O. SHA, ka përcaktuar se për vitin 2017, koha reale e ndërprerjes së energjisë elektrike është 33 orë, dhe jo 90 orë sa është pasqyruar në pasqyrat e konsumit vjetor të karburantit. Për pasojë është rritur në mënyrë të pa argumentuar koha e punës së gjeneratorit me 57 orë, dhe natyrshëm dhe sasia e konsumuar të karburantit **me 2,770.2 litra naftë**, e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale **478,413.5 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD.**

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, e cila përcakton se: “*“Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative*”, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, e cila përcakton se: “*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve*”.

Gjeneratori i Maternitetit

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me konsumin e karburantit për Gjeneratorin e Maternitetit për vitet periudhën 01.01.2015-31.12.2018, u konstatua se konsumi vjetor dhe normativa përkatëse janë sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Orët e Punës	Normativa	Konsumi vjetor
------	--------------	-----------	----------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

2015	40	47.0	1,880.0
2016	72	32.7	2,354.4
2017	46	34.6	1,591.6
2018	9	38.8	349.2
Shuma			6,175.2

Siç vërehet dhe nga tabela e mësipërme, normativa e konsumit të karburantit për gjeneratorin e maternitetit, për vitet 2015-2018, ka pësuar ndryshime çdo vit, duke filluar nga normativa më e lartë 47 lt/orë punë dhe deri te normativa më e ulët në 32.7 lt/orë punë. Kjo nënkupton një përlogaritje jo të saktë të kryer nga ana e grupeve të punës përkatëse, duke e rritur në mënyrë të pa argumentuar këtë normativë.

Grupi i auditimit në këtë rast ka marrë për bazë normativën e vitit 2016, e cila është normativa më e ulët e përlogaritur. Në rast rilogaritje të konsumit real të periudhës 2015-2018, duke përdorur normativën e vitit 2016, konstatohet se ka një **rritje të pa argumentuar të sasisë** së karburantit të konsumuar për këtë gjenerator me **714.3 litra naftë**, e cila e përthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale **111,564 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD.**

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 26, e cila përcakton se: "*Dokument financiar*" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative", si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36, e cila përcakton se: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve*".

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. H.O. për periudhën 01.01.2015-14.02.2018 dhe z. A. K. për periudhën 14.02.2018-31.12.2018.



III.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave

1. Titulli i gjetjes: Largimet nga puna të punonjësve, me pasojë efekt financiar negativ.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave, u konstatua se:

Për periudhën 01.01.2015-31.12.2018, janë ndërprerë marrëdhëniet për 264 punonjës të spitalit, për arsye të ndryshme (ndryshime strukturore, dalje në pension, dorëheqje, përfundim kontrate, largime nga detyra, etj.). Në lidhje me largimet nga detyra të punonjësve të Spitalit Rajonal Durrës, është konstatuar se nuk është bërë një analizë për arsyet e lëvizjeve të personelit. Nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se këto largime janë kryer bazuar në vjetërsinë në punë apo vlerësimeve periodike të punonjësve. Si rezultat i kësaj, për periudhën objekt auditimi, kundër vendimeve për largim nga puna, 29 punonjës i janë drejtuar gjykatave për ankimimin e ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës. Nga këto, 18 procese gjyqësore janë në proces shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Apelit, 5 raste janë fituar nga Spitali Rajonal Durrës, dhe për 6 raste në vlerën 7,849,110 lekë, procesi ka përfunduar në favor të punonjësve. Shuma totale e kërkuar për tu dëmshpërblyer nga Spitali Rajonal Durrës, për çështjet gjyqësore në proces, është në vlerën 28,908,874 lekë.

Ndikimi/efekti: *Efekt financiar negativ në vlerën 7,849,110 lekë.*

Shkaku: Largimi i punonjësve pa shkaqe të arsyeshme.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarem, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për Institucionin, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

2. Titulli i gjetjes: Mosplotësimi i dosjeve të personelit të Spitalit Rajonal Durrës.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i 20 dosjeve të personelit të Spitalit Rajonal Durrës, përzgjedhje e kryer referuar strukturës së Spitalit Rajonal Durrës, konstatohet se në përgjithësi ka mangësi dokumentacioni referuar kontratave të punës të cilat në 11 dosje mungojnë, në kundërshtim me nenin 13 dhe 21 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i ndryshuar. Gjithashtu në disa dosje nuk konstatohet noterizimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e SRD dhe në dosje ndodhet vetëm kopja e certifikatave të kualifikimit, si rrjedhojë regjistrat themeltarë të shoqërisë nuk janë të plotësuar plotësisht me të dhënat identifikuese të punonjësve, data e fillimit të punës, arsimi profesional, kurset e ndryshme të kryera, paga mujore. Përgjithësisht për çdo punonjës mbahet dosje e veçantë, me dokumentacionin përkatës dhe kontratën e punës individuale sipas pozicionit të punës. Për mangësitë që janë konstatuar në plotësimin e dosjeve të personelit të Spitalit Rajonal Durrës ngarkojnë me përgjegjësi Shefen e Sektorit të Burimeve Njerëzore të Spitalit Rajonal Durrës.

Ndikimi: Mungesë kontrolli dhe mosidentifikim i të dhënave në dosjet e personelit të SRD.

Shkaku: Mosbatim i ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i ndryshuar.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga sektori i burimeve njerëzore të Spitalit Rajonal Durrës të merren masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të dhënat identifikuese të punonjësve, data e fillimit të punës, arsimi profesional, kurset e ndryshme të kryera, paga mujore dhe noterizimi i certifikatave dhe trajnimeve të ndryshme kualifikuese.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

3. Titulli i gjetjes: Hartimi i listpagesave pa llogaritur sigurimet shoqërore, për punonjësit me kohë të pjesshme të Spitalit Rajonal Durrës.

Situata: Për periudhën Nëntor-Dhjetor 2016, Janar-Dhjetor 2017, Janar-Maj 2018, Spitali Rajonal Durrës ka angazhuar 20 mjekë pediatër me kohë të pjesshme, të cilët janë paguar në total me page bruto në vlerën 728,992 lekë, me pagë neto total në vlerën 619,643 lekë dhe i është mbajtur tatimi në burim në vlerën totale 109,349 dhe nuk janë llogaritur sigurimet shoqërore, në kundërshtim me, nenin 6 i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Shefen e Financës të Spitalit Rajonal Durrës.

Ndikimi: Mungesë kontrolli i listëpagesave nga sektori i financës, për punonjësit me kohë të pjesshme pranë Spitalit Rajonal Durrës.

Shkaku: Mosbatim i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Rekomandimi: Nga drejtorja dhe sektori i financës të merren masa për llogaritjen e sigurimeve shoqërore për punonjësit me kohë të pjesshme që punojnë pranë Spitalit Rajonal Durrës duke i identifikuar rast pas rasti, në bazë të kontratave të përkohshme që këto punonjës lidhin me SRD.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Spitali Rajonal Durrës është i organizuar si person juridik publik, në kuptimin të nenit 25, të Kodit Civil, me qendër në Durrës. Spitali si institucion i shërbimit shëndetësor publik, është jo fitimprurës dhe e ushtron veprimtarinë e tij sipas ligjit bazë të shërbimit shëndetësor, si edhe të ligjit të shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë. Spitali Rajonal Durrës drejtohet nga Bordi i Spitalit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit. Bordi është organi më i lartë ekzekutiv i spitalit.

Marrëdhëniet e punës, janë rregulluar me ligjin nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.237, datë 12.04.2006 “Për disa ndryshime në vendimin nr.560, datë 23.10.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e spitalit rajonal të durrësit në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, Urdhri nr.506, date 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe të dhënies me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”, kontratën kolektive të punës nr.922, date 03.05.2016 me afat 3 vjeçar nënshkruar ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm dhe punëmarrësve përfaqësuar nga Sindikata e Pavarur, rregulloren e marrëdhënieve me personelin miratuar me vendimin nr.33, date 17.10.2018 të Bordit të Spitalit.

Struktura Organizative e Spitalit Rajonal Durrës për periudhën 2015-2018

Struktura SRD për periudhën:	Nr. Punonjësve i miratuar	Vendim Bordi	
		Nr	Data
Viti 2015	717	8	1/29/2015
Viti 2016	664	255	1/18/2016
Viti 2017	710	7	2/27/2018
Ndryshim për vitin 2017	700	19	11/3/2017
Viti 2018	700	3	3/19/2018
Ndryshim për vitin 2018	700	31	6/20/2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Ndryshim për vitin 2018	700	29	6/20/2018
-------------------------	-----	----	-----------

Burimi: Spitali Rajonal Durrës

Më hollësisht:

Për vitin 2015 Struktura organizative e spitalit Durrës ka pësuar 1 ndryshim përkatësisht me vendimin nr.8, datë 29.01.2015, të Bordit të Spitalit me objekt ndryshimin e numrit të punonjësve, me një numër të miratuar prej 717 punonjësish.

Për vitin 2016, struktura organizative e spitalit Durrës është ndryshuar me Udhëzimin nr.13, datë 15.01.2016 të Ministrisë së Shëndetësisë, me një numër të miratuar prej 664 punonjësish.

Për vitin 2017, struktura organizative e Spitalit Durrës ka pësuar 2 ndryshime me vendimin nr.7, datë 27.02.2017 të Bordit të Spitalit me një numër të miratuar prej 710 punonjësish dhe një ndryshim tjetër me vendimin nr.19, date 03.11.2017, duke shkurtuar nga kontrata e lavanterisë 10 punonjës të stafit, duke e ndryshuar edhe numrin e punonjësve në total me 700.

Për vitin 2018 struktura organizative e Spitalit Rajonal Durrës, ka pësuar tre ndryshime, konkretisht me vendimin nr.3, datë 19.03.2018 të Bordit të Spitalit, me vendimin nr.31, datë 20.06.2018, ku shoferët e autoambulancave kanë kaluar nga sektori teknik në shërbimin e urgjencës, me vendimin nr.29, datë 20.06.2018, klinika e patologjisë së barrës ka kaluar në shërbimin e obstetrikës, ndërsa numri i punonjësve për vitin 2018 ka mbetur 700, i pandryshuar.

Marrëdhëniet e punës. Rekrutimi

Sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) “Punëdhënësi punëson në mënyrë të drejtëpërdrejtë punëmarrësin”. Kushtet, procedurat dhe format e pranimit, fillimit, mbarimit dhe çdo gjë që lidhet me marrëdhëniet e punës janë të përcaktuara në kontratën individuale dhe kontratën kolektive që lidhet midis punëmarrësve dhe punëmarrësit dhe Spitalit Rajonal Durrës, bazuar në VKM nr.560, date 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar.

Kontrata Kolektive e Punës

Kontrata Kolektive e punës në fuqi me nr. nr.922, date 03.05.2016 me afat 3 vjeçar 2016-2019 nënshkruar ndërmjet Spitalit Rajonal Durrës, Ish Drejtorit të Përgjithëm A. R. dhe punëmarrësve përfaqësuar nga Zv/Presidenti z.P.F. dhe Kryetari i Seksionit të Shëndetësisë për qarkun Durrës z.A.N. nga Federata e Sindikatës së Punonjësve të Shëndetësisë të Shqipërisë (FSPSHSH) në cilësinë e punëmarrësit.

Kontrata individuale e punës

Çdo punonjës, duhet të ketë në përbërje të dosjes së tij personale, kontratat individuale të punës. Në rastet e ndryshimeve si pasojë e strukturës së re organizative, duhen përpiluar dhe aneks kontratat respektive me pershkrimet e reja të punës bashkëlidhur. Kontrata individuale e punës, mbështetet në legjislacionin Shqiptar të punës dhe përmban të gjithë elementët përbërës të marrëdhënies juridike të punës që krijohet midis SRD dhe punëmarrësit.

Vlerësimi i performancës

Për periudhën objekt auditimi, përgjithësisht të gjithë punonjësit e Spitalit Rajonal Durrës janë vlerësuar sipas një formulari performance. Vlerësimet janë kryer nga eprori i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

drejtpërdrejtë i punonjësve. Kanë qenë vlerësime të hapura për punonjësit dhe janë miratuar dhe kundërfirmosur nga eprorët e drejtpërdrejtë të çdo vlerësuesi.

Të dhëna mbi largimet 2015- 2016 – 2017 – 2018

Në rastet e zgjidhjes së kontratës nga Punëdhënësi përgjithësisht janë respektuar afatet e njoftimit sipas parashikimeve të nenit 143 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), parashikimet e nenit 144 për procedurën e zgjidhjes së kontratës nga punëdhënësi, por referuar periudhës së auditimit gjatë vitit 2016 janë kryer 26 zgjidhje kontrata pune, për efekt riorganizimi strukturor, në kundërshtim me nenin 148 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit auditues, konstatohet se me propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Spitalit Durrës, Bordi i Spitalit ka vendosur me vendimin qarkullues nr.19, datë 03.11.2017, miratimin e strukturës dhe pasqyrave të pagave për vitin 2017, konkretisht:

-miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve gjithsej 700 punonjës nga 710 që ishte më parë;

-pakësim të numrit të punonjësve të sektorit të hotelarisë me 22 punonjës (specifikisht 1 përgjegjës lavanterie, 10 punonjës hotelerie, 11 përgjegjës materiali);

-Shtim të numrit të punonjësve të sektorit të Shërbimeve Mjedisore me 12 punonjës (specifikisht numri i sanitarëve nga 64 bëhet 76).

Me shkresën nr 4778, date 15.11.2017, Ministri i Shëndetësisë, ka miratuar vendimin e Bordit të Spitalit për ndryshimin e strukturës organizative të SRD, duke u bazuar në VKM nr.18 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, nga ku numri i përgjithshëm i punonjësve të SRD nga 710 bëhet 700.

Përsa më sipër konstatohet se SRD ka lidhur kontratën nr.1905, datë 26.09.2017 me operatorin B.S. C. SHA dhe A.G L., nga ku Spitali Rajonal Durrës ka prokuruar furnizimin e shërbimit të lavanterisë. Në kontratë nuk përcaktohet se punonjësit e shkurtuar nga sektori i lavanterisë referuar ndryshimeve në strukturë, do të jenë pjesë e kësaj kontrate dhe nuk ka gjurmë periodike të raportuar nga firma që privatizoi shërbimin e lavanterisë, të angazhimit të tyre në mënyrë private tek ky shërbim, duke pasur një efekt social tek këta punonjës të cilëve i është shkurtuar vendi i punës.

Mbajtja e dokumentacionit të personelit

Nga shqyrtimi me zgjedhje i **20 dosjeve të personelit të Spitalit Rajonal Durrës**, konstatohet se në përgjithësi ka mangësi dokumentacioni referuar kontratave të punës që në **11 dosje** mungojnë, në kundërshtim me nenin 13 dhe 21 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i ndryshuar, gjithashtu në disa dosje nuk konstatohet noterizimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e SRD dhe në dosje ndodhet vetëm kopja e certifikatave të kualifikimit, si rrjedhojë regjistrat themeltarë të shoqërisë nuk janë të plotësuar plotësisht me të dhënat identifikuese të punonjësve, data e fillimit të punës, arsimi profesional, kurset e ndryshme të kryera, paga mujore. Përgjithësisht për çdo punonjës mbahet dosje e veçantë, me dokumentacionin përkatës dhe kontratën e punës individuale sipas pozicionit të punës. Për mangësitë që janë konstatuar në plotësimin e dosjeve të personelit të Spitalit Rajonal Durrës ngarkojnë me përgjegjësi Shefen e Sektorit të Burimeve Njerëzore znj. B. C.

Hartimi i listë pagesave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Nga auditimi me zgjedhje i listpagesave, u konstatua se përgjithësisht mbahen të rregullta, të shoqëruara me listëprezëncat e firmosura nga drejtuesit përkatës. Në procedurën për mbledhjen e të dhënave për ditët e punës së kryer nga çdo punonjës, nga burimet njerëzore, mbahen të dhënat për ditët e raportit, lejet, ndryshimet e nivelit të pagave, ditët e punës dhe i dërgohen sektorit të Financës. Ky sektor, bën përlllogaritjet e pagës bruto, kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP, ndalesa të kryera dhe të përlllogaritura në mbështetje të legjislacionit respektiv në fuqi. Pagesat neto të pagës, kryhen nëpërmjet sistemit bankar, megjithatë për periudhën Nëntor-Dhjetor 2016, Janar-Dhjetor 2017, Janar-Maj 2018, për 20 mjekë pediatër të angazhuar me kohë të pjesshme në Spitalin Rajonal Durrës, janë paguar në total me page bruto në vlerën 728,992 lekë, me pagë neto total në vlerën 619,643 lekë dhe i është mbajtur tatimi në burim në vlerën totale 109,349 dhe nuk janë llogaritur sigurimet shëndetësore, në kundërshtim me, neni 6 i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Shefen e Financës znj.I.V.

Cështjet Gjyqësore për periudhën objekt auditimi

Largimet nga puna të punonjësve, me pasojë efekt financiar negativ.

Nga auditimi i largimeve nga detyra të punonjësve të Spitalit Rajonal Durrës, të cilat janë kryer kryesisht si pasojë e ndryshimeve strukturore të spitalit gjatë periudhës objekt auditimi, është konstatuar se nuk është bërë një analizë se cilët punonjës do të largohen dhe cilët do të qëndrojnë. Nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se këto largime janë kryer bazuar në vjetërsinë në punë apo vlerësimeve periodike të punonjësve.

Për pasojë grupi i auditimit i vlerëson këto largime jo transparente, duke rrezikuar cenimin e ecurisë dhe kryerjes me cilësi të punës. Për periudhën 2015-2018, kundër vendimeve për largim nga puna, Spitalit Rajonal Durrës janë hapur 29 procese gjyqësore. Nga këto, 18 procese gjyqësore janë në proces shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Apelit, 5 raste janë fituar nga pala e paditur Spitali Rajonal Durrës të cilat janë ankimuar nga pala paditëse (punonjësit e larguar) dhe për 6 raste, procesi ka përfunduar në favor të punonjësve të larguar pa shkaqe të arsyeshme, me vlerë totale për tu dëmshpërblyer nga Spitali Rajonal Durrës 28,908,874 lekë (efekt financiar negativ i pritshëm në varësi të përfundimit të procesit gjyqësor). ***Spitali Rajonal Durrës deri aktualisht, i ka dëmshpërblyer punonjësve të larguar në vlerën 7,849,110 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për llogari të Buxhetit të Shtetit.***

Në disa raste konstatohet një mosndjekje e rregullt e proceseve gjyqësore duke sjellë paralajmërime për gjoba administrative në drejtim të Spitalit Rajonal Durrës dhe ky veprim ngarkon me përgjegjësi Sektorin Juridik pranë Spitalit Rajonal Durrës, sipas periudhës objekt auditimi.



III.5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit

1. Titulli i gjetjes: Garanci të vjetra të mbetura në llogarinë 520

Situata: Nga auditimi i pasqyrave financiare, u konstatua se llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” ka gjendje vlerën 1,016,375 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat u mbahen operatorëve ekonomik si garanci për kontratat e nënshkruara. Kjo shumë rezulton ende e pa tërhequr, edhe pse nga verifikimi analitik i kësaj llogarie, kjo vlerë i përket viteve 2006, 2007 dhe 2011. Nga Spitali Rajonal Durrës edhe pse kanë kaluar disa vite, nuk janë marrë masat e nevojshme për sistemimin e vlerës 1,016,375 lekë nga kjo llogari, pasi garancia duhet të shlyhet ndaj operatorëve ekonomik ose të kalojë në favor të autoritetit kontraktor me përfundimin e afatit të garancisë.

Ndikimi/efekti: Llogaria 520 është e ngarkuar me vlerën 1,016,375 lekë.

Shkaku: Nuk janë shlyer apo kaluar në llogari të SRD vlera 1,016,375 lekë

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Titullari i Spitalit Rajonal Durrës dhe Bordi Drejtues të marrin vendim në lidhje me vlerën 1,016,375 lekë e cila ka mbetur në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar”, pasi periodha e garancisë për këto raste ka përfunduar.

2. Titulli i gjetjes: Regjistrim i papërfunduar i aktiveve të shoqërisë në ZRPP.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të pronave të Spitalit Rajonal Durrës u konstatua se: Në aktivet e SRD figurojnë 8 godina. Të gjitha këto godina ndodhen brenda territorit të Spitalit me përjashtim të godinës së poliklinikës. Gjithashtu SRD zotëron edhe një pjesë të godinës së ish-befotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Shumica e godinave janë të ndërtuara para vitit 1990 dhe si pasojë në ZRPP Durrës ka mungesa të theksuara të dokumentacionit teknik mbi sipërfaqet e ndërtimit të tyre. Gjatë vitit 2003 nga ana e ZRPP-së nëpërmjet fotografimit satelitor është bërë riazhornimi i të gjitha pronave dhe si pasojë edhe godinat që përfshin SRD. Për sa më sipër statusi juridik i tyre është “Sheshe” dhe pronar “Shtet” gjë e cila ka sjellë që në sipërfaqen e ndërtimit është përfshirë vetëm njolla e objekteve (kati përdhe). Duke qenë se nga fotografimi satelitor nuk ishte përfshirë edhe godina e katërkatëshit, pasi është ndërtuar në vitin 2007, nga ana e SRD është kryer hipotekimi i saj. Në opinionin e grupit të auditimit, nga ana e drejtimit nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekor të saktë të Spitalit Rajonal Durrës.

Ndikimi/efekti: Regjistrim i papërfunduar në ZRPP

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Titullari i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme për përfundimin e regjistrimit të pronave në ZRPP me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekor.

3. Titulli i gjetjes: Diferenca në gjendjen e farmacisë së SRD.

Situata: Nga auditimi i ushtruar në magazinën e farmacisë së spitalit, u konstatua se:

-Në 3 raste kishte teprica në sasi të medikamenteve.

-Në 5 raste kishte mangësi në sasi të medikamenteve në vlerën 84,006 lekë (nga të cilat 3 medikamente konsiderohen si drogë e fortë).

Diferencat e konstatuara janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 89. Për pasojë vlera 84,006 lekë, që përbën vlerën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

medikamenteve të munguara, përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. Përgjegjësia për këtë vlerë i ngarkohet përgjegjësës së farmacisë së SRD, A. M.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik në vlerën **84,006** lekë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën 84,006 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me diferencat e konstatuara në sasitë fizike dhe kontabile të medikamenteve në Farmacinë e Spitalit Rajonal Durrës, si dhe të evidentohen përgjegjësitet dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

4. Titulli i gjetjes: Mangësi në medikamentet të rëndësisë së lartë

Situata: Nga auditimi i ushtruar në magazinën e farmacisë së spitalit u gjendën 7 flakona Dopaminë 50 mg/10ml (medikament i cili kategorizohet si drogë e fortë), të bërë hyrje me fletë hyrje nr. 364, datë 02.11.2018, të cilët janë kaluar nga Spitali i Përmetit, për shkak të tepricave të këtij të fundit. Këto flakona kanë datë skadence 11/2018, pra në momentin e hyrjes, kanë qenë të skaduara. Këto flakona janë bërë dalje me fletëdaljet nr. 6579, datë 12.11.2018, sasia 5 copë, dhe nr. 6663, datë 16.11.2018, sasia 2 copë. Aktualisht edhe pse në gjendja kontabël është zero, gjendja fizike e tyre është 7, të cilat janë të skaduara.

Grupi i auditimit e vlerëson këtë situatë me risk mjaft të lartë, për arsye se:

-Janë bërë hyrje medikamente të skaduara, madje në këtë rast kemi të bëjmë me medikamente të rëndësisë së lartë.

-Janë kryer veprime kontabël në mënyrë të pa argumentuara, pasi këto flakona vazhdojnë të jenë në magazinën e spitalit, madje në gjendje të skaduara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 “Për Miratimin E Rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””.

Kriteri: Ligji nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 “Për Miratimin E Rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””

Ndikimi/efekti: Risk i lartë në administrimin e barnave

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Titullari i Spitalit Rajonal Durrës të analizojë situatën e krijuar në lidhje me barnat e rëndësisë së lartë, të vlerësojë arsyet duke nxjerrë përgjegjësitë individuale si dhe marrë masat e nevojshme administrative.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

III.5.1. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua:

ANALIZË E TREGUESVE FINANCIARË PËR VITIN 2015

Për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2015 gjendja Financiare e Spitalit Rajonal Durrës paraqitet si më poshtë:

Aktivi i Bilancit

A.I.Aktive të patrupëzuara

1.Llogaria 205 “Konçesione, patenta, liçensa e të tjera të ngjashme”

Vlera 20,349,782 lekë. Në këtë llogari është pasqyruar vlera e programeve kompjuterike.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

2. Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”.
Vlera -13,213,367 lekë. Kjo vlerë paraqet amortizimin e akumuluar të këtyre programeve, i llogaritur me normën e amortizimit 25% të vlerës së mbetur.

A. Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

1. Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”.

Paraqitet në fund të periudhës në vlerën 2,346,831,045 lekë, e cila në krahasim me fillimin e periudhës ka një rritje prej 2,074,128 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i kryerjes së investimeve në shërbimin e Maternitetit.

2. Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune.”

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 771,564.816 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i investimeve nga të ardhurat dytësore në këtë zë, ndihmave të ardhura dhe levizja brenda aktiveve. Në llogarinë 214 kemi paksim.

3. Llogaria 215 “Mjete Transporti”:

Paraqitet e ndryshuar nga viti i mëparshëm me vlerën 63,003,171 lekë. Ka një rritje të këtij zëri me vlerë 7,482,000 lekë (ambulanca dërguar Urgjencës së Tiranës).

4. Llogaria 218 “Inventar ekonomik”.

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 122,190,854 lekë, pra me një rritje prej 867,770 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë dy nënlllogari:

5. Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Në fund të vitit kjo llogari paraqitet me gjendjen -894.791.754 lekë.

Për pajisjet kompjuterike amortizimi është llogaritur në masën 25% të vlerës së mbetur.

B. Aktive Qarkulluese.

Aktivet qarkulluese në këtë bilanc kapin vlerën 161,859,338 lekë.

-Klasa 3. “Gjendje inventari”

Gjendja e saj në fund të vitit kap vlerën 76,496,982 lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm kjo klasë ka një rritje prej 2,630,303 lekë. Kjo rritje i përket llogarive përbërëse të kësaj klase dhe konkretisht:

-Llogaria 31 “Materiale” me gjendjen në fund të periudhës 43,926,250 lekë, me një ulje prej 943,483 lekë në krahasim me vitin e kaluar.

-Llogaria 32 “Objekte Inventari” me gjendje në fund të periudhës 32,570,732 lekë, me një rritje prej 3,573,786 lekë në krahasim me një vit më parë si pasojë e nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit.

-Klasa 4. “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët”

Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 411. “Kliente e llogari te ngjashme”

-Llogaria 423. “Personeli, paradhënie, defiçite e gjoba”.

Gjendja në fund të periudhës është 1,371,444 lekë, një ulje prej 298,408 lekë.

-Llogaria 468 “Debitorë te ndryshëm”.

Gjendja e saj në fund të periudhës është 3,567,674 lekë. Pra me një rritje prej 1,306,121 lekë.

-Klasa 5 “Llogaritë Financiare”

Gjendja e saj në fund të periudhës është 81,729,359 lekë. E analizojmë sipas llogarive që e përbëjnë:

-Llogaria 512. “Llogari në Bankë”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Gjendja e saj në fund të vitit është 80,712,984 lekë. Bankat me të cilat operon Spitali Rajonal Durrës është Banka Credins si dhe Abi Bank. Përsa i përket burimit të këtyre fondeve ato përbëhen si më poshtë;

Gjendja e Bankës e analizuar më 31.12.2015

1	Te trashiguara	99.901.406
2	Te ardhura dytesore	24.468.607
3	Garanci qeraje	155.826
	Totali	124.542.214

-Llogaria 520 "Disponibilitete ne Thesar"

Ka gjendje në fund të vitit vlerën 1,016,375 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat firmat i lënë në Thesar si garanci për investimin. Kjo shumë nuk është tërhequr prej tyre deri më 31.12.2015. E analizuar kjo shumë analizohet si me poshtë:

1.Viti 2006 5% garanci punimesh lekë 545,856.

2.Viti 2007 garanci lekë 3,000.

3.Viti 2011 5% garanci punimesh lekë 467,519.

Shuma e garancive që Spitali Rajonal Durrës i trashëgon për vitin 2015 është =1,016,375 lekë.

Pasivi i Bilançit

A.Fondet e Veta

-Llogaria 10 "Fonde të veta"

në fund të vitit paraqitet me gjendje në vlerën 2,445,013,725 lekë,

Kjo llogari përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 101 "Fonde Bazë" e cila në fund të vitit ka një gjendje prej 2,092,259,372 lekë, pra me një pakësim 18,127,476 lekë.

-Llogaria 106 "Grante të Huaja Kapitale" Gjendja në fund të periudhës është 352,754,353 lekë.

B.Detyrimet.

-Klasa 4 "Detyrimet afatshkurtër" Gjendja në fund të periudhës paraqitet me vlerën 35,619,497 lekë pra me një rritje prej 2,823,314 lekë. Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 401 "Furnitorë paraqitet me saldo kreditore" 9,602,553 lekë. Të gjithë detyrimet që i përkasin kësaj llogarie janë shlyer në muajin janar dhe shkurt 2016.

-D. I. 47,838 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-K. 18,540 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-M. 212,404 lekë nga viti 2008 mall i pa shoqëruar me procedurën përkatëse

-N. 199,800 lekë faturë e thjeshtë pa kupon tatimor

-M. 4,632 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-Llogaria 42 "Personeli e llogari të lidhura me to" Gjendja në fund të vitit është 12,799,461 lekë dhe paraqet detyrimin e Spitalit për pagat e punonjësve të periudhës 01-31 dhjetor 2015.

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa". Gjendja e saj në bilanc është 1,734,921 lekë dhe paraqet vlerën e Tatimit për të ardhurat nga Punësimi të muajit dhjetor 2015, që paguhet në muajin janar 2016.

-Llogaria 435 "Sigurime shoqërore". Gjendja e saj është 8,395,577 lekë dhe paraqet detyrimin për Sigurimet shoqërore të muajit dhjetor 2015 i cili paguhet në janar 2016.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore”. Pararqet edhe kjo shumën prej 1,165,995 lekë e cila është vlera e sigurimit shëndetësor të muajit dhjetor 2015 i cili paguhet në janar 2016.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Gjendja e saj në fund të vitit është 1,013,375. Kjo vlerë i takon garancive të mbajtura në thesar nga likuidimi i investimeve dhe konkretisht:

1.Viti 2006	5% garanci punimesh	lekë	545,856 (S.)
2.Viti 2011	5% garanci punimesh	lekë	467,519 (D.)

-Llogaria 467”Kreditorë të ndryshëm”. Në fund të vitit paraqitet me gjëndjen 1,892,830 lekë.

Shpenzimet

Gjatë vitit 2015 janë kryer shpenzime si më poshtë:

-Llogaria 600 “Paga dhe shpërblime të tjera personeli” 405,760,123 lekë

-Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve shoqërore e shëndetësore” 67,522,694 lekë

-Llogaria 602 “Mallra e shërbime te tjera” 328,690,694 lekë

Totali i llogarisë 60 “Shpenzime Korrente” 801,973,511 lekë.

Të ardhurat

Në vitin 2015 të ardhurat paraqiten si më poshtë:

-Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore” 40,717,105 lekë e analizuar si më poshtë:

-Llogaria 710 “Nga ndërmarrjet dhe pronësia”, këtu përfshihen të ardhurat nga objektete e dhëna me qera.

-Llogaria 711 “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” 40,137,835 lekë e analizuar si më poshtë:

-Llogaria 7111 “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” 23,793,615 lekë

-Llogaria 7112 “Taksë për veprime gjyqësore e noteriale”

-Llogaria 7113 “Nga shitja e mallrave e shërbimeve” 14,497,233 lekë.

-Llogaria 7115 “Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime” 1,846,987 lekë

-Llogaria 72 “Grante Korrente” 826,084,000 lekë përfaqëson fondin e dhënë nga DRSKSH, për shpenzimet korrente.

-Llogaria 7207 “Sponsorizime nga të tretë” 84,000 lekë.

-Llogaria 76 “Të ardhura financiare” 44,398 lekë. Kjo llogari përmban të ardhurat nga interesat e llogarisë bankare në lekë.

ANALIZË E TREGUESVE FINANCIARË PËR VITIN 2016

Për periudhën 1 Janar deri më 31 dhjetor 2016 gjendja Financiare e Spitalit Rajonal Durrës paraqitet si më poshtë:

Aktivi i Bilancit

A.I.Aktive të trupëzuara

1.Llogaria 205 “Konçesione, patenta, liçensa e të tjera të ngjashme”

Vlera 20,645,833 lekë. Në këtë llogari është pasqyruar vlera e programeve kompjuterike.

Rritja prej 296,051 lekë është liçensa e recetës programit të recetës elektronike.

2. Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”.

Vlera 14,997,471 lekë. Kjo vlerë paraqet amortizimin e akumuluar të këtyre programeve, i llogaritur me normën e amortizimit 25% të vlerës së mbetur.

A.Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

1.Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Paraqitet në fund të periudhës në vlerën 2,351,035,227 lekë, e cila në krahasim me fillimin e periudhës ka një rritje prej 4,204,182 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i kryerjes së investimeve si hidroizolimi i taracës së Poliklinikës si dhe dyert e Urgjencës vlera 1,238,766 lekë i takojnë investimeve të kryera me fondet nga të ardhurat dytësore dhe 2,965,416 lekë janë lëvizje brenda aktiveve.

2.Llogaria 214 “Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune.”

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 778,711,035 lekë, pra me një rritje 9,963,485 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i investimeve nga të ardhurat dytësore në këtë zë në vlerën 462,000 lekë, ndihmave të ardhura në vlerën 9,686,716 lekë.

3.Llogaria 215 “Mjete Transporti”:

Paraqitet e ndryshuar nga viti i mëparshëm me vlerën 63,003,171 lekë.

4.Llogaria 218 “Inventar ekonomik”.

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 156,539,240 lekë, pra me një rritje prej 34,348,386 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë dy nënlllogari:

a)218/1”Orendi Zyre”.

E cila në fund të periudhës paraqitet me vlerën 114,335,352 lekë, pra me një rritje prej 129,516 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat nga ndihmat e ardhura.

b)218/6 “Paisje Kompjuterike”.

Vlera në fund të periudhës e kësaj nënlllogarie është 42,203,888 lekë. Pra paraqitet me një rritje prej 34,218,865 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i blerjeve me fondet e të ardhurave dytësore në vlerën 579,480 lekë, nga ndihmat në vlerën 33,895,540 lekë si dhe nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të dëmtuara në vlerën 185,231 lekë.

5.Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Në fund të vitit kjo llogari paraqitet me gjendjen 971,960,443 lekë: Amortizimi i llogaritur për vitin 2016 është si më poshtë:

-12. Ndërtesa amortizimi	23,497,965 lekë
-14. Pajisje,vegla pune	42,915,882 lekë
-15. Mjete transporti	1,865,298 lekë
-218/1 Inventar ekonomik	3,428,123 lekë
-218/6 Pajisje kompjuterike	6,088,845 lekë

Për pajisjet kompjuterike amortizimi është llogaritur në masën 25% të vlerës së mbetur.

Vlera totale e amortizimit e llogaritur për vitin 2016 është 77,796,113 lekë.

B.Aktive Qarkulluese.

Aktivet qarkulluese në këtë bilanc kapin vlerën 192,515,447 lekë. I analizojmë me rradhë sipas klasave që e përbëjnë këtë grup.

-Klasa 3.”gjendje inventari”

Gjëndja e saj në fund të vitit kap vlerën 79,511,572 lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm kjo klasë ka një rritje prej 3,014,590 lekë. Kjo rritje i përket llogarive përbërëse të kësaj klase dhe konkretisht:

-Llogaria 31 “Materiale” me gjendjen në fund të periudhës 46,544,744 lekë, me një rritje prej 2,618,494 lekë në krahasim me vitin e kaluar.

-Llogaria 32 “Objekte Inventari” me gjendje në fund të periudhës 32,966,828 lekë, me një rritje prej 396,096 lekë në krahasim me një vit më parë.

-Klasa 4. “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët”

Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 423. “Personeli, paradhënie, defiçite e gjoba”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Gjendja në fund të periudhës është 4,334,829 lekë, një rritje prej 2,963,385 lekë. Nga këta:
-Debitorë mbi 5 vjet 750,921 lekë.

-Llogaria 468 “Debitorë te ndryshëm”.

Gjendja e saj në fund të periudhës është 3,567,674 lekë. Nga këto:

Debitorë mbi 5 vjet 307,269 lekë

Debitorë të krijuar në vitin 2014 në vlerën 1,786,100 lekë

Debitorë të krijuar në vitin 2015 në vlerën 168,184 lekë

Debitorë të krijuar në vitin 2016 në vlerën 1,306,125 lekë

-Klasa 5 “Llogaritë Financiare”

Gjendja e saj në fund të periudhës është 120,505,420 lekë. E analizojmë sipas llogarive që e përbëjnë:

-Llogaria 512. “Llogari në Bankë”.

Gjendja e saj në fund të vitit është 119,489,045 lekë. Bankat me të cilat operon Spitali Rajonal Durrës është Banka Credins si dhe Abi Bank. Për sa i përket burimit të këtyre fondeve ato përbëhen si më poshtë;

Gjendja e Bankës e analizuar më 31.12.2016

1	Të trashëguara	99,239,631
2	Të ardhura dytësore	20,093,589
3	Garanci qeraje	155,826
	Totali	119,489,046

-Llogaria 520 “Disponibilitete ne Thesar”.

Ka gjendje në fund të vitit vlerën 1,016,375 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat firmat i lënë në Thesar si garanci për investimin. Kjo shume nuk është tërhequr prej tyre deri më 31.12.2016. E analizuar kjo shumë analizohet si më poshtë:

1.Viti 2006 5% garanci punimesh leke 545,856.

2.Viti 2007 garanci leke 3,000.

3.Viti 2011 5% garanci punimesh leke 467,519.

Shuma e garancive që Spitali Rajonal Durrës i trashëgon për vitin 2016 është 1,016,375 lekë.

Pasivi i Bilancit

A.Fondet e Veta

-Llogaria 10 “Fonde të veta” në fund të vitit paraqitet me gjendje në vlerën 2,508,181,115 lekë. Kjo llogari përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 101 “FondeBazë” e cila në fund të vitit ka një gjendje prej 2,018,518,791 lekë, pra me një pakësim 73,740,581 lekë. Në këtë pakësim ndikojnë amortizimi i aktiveve 77,796,113, dalja e aktiveve nga përdorimi në vlerën 185,231 lekë, si dhe investimet e kryera në vlerën 2,280,246 lekë.

-Llogaria 106 “Grante të Huaja Kapitale” Gjendja në fund të periudhës është 396,762,176 lekë, pra me një rritje prej 44,007,823 lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i hyrjeve në magazine nga ndihmat.

-Llogaria 11 “Fonde të tjera të veta” në rastin tone kjo vlerë i korrespondon vlera e investimeve të likuiduara me fonde nga të ardhurat dytësore në shumën 1,136,928 lekë.

-Llogaria 115 “Caktim nga rezultati i vitit për investime” e cila në fund të vitit ka vlerën 1,136,928 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

B.Detyrimet.

-Klasa 4 "Detyrimet afatshkurtër" Gjendja në fund të periudhës paraqitet me vlerën =46,057,847 lekë pra me njëritje prej 10,438,350 lekë. Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 401 "Furnitorë paraqitet me saldo kreditore" 18,836,211 lekë. Të gjithë detyrimet që i përkasin kësaj llogarie janë shlyer në muajin janar dhe shkurt 2018.

-D.I. 47,838 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-K. 18,540 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-M. 212,404 lekë nga viti 2008 mall i pa shoqëruar me procedurën përkatëse

-N. 199,800 lekë faturë e thjeshtë pa kupon tatimor

- M. 4,632 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-Llogaria 42 "Personeli e llogari të lidhura me to" Gjendja në fund të vitit është 12,949,099 lekë dhe paraqet detyrimin e Spitalit për pagat e punonjësve të periudhës 16-31 dhjetor 2016.

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa". Gjendja e saj në bilanc është 1,778,579 lekë dhe paraqet vlerën e Tatimit për të ardhurat nga Punësimi të muajit dhjetor 2016, që paguhet në muajin janar 2017.

-Llogaria 435 "Sigurime Shoqërore" Gjendja e saj është 8,419,693 lekë dhe paraqet detyrimin për Sigurimet shoqërore të muajit dhjetor 2016 i cili paguhet në janar 2017.

-Llogaria 436 "Sigurime Shëndetësore" Pararqet edhe kjo shumën prej 1,168,060 lekë e cila është vlera e sigurimit shëndetësor të muajit dhjetor 2016 i cili paguhet në janar 2017.

-Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje". Gjendja e saj në fund të vitit është 1,013,375 lekë.

Kjo vlerë i takon garancive të mbajtura në thesar nga likuidimi i investimeve dhe konkretisht:

1.Viti 2006 5% garanci punimesh lekë 545,856 (S.)

2.Viti 2011 5% garanci punimesh lekë 467,519 (D.)

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" Në fund të vitit paraqitet me gjëndjen 1,892,830 lekë

Shpenzimet

Gjatë vitit 2016 janë kryer shpenzime si më poshtë:

-Llogaria 600 "Paga dhe shperblime te tjera personeli" 406,137,095 lekë

-Llogaria 601 "Kontribute te Sigurimeve shoqerore e shendetesore" 67,641,613 lekë

-Llogaria 602 "Mallra e sherbime te tjera" 316,792,695 lekë

Totali i llogarisë 60"Shpenzime Korrente" 787,556,813 lekë.

Të ardhurat

Në vitin 2016 të ardhurat paraqiten si më poshtë:

-Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore" 55,479,272 lekë e analizuar si më poshtë:

-Llogaria 710 "Nga ndërmarrjet dhe pronësia" 861,011 lekë, këtu përfshihen të ardhurat nga objektet e dhëna me qera.

-Llogaria 711 "Të ardhura sekondare e pagesa sherbimesh" 54,618,261 lekë e analizuar si më poshtë:

-Llogaria 7111 "Të ardhura sekondare e pagesa sherbimesh" 1,121,216 lekë

-Llogaria 7113 " Nga shitja e mallrave e sherbimeve" 49,397,390 lekë.

-Llogaria 7115 "Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime" 4,099,655 lekë

-Llogaria 72 "Grante Korrente" 770,000,000 lekë përfaqëson fondin e dhënë nga DRSKSH, për shpenzimet korrente.

Llogaria 7207 "Sponsorizime nga të tretë" 15,000 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Llogaria 76 “Të ardhura financiare” 111,309 lekë. Kjo llogari përmban të ardhurat nga interesat e llogarisë bankare në lekë.

ANALIZË E TREGUESVE FINANCIARË PËR VITIN 2017

Për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2017 gjendja Financiare e Spitalit Rajonal Durrës paraqitet si më poshtë:

Aktivi i Bilancit

A.I.Aktive të trupëzuara

1.Llogaria 205 “Konçesione, patenta, liçensa e të tjera të ngjashme”

Vlera 20,645,833 lekë. Në këtë llogari është pasqyruar vlera e programeve kompjuterike.

2. Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”.

Vlera 16,409,562 lekë. Kjo vlerë paraqet amortizimin e akumuluar të këtyre programeve, i llogaritur me normën e amortizimit 25% të vlerës së mbetur.

A.Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

1.Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”.

Paraqitet në fund të periudhës në vlerën 2,349,829,017 lekë, e cila në krahasim me fillimin e periudhës ka një ulje prej 1,206,210 lekë.

2.Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune.”

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 781,812,212 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i investimeve nga të ardhurat dytësore në këtë zë në vlerën 2,107,800 lekë, ndihmave të ardhura në vlerën 6,927,043 lekë dhe levizja brenda aktiveve për shumën 2,174,076 lekë. Në llogarinë 214 kemi paksim në shumën 1,085,033 lekë ku përfshihet (pjesët e autoambulancës dhënë urgjencës të Tiranës me vlerë 121,363 lekë dhe heqja nga kontabiliteti Spitalin e Shijakut me vlerë 963,670 lekë gjithashtu në këtë llogari kemi pakësim me vlerë 7,022,712 lekë nxjerrë jashtë përdorimit.

3.Llogaria 215 “Mjete Transporti”:

Paraqitet e ndryshuar nga viti i mëparshëm me vlerën 55,393,147 lekë. Kemi një ulje të këtij zëri me vlerë 7,610,024 lekë (ambulanca dërguar Urgjencës së Tiranës).

4.Llogaria 218 “Inventar ekonomik”.

Paraqitet në fund të periudhës me vlerën 154,812,117 lekë, pra me një ulje prej 1,727,123 lekë.

Në përbërje të kësaj llogarie janë dy nënlllogari:

a)218/1 “Orendi Zyre”.

E cila në fund të periudhës paraqitet me vlerën 113,624,866 lekë, pra me një rritje prej 4,858,924 lekë kjo rritje ka ardhur si rezultat nga ndihmat e ardhura. Paksim të këtij zëri me vlerë 4,855,033 lekë (heqja nga kontabiliteti i Spitalit të Shijakut) dhe materiale të nxjerra jashtë përdorimit me vlerë 714,356.

b)218/6 “Paisje Kompjuterike”.

Vlera në fund të periudhës e kësaj nënlllogarie është 41,187,251 lekë. Pra paraqitet me një ulje prej 1,016,626 lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të materialeve.

5.Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Në fund të vitit kjo llogari paraqitet me gjendjen 1,005,952,483 lekë: Amortizimi i llogaritur për vitin 2017 është si më poshtë:

-212. Ndërtesa amortizimi	23,495,064 lekë
-214. Pajisje, vegla pune	43,391,957 lekë
-215. Mjete transporti “	1,865,298 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-218/1. Inventar ekonomik 3,358,049 lekë

-218/6. Pajisje kompjuterike 7,635,333 lekë

Për pajisjet kompjuterike amortizimi është llogaritur në masën 25% të vlerës së mbetur.

Vlera totale e amortizimit e llogaritur për vitin 2017 është 79,745,701 lekë.

B. Aktive Qarkulluese.

Aktivitet qarkulluese në këtë bilanç kapin vlerën 219,816,734 lekë.

-Klasa 3. "Gjendje inventari"

Gjendja e saj në fund të vitit kap vlerën 86,525,079 lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm kjo klasë ka një rritje prej 7,013,507 lekë. Kjo rritje i përket llogarive përbërëse të kësaj klase dhe konkretisht:

-Llogaria 31 "Materiale" me gjendjen në fund të periudhës 59,210,082 lekë, me një rritje prej 12,665,338 lekë në krahasim me vitin e kaluar.

-Llogaria 32 "Objekte Inventari" me gjendje në fund të periudhës 27,314,998 lekë, me një ulje prej 5,651,830 lekë në krahasim me një vit më parë si pasojë e nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit.

-Klasa 4. "Kërkesa arkëtimi mbi debitorët"

Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 411. "Kliente e llogari të ngjashme"

Gjendja në fund të periudhës është 24,000 lek (pacientja ruse)

-Llogaria 423. "Personeli, paradhënie, defiçite e gjoba"

Gjendja në fund të periudhës është 3,141,392 lekë, një ulje prej 1,193,437 lekë. Nga këta:

-Debitorë mbi 5 vjet 701,589 lekë

-Në procese gjyqësore 2,062,804 lekë

Debitorë të krijuar në vitin 2014

-Nën 1 vit 39,764 lekë.

-Llogaria 468 "Debitorë te ndryshëm"

Gjendja e saj në fund të periudhës është 3,567,674 lekë. Nga këto:

-Debitorë mbi 5 vjet 307,269 lekë

Debitorë të krijuar në vitin 2014 në vlerën 1,786,100 lekë

Debitorë të krijuar në vitin 2015 në vlerën 168,184 lekë

Debitorë të krijuar në vitin 2016 në vlerën 1,306,125 lekë

-Klasa 5 "Llogaritë Financiare"

Gjendja e saj në fund të periudhës është 125,542,214 lekë.

-Llogaria 512. "Llogari në Bankë"

Gjendja e saj në fund të vitit është 125,542,214 lekë. Bankat me të cilat operon Spitali Rajonal Durrës është Banka Credins si dhe Abi Bank. Përsa i përket burimit të këtyre fondeve ato përbëhen si më poshtë;

Gjendja e Bankës e analizuar më 31.12.2017

1	Te trashëguara	99.901.406
2	Te ardhura dytesore	24.468.607
3	Garanci qeraje	155.826
	Totali	124.542.214

-Llogaria 520 "Disponibilitete ne Thesar"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Ka gjendje në fund të vitit vlerën 1,016,375 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat firmat i lënë në Thesar si garanci për investimin. Kjo shumë nuk është tërhequr prej tyre deri më 31.12.2017. E analizuar kjo shumë analizohet si me poshtë:

1.Viti 2006	5% garanci punimesh	lekë	545,856.
2.Viti 2007	garanci	lekë	3,000.
3.Viti 2011	5% garanci punimesh	lekë	467,519.

Shuma e garancive që Spitali Rajonal Durrës i trashëgon për vitin 2017 është 1,016,375 lekë.

Pasivi i Bilançit

A.Fondet e Veta

-Llogaria 10 "Fonde të veta"

në fund të vitit paraqitet me gjendje në vlerën 2,501,991,927 lekë,

Kjo llogari përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 101 "Fonde Bazë"

e cila në fund të vitit ka një gjendje prej 1,976,809,416 lekë, pra me një pakësim 41,709,375 lekë. Në këtë pakësim ndikojnë amortizimi i aktiveve 81,157,792, dalja e aktiveve nga përdorimi në vlerën 8,753,692 lekë, si dhe investimet e kryera në vlerën 3,075,666 lekë.

-Llogaria 106 "Grante të Huaja Kapitale". Gjendja në fund të periudhës është 396,762,176 lekë.

B.Detyrimet.

-Klasa 4 "Detyrimet afatshkurtër". Gjendja në fund të periudhës paraqitet me vlerën 78,807,174 lekë pra me një rritje prej 32,749,327 lekë. Kjo klasë përbëhet nga llogaritë si më poshtë:

-Llogaria 401 "Furnitorë paraqitet me saldo kreditore" 32,926,888 lekë. Inventarin e kësaj llogarie ia bashkëngjisim këtij bilançi. Të gjithë detyrimet që i përkasin kësaj llogarie janë shlyer në muajin janar dhe shkurt 2018.

-D.I. 47,838 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-K. 18,540 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-M. 212,404 lekë nga viti 2008 mall i pa shoqëruar me procedurën përkatëse

-N. 199,800 lekë faturë e thjeshtë pa kupon tatimor

- M. 4,632 lekë garanci e parashikuar në kontratë

-Llogaria 42 "Personeli e llogari të lidhura me to" Gjendja në fund të vitit është 31,361,835 lekë dhe paraqet detyrimin e Spitalit për pagat e punonjësve të periudhës 01-31 dhjetor 2017.

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa". Gjendja e saj në bilanc është 2,457,487 lekë dhe paraqet vlerën e Tatimit për të ardhurat nga Punësimi të muajit dhjetor 2017, që paguhet në muajin janar 2018.

-llogaria 435 "Sigurime Shoqërore. Gjendja e saj është 9,219,155 lekë dhe paraqet detyrimin për Sigurimet shoqërore të muajit dhjetor 2017 i cili paguhet në janar 2018.

-Llogaria 436 "Sigurime Shendëtsore" Pararqet edhe kjo shumë prej 1,297,804 lekë e cila është vlera e sigurimit shendëtsor të muajit dhjetor 2017 i cili paguhet në janar 2018.

-Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje". Gjendja e saj në fund të vitit është 1,013,375 lekë.

Kjo vlerë i takon garancive të mbajtura në thesar nga likuidimi i investimeve dhe konkretisht:

1.Viti 2006 5% garanci punimesh lekë 545,856 (S.)

2.Viti 2011 5% garanci punimesh lekë 467,519 (D.)

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" Në fund të vitit paraqitet me gjendjen 530,630 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Shpenzimet

Gjatë vitit 2017 janë kryer shpenzime si më poshtë:

- Llogaria 600 "Paga dhe shperblime te tjera personeli" 462,064,022 lekë
- Llogaria 601 "Kontribute te Sigurimeve shoqerore e shendetesore" 76,104,533 lekë
- Llogaria 602 "Mallra e sherbime te tjera" 370,191,805 lekë
- Totali i llogarisë 60"Shpenzime Korrente" 901,346,852 lekë.

Të ardhurat

Në vitin 2017 të ardhurat paraqiten si më poshtë:

- Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore" 49,525,408 lekë e analizuar si më poshtë:
- Llogaria 710 "Nga ndërmarrjet dhe pronësia" 1,584,772 lekë, këtu përfshihen të ardhurat nga objektete e dhëna me qera.
- Llogaria 711 "Të ardhura sekondare e pagesa sherbimesh" 47,940,636 lekë e analizuar si më poshtë:
- Llogaria 7111 "Të ardhura sekondare e pagesa sherbimesh" 4,141,822 lekë
- Llogaria 7112 "Taksë për veprime gjyqësore e noteriale" 427,100 lekë
- Llogaria 7113 " Nga shitja e mallrave e sherbimeve" 42,981,733 lekë.
- Llogaria 7115 "Gjoha, kamatvonesa, sekuestri e zhdemtime" 389,981 lekë
- Llogaria "Grante Korrente" 834,446,029 lekë përfaqëson fondin e dhënë nga DRSKSH, për shpenzimet korrente.
- Llogaria 7207 "Sponsorizime nga të tretë" 10,000 lekë.
- Llogaria 76 "Të ardhura financiare" 64,431 lekë. Kjo llogari përmban të ardhurat nga interesat e llogarisë bankare në lekë.

Si përfundim:

Nga auditimi i pasqyrave financiare të viteve 2015, 2016 dhe 2017, u konstatua se:

1. Llogaria 520 "Disponibilitete ne Thesar" ka gjendje vlerën 1,016,375 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat firmat i lënë në Thesar si garanci për investimin. Kjo shumë rezulton ende e pa tërhequr. E detajuar paraqitet si më poshtë:

Viti 2006	5% garanci punimesh	545,856 lekë
Viti 2007	garanci	3,000 lekë
Viti 2011	5% garanci punimesh	467,519 lekë

Shuma e garancive që Spitali Rajonal Durrës i trashëgon për vitin 2017 është 1,016,375 lekë. Gjithashtu llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" ka gjendja e saj në fund të vitit 1,013,375 lekë.

Kjo vlerë i takon garancive të mbajtura në thesar nga likuidimi i investimeve dhe konkretisht:

Viti 2006	5% garanci punimesh	545,856 lekë (S.)
Viti 2011	5% garanci punimesh	467,519 lekë (D.)

Nga sa më sipër, konstatohet se këto garanci punimesh janë të vjetra, dhe normalisht ose duhet të ishin paguar në favor të operatorëve ekonomik ose duhet të ishin mbajtur si penalitet për shkak të mospërmbushjes së kontratës në kohë apo defekteve gjatë periudhës së garancisë. Gjithashtu konstatohet se dy llogaritë kanë një diferencë prej 3,000 lekë, diferencë për të cilën nga ana e stafit të SRD nuk ka shpjegim, si dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për heqjen e këtyre vlerave nga këto llogari.

2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se:

Në aktivet e SRD figurojnë 8 godina. Të gjitha këto godina ndodhen brenda territorit të Spitalit me përjashtim të godinës së poliklinikës. Gjithashtu SRD zotëron edhe një pjesë të godinës së ish-befotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Shumica e godinave janë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

ndërtuara para vitit 1990 dhe si pasojë në ZRPP Durrës ka mungesa të theksuara të dokumentacionit teknik mbi sipërfaqet e ndërtimit të tyre. Gjatë vitit 2003 nga ana e ZRPP-së nëpërmjet fotografimit satelitor është bërë riazhurnimi i të gjitha pronave dhe si pasojë edhe godinat që përfshin SRD. Për sa më sipër statusi juridik i tyre është “Sheshe” dhe pronar “Shtet” gjë e cila ka sjellë që në sipërfaqen e ndërtimit është përfshirë vetëm njolla e objekteve (kati përdhe). Duke qënë se nga fotografimi satelitor nuk ishte përfshirë edhe godina e katërkatëshit, pasi është ndërtuar në vitin 2007, nga ana e SRD është kryer hipotekimi i saj. Sipas stafit të SRD, për hipotekimin rigoroz do të ishte e nevojshme dalja e një akti rregullator në lidhje me kalimin e pronës nga “Sheshe” në pronar “Shtet”, si dhe parashikimi i fondit të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit teknik, bazuar në kërkesat e hipotekës.

Në opinionin e grupit të auditimit, nga ana e drejtimit nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekor të saktë të Spitalit Rajonal Durrës.

3. Në klasën 4 Kërkesa arkëtimi mbi debitorët në bilancin e vitit 2017 rezulton të jetë 6,733,066 lekë, në vitin 2016 është 7,902,503 lekë dhe në vitin 2015 është 3,632,997 lekë. Pra në total për këto tre vite konstatohet se kjo klasë ka pësuar një rritje prej 3,100,069 lekë. Nga ana e SRD nuk rezulton të jenë analizuar shkaqet dhe pasojat e kësaj rritjeje, apo edhe veprimet që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës së debitorëve.

Procesi i inventarizimit vjetor

Inventarizimet fizike janë kryer sipas planit të përcaktuar nga Drejtoria. Janë ngritur komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, me urdhër të brendshëm. Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit ka bërë dhe propozimet për dalje nga përdorimi të aktiveve të cilat nuk janë në gjendje pune. Ka paraqitur raportin përmbledhës të shoqëruar me proces verbalet përkatëse për miratim tek Titullari. Pas miratimit të raportit përmbledhës komisioni për daljen nga përdorimi të aktiveve, i ngritur me urdhër të brendshëm nga titullari, ka bërë verifikimin dhe asgjësimin e aktiveve të propozuara për tu nxjerrë nga përdorimi duke hartuar dhe proces verbalet përkatëse. Pas kompletimit të dosjeve janë kryer edhe kontabilizimet.

U audituan me zgjedhje dy praktika të inventarizimit vjetor, saktësisht për vitin 2016 dhe 2017. Për këto dy vite, procesi i inventarizimit është kryer konform udhëzimit nr. 30 datë, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Për vitin 2016 janë evidentuar diferenca në vlerën 208,198 lekë (nga të cilat 175,572 për shkak të një vjedhjeje), teprica në vlerën 47,405 lekë, dhe materiale për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 6,710,191 lekë. Për vitin 2018 janë evidentuar diferenca në vlerën 45,195 lekë, teprica në vlerën 2,924 lekë dhe materiale për nxjerrje jashtë përdorimi në vlerën 59,722,888 lekë.

Në lidhje me diferencat e konstatuara, janë caktuar dhe ngarkuar përgjegjësit material për to dhe është bërë arkëtimi i tyre, ndërsa në rastin e tepricave, ato kanë kaluar në favor të Spitalit Rajonal Durrës. *Por nga auditimi i praktikave dhe më tej, nuk rezulton të jetë kryer asnjë analizë mbi këto diferenca apo qoftë edhe tepricat e konstatuara, me qëllim shmangien në të ardhmen dhe parandalimin e tyre.*

III.5.2. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në menaxhimin e aktiveve të spitalit

Në zbatim të Programit të Auditimit u konsiderua si e nevojshme zhvillimi, në ambientet e magazinës, i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së Z. B.D. dhe Znj. J.Zh., në prezencë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

përfaqësuesve të subjektit të auditimit Znj. A.M. me detyrë Shefe farmacie, Znj. A.M., me detyrë farmacistë dhe Znj. M.M., me detyrë farmacistë.

Grupi i auditimit në datën 19.03.2019 kreu një verifikim në magazinat e medikamenteve të Spitalit Rajonal Durrës, për të cilën u mbajt Akverifikimi nr. 1, protokolluar në datën 20.03.2019 me nr. 573 prot. Ky aktverifikim u nënshkrua nga grupi i auditimit i përbërë nga B. D., J. Zh. dhe A. G., si dhe nga përfaqësuesit e SRD A. M., A.M. dhe M.M. Grupi i auditimit verifikoi gjendjen kontabël nëpërmjet sistemit të Financa 5, gjendjen fizike si dhe fletë daljet të cilat ende nuk ishin hedhur në sistem. Nga verifikimi rezultuan mungesa të disa medikamenteve, ndër të cilat edhe medikamente të konsideruara si “drogëra të forta”, teprica në disa medikamente, si dhe 7 (shtatë) flakona Dopamin të cilat kanë kaluar afatin e skadencës.

Grupi i auditimit verifikoi me zgjedhje në total 10 lloje medikamentesh duke u orientuar drejt vlerës ekonomike dhe rëndësisë së përdorimit. Saktësisht u verifikuan: Metronidazole, Dopaminë, Petidinë, Morfinë, Filma Radiologji 35-35, Filma Radiologji 30-40, Mesh e madhe, Mesh e vogël, Kartrixhe, Sevofluran.

Saktësisht rezultuan:

1. Mangësi në gjendjen fizike kundrejt asaj kontabël si më poshtë:

Medikamenti	Gjendja Kontabël	Gjendja fizike	Diferenca	Vlera totale (në lekë)
Metronidazole	3001	3000	1	80
Petidinë	177	166	11	1,650
Morfinë	2962	2959	3	520
Dopaminë	1030	1025	5	246
Mesh e vogël	136	125	11	81,510
TOTAL			31	84,006

Shënim: Si gjendje kontabël është konsideruar gjendja e nxjerrë nga sistemi. Si gjendje fizike është konsideruar, gjendja reale në magazinë plus sasia e shënuar e fletë daljeve të cilat nuk ishin hedhur ende në sistem.

Mangësitë e konstatuara janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”. **Vlera 84,006 lekë përbën dëm ekonomik** për Spitalin Rajonal Durrës, dhe në bazë të udhëzimit të mësipërm pika 89, ku citohet “Në rast se pas inventarizimit dalin ndryshime në vleftë, mungesa mbetet në ngarkim të punonjësit me përgjegjësi materiale, kurse tepricat bëhen hyrje në magazinë dhe shkojnë në dobi të njësisë”, përgjegjësia për këtë vlerë i ngarkohet përgjegjëses së farmacisë së SRD, A.M.

2. Tepricë në gjendjen fizike kundrejt asaj kontabël si më poshtë:

Medikamenti	Gjendja Kontabël	Gjendja fizike	Diferenca
Filma Radiologji 30 – 40	55	65	10
Filma Radiologji 35 – 35	55	65	10
Mesh e madhe	45	52	7

Shënim: Si gjendje kontabël është konsideruar gjendja e nxjerrë nga sistemi. Si gjendje fizike është konsideruar, gjendja reale në magazinë plus sasia e shënuar e fletë daljeve të cilat nuk ishin hedhur ende në sistem.

Tepricat e konstatuara janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”. Për tepricat e konstatuara mban përgjegjësi përgjegjësja e farmacisë së SRD, A.M.

Vlera e tepricave kalon në favor të SRD.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

3. U gjendën 7 flakona Dopaminë 50 mg/10ml, të bërë hyrje me fletë hyrje nr. 364, datë 02.11.2018 nga Spitali i Përmetit. Këto flakona kanë datë skadence 11/2018, pra në momentin e hyrjes, kanë qënë të të skaduar. Këto flakona janë bërë dalje me fletëdaljet nr. 6579 datë 12.11.2018 sasia 5 copë, dhe nr. 6663 datë 16.11.2018 sasia 2 copë. Aktualisht edhe pse në kontabilitet gjendja është zero, gjendja fizike e tyre është 7, të cilat janë të skaduar.

Grupi i auditimit e vlerëson këtë situatë me risk mjaft të lartë, për arsye se:

-Janë bërë hyrje medikamente të skaduara, madje në këtë rast kemi të bëjmë me një medikament të rëndësisë së lartë.

-Janë kryer veprime kontabël në mënyrë të pa argumentuar, pasi këto flakona vazhdojnë të jenë në magazinën e spitalit, madje në gjendje të sakduar.

Për këtë mban përgjegësi përgjegjësjë e farmacisë së SRD, A.M.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 “Për Miratimin E Rregullores “Për Administrimin E Mbetjeve Spitalore””



III.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave

1. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave, u konstatua se:

Spitali Rajonal Durrës për periudhën 01.01.2015-31.12.2018, ka zhvilluar gjithsej 309 procedura prokurimi me vlerë 1,518,599 mijë lekë.

Nga 309 procedura të zhvilluara, 238 procedura (77% të tyre) janë zhvilluar ana nga Ministria e Shëndetësisë, si Blerje e Përqendruar dhe/ose Marrëveshje Kuadër, ndërsa 71 procedura janë zhvilluar nga Spitali Durrës.

Nga këto procedura janë përzgjedhur për tu audituar, 37 procedura (52% ndaj totalit) prokurimi me vlerë 299,898 mijë lekë.

Shumica e procedurave (**77% të tyre**) janë zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë, si Blerje e Përqendruar dhe/ose Marrëveshje Kuadër, e konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Realizuar gjithsej	Procedura të Përqendruara	Përqindja
Viti 2016	58	52.00	90%
Viti 2017	108	94.00	87%
Viti 2018	100	92.00	92%

Për procedurat e zhvilluara nga Ministria, grupi i auditimit verifikoi zbatimin e tyre, ndërsa për ato të zhvilluara nga vetë Spitali, u audituan dhe procedura e prokurimit.

Nga auditimi u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Pavarësisht nga sa cituam më sipër, nga auditimi i këtyre procedurave u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave, kryesisht si më poshtë vijon:

-Dosjet e procedurave të zhvilluara nuk janë të arkivuar, por mbahen në zyrat e sektorit të prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13.

-Nuk janë kryer trajnime të stafit që bëjnë pjesë e komisioneve të caktuara në procedurat e prokurimeve publike, çka ka rezultuar në mos kuptimin e plotë të legjislacionit të prokurimit publik nga këta punonjës, kryesisht stafi mjekësor.

-Në të gjitha rastet e audituara nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në procedurën e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Pediatrisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me vlerë kontrate 166,660,826.5 lekë pa TVSH, përlllogaritja e vlerës së kontratës është kryer në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28.

-Në 3 raste janë vendosur kërkesa dhe kriterë për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26.

-Në 2 raste, procesi i vlerësimit është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Në 2 raste, Raporti Përmbledhës është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 68.

-Në 1 rast, formulari i njoftimit të nënshkrimit të kontratës, është dërguar 9 muaj me vonë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 25, pika 1.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës” me vlerë kontrate 166,660,826.5 lekë pa TVSH, u konstatua se Formulari nr. 1 “Oferta ekonomike”, e paraqitur, është përcaktuar se vlera e pajisjeve pa tvsh është 56,450,298 lekë, tatimi në vlerën e shtuar në vlerën 11,290,059.6 lekë, dhe shuma totale në vlerën 67,740,357.6 lekë. Pra B.E.-A. SHPK & V.K.SHPK & M. SHPK, ka ofertuar pajisjet me tvsh në vlerën 11,290,059.6 lekë, e për pasojë oferta nuk duhej kualifikuar, edhe pse KVO në vlerësimin e saj nuk e ka përmendur këtë fakt.

-Në 1 rast, në vlerën e përlllogaritur të kontratës është vendosur vlera e TVSH së pajisjeve në shumën 17,659,428 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, kreu I, gërma A. Duke genë se në procedurën e prokurimit është përdorur vlera pa TVSH, nuk ka patur efekte financiare nga kjo përlllogaritje.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Zhvillim i procedurave të prokurimit publik jo në përputhje me LPP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: -Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj, titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt.

-Nga titullari i AK, të merren masa për kryerjen e trajnimeve të nevojshme për punonjësit që janë pjesë të komisioneve të procedurave të prokurimit publik, me qëllim sigurimin e një procesi sa më transparent në përmbushje të qëllimit të LPP.

Vazhdimisht

2. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e zbatimit të kontratave.

Situata:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës (Marrëveshjes Kuadër) nr. 1830, datë 05.09.2016 “Për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë së Spitalit Rajonal Durrës”, u konstatua se:

-Sipas kontratës së nënshkruar, afati i dorëzimit është brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, pra data e fundit e dorëzimit është data 16.03.2017. Për faturat nr. 501330, datë 21.03.2017 dhe nr. 501337, datë 21.03.2017, afati i dorëzimit ka kaluar me 5 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar në vlerën 69,248 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

-Për faturën tatimore nr. 501360, datë 28.03.2017, me vlerë 68,630 lekë, afati i dorëzimit ka kaluar me 12 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar në vlerën 84,759 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Për faturën tatimore nr. 6541502505, datë 10.04.2018, me vlerë 610,590 lekë, afati i dorëzimit ka kaluar me 2 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar në vlerën 4,885 lekë ($610,590 * 2 \text{ ditë} * 4/1000$), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës (Marrëveshjes Kuadër) nr. 1830, datë 05.09.2016 “Për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë së Spitalit Rajonal Durrës”, u konstatua se:

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, e konkretisht procesverbaleve të marrjes në dorëzim, në mungesë të verifikimit fizik të mallrave, për arsye se nga deklarimi verbal i drejtuesve të spitalit dhe drejtuesve të shërbimit të ortopedisë, këto materiale janë konsumuar të gjitha, konstatohet se për materialin e mjekimit “Cementi kockorë”, të sjellë me anë të faturës tatimore nr. 6541502505, datë 10.04.2018, me vlerë 68,630 lekë dhe me anë të faturës tatimore nr. 6541502143, datë 31.10.2017, me vlerë 68,630 lekë, origjina e këtij materiali është Fabrika M. në Poloni, ndërsa sipas kontratës duhej të ishte fabrika B., Zvicër.

Si rezultat i kësaj, arrihet në përfundimin se B.T.SHPK dhe L. SHPK, nuk ka sjellë materialet në përputhje me kontratën e nënshkruar, e për pasojë vlera e materialit të mjekimit “Cementi kockorë” në shumën 137,260 lekë, përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 911/7, datë 14.06.2017 “Blerje medikamente”, u konstatua se:

Nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 2172, datë 28.06.2017, me vlerë 19,200 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 40,800 lekë, por është sjellë më pak në vlerën 21,600 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore të datës 01.12.2017, pra 156 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, në vlerën 15,912 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

Ndërsa për faturën tatimore nr. 3063, datë 28.09.2017, me vlerë 6,000 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 40,800 lekë, por është sjellë më pak në vlerën 34,800 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore të datës 01.12.2017, pra 140 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, në vlerën 14,280 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 992/8, datë 22.05.2017 “Blerje medikamente”, u konstatua se:

Nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 2173, datë 28.06.2017, me vlerë 105,000 lekë, malli i sjellë duhej të ishte sjellë më datë 05.06.2017, por është sjellë më datë 28.06.2017, pra 23 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, **në vlerën 2,415 lekë**, vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit**.

Ndërsa për faturën tatimore nr. 2895, datë 12.09.2017, me vlerë 105,000 lekë, malli i sjellë duhej të ishte sjellë më datë 22.06.2017, por është sjellë më datë 12.09.2017, pra 82 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, **në vlerën 8,610 lekë**, vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 770/7, datë 05.05.2017 “Blerje medikamente”, lidhur me OE F. SHPK, u konstatua se:

Nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 8492, datë 27.06.2017, me vlerë 222,000 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 398,000 lekë, por është sjellë më pak në vlerën 176,000 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore nr. 3076, datë 11.07.2017, pra 37 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, në vlerën 36,815 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe kontratat respektive.

Ndikimi/Efekti: Penalitete të pa mbajtura nga AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerave të mësipërme, nga OE të sipërpërmendur, për arsye se këto vlera përbëjnë dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

3. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e zbatimit të kontratave.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratave me objekt “Asgjësimit i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se:

Për periudhën objekt auditimi, janë realizuar gjithsej 6 kontrata për asgjësim të mbetjeve spitalore, për vlerën totale 20,904,861.60 lekë, më hollësisht sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Kontrata	Vlera me tvsh
1	Nr. 707/2 Prot., datë 29.04.2016	4,762,908.00
2	Nr. 59/6 Prot., datë 11.01.2017	952,581.60
3	Nr. 1218/6 Prot., datë 01.06.2017	1,959,600.00
4	Nr. 708/16, datë 07.08.2017	4,477,584.00
5	Nr. 47/2 Prot., datë 10.01.2018	852,444.00
6	Nr. 61/16 Prot., datë 26.04.2018	7,899,744.00
7	Shuma	20,904,861.60

Në lidhje me këto kontrata konstatohet se:

-Nga grupet e monitorimit të kontratave, janë ndjekur procedurat për peshimin e mbetjeve spitalore, para dorëzimit tek kontraktori, por nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme për verifikimin nëse këto mbetje janë asgjësuar apo jo, në kundërshtim me kushtet e kontratave të lidhura (*Specifikimet teknike: Metodat për trajtim dhe asgjësim*).

-Në kontratat e nënshkruara, është prokuruar shërbimi i asgjësimit për mbetjet me kod 18 01 01 “Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)”, 18 01 02 “Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)”, 18 01 03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet”, si dhe 18 01 07 “Kimikate të tjera nga ato të përmendura në 18 01 06”. Por nga verifikimi i listës së mbetjeve spitalore të rrezikshme spitalore të prodhuara nga SRD, konstatohet se për periudhën 2016-2018, janë prodhuar gjithsej **373 kg** mbetje të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

krijuara nga pavioni i Paliativit, mbetje të cilat sipas VKM nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, janë me kod 18 01 08 “*Medikamente citostatika dhe citotoksike*”, e si të tilla janë mbetje shumë të rrezikshme dhe toksike, të cilat SRD i ka trajtuar si mbetjet e tjera spitalore.

Në lidhje me mbetjet spitalore, përveç parregullsive financiare dhe ligjore të konstatuara në kryerjen e këtij shërbimi, duhet të merren parasysh dhe pasojat mjedisore dhe shëndetësore që mund të vijnë si pasojë e mos ndjekjes nga SRD të procedurave ligjore rigoroze në trajtimin e të mbetjeve të rrezikshme citostatike dhe citotoksike.

Dokumentacioni i mbajtur nga SRD në lidhje me këto procedura, nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, e për pasojë nuk mund të quhen dokumente financiare.

Për pasojë, grupi i auditimit **nuk mund të shprehet mbi saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë** e kryerjes së shërbimit të asgjësimit të mbetjeve spitalore, për 6 kontratat e lidhura për periudhën 2016-2018, me vlerë 20,904,861.60 lekë. Në mungesë të dokumentacionit të duhur ligjor dhe financiar, që do provonte kryerjen e këtij shërbimi nga OE të kontraktuar nga SRD, vlera 20,904,861.60 lekë, përbën një shpenzim të pa argumentuar dhe të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60;

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3;

VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 8, e cila përcakton se: “Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre”;

VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 5, e cila përcakton se: “5. Prodhuësit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për:

- a) grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor;
- b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;
- c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;
- d) shpenzimet e transportit, asgjësimit ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi, për të ndërmarrë këto veprimtari;
- e) të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.”, pika 8, e cila përcakton se: “Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre”, si dhe pika 8.1, e cila përcakton se: “Çdo prodhues ndan që në burim elementet e rrezikshme nga ato të parrezikshme të mbetjeve spitalore, sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore dhe i magazinon ato të ndara”;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, e cila përcakton se: ““Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkaktun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36, e cila përcakton se: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundesine për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ate të mashtrimeve”.

Ndikimi/Efekti: Materiali mjekësor i sjellë nuk është në përputhje me kontratën.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën **20,904,861.60 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurave të prokurimit me objekt “Asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, si dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **një shpenzim të pa argumentuar dhe të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës.**

Menjëherë

4. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e zbatimit të kontratave.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017 “Blerje Oksigjen lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, lidhur me OE M.A. SHPK, u konstatua se:

Me anë të 41 faturave tatimore, OE M.A. SHPK, i caktuar për zbatimin e kësaj kontrate sipas marrëveshjes së bashkimit të OE, ka sjellë në ambientet e Spitalit Rajonal Durrës sasinë prej 122,210 litra oksigjen të lëngshëm. Por sipas Aneksit nr. 2, të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017, sasia e kontraktuar është 122,240 litra oksigjen të lëngshëm. Nuk konstatohet arsyeja e mos dorëzimit të sasisë së kontraktuar, si dhe nga AK nuk janë marrë masa për konfiskimin e sigurimit të kontratës dhe njoftimin në APP për mos zbatimin e kontratës nga ky B. Për pasojë AK, duhet të konfiskonte formularin e sigurimit të kontratës nr. 46451579, datë 21.02.2017, me vlerë 1,711,360 lekë, si dhe të njoftonte APP për mos realizimin e kësaj kontrate nga ky OE.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe kontrata nr. 433, datë 23.02.2017.

Ndikimi/Efekti: Penalitete të pa mbajtura nga AK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik, të merren masat për konfiskimin e sigurimit të kontratës nr. 46451579, datë 21.02.2017, me vlerë 1,711,360 lekë nga OE M.A.SHPK, si dhe të përcillet në APP informacioni mbi zbatimin e kësaj kontrate.

Menjëherë

5. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e zbatimit të kontratave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017 “Blerje Oksigjen lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, u konstatua se:

Në lidhje me sasinë, konstatohet se kontraktori M.A. SHPK, e sjell sasinë në kilogramë, sasia e cila për këtë kontratë është 139,442 kg ose 122,210 litra. Më pas sasia e sjellë në kilogramë, është konvertuar në litra nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe OE M.A. SHPK, sipas koeficientit 1.141 kg/lt. Por sipas Aneksit nr. 2, të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017, koeficienti i konvertimit është 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), e si i tillë ky është koeficienti me të cilin duhej të përdorej nga kontraktori M.A. SHPK.

Nëse bëhen rilogaritjet me koeficientin 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), atëherë për sasinë 139,442 kg, sasia reale në litra e furnizuar nga kontraktori do jetë 104,294 lt oksigjen të lëngshëm.

Si konkluzion, nga përdorimi i koeficientit në kundërshtim me atë të përcaktuar në kontratë, kontraktori M.A. SHPK **ka sjellë më pak 17,916 litra oksigjen të lëngshëm** (122,210 lt – 104,294 lt), ose në vlerën **2,508,184 lekë** (e konvertuar me çmimin 140 lekë/lt), **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3 dhe kontrata nr. 433, datë 23.02.2017.

Ndikimi/Efekt: Materiali mjekësor i sjellë nuk është në përputhje me kontratën.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **2,508,184 lekë**, nga OE M. A. SHPK, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

6. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e zbatimit të kontratave.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës (Marrëveshjes Kuadër) nr. 911/10, datë 23.04.2018 “Blerje Oksigjen lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, u konstatua se:

Në lidhje me sasinë, konstatohet se kontraktori M. A. SHPK, e sjell sasinë në kilogramë, sasia e cila për këtë kontratë është 152,386 kg, deri më 31.12.2018. Më pas sasia e sjellë në kilogramë, është konvertuar në litra nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe OE M. Albagaz SHPK, sipas koeficientit 1.141 kg/lt. Duke qenë se në Kontratën nr. 1 të Furnizimit nr. 1198/8, datë 11.05.2018, nuk përcaktohej koeficienti i konvertimit nga kilogramë në litra që do përdoret, grupi i auditimit i referohet koeficientit 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), të përdorur në kontratën nr. 433, datë 23.02.2017.

Për pasojë, nëse bëhen rilogaritjet me koeficientin 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), atëherë për sasinë 152,386 kg, sasia reale në litra e furnizuar nga kontraktori do jetë 113,976 lt oksigjen të lëngshëm.

Si konkluzion, nga përdorimi i koeficientit të pamiruar, kontraktori M.A. SHPK **ka sjellë më pak 19,579 litra oksigjen të lëngshëm** (133,555 lt – 113,976 lt), ose në vlerën - **2,682,288 lekë** (e konvertuar me çmimin 137 lekë/lt), **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3 dhe kontrata nr. 433, datë 23.02.2017.

Ndikimi/Efekt: Materiali mjekësor i sjellë nuk është në përputhje me kontratën.

Rëndësia: E lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **2,682,288 lekë**, nga OE M.A. SHPK, për arsye se kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

SRD për çdo vit ka dërguar në APP, regjistrat e parashikimit dhe realizimit, të procedurave të prokurimit. Nga auditimi i këtyre dokumenteve, u konstatua se:

Për vitin 2015: Regjistri i Parashikimit për vitin 2015, është dërguar në APP (dhe Institucione te tjera) me shkresën nr. 95, datë 15.01.2015. Numri i procedurave të parashikuara për vitin 2015, është 31, në vlerën 263,975,000 lekë pa TVSH. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ka patur ndryshime të regjistrit të realizimit.

Regjistri i Realizimit për vitin 2015, është dërguar në APP me shkresën nr. 18, datë 07.01.2016. Për vitin 2015, janë realizuar gjithsej 43 procedura (në investime dhe shpenzime) me vlerë fondi limit 289,305,390 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate 290,504,270 lekë me TVSH.

Për vitin 2016: Regjistri i Parashikimit për vitin 2016, është dërguar në APP (dhe Institucione te tjera) me shkresën nr. 103, datë 15.01.2016. Numri i procedurave të parashikuara për vitin 2016, është 51, në vlerën 554,349,560 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 498, datë 23.02.2016, është dërguar ndryshimi në regjistrin e parashikimit, në APP. Janë ndryshuar 11 procedura ku 10 prej tyre janë pakësuar me një vlerë prej 29,073,000 leke pa tvsh dhe një procedurë është shtuar me vlerën 1,167,000 leke pa tvsh.

Regjistri i Realizimit për vitin 2016, është dërguar në APP me shkresën nr. 53, datë 10.01.2017. Për vitin 2016, janë realizuar gjithsej 58 procedura (në investime dhe shpenzime) me vlerë fondi limit 341,913,274.9 lekë pa tvsh dhe me vlerë kontrate 360,579,358.25 lekë me tvsh.

Për vitin 2017: Regjistri i Parashikimit për vitin 2017, është dërguar në APP (dhe Institucione te tjera) me shkresën nr. 355/1, datë 28.02.2017. Numri i procedurave të parashikuara për vitin 2017, është 100, në vlerën 527,034,402 lekë pa tvsh.

Regjistri i Realizimit për vitin 2017, është dërguar në APP me shkresën nr. 50/1, datë 10.01.2018. Për vitin 2017, janë realizuar gjithsej 108 procedura (në investime dhe shpenzime) me vlerë fondi limit 535,924,079.56 lekë pa tvsh dhe me vlerë kontrate 504,248,545.71 lekë me tvsh.

Për vitin 2018: Regjistri i Parashikimit për vitin 2018, është dërguar në APP (dhe Institucione te tjera) me shkresën nr. 817, datë 23.03.2018. Numri i procedurave të parashikuara për vitin 2018, është 82, në vlerën 435,201,839 lekë pa tvsh.

Regjistri i Realizimit për vitin 2018, është dërguar në APP me shkresën nr. 87/1, datë 10.01.2019. Për vitin 2018, janë realizuar gjithsej 100 procedura (në investime dhe shpenzime) me vlerë fondi limit 485,156,232.39 lekë pa tvsh dhe me vlerë kontrate 363,266,753.25 lekë me tvsh.

Ndryshimet për vitin 2018, janë si më poshtë vijon:

Me shkresën nr. 817/1, datë 06.04.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Ndryshimin e vlerës së zërit “Sigurim Ndërtesash”, i miratuar në buxhet me vlerë 2,500,000 lekë dhe i parashikuar për prokurim me vlerë 2,083,333 leke pa tvsh. Në zbatim të Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 53, pika a) “...shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit, ky lloj shërbimi është i përjashtuar nga TVSH”, ky zë u rihap në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve të vitit 2018, me vlerën 2,500,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 1165, datë 27.04.2018

Për ndryshimin e afateve të realizimit të disa procedurave.

Me shkresën nr. 1381, datë 16.05.2018

Për ndryshimin e afateve të realizimit të disa procedurave si edhe për ndarjen e objektit të prokurimit në dy zëra prokurimesh me vlera të vogla: një për Mirëmbajtje Ashensorësh dhe një tjetër për Blerje Pjesë për Ashensorët.

Me shkresën nr. 1496, datë 31.05.2018

Rihapjen e procedurës së prokurimit si element të ndryshuar të regjistrit me objekt “Blerje e Shërbimit të Ruajtjes së Sigurisë Fizike”, me fond 13,683,216 lekë pa TVSH të parashikuar për tu prokuruar në muajin Qershor 2018. Meqenëse kontrata për këtë procedure do të ekzekutohet edhe me fonde të vitit 2019, është marrë miratimi i Bordit Drejtues të Spitalit për përdorimin e fondeve të të ardhurave dytësore për vitin 2019.

Fondi i miratuar për investim në riparimin e murit rrethues të spitalit, është rialokuar për tu përdorur për “Hidroizolim tarrace” si edhe për “Blerje Pompa vakumi”. Përmes shkresës nr. 100/97, datë 10.04.2018, MSHMS ka miratuar e fondin në vlerën 4,215,200 lekë për kryerjen e zërit të investimit “Hidroizolim tarrace”.

Për ndryshimin e afateve të realizimit të disa procedurave.

Me shkresën nr. 1496/1, datë 29.06.2018

Për ndryshimin e afateve të realizimit të disa procedurave

Me shkresën nr. 1787, datë 05.07.2018

Krijimin e zërit të regjistrit të parashikimit të prokurimeve për procedurën e Prokurimit me Vlera të Vogla me objekt “Blerje materiale kancelarie” me fond limit 541,666.67 lekë pa tvsh. Kjo procedurë prokurimi është parashikuar të kryhej përmes prokurimit të përqendruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, së cilës i është nisur kërkesa me materialet përkatëse me shkresën nr. 892, datë 30.03.2018. Me shkresën nr. 344/1 datë 11.04.2018 prot. Protokolluar në SRD me nr 892/1 datë 18.04.2018, MPB ka kthyer përgjigje ku sqaron se në zbatim të VKM nr. 82, datë 14.02.2018, për mallrat vlera e të cilave gjatë një viti kalendarik është nën 800,000 lekë pa tvsh, prokurimi do të kryhet nga vetë AK.

Me shkresën nr. 1808, datë 09.07.2018

Rikrijimin e zërit të regjistrit të parashikimit të prokurimeve për procedurën e prokurimit me “Kërkesë për Propozim” me objekt “Mirëmbajtje Aparaturash Mjekësore”, me fond limit 1,601,965 lekë pa tvsh të parashikuar për tu prokuruar në muajin Korrik 2018. Ky zë regjistri rikrijohet për prokurimin e Loteve 2,3,4, të anuluar në procedurën e parë të prokurimit të cilat nuk mund të publikoheshin në zërin aktual të regjistrit të parashikimit të prokurimeve për vitin 2018, pasi kishte kaluar afati (periudha e parashikimit) për publikim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me shkresën nr. 1825, datë 10.07.2018

Rikrijimin e zërit të regjistrit të parashikimit të prokurimeve për procedurën e Prokurimit me “Kërkesë për Propozim” me objekt “Blerje Aksesorë për Aparaturat Mjekësore”, me fond limit 1,388,200 lekë pa tvsh, të parashikuara për tu prokuruar në muajin Korrik 2018. Ky zë regjistri rikrijohet për prokurimin e Loteve 2,3 të anuluar në procedurën e parë të prokurimit të cilat nuk mund të publikoheshin në zërin aktual të regjistrit të parashikimit të prokurimeve për vitin 2018.

Me shkresën nr. 1863, datë 13.07.2018

Pas anulimit të lotit 5 të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Kite Reagentë”, për arsye të mungesës së konkurrencës, është rihapur ky zë i regjistrit për rishpalljen sërish të procedurës për blerjen e mallrave të parashikuara në këtë lot të anuluar.

Me shkresën nr. 1976, datë 27.07.2018

Referuar shkresës së MSHMS nr. 882/2, datë 26.04.2018 dhe shkresës nr. 4169, datë 03.07.2018 “Mbi dhënien e lejes për blerjen nga vetë institucionet spitalore të disa barnave për lotet e anuluar në procedurat e përqendruara të prokurimit publik për vitin 2018” sipas së cilës është dhënë leja për Spitalin Durrës për mbulimin e nevojave për periudhën 12 mujore bazuar në planifikimin vjetor 2018 të dërguar në MSHMS, është paraqitur nga Sektori i Farmacisë kërkesa nr. 1240/1, datë 27.07.2018, për “Blerje medikamente për Spitalin Rajonal Durrës” për të plotësuar nevojat spitalore. Sipas sasive dhe vlerës së medikamenteve të kërkuara për tu prokuruar në këtë procedurë, është krijuar ky zë parashikimi në regjistrin e parashikimit të prokurimeve të vitit 2018.

Me shkresën nr. 2016, datë 31.07.2018

Sipas shkresës nr 505, datë 16.02.2018 është dërguar nga MSHMS çelja e buxhetit për vitin 2018, për shpenzime kapitale në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në të cilën ishte specifikuar fondi i miratuar për shpenzimet e supervizimit për projektin e rikonstruksionit të godinës së pediatriisë së Spitalit Rajonal Durrës. Pas rishikimeve të zërave të preventivit nga kompania projektuese sipas manualit të çmimeve të ndërtimit të vitit 2015, ndryshoi vlera totale e zbatimit të projektit, arsye për të cilën MSHMS ridërgoi shkresën nr. 2544/3, datë 05.06.2018, me objekt “Dërgohet miratimi i transferimit të fondeve të investimeve”, ku u pasqyruan shtesat/pakësimet vjetore të miratuara për këtë shërbim. Në zbatim të saj, sipas shkresës nr. 1997/1, datë 30.07.2018, është dërguar vlera e fondit limit për prokurimin me objekt “Supervizion i Rikonstruksionit të Godinës së Pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës” nga grupi i punës, për të cilin është rihapur ky zë buxheti.

Me shkresën nr. 2279, datë 07.09.2018

Pas anulimit të lotit 1 të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Kite Reagentë”, për arsye të kërkesës për rishikimin e fondit nga grupi i punës i ngritur nga AK, kërkesë e ardhur si rezultat i paraqitjes së ankesave nga disa OE, është rihapur ky zë me fond të rishikuar.

Me shkresën nr. 2477, datë 02.10.2018

Elementi i Regjistrit me fond limit 1,666,166.67 me objekt “Blerje Pajisje dhe Instalime për Sistemin e Receptonit për Spitalin Rajonal Durrës”. Pasi ka evidentuar se deri më datë 28.09.2018, AKSHI ende nuk ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Pajisje dhe Instalime për Sistemin e Receptonit për Spitalin Durrës”, sipas kërkesës së SRD



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

nr. 2077, datë 10.08.2018, Spitali Rajonal Durrës ka bërë një rivlerësim të nevojave në bazë të situatës financiare të institucionit. Është rishikuar kërkesa për blerje Pajisje dhe Instalime për Sistemin e Receptonit dhe SRD ka vendosur të instalojë sistemin e rradhës në ambientet e “Poliklinikës së Specialiteteve”, me fond limit 250,000 lekë pa tvsh. Përmes shkresës nr 2077/2 datë 28.09.2018, SRD ka vënë në dijeni edhe AKSHI për të ndaluar vazhdimin e hapave të mëtejshëm për kryerjen e procedurës për blerje të përqendruar me vlerën 1,666,166.67 lekë pa tvsh, dhe ka njoftuar se Spitali Rajonal Durrës do të kryejë vetë prokurimin për procedurën me objekt si më lart, duke qenë se ajo është mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla (nën 800,000 lekë pa tvsh).

Me shkresën nr. 2832, datë 22.11.2018

Duke iu referuar njoftimit nr. 10140, datë 15.11.2018 të APP, rekomandohet që “AK të fillojnë procedurat e prokurimit për objektet (mall/punë/shërbim) të parashikuara për vitin 2019, për sa kohë që fondet i kanë të parashikuara dhe brenda kufirit buxhetor për vitin 2019” si edhe “krijimin në SPE të elementit përkatës të procedurës së prokurimit që do të zhvillojnë, për mbulimin e nevojave të vitit 2019, në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2018”, edhe në zbatim të e-mail`it të MSHMS të datës 15.11.2018 në përgjigje të shkresës së dërguar nga SRD nr. 2736 prot., datë 07.11.2018, është vendosur krijimi i zërit të regjistrit të parashikimit të prokurimeve për procedurën e Prokurimit “Transport dhe Evadim i Mbetjeve Urbane”, me fond limit 1,956,005 lekë pa tvsh, të parashikuar për tu prokuruar në muajin Nëntor 2018 si Marrëveshje Kuadër me Fonde nga të ardhurat dytësore për vitin 2019, në mënyrë që në fillim të vitit 2019, SRD të nënshkruajë kontratën e furnizimit brenda marrëveshjes kuadër dhe të mos ketë nevojë të zgjasë deri në 20% kontratën aktuale.

Me shkresën nr. 2832/1, datë 12.12.2018

Duke iu referuar njoftimit nr. prot. 10140 datë 15.11.2018 të APP, rekomandohet që “AK të fillojnë procedurat e prokurimit për objektet (mall/punë/shërbim) të parashikuara për vitin 2019, për sa kohë që fondet i kanë të parashikuara dhe brenda kufirit buxhetor për vitin 2019” si edhe “krijimin në SPE të elementit përkatës të procedurës së prokurimit që do të zhvillojnë, për mbulimin e nevojave të vitit 2019, në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2018”, Edhe në zbatim të e-mail`it të MSHMS të datës 15.11.2018 në përgjigje të shkresës së dërguar nga SRD nr. 2736 prot., datë 07.11.2018, është vendosur krijimi i zërit të regjistrit të parashikimit të prokurimeve për procedurën e Prokurimit “Asgjësim i Mbetjeve Spitalore”, me fond limit 7,790,000 lekë pa tvsh të parashikuar për tu prokuruar në muajin Nëntor 2018 si Marrëveshje Kuadër me fonde nga të ardhurat dytësore për vitin 2019, në mënyrë që në fillim të vitit 2019, SRD të nënshkruajë kontratën e furnizimit brenda marrëveshjes kuadër dhe të mos ketë nevojë të zgjasë deri në 20% kontratën aktuale.

Me shkresën nr. 2832/2, datë 12.12.2018

Është evidentuar përmes relacioneve të shërbimeve nevoja për blerjen e EKG. Ky investim është miratuar nga Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës me Vendimin nr. 42, datë 19.11.2018, për kryerjen e tij përmes fondeve të të ardhurave dytësore të gjeneruara nga veprimtaria e Spitalit, fonde të cilat janë teprica të procedurave të prokurimit për investimet e parashikuara në fillim të vitit. Gjithashtu ky investim është miratuar nga MSHMS me shkresën nr. 100/348 datë 11.12.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Nga auditimi në përgjithësi për procedurat e prokurimit, u konstatua se:

-Dosjet e procedurave të zhvilluara nuk janë të arkivuar, por mbahen në zyrat e sektorit të prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13.

-Nuk janë kryer trajnime të stafit që bëjnë pjesë e komisioneve të caktuara në procedurat e prokurimeve publike, çka ka rezultuar në mos kuptimin e plotë të legjislacionit të prokurimit publik nga këta punonjës, kryesisht stafi mjekësor.

Përveç procedurave të prokurimit për të cilat grupi i auditimit është shprehur në Akt Konstatime të veçanta, u audituan dhe procedurat e mëposhtme, për të cilat nuk u konstatuan parregullsi të qenësishme:

Këto procedura u përzgjedhën rastësisht nga grupi i auditimit, duke qenë se shumë procedura janë realizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

III.6.1. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale Radiologjie të Spitalit Rajonal Durrës”, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 1022/3, datë 25.04.2018 Vlera e përlogaritur e kontratës 1,511,500 lekë pa TVSH. Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 07.05.2018. OE fitues “S. M.” SHPK me ofertë 1,244,150 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 267,350 lekë pa TVSH. Kanë marrë pjesë në tender 2 operatorë ekonomikë. Kualifikuar 1 operator ekonomikë. Skualifikuar 1 operator ekonomikë. Kontrata nr. 1022/15 Prot., datë 06.06.2018, me vlerë 1,244,150 lekë pa tvsh.	G. K., mjek, kryetar, Dh.K., ekonomiste, M. M., Farmaciste, anëtarë. Urdhri Nr. 1022/4 Prot., datë 25.04.2018.	V.C., ekonomiste, O.G., juriste, E.C., mjek.
Titullari i Autoritetit Kontraktor: N. J. Raporti përmbledhës nr. 1022/11, datë 21.05.2018. Miratuar me Vendimin nr. 1022/13 Prot., datë 21.05.2018.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit) dhe për hartimin e specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 1022/1, datë 16.04.2018: A. M., I. D., G.S.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 1022/5, datë 25.04.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 1022/12, datë 21.05.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 1570, datë 08.06.2018. Ankesa: Nuk ka.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me anë të procesverbalit nr. 1022/6, datë 25.04.2018, njësia e prokurimit ka miratuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Nga auditimi i këtyre DT, u konstatua se nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të **argumentohet teknikisht dhe ligjërisht**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 07.05.2018, ora 12:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S`kualifikuar	Klasifikuar
1	S.M. SHPK	1,244,150	Kualifikuar	1
2	M.D. SHPK	1,500,000	S`kualifikuar	

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, me anë të Raportit Përmbledhës nr. 1022/11, datë 21.05.2018, i miratuar nga titullari i AK me Vendim Miratimi nr. 1022/13, datë 21.05.2018, është vendosur skualifikimi i ofertës së OE M.D. SHPK, kualifikimi dhe shpallja fituese e ofertës së OE S.M. SHPK. Në lidhje me Raportin Përmbledhës, u konstatua se nuk paraqitet e vlera e ofertës së OE M. D. SHPK, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 68, i cili ndër të tjera përcakton se: “Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”.

OE S. M. SHPK, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 0052069, datë 28.05.2018, me vlerë 149,300 lekë.

Kontrata nr. 1022/15, datë 06.06.2018, me vlerë 1,492,980.5 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2018, është nënshkruar nga znj. N. J. për AK dhe z. R. C. për kontraktorin S. M. SHPK.

III.6.2. Blerje Medikamente Ndarë në Lote

Kontrata per lotin 3 dhe 7 nr. 1681 Prot., datë 24.08.2017, me vlerë 999,400 lekë pa TVSH. me afat dorëzimi 30% brenda 7 ditëve nga nënshkrimi pjesa tjetër sipas kërkesave të AK, është nënshkruar nga z. V. C. për AK dhe z. E. L. për kontraktorin OE I. Shpk.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 1248/2, datë 07/06/2017	F.R., Mjeke, kryetar,	O. G., Juriste, Kryetare

OE I. Shpk, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 46453231, datë 21.08.2017, me vlerë 99,940 lekë.

Kontrata per lotin 5 nr. 1681/2 Prot., datë 25.08.2017, me vlerë 4,322,500 lekë pa TVSH me afat dorëzimi 30% brenda 7 ditëve nga nënshkrimi pjesa tjetër sipas kërkesave të AK, është nënshkruar nga z. V. C. për AK dhe z. A. T. për kontraktorin OE M. Shpk.

OE M. Shpk, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 8784, datë 23.08.2017, me vlerë 432,250 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Vlera e përlogaritur e kontratës 9,219,312.48 lekë pa TVSH.	G.S., Ekonomiste, B.S., Farmaciste, M.M., Farmaciste R. K., Ekonomiste anëtarë.	M. L., Ekonomiste, anëtare A. H., Inxhinierë, anëtare.
Procedurë “E Hapur” me lote me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 27.07.2017.	Urdhri Nr. 1248/3 Prot., datë 07.06.2017.	
OE fitues per lotin 3 dhe 7 “I.” SHPK me ofertë 101,400 lekë pa TVSH per lotin 3 dhe 898,000 lekë pa TVSH per lotin 7 Zbritja nga fondi limit 178,111.6 lekë pa TVSH. dhe OE fitues per lotin 5 “M.” Shpk me ofertë 4,322,500 lekë pa TVSH Zbritja nga fondi limit 2,236 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender: 2 operatorë ekonomikë per lotin 3 1 operatorë ekonomikë per lotin 5 2 operatorë ekonomikë per lotin 7		
Kualifikuar 3 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 2 operatorë ekonomikë.		
Kontrata per lotin 3 dhe 7 nr. 1681 Prot., datë 24.08.2017, me vlerë 999,400 lekë pa TVSH. Kontrata per lotin 5 nr. 1681/2 Prot., datë 25.08.2017, me vlerë 4,322,500 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor V.C. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 15.08.2017 Prot., datë 1248/11.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 1248, datë 05.06.2017: 9,219,312.48.fondit limit) dhe për hartimin e kriterëve të vecanta të vlerësimit A.M., Farmaciste M.Xh., Ekonomiste M.G., Farmaciste	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. Prot 1248/5 datë 21.06.2017 Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 1248/12, datë 15.08.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar per lotin 3 dhe 7 nr. 1681/4 Prot., datë 28.08.2017, dhe per lotin 5 nr. 1681/3 Prot., datë 28.08.2017, Ankesa: Nuk ka.

III.6.3. Sigurim i Ndërtesave, Inv. Ekonomik, Pajisje Informatike të Spitalit

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 125/3, datë 21.02.2017	F.I., Ekonomiste, kryetar, A.K., Inxhinier, V.Gj., Juriste, anëtarë. Urdhri Nr. 125/4 Prot., datë 21.02.2017.	V. C., Ekonomiste, O.G., Juriste, M.L., Ekonomiste, anëtarë.
Vlera e përlogaritur e kontratës 2,444,500 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 06.03.2017		
OE fitues “I.” SHPK me ofertë 2,444,000 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 500 lekë pa TVSH.		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kanë marrë pjesë në tender 1 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 125/12 Prot., datë 24.03.2017, me vlerë 2,444,000 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor A.R. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 125/9 Prot., datë 20.03.2017.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 125, datë 28.01.2017: 2,444,500.fondit limit) dhe për hartimin e kriterëve për kualifikim L.B., Ekonomiste S.A., Jurist O.D., Ekonomiste	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 125/6, datë 22.02.2017. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 125/10, datë 20.03.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 125/13, datë 24.03.2017. Ankesa: Nuk ka.

Kontrata nr. 125/12, datë 24.03.2017, me vlerë 2,444,000 lekë pa tvsh, me afat dorëzimi menjehere, është nënshkruar nga z. A.R. për AK dhe z. E.H. për kontraktorin OE I.Sha. OE I.Sha, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 020973, datë 24.03.2017, me vlerë 244,400 lekë.

III.6.4. Sigurim i Ndërtesave, Inv. Ekonomik, Pajisje Informatike të Spitalit

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 909/2, datë 24.04.2018		
Vlera e përlogaritur e kontratës 2,492,118 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 07.05.2018.	I.F., Ekonomist, kryetar, V.Gj., Juriste, A. K., Inxhinier, anëtarë.	V. C., Ekonomiste, O.G., Juriste, A.H., Inxhiniere, anëtarë.
OE fitues “A.S.” Sha me ofertë 2,490,400 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 1,718 lekë pa TVSH.	Urdhri Nr. 909/6 Prot., datë 02.05.2018.	
Kanë marrë pjesë në tender 1 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 1635 Prot., datë 19.06.2018, me vlerë 2,490,400 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor N.J. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 909/10 Prot., datë 06.06.2018.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 909, datë 04.04.2018: 2,492,118.fondit limit) dhe për hartimin e kriterëve për kualifikim me	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 909/4, datë 24.04.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 909/11, datë 06.06.2018. Formulari i Njoftimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

	anëtarë I. V., Ekonomiste O. D., Ekonomiste A. Xh., Jurist Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të Vlerësimit sipas Urdhrit nr. 1404/1, datë 21.05.2018: G. K., A. F., E. K..	Kontratës së Nënshkruar nr. 1635/1, datë 19.06.2018. Ankesa: Ka.
--	---	--

Kontrata nr. 1635, datë 19.06.2018, me vlerë 2,490,400 lekë pa tvsh, me afat dorëzimi menjëherë, është nënshkruar nga znj. N. J. për AK dhe z. A. C. për kontraktorin OE A.-S.Sha. OE A.-S. Sha, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 070300530024167, datë 13.06.2018, me vlerë 249,040 lekë.

III.6.5. Blerje Shtypshkrime

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Vlera e përlogaritur e kontratës 1,837,026 lekë pa TVSH.		
Procedurë "Kërkesë për propozim nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër" me mjete elektronike. Zhvilluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme.		
OE fitues "K.-K." SHPK me ofertë 1,470,000 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 367,026 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 5 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 4 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 1 operatorë ekonomikë.		
Marrëveshje Kuadër nr. 24/5 datë 14.09.2018 me vlerë 1,837,026 lekë pa TVSH. Kontrata nr. 2387/5 Prot., datë 19.10.2018, me vlerë 516,000.40 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor N. J.		Ankesa: Ka ose Nuk ka.

Kontrata nr. 2387/5, datë 19.10.2018, me vlerë 516,000.40 lekë pa tvsh, me afat dorëzimi brenda 7 ditëve, është nënshkruar nga znj. N.J. për AK dhe z. K.H. për kontraktorin OE K.-K. OE K.-K., ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 053331, datë 19.10.2018, me vlerë 61,920 lekë.

III.6.6. Blerje Materiale Okulistike

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 1393/2, datë 30.05.2018		V. C., Ekonomiste,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Vlera e përlogaritur e kontratës 1,249,000 lekë pa TVSH.	G.K., Mjek, kryetar, V.S., Ekonomiste, E. Q., Mjek, anëtarë.	O.G., Juriste, M.T., Mjek, anëtarë.
Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 11.06.2018.	Urdhri Nr. 1393/6 Prot., datë 30.05.2018.	
OE fitues “G.-A.” Farma SHPK me ofertë 1,246,600 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 3,000 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 1 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 1393/15 Prot., datë 10.07.2018, me vlerë 1,246,600 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor N. J. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 1393/11 Prot., datë 26.06.2018.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 1393, datë 17.05.2018: 1,249,000.fondit limit) dhe për hartimin e kriterëve për kualifikim A. M., Farmaci M.T., Mjek G. S., Ekonomiste	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 1393/5, datë 30.05.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 1393/12, datë 26.06.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 1393/17, datë 16.07.2018. Ankesa: Nuk ka.

Kontrata nr. 1393/15, datë 10.07.2018, me vlerë 1,246,600 lekë pa tvsh, me afat dorëzimi brenda 7 ditëve, është nënshkruar nga znj. N. J. për AK dhe z. A. B. për kontraktorin OE “G.-A.” Farma.

OE “G.-A.” Farma, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 59078847, datë 02.07.2018, me vlerë 149,592 lekë.

III.6.7. Blerje Aksesorë për Aparaturat Mjekësore

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 1804/2, datë 13.07.2018 Vlera e përlogaritur e kontratës 1,388,200 lekë pa TVSH. Loti 2: 260,000 lekë pa TVSH Loti 3: 1,128,200 lekë pa TVSH	G.K., Ekonomist, kryetar, H.P., Inxhinier, K.B., IT, anëtarë.	V. C., Ekonomiste, I.F., Inxhiniere, A.H., Inxhiniere, anëtarë.
Procedurë me 2 lote (2,3) “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike, Hapja e ofertave datë 26.07.2018.	Urdhri Nr. 1804/7 Prot., datë 13.07.2018.	
OE fitues loti 2 “M.” SHPK me ofertë 250,000 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 10,000 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 1 operatorë ekonomikë.		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 1804/17 Prot., datë 08.08.2018, me vlerë 250,000 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor N.J. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 1804/13 Prot., datë 06.08.2018.	Grupi i punës për përllogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 1798/1, datë 09.07.2018: 1,388,200.fondit limit) dhe për hartimin e kriterëve për kualifimin I.F., Inxhinieri A.F., IT A.I., Ekonomiste	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 1804/3, datë 13.07.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 1804/14, datë 06.08.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 1804/19, datë 10.08.2018. Ankesa: Nuk ka.

Kontrata nr. 1804/17, datë 08.08.2018, me vlerë 250,000lekë pa tvsh, me afat dorëzimi menjëherë, është nënshkruar për AK nga z. G.K. për AK dhe z. L.K. për kontraktorin OE M. Shpk.

OE M. Shpk, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 0053648, datë 08.08.2018, me vlerë 30,000 lekë.

Gjithashtu janë audituar dhe procedurat e mëposhtme, për të cilat u konstatuan parregullsitë si më poshtë vijon:

III.6.8. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë së Spitalit Rajonal Durrës”, Marrëveshje Kuadër, zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë

Të dhëna mbi tenderin	Kontratat	Formularët e Njoftimit të Kontratës
Urdhër Prokurimi Nr. 3673, datë 06.07.2016		
Vlera e përllogaritur e kontratës 199,694,742 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Marrëveshje Kuadër me një OE, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 2 vjeçar”, zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.	Kontrata I nr. 1830/1, datë 09.09.2016, me vlerë 8,488,921 lekë.	Formulari i Njoftimit të Kontratës I së Nënshkruar nr. 1830/2, datë 14.09.2016.
B. fitues “T.” SHPK & “L.” SHPK me ofertë 198,520,968 lekë pa TVSH.	Kontrata II nr. 343/3, datë 09.03.2017, me vlerë 7,063,239 lekë.	Formulari i Njoftimit të Kontratës II së Nënshkruar nr. 343/4, datë 15.03.2017.
Zbritja nga fondi limit 1,173,774 lekë pa TVSH.	Kontrata III nr. 1962/3, datë 09.03.2017, me vlerë 3,310,429 lekë.	Formulari i Njoftimit të Kontratës III së Nënshkruar nr. 1962/4, datë 30.10.2017.
Kanë marrë pjesë në tender 7 operatorë ekonomikë.	Kontrata IV nr. 331/5, datë 06.04.2018, me vlerë 1,220,091 lekë.	Formulari i Njoftimit të Kontratës IV së Nënshkruar nr. 13, datë 03.01.2019.
Kualifikuar 1 operator ekonomikë. Skualifikuar 6 operatorë ekonomikë.		
Kontrata (Marrëveshja Kuadër) nr. 1830, datë 05.09.2016, me vlerë 20,083,742 lekë pa		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: A.R. V.C.	Grupi i punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e kontratës sipas Urdhrit nr. 1830/3, datë 13.09.2016: N.M., A.M. dhe Dh. K.	

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me anë të shkresës nr. 3673/6, datë 15.08.2016, protokolluar në SRD me nr. 1715, datë 17.08.2016, Ministri i Shëndetësisë ka dërguar dokumentacionin për lidhjen e marrëveshjes kuadër, për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë.

Kontrata (Marrëveshja Kuadër) nr. 1830, datë 05.09.2016 “Për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë së Spitalit Rajonal Durrës”, me vlerë 20,083,742 lekë pa tvsh (përfshirë nga tvsh), me afat 24 muaj, është nënshkruar për AK nga z. A. R. dhe për B. T. SHPK dhe L. SHPK nga znj. G.P. dhe z. V. L.

BOE T. SHPK dhe L. SHPK, ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 0006897, datë 01.09.2016, me vlerë 2,008,374 lekë, me afat deri më 01.08.2018.

Me anë të Urdhrit nr. 1830/3, datë 13.09.2016, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave objekt i kësaj kontrate të përbërë nga z. N.M., znj. A. M. dhe znj. Dh. K., si dhe ka përcaktuar personin përgjegjës për ndjekjen e kësaj kontrate, znj. A. M. me detyrë përgjegjëse e Farmacisë së SRD.

Në zbatim të kontratës së mësipërme, AK ka lidhur me BOE T. SHPK dhe L. SHPK, kontratat e furnizimit si më poshtë vijon:

III.6.8.1. Kontrata nr. 1830/1, datë 09.09.2016

Kontrata nr. 1830/1, datë 09.09.2016, me vlerë 8,488,921 lekë, me afat dorëzimi brenda datave 13-16 shtator 2016, është nënshkruar nga z. A. R. për AK dhe për BOE T. SHPK dhe L. SHPK nga znj. G. P. dhe z. V.Ll.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:

Me anë të Fletë-Hyrjeve nr. 332, 333 dhe 334, datë 16.09.2016, janë bërë hyrje materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë me vlerë 8,488,921 lekë (899,740 lekë, 343,150 lekë dhe 7,246,301 lekë).

III.6.8.2. Kontrata nr. 343/3, datë 09.03.2017

Kontrata nr. 343/3, datë 09.03.2017, me vlerë 7,063,239 lekë, me afat dorëzimi brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, është nënshkruar nga z. A. R. për AK dhe për BOE T. SHPK dhe L. SHPK nga znj. G. P. dhe z. V. L.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me anë të faturës tatimore nr. 1074, datë 15.03.2017, me vlerë 3,532,201 lekë, bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen nr. 65, datë 15.03.2017, si dhe marrë në dorëzim me anë të procesverbalit pa numër, datë 15.03.2017, OE L. SHPK ka sjellë një pjesë të materialeve të kontraktuara.

Me anë të faturës tatimore nr. 501330, datë 21.03.2017, me vlerë 2,721,823 lekë, bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen nr. 69, datë 21.03.2017, si dhe marrë në dorëzim me anë të procesverbalit pa numër, datë 21.03.2017, OE T. SHPK ka sjellë një pjesë të materialeve të kontraktuara.

Me anë të faturës tatimore nr. 501337, datë 21.03.2017, me vlerë 740,585 lekë, bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen nr. 70, datë 21.03.2017, si dhe marrë në dorëzim me anë të procesverbalit pa numër, datë 21.03.2017, OE T. SHPK ka sjellë një pjesë të materialeve të kontraktuara.

Me anë të faturës tatimore nr. 501360, datë 28.03.2017, me vlerë 68,630 lekë, bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen nr. 73, datë 28.03.2017, si dhe marrë në dorëzim me anë të procesverbalit pa numër, datë 28.03.2017, OE T. SHPK ka sjellë një pjesë të materialeve të kontraktuara.

Sipas kontratës së nënshkruar, afati i dorëzimit është brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, pra data e fundit e dorëzimit është data 16.03.2017. Për faturat nr. 501330, datë 21.03.2017 dhe nr. 501337, datë 21.03.2017, afati i dorëzimit ka kaluar me 5 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar **në vlerën 69,248** lekë (vlera e 2 faturave $3,462,410 * 5 \text{ ditë} * 4/1000$), **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Për faturën tatimore nr. 501360, datë 28.03.2017, me vlerë 68,630 lekë, afati i dorëzimit ka kaluar me 12 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar **në vlerën 84,759** lekë (duke qenë se vlera e mbetur e perealizuar është më e vogël se 25% e kontratës, do përdoret 25% i vlerës së kontratës vlera $1,765,810 * 12 \text{ ditë} * 4/1000$), **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

III.6.8.3. Kontrata nr. 1962/3, datë 09.03.2017

Kontrata nr. 1962/3, datë 09.03.2017, me vlerë 3,310,429 lekë, me afat dorëzimi brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, është nënshkruar nga znj. V.C. për AK dhe për BOE T. SHPK dhe L. SHPK nga znj. G.P. dhe z. V. Ll.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:

Me anë të Fletë-Hyrjeve nr. 369, datë 30.10.2017, me vlerë 1,655,216 lekë dhe nr. 370, datë 31.10.2017, me vlerë 1,655,213 lekë, janë bërë hyrje materialet mjekësore për shërbimin e ortopedisë.

III.6.8.4. Kontrata nr. 331/5, datë 06.04.2018

Kontrata nr. 331/5, datë 06.04.2018, me vlerë 1,220,091 lekë, me afat dorëzimi brenda 2 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, është nënshkruar nga z. A. R. për AK dhe për BOE T. SHPK dhe L.SHPK nga znj. G. P. dhe z. V. Ll.

Formulari i njoftimit të nënshkrimit të kontratës, është dërguar me shkresën nr. 13, datë 03.01.2019, ose 9 muaj me vonesë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 25, pika 1, e cila përcakton se: “Autoriteti kontraktor dërgon për publikim njoftimin e kontratës së lidhur brenda 5 ditëve nga lidhja e kontratës” dhe pika 3, e cila përcakton se: “Autoriteti kontraktor duhet të dërgojë për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

publikim kontratën fituese për një kontratë të lidhur nga një marrëveshje kuadër”. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi juristi i ngarkuar për hartimin e kontratës dhe titullari i AK.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:

Me anë të faturës tatimore nr. 1703, datë 06.04.2018, me vlerë 609,501 lekë, bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen nr. 50, datë 06.04.2018, si dhe marrë në dorëzim me anë të procesverbalit pa numër, datë 06.04.2018, OE L. SHPK ka sjellë një pjesë të materialeve të kontraktuara.

Me anë të faturës tatimore nr. 6541502505, datë 10.04.2018, me vlerë 610,590 lekë, bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen nr. 51, datë 10.04.2018, si dhe marrë në dorëzim me anë të procesverbalit pa numër, datë 10.04.2018, OE T. SHPK ka sjellë një pjesë të materialeve të kontraktuara.

Për faturën tatimore nr. 6541502505, datë 10.04.2018, me vlerë 610,590 lekë, afati i dorëzimit ka kaluar me 2 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar **në vlerën 4,885 lekë** ($610,590 * 2 \text{ ditë} * 4/1000$), **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi:

-Përgjegjësja e Farmacisë A. M., në zbatim të pikës 2/b dhe 2/d, të Urdhrit nr. 1830/3, datë 13.09.2016, për mos ndjekjen e realizimit të vonuar dhe mos njoftimin e drejtorisë për problemet e konstatuara.

-Shefja e Sektorit të Financës I.V., për mos konstatimin e vonësve dhe kryerjen e likuidimeve pa i zbritur dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar për vitin 2018.

Mbi origjinën e materialeve mjekësore të prokuruar

Nga auditimi konstatohet se kontratën (Marrëveshjen Kuadër) nr. 1830, datë 05.09.2016 “Për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë së Spitalit Rajonal Durrës”, me vlerë 20,083,742 lekë pa tvsh (përfshirë nga tvsh), me afat 24 muaj, janë përcaktuar dhe origjina e mallrave të kontraktuara, sipas të cilët duheshin sjellë nga kontraktorët.

Por nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, e konkretisht procesverbaleve të marrjes në dorëzim, në mungesë të verifikimit fizik të mallrave, për arsye se nga deklarimi verbal i drejtuesve të spitalit dhe drejtuesve të shërbimit të ortopedisë, këto materiale janë konsumuar të gjitha, konstatohet se për materialin e mjekimit “Cementi kockorë”, të sjellë me anë të faturës tatimore nr. 6541502505, datë 10.04.2018, me vlerë 68,630 lekë dhe me anë të faturës tatimore nr. 6541502143, datë 31.10.2017, me vlerë 68,630 lekë, origjina e këtij materiali është Fabrika M. në Poloni, ndërsa sipas kontratës duhej të ishte fabrika B., Zvicër.

Si rezultat i kësaj, arrihet në përfundimin se BOE T. SHPK dhe L. SHPK, nuk ka sjellë materialet në përputhje me kontratën e nënshkruar, e për pasojë vlera e materialit të mjekimit “Cementi kockorë” **në shumën 137,260 lekë, përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave objekt i kësaj kontrate, sipas Urdhrit nr. 1830/3, datë 13.09.2016.

III.6.9. Kontrata nr. 991/6, datë 16.05.2017

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 92, datë 17.02.2017		
Loti 25 “Sistemi nervor - Midazolam “Vlera e përlogaritur e kontratës 1,265,102.4 lekë pa TVSH. Loti 28 “Sistemi nervor- Paracetamol ” “Vlera e përlogaritur e kontratës 5,810,710.2 lekë pa TVSH. Loti 30 “Sistemi nervor- Propofol ” “Vlera e përlogaritur e kontratës 7,949,968.9 lekë pa TVSH.		
Procedurë “E Hapur” me mjete elektronike. Zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.		
Loti 25 “Sistemi nervor - Midazolam OE fitues “R.F.” SHPK me ofertë 1,258,796 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 6,306.4 lekë pa TVSH. Loti 28 “Sistemi nervor- Paracetamol ” OE fitues “R.F.” SHPK me ofertë 4,370,114 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 1,440,596.2 lekë pa TVSH. Loti 30 “Sistemi nervor- Propofol ” OE fitues “R.F.” SHPK me ofertë 7,939,869.5 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 10,099.4lekë pa TVSH.		
Loti 25 “Sistemi nervor – Midazolam ” Kanë marrë pjesë në tender 4 operatorë ekonomikë. Loti 28 “Sistemi nervor- Paracetamol ” Kanë marrë pjesë në tender 5 operatorë ekonomikë. Loti 30 “Sistemi nervor- Propofol ” Kanë marrë pjesë në tender 1 operatorë ekonomikë.		
Loti 25 “Sistemi nervor – Midazolam ” Kualifikuar 3 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Loti 28 “Sistemi nervor- Paracetamol ” Kualifikuar 5 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë. Loti 30 “Sistemi nervor- Propofol ” Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 991/6 Prot., datë 16.05.2017, me vlerë 718,350 lekë pa TVSH.		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. R.		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 991/7, datë 18.05.2017.
--	--	--

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Kontrata nr. 991/6, datë 16.05.2017, me vlerë 718,350 lekë me tvsh, me afat përfundimtar dorëzimi 15.12.2017, është nënshkruar nga z. A. R. për AK dhe z. A. H. për kontraktorin OE R. F. SHPK.

OE R. F. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 0000481, datë 11.05.2017, me vlerë 71,835 lekë.

Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate, nuk u konstatuan problematika në afatet dhe sasitë e sjella nga kontraktori.

III.6.10. Kontrata nr. 911/7, datë 14.06.2017

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 120, datë 06.03.2017		
“Loti 1 Anestezi Reanimacion- Fentanyl” Vlera e përlogaritur e kontratës 3,316,987 lekë pa TVSH.		
Procedurë “E Hapur ” me mjete elektronike. Zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.		
OE fitues “I.” SHPK me ofertë 2,700,960 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 616,027 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 3 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 911/7 Prot., datë 14.06.2017, me vlerë 204,000 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. V. C.		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 911/8, datë 14.06.2017.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kontrata nr. 911/7, datë 14.06.2017, me vlerë 204,000 lekë me tvsh, me afat dorëzimi 20% brenda 2 javëve, 20% brenda 1 muaji dhe pjesa e mbetur deri më datë 15.12.2017, është nënshkruar nga znj. V.C. për AK dhe z. E. L. për kontraktorin OE I. SHPK.

OE I. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 0002153, datë 23.05.2017, me vlerë 20,400 lekë.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:

Me anë të faturave të ndryshme tatimore, kontraktori OE I. SHPK ka sjellë mallin sipas kontratës së lidhur.

Por nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 2172, datë 28.06.2017, me vlerë 19,200 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 40,800 lekë, por është sjellë më pak në vlerën 21,600 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore të datës 01.12.2017, pra 156 ditë me vonesë.

Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, **në vlerën 15,912 lekë** ($156 \text{ ditë} * 2/1000 * 51,000 \text{ lekë}$ “duke qenë se vlera e mbetur e pasjellë është më e vogël se 25% e vlerës së kontratës, do përdorët 25% i vlerës së kontratës”), vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Ndërsa nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 3063, datë 28.09.2017, me vlerë 6,000 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 40,800 lekë, por është sjellë më pak në vlerën 34,800 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore të datës 01.12.2017, pra 140 ditë me vonesë.

Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, **në vlerën 14,280 lekë** ($140 \text{ ditë} * 2/1000 * 51,000 \text{ lekë}$ “duke qenë se vlera e faturës është më e vogël se 25% e vlerës së kontratës, do përdorët 25% i vlerës së kontratës”), vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

III.6.11. Kontrata nr. 2050/7, datë 24.10.2017

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 1613/5, datë 04.09.2017		
Per “Barrna hormonale sistemike,hormonet seksuale – Oxytocin ” me Vlera e përlllogaritur e kontratës 354’340 lekë pa TVSH.	F. R., Mjeke, kryetar, G. S., ekonomiste, B. S., Farmaciste, anëtarë, M. M., Farmaciste, anëtarë, R. K., ekonomiste, anëtarë.	O. G., Juriste, kryetar, M. L., Ekonomiste, anëtarë A. H., Inxhinieri, anëtarë.
Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 15.09.2017. Zhvilluar në Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Durrës.		
Per “Barrna hormonale sistemike,hormonet seksuale – Oxytocin ”OE fitues “I.F.” SHPK me ofertë 354,340 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 0 lekë pa TVSH.	Urdhri Nr. 1613/6 Prot., datë 04.09.2017.	
Per “Barrna hormonale sistemike,hormonet seksuale – Oxytocin ” Kanë marrë pjesë në		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

tender 1 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 2050/7 Prot., datë 24.10.2017, me vlerë 354,340 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor zgj. V.C. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 1873/3 Prot., datë 27.09.2017.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit) dhe për hartimin e specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 1613/3, datë 07.08.2017: A. M., M. Xh. dhe M. G.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 1613/7, datë 04.09.2017. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 1873/5, datë 28.09.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 2050/8, datë 24.10.2017. Ankesa: Nuk ka.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Kontrata nr. 2050/7, datë 24.10.2017, me vlerë 354,340 lekë me tvsh, me afat dorëzimi 30% brenda 7 ditëve dhe pjesa e mbetur deri më datë 15.12.2017, është nënshkruar nga zgj. V. C. për AK dhe z. Sh.A. për kontraktorin OE I.-F. SHPK.
OE I.-F. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 017628, pa datë, me vlerë 35,434 lekë.

Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate, nuk u konstatuan problematika në afatet dhe sasitë e sjella nga kontraktori.

III.6.12. Kontrata nr. 654/5, datë 19.04.2017

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 720, datë 13.02.2017		
Per Spitalin Rajonal Durres Vlera e përlogaritur e kontratës 25,613,848 lekë pa TVSH.		
Procedurë “E Hapur” me mjete elektronike. Zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.		
OE fitues “B. E. & O. D.” SHPK me ofertë 24,773,248 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 840,600 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 4 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 3 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 654/5 Prot., datë 19.04.2017, me		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

vlerë 24,773,248 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A.R.		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 654/7, datë 21.04.2017.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Kontrata nr. 654/5, datë 19.04.2017, me vlerë 29,727,897.60 lekë me tvsh, me afat dorëzimi deri më datë 15.12.2017, është nënshkruar nga z. A.R. për AK dhe z. E. H. dhe znj. O.J. për kontraktorin B. E. SHPK & O. D. SHPK.

OE O. D. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 46453690, datë 23.03.2017, me vlerë 1,423,310.40 lekë.

OE E. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 46453649, datë 23.03.2017, me vlerë 1,549,479.36 lekë.

Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate, nuk u konstatuan problematika në afatet dhe sasitë e sjella nga kontraktori.

III.6.13. Kontrata nr. 654/1, datë 11.04.2017

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 73, datë 13.02.2017		
Per Spitalin Rajonal Durres Vlera e përlllogaritur e kontratës 15,006,165 lekë pa TVSH.		
Procedurë “E Hapur” me mjete elektronike. Zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.		
OE fitues “B. M. & B. A.” SHPK me ofertë 14,314,710 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 691,455 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 2 operatorë ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operator ekonomikë. Skualifikuar 1 operator ekonomikë.		
Kontrata nr. 654/1 Prot., datë 11.04.2017, me vlerë 14,314,710 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. R.		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 654/3, datë 11.04.2017.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kontrata nr. 654/1, datë 11.04.2017, me vlerë 17,177,652 lekë me tvsh, me afat dorëzimi deri më datë 15.12.2017, është nënshkruar nga z. A.R. për AK dhe z. S.L. dhe z. A.K. për kontraktorin B. M. SHPK & B. A. SHPK.

B. M. SHPK & B. A. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 050959, datë 23.03.2017, me vlerë 1,717,766 lekë.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:

Me anë të 20 faturave tatimore me data të ndryshme, B. M. SHPK & B. A. SHPK, ka sjellë mallrat sipas kontratës së nënshkruar midis palëve.

Por nga verifikimi i këtyre faturave tatimore, konstatohet se B. M. SHPK & B. A. SHPK, nuk ka sjellë mallra për vlerën 5,400 lekë.

Me anë të Observacionit të dërguar me shkresën nr. 1445, datë 24.07.2019, Drejtori i SRD pretendon se: *“Për shkak se produkti Letër Printeri Fotografike (copë 1) nuk mund të përdorej për periudhën në vazhdim, si pasojë e mosfunksionimit të Printer kolor për Eko kolor dopler, duke patur parasysh edhe se ka një kosto 3.4 herë më të lartë se Letër printeri Echo, i është kërkuar subjektit të mos e lëvrojë këtë produkt, përderisa sasia e lëvruar prej 200 copësh e letër printer Echo (e zakonshme) i plotësonte kërkesat teknike për printerat që Spitali kishte në gjendje funksionale. U dakordësua që produkti i pa tërhequr nga ana jonë, të na vihej në dispozicion në momentin e parë që do ta kishim të nevojshëm, por nevojat e spitalit, siç përmendëm edhe më lart, arritëm të mbuloheshin me Letër printeri Echo, pa pasur të nevojshëm lëvrimin e Letër printeri Fotografike”.*

Për sa më sipër:

-Nisur nga pretendimi juaj, se si pasojë e mosfunksionimit të printerit Echo Kolor Dopler, i keni kërkuar OE që të mos e lëvrojë këtë produkt, duke qenë se letra e printerit Echo e zakonshme i plotësonte kërkesat teknike për printerat e SRD;

-Si dhe, nisur nga fakti që vlera e ulët porealizuar e kësaj kontrate, e cila është në vlerën 5,400 lekë (**0.04% e totalit të kontratës**), e si e tillë përbën një vlerë jo materiale;

Observacioni juaj qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

III.6.14. Kontrata nr. 992/8, datë 22.05.2017

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 90, datë 17.02.2017		
Vlera e përlllogaritur e kontratës “Loti 4 Anestezi reanimacion – Isoflurane” është 6,618,742 lekë pa TVSH.		
Procedurë “E Hapur” me mjete elektronike. Zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.		
“Loti 4 Anestezi reanimacion – Isoflurane” OE fitues “I.” SHPK me ofertë 6,451,200 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 167,542 lekë pa TVSH.		
“Loti 4 Anestezi reanimacion – Isoflurane” Kanë marrë pjesë në tender 2 operatorë ekonomikë.		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 1 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 992/8 Prot., datë 22.05.2017, me vlerë 210,000 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. R.		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 992/9, datë 25.05.2017.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Kontrata nr. 992/8, datë 22.05.2017, me vlerë 210,000 lekë me tvsh, me afat dorëzimi 20% brenda 2 javëve, 20% brenda 1 muaji dhe pjesa e mbetur deri më datë 15.12.2017, është nënshkruar nga z. A. R. për AK dhe z. E. L. për kontraktorin OE I. SHPK.

OE I. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 46453974, datë 17.05.2017, me vlerë 21,000 lekë.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:

Me anë të faturës tatimore nr. 2173, datë 28.06.2017, me vlerë 105,000 lekë dhe faturës tatimore nr. 2895, datë 12.09.2017, me vlerë 105,000 lekë, kontraktori OE I. SHPK ka sjellë mallin sipas kontratës së lidhur.

Por nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 2173, datë 28.06.2017, me vlerë 105,000 lekë, malli i sjellë duhej të ishte sjellë më datë 05.06.2017, por është sjellë më datë 28.06.2017, pra 23 ditë me vonesë.

Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, **në vlerën 2,415 lekë** (23 ditë * 2/1000 * 52,500 lekë “duke qenë se vlera e faturës është më e vogël se 25% e vlerës së kontratës, do përdorët 25% i vlerës së kontratës”), vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Ndërsa për faturën tatimore nr. 2895, datë 12.09.2017, me vlerë 105,000 lekë, malli i sjellë duhej të ishte sjellë më datë 22.06.2017, por është sjellë më datë 12.09.2017, pra 82 ditë me vonesë.

Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, **në vlerën 8,610 lekë** (82 ditë * 2/1000 * 52,500 lekë “duke qenë se vlera e faturës është më e vogël se 25% e vlerës së kontratës, do përdorët 25% i vlerës së kontratës”), vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

III.6.15. Kontrata nr. 770/7, datë 05.05.2017

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr.86, datë 17.02.2017		
Vlera e përlllogaritur e kontratës “ Lotin 10 “Anti-infektive të përgjithshëm-Ceftazidime” është 8,351,857 lekë pa TVSH.		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Vlera e përlogaritur e kontratës “ Lotin 13 “Anti-infektive të përgjithshëm- Cefuroxime ” është 7,012,267 lekë pa TVSH		
Procedurë “E Hapur ” me mjete elektronike. Zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.		
“ Lotin 10 “Anti-infektive të përgjithshëm- Ceftazidime ” OE fitues “F.” SHPK me ofertë 8,323,890 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 27,967 lekë pa TVSH. “ Lotin 13 “Anti-infektive të përgjithshëm- Cefuroxime ” OE fitues “F.” SHPK me ofertë 6,943,860 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 68,407 lekë pa TVSH.		
“ Lotin 10 “Anti-infektive të përgjithshëm- Ceftazidime ” Kanë marrë pjesë në tender 2 operatorë ekonomikë. “ Lotin 13 “Anti-infektive të përgjithshëm- Cefuroxime ” Kanë marrë pjesë në tender 3 operatorë ekonomikë		
“ Lotin 10 “Anti-infektive të përgjithshëm- Ceftazidime ” Kualifikuar 1 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 1 operatorë ekonomikë. “ Lotin 13 “Anti-infektive të përgjithshëm- Cefuroxime ” Kualifikuar 2 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 1 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 770/1 Prot., datë 05.05.2017, me vlerë total 1,990,000 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. R.		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 1014, datë 09.05.2017.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Kontrata nr. 770/7, datë 05.05.2017, me vlerë 1,990,000 lekë me tvsh, me afat dorëzimi 20% brenda 2 javëve, 20% brenda 1 muaji dhe pjesa e mbetur deri më datë 15.12.2017, është nënshkruar nga z. A. R. për AK dhe znj. A. T. për kontraktorin OE F. SHPK. OE F. SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 46452324, datë 05.05.2017, me vlerë 199,000 lekë.

Zbatimi i kësaj kontrate është si më poshtë vijon:

Me anë të 6 faturave tatimore, për kontraktorin OE F. SHPK, ka sjellë ilaçet sipas kontratës së lidhur midis palëve.

Por nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 8492, datë 27.06.2017, me vlerë 222,000 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 398,000 lekë, por është sjellë më pak në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

vlerën 176,000 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore nr. 3076, datë 11.07.2017, pra 37 ditë me vonesë.

Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, **në vlerën 36,815 lekë** (37 ditë * 2/1000 * 497,500 lekë “duke qenë se vlera e faturës është më e vogël se 25% e vlerës së kontratës, do përdoret 25% i vlerës së kontratës”), vlerë e cila **përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

-Shefja e Sektorit të Farmacisë znj. A. M., për mos ndjekjen e zbatimit të këtyre kontratave, dhe

-Shefja e Sektorit të Financës, për mos përlllogaritjen dhe mos mbajtjen e penaliteteve nga kontraktorët.

III.6.16. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Peditrisë për Spitalin Rajonal Durrës”

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 1483, datë 31.05.2018		
Vlera e përlllogaritur e kontratës 218,082,112.5 lekë pa TVSH.	G. K., ekonomist, kryetar, V. H., inxhinieri ndërtimi (QSUT - MSHMS), N. M., inxhinier mekanik, I. F., inxhinieri biomjekësore, E.K., juriste, anëtarë.	V.C., ekonomiste, O.G., juriste, A.H., inxhinieri mjedisi. (Zëvendësohet me R. C., inxhinieri mjedisi, Me Urdhrin nr. 1684/10, datë 01.08.2018)
Procedurë “Tender i hapur” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 17.08.2018.		
OE fitues “Sh.” SHPK me ofertë 166,660,826.50 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 51,421,286.00 lekë pa TVSH.	Urdhri Nr. 1483/2 Prot., datë 31.05.2018.	
Kanë marrë pjesë në tender 16 operatorë ekonomikë.	Njëkohësisht me Urdhrin nr. 1596, datë 13.06.2018, janë dhe anëtarë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për ankesat e ardhura për DT.	
Kualifikuar 3 operatorë ekonomikë. Skualifikuar 13 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 2729/7 Prot., datë 14.11.2018, me vlerë 166,660,826.5 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: A.R. deri më datë 05.05.2018; N.J., pas datës 05.05.2018. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 2729/2 Prot., datë 09.11.2018.	Grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit) dhe për hartimin e specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 505/3, datë 26.03.2018: A. K., E. P., F. Sh., V.Gj. dhe O.D. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të Vlerësimit sipas Urdhrit nr. 2069/2, datë 06.09.2018: I.V., A. Xh. dhe H. P.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 1483/3, datë 31.05.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 2729/4, datë 09.11.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 2729/8, datë 19.11.2018. Ankesa: Ka.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Nisur nga vlera e lartë, si dhe fakti që SRD nuk ka zhvilluar procedura të tilla më parë, grupi i auditimit e gjykoj me risk të lartë këtë procedurë, e për pasojë e përzgjodhi për tu audituar.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e sektorit të prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Hartimi i Dokumenteve të Tenderit

Preventivi i punimeve për këtë procedurë, është hartuar nga OE “Gj. & C.” SHPK. Sipas këtij preventivi, vlera totale e mallrave dhe punimeve është në shumën 261,698,535.4 lekë me tvsh.

Me Urdhrin nr. 505/3, datë 26.03.2018, titullari i AK ka ngritur komisionin për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës, i cili me anë të relacionit dërguar titullarit të AK me shkresën nr. 505/9, datë 31.05.2019, ka miratuar vlerën e fondit limit dhe ka hartuar kriteret e veçanta për këtë procedurë. Projekti dhe fondi limit për këtë procedurë, janë miratuar dhe nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. 54/3, datë 12.04.2018, protokolluar në SRD me nr. 505, datë 12.04.2018 “Dërgim Rishikim i Oponencës Teknike”.

Nga auditimi i zërave të këtij preventivi, u konstatua se:

-Vlera e pajisjeve të përlllogaritura është në shumën 88,297,140.1 lekë pa tvsh, dhe më pas në vlerën totale, i është shtuar dhe TVSH e pajisjeve në vlerën 17,659,428 lekë, duke e çuar vlerën totale të pajisjeve në shumën 105,956,568.1 lekë. Vendosija e vlerës së TVSH së pajisjeve, është kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, kreu I, gërma A, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat”. Duke qenë se në procedurën e prokurimit është përdorur vlera pa TVSH, nuk ka patur efekte financiare nga kjo përlllogaritje.

-Për 230 zëra të preventivit (kryesisht pajisje), sipas shënimeve përcaktohet se janë përlllogaritur me studim tregu (oferta), por nuk dokumentohet dhe argumentohet mënyra e përlllogaritjes së tyre, nuk dokumentohen ofertat e administruara, nuk dokumentohet se cilët janë OE të cilëve u është kërkuar ofertë, cila është mënyra e komunikimit me këta OE. Ky fakt i është vënë në dijeni SRD dhe nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. 54/3, datë 12.04.2018, protokolluar në SRD me nr. 505, datë 12.04.2018 “Dërgim Rishikim i Oponencës Teknike”. Gjithashtu sipas kësaj shkrese, konstatohet se nuk janë paraqitur volumet metrike të punimeve të ndërtimit, në mënyrë që të kryhej një vlerësim i plotë i kostos së ndërtimit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

-Për çmimet për të cilat sipas preventivat janë përlllogaritur duke u kryer analizat përkatëse, nuk janë dërguar të gjitha analizat, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Për sa më sipër mban përgjegjësi OE “Gj. & C.” SHPK, për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit në kundërshtim me LPP.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me anë të procesverbalit nr. 1483/1, datë 31.05.2018, njësia e prokurimit ka miratuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë. Pas miratimit të dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit ka kryer 6 ndryshime në DT, kjo dhe si pasojë e ankesave të shumta të ardhura për këtë procedurë prokurimi.

Kriteret e Veçanta për këtë procedurë prokurimi, janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 505/3, datë 26.03.2018, si dhe janë miratuar nga titullari i AK, sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1483, datë 31.05.2018.

Në procesverbalin nr. 1483/1, datë 31.05.2018 *“Mbi hartimin dhe miratimin e dokumentave standarde të tenderit për procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i pediatriisë së Spitalit Rajonal Durrës”*”, faqe 1, paragrafi i fundit, njësia e prokurimit ka cituar se janë hartuar nga njësia e posaçme.

Nga auditimi i këtyre DT, u konstatua se:

-Nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: *“Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”*.

-Në pikën 2.3.4, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: *“Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates. Numri i punonjesve per periudhen Dhjetor 2017-Maj 2018 te jete mesatarisht jo me pak se 40 punonjës në muaj. Ne kete numer perfshihet dhe stafi drejtues”*, kërkesë e pa argumentuar në lidhje me numrin e fuqisë punëtore dhe periudhën e kërkuar prej 6 muajsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në pikën 2.3.4.c, të Shtojcës nr. 12, ndër të tjera është kërkuar që: *“Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt dhe zbatimin e kontrates, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, librezat e punës si dhe me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj per periudhen (Dhjetor 2017-Maj 2018) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit (Dhjetor 2017-Maj 2018) Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar dhe te perfshire ne licencen profesionale te shoqerise, stafin inxhinierik si më poshtë:*

- *1 (nje) ekspert zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri, te figuroje ne listpagesat e shoqerise per te pakten 6 muajt e fundit per te cilin te paraqitet kontrate pune, diplome perkatese, certifikate perkatese dhe leja e ushtrimit te profesionit “Ekspert Zjarrfikës”, libeze pune, CV. Dhe OE duhet te kete License per Mbrojtjen nga Zjarri te leshuar nga QKL Kodi 1.2.A ose te kete te lidhur nje kontrate te rregullt me nje kompani per trajtime te tilla, vertetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontrates se lidhur me subjektin trajnues.*

- *1 (nje) Inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni, te figuroje ne listpagesat e shoqerise per te pakten 6 muajt e fundit per te cilin te paraqitet kontrate pune, diplome perkatese, certifikate perkatese, libeze pune, CV.*

Per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri, Operatoret Ekonomike duhet te paraqesin diplomat, kontratat e punes te vlefshme per periudhen e zbatimit te punimeve dhe CV perkatese + libeza pune, si dhe te rezultojne ne listpagesa minimumi 6 muajt e fundit (per periudhen



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Dhjetor 2017-Maj 2018)”. Këto kërkesa nuk janë argumentuar për periudhën e kërkuar prej 6 muajsh, si dhe janë kërkuar punonjës të cilët nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, si dhe neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”.

-Në pikën 2.3.4.d, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me ane të nje deklarate të Administratorit të shoqërisë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, i cili të ketë eksperience pune jo më pak se 3 vjet dhe të jetë i pajisur me Diplome, Kontrate pune, CV”, kërkesë e pa argumentuar në lidhje me eksperiencën e kërkuar prej 3 vitesh për drejtuesin teknik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në pikën 2.3.4.e, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 3 (tre) specialiste të certifikuar “Punime në lartesi”, të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 6 muajt e fundit (Dhjetor 2017-Maj 2018)”, kërkesë kjo e paqartë për arsye se nuk është përcaktuar organi që do kryerjë certifikimet, si dhe nuk është argumentuar periudha e kërkuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 3, e cila përcakton se: “Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës”.

-Në pikën 2.3.4.f dhe 2.3.4.g, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “f) Operatori ekonomik të deshmojë se ka të punësuar në stafin e vete punonjës me profesionet si me poshte:

- jo më pak se 3 (tre) punonjës elektrikist
- jo më pak se 4 (kater) punonjës hidraulik
- më pak se 2 (dy) punonjës saldator
- më pak se 3 (tre) punonjës mekanik
- jo më pak se 4 (kater) punonjës pllakashtrues
- jo më pak se 5 (pese) muratore
- jo më pak se 2 (dy) karpentier
- jo më pak se 4 (kater) punonjës bojaxhi

g) Per gjithë drejtuesit e makinerive të renda, sipas Urdher Nr.44, datë 4.2.2004 “Per miratimin e rregullores “Per Procedurat dhe kriteret per dhenien e lejeve te manovrimit perdoruesve te makinerive te renda te ndertimit dhe disiplinimi i perdorimit te makinerive te ndertimit” te paraqese Deshmi te aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures te vlefshme, per minimumi 2 manovratore, te shoqeruar me kontratat e punes, librezat e punes dhe të figurojnë në listpagesa 6 muajt e fundit (Dhjetor 2017-Maj 2018)”. Këto kërkesa janë të pa argumentuara në lidhje me numrin dhe llojin e fuqisë punëtore, si dhe periudhën e kërkuar prej 6 muajsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në pikën 2.3.5, të Shtojcës nr. 12, ndër të tjera është kërkuar që: “Licensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- NP-12 A të Inxhinierise se Mjedisit.
- NS-18 A Punime topogjeodezike”, ndërsa nga verifikimi i zërave të preventivit nuk konstatohen punime të këtyre kategorive, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, gërma a, e cila përcakton se: “a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”.

-Në pikën 2.3.7, të Shtojcës nr. 12, është kërkuar që: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë*”, ku janë listuar 16 makineri dhe pajisje të ndryshme të kërkuara, por pa argumentuar nevojën e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

-Anëtarët e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, për hartimin e specifikimeve teknike në kundërshtim me LPP: A. K., E. P., F. Sh. dhe O. D.;

-Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankesave, në zbatim të RrPP, neni 78, pika 6, gërma a, e cila përcakton se: “*Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës*”.

Zhvillimi i procedurës

Tenderi është zhvilluar më datë 17.08.2018, ora 10:00. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës së paraqitur	Kualifikuar ose S`kualifikuar	Klasifikuar
1	Sh. SHPK	166,660,826.50	Kualifikuar	1
2	J. SHPK	193,836,080.00	Kualifikuar	2
3	S. SHPK	194,073,559.24	Kualifikuar	3
4	B.E.-A. SHPK & V.K. SHPK & M. SHPK	137,946,298.43	S`kualifikuar	
5	B.B.SHPK & K. SHPK	156,792,972.74	S`kualifikuar	
6	A. K. SHPK	170,044,743.55	S`kualifikuar	
7	B. A.K. SHPK & B.-I. SHPK	173,085,562.92	S`kualifikuar	
8	S. SHPK	173,512,246.43	S`kualifikuar	
9	B. E. SHPK & 2. SHPK	180,569,192.00	S`kualifikuar	
10	B. A.G.SHPK & Gj. SHPK	187,744,962.28	S`kualifikuar	
11	S. SHPK	188,000,000.00	S`kualifikuar	
12	A. SHPK	192,500,000.00	S`kualifikuar	
13	B.Sh. SHPK & B. B SHPK	202,747,859.93	S`kualifikuar	
14	A. P.	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	
15	A. T.	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	
16	E.-V. SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	

Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të ankesave, me anë të Raportit Përmbledhës nr. 2729/2, datë 09.11.2018, i miratuar nga titullari i AK me Vendim Miratimi nr. 2729/3, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

09.11.2019, është vendosur kualifikimi i ofertave të OE Sh. SHPK, J.SHPK dhe S. SHPK, skualifikimi i ofertave të OE S. SHPK, A. P., A. T.SHPK, A. K. SHPK, A. SHPK, BOE A. G. SHPK & Gj.SHPK, BOE A. K. SHPK & B.-I.SHPK, BOE B. SHPK & K. SHPK, BOE E.SHPK & 2.SHPK, E.-V.SHPK, BOE E.-A. SHPK & V. K. SHPK & M. SHPK, S. SHPK dhe BOE Sh. SHPK & B. B. SHPK, si dhe shpallja fituese e ofertës së OE Sh. SHPK.

Në lidhje me Raportin Përmbledhës, u konstatua se:

-Nuk paraqiten gabimet aritmetikore, mënyra e përlllogaritjes, si dhe masa e gabimit;
-Sipas RP, OE S. SHPK, nuk ka paraqitur ofertë, ndërsa sipas procesverbaleve të hapjes dhe vlerësimit, si dhe në sistemin elektronik, ka paraqitur ofertë 188,000,000.00 lekë;
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 68, i cili ndër të tjera përcakton se: “*Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave*”. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Nga auditimi i procesit të vlerësimit të ofertave u konstatua se:

BOE B.SHPK & K. SHPK

Në vlerësimin e kryer për ofertën e këtij OE, KVO është shprehur se:

- Asnjëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim nuk plotëson kushtin e licencës profesionale.
- Certifikatat ISO të subjektit B. janë të anuluar.
- Subjekti B. nuk plotëson kushtin për punë të ngjashme me vlerë në nivelet e kërkuara nga AK.
- Inxhinieri elektronik nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë ëpr periudhën e kërkuar dhjetor 2017-janar 2018.

Ky BOE, nuk ka pranuar kualifikimin e kryer nga KVO, e për pasojë ka ndjekur hapa e animimit, deri në KPP, institucion i cili me Vendimin nr. 745/2018, ka vendosur të mos pranojë ankesën e këtij BOE.

BOE E.-A. SHPK & V. K. SHPK & M. SHPK

Në vlerësimin e kryer për ofertën e këtij OE, KVO është shprehur se:

-Vërtetimi i paraqitur nga subjekti V. K., nuk përmban informacionin sipas modelit zyrtar të vendosur nga OSHEE. KVO vendos të mos pranojë këtë vërtetim, e bazuar në arsyetimin e Vendimit nr. 192/2015, në të cilin citohet qartë se formati i informacionit të dhënë nga OSHEE me Vërtetimin nr. 1516, datë 26.07.2018, nuk është në përputhje me dokumentin zyrtar “vërtetim debie” të miratuar nga ky institucion.

Në lidhje me këtë kriter, vlerësimi i KVO është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 26, pika 7, gërma c dhe nenin 66, për arsye se OE V.K. SHPK ka paraqitur Vërtetimin e OSHEE SHA nr. 1516, datë 26.07.2018, me anë të së cilit vërteton se ky OE nuk rezulton të jetë mbajtës kontrate me OSHEE (pra nuk rezulton të ketë as detyrime). Për më tepër Komisioni i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Shqyrtimit të Ankesës, për ankesën e ardhur nga ky BOE me nr. 2065, datë 06.09.2018, me anë të relacionit nr. 2309, datë 12.09.2018, drejtuar titullarit të AK, e cila e ka miratuar me Urdhrin e Brendshëm për Rivlerësim nr. 2345, datë 14.09.2018, e ka pranuar ankesën e BOE për këtë pikë, e megjithatë KVO nuk e ka pasqyruar në vlerësimin përfundimtar. Për sa më sipër, BOE E.-A. SHPK & V.Ko.SHPK & M. SHPK, duhej kualifikuar për këtë kriter.

-Ky kriter i DST, meqenëse operatorët ofertues janë anëtarë të një bashkimi, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duhet të përmbushet nga subjekti V. K. Kontrata e paraqitur sipas shtojcës 8 “Ndërtimi i HEC Banjë...” nuk përmbush kërkesat e AK. KVO në vlerësimin e kësaj kontrate është bazuar edhe në Vendimin nr. 521/2016 të KPP, dhe ka vlerësuar të vlefshme vetëm ato fatura tatimore të punimeve të realizuara nga data 17.08.2015 (që është data e zhvillimit të procedurës së prokurimit) e në vazhdim, e cila është periudha që përfshihet në “tre vitet e fundit”. Dhe në total faturat e paraqitura nuk e përmbushin kriterin për “punë të ngjashme jo më pak se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

-Subjekti V., me dy kontratat e paraqitura nuk e përmbush as këtë kriter të DST për arsye se vlera e punëve të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, sipas kontratave të paraqitura nga subjekti Viante Konstruksion nuk plotësohet kushti sipas pikës b).

Në lidhje me këtë kriter, OE V. k., me kontratat e paraqitura nuk e përmbush as këtë kriter të DST për arsye se vlera e punëve të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, nuk e plotësojnë kriterin ligjor, e për pasojë nuk duhej kualifikuar për këtë kriter.

-Subjektet si anëtare të bashkimit kanë plotësuar dhe nënshkruar shtojcën 10 ku kanë listuar mjetet dhe pajisjet duke deklaruar se kanë edhe të tjera për të kryer punimet. Gjithashtu kanë deklaruar se i lejojnë AK të kryejë verifikimet e nevojshme. Por subjekti V. K. dhe M. nuk kanë paraqitur deklaratë për të dokumentuar disponibilitetin e këtyre mjeteve. Dhe as për faktin nëse këto mhte janë deklaruar në procedura të tjera prokurimi ku subjektet mund të jenë palë. Një deklaratë e tillë është paraqitur vetë nga subjekti “E.-A.”, por jo në cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit por vetëm për mjetet dhe pajisjet e tij që ka deklaruar se angazhon në këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me këtë kriter, BOE E.-A. SHPK & V.K. SHPK & M.SHPK, ka paraqitur të gjithë makineritë dhe pajisjet e kërkuara, si dhe ka lëshuar Shtojcën nr. 10, e cila është firmosur nga përfaqësuesi i OE E.-A. SHPK z. B. M., në emër të grupit sipas Prokurës së Posaçme nr. 6785 Rep, nr. 4936 Kol., datë 16.08.2018, pika a, ku autorizohet Administratori i OE E.-A. SHPK z. B.M. për të nënshkruar, vulosur dhe dorëzuar pranë çdo institucioni, të gjithë dokumentacionin e përgatitur për këtë procedurë, konform nenit 64 të Kodit Civil. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, e për pasojë BOE E.-A. SHPK & V.K. SHPK & M.SHPK, duhej kualifikuar për këtë kriter.

-Nga auditimi i dokumentacionit elektronik të paraqitur nga ky BOE, u konstatua se Formulari nr. 1 “Oferta ekonomike”, e paraqitur, është përcaktuar se vlera e pajisjeve pa tvsh është 56,450,298 lekë, tatimi në vlerën e shtuar në vlerën 11,290,059.6 lekë, dhe shuma totale në vlerën 67,740,357.6 lekë. Pra BOE E.-A. SHPK & V. K. SHPK & M. SHPK, **ka ofertuar pajisjet me tvsh në vlerën 11,290,059.6 lekë, e cila në rast kualifikimi do përbënte dëm**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit, e për pasojë oferta nuk duhej kualifikuar, edhe pse KVO në vlerësimin e saj nuk e ka përmendur këtë fakt.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, kreu I, gërma A, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat”. Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

OE Sh. SHPK, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 71483607, datë 13.11.2018, me vlerë 19,999,299.18 lekë.

Kontrata nr. 2729/2, datë 14.11.2018, me vlerë 166,660,826.5 lekë pa tvsh, me afat 26 muaj, është nënshkruar nga znj. N. J. për AK dhe z. A.Z. për kontraktorin Sh.SHPK.

III.6.17. Dokumentacioni ligjor, financiar dhe teknik i zbatimit të procedurave të prokurimit të zhvilluar me objekt “Asgjësim i mbetjeve (të rrezikshme) spitalore”

Grupi i auditimit përzgjedhi për të audituar këto procedura, nisur vlera monetare që kanë në krahasim me procedurat e tjera, si dhe nisur nga fakti i rëndësisë dhe ndjeshmërisë së opinionit publik, në lidhje me çështjen e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore.

III.6.17.1. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Asgjësim i mbetjeve të rrezikshme”, viti 2016, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 707, datë 25.03.2016		
Vlera e përlogaritur e kontratës 4,068,090 lekë pa TVSH.		
Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 08.04.2016.		
OE fitues “M. T.” SHPK me ofertë: Loti 1: 3,315,150 lekë pa TVSH. Loti 2: 653,940 lekë pa Tvsh. Loti 3: Anuluar Zbritja nga fondi limit 66,250 lekë pa TVSH.	F. R., mjekësi, kryetar, T. Z., ekonomiste, N. M., inxhinier mekanik.	A.Xh., jurist, K. S., ekonomiste, I.M., juriste.
Kanë marrë pjesë në tender 1 operator ekonomikë.	Urdhri Nr. 707/1 Prot., datë 25.03.2016.	
Kualifikuar 1 operator ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 707/2 Prot., datë 29.04.2016, me vlerë 4,762,908 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: A. F. deri më datë 01.04.2016. E.Sh. deri më datë 20.04.2016. A.R. pas datës 20.04.2016.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit), sipas Urdhrit nr. 414/1, datë 12.02.2016: V. Xh., K.S., I. M.	Formulari i Njoftimit të Kontratës pa numër dhe pa datë. Formulari i Njoftimit të Fituesit pa numër dhe pa datë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Raporti përmbledhës, miratuar pa numër protokoll, Prot., datë 20.04.2016.	Komisioni i monitorimit të kontratës, Urdhri nr. 707/3, datë 29.04.2016: A. H., A. N., E. D.	Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar pa numër dhe pa datë. Ankesa: Nuk ka.
---	--	---

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e sektorit së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

OE M. T. SHPK, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 0001117, datë 22.04.2016, me vlerë 397,818 lekë dhe formularin e sigurimit të kontratës nr. 0002066, datë 22.04.2016, me vlerë 78,473 lekë.

Kontrata nr. 707/2 Prot., datë 29.04.2016, me vlerë 4,762,908 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2016, është nënshkruar nga A.R. për AK dhe z. A.P. për kontraktorin M. T.SHPK.

III.6.17.2. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Asgjësim i mbetjeve të rrezikshme”, viti 2017, zhvilluar me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake”, shtesë 20% të kontratës nr. 707/2 Prot., datë 29.04.2016.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e sektorit së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

OE M.T. SHPK, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 30908042, datë 11.01.2017, me vlerë 95,259 lekë dhe formularin e sigurimit të kontratës nr. 0002066, datë 22.04.2016, me vlerë 78,473 lekë.

Kontrata nr. 59/6 Prot., datë 11.01.2017, me vlerë 952.581.60 lekë me tvsh, është nënshkruar nga A. R. për AK dhe z. A.P. për kontraktorin M. T.SHPK.

Me Urdhrin e titullarit të AK nr. 59/8, datë 11.01.2017, është ngritur grupi për monitorimin e kontratës, i përbërë nga:

1. A. N.,
2. A.Xh. dhe
3. K. Ç.

III.6.17.3. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Transport dhe Asgjësim i mbetjeve të rrezikshme për Spitalin Rajonal Durrës”, viti 2017, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 564/6, datë 17.03.2017	L. B., ekonomiste, kryetar,	V.C., ekonomiste.
Vlera e përlogaritit e kontratës 1,633,000 lekë pa TVSH.	A. Xh., jurist,	O. G., juriste,
Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike.	G. S., ekonomiste.	A. H., inxhinierë mjedisi.
	Urdhri Nr. 564/9 Prot., datë	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Hapja e ofertave datë 05.04.2017. OE fitues “M. T.” SHPK me ofertë 1,633,000 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 0 lekë pa TVSH.	23.03.2017.	
Kanë marrë pjesë në tender 2 operatorë ekonomikë. 1. OE “M. T.” SHPK me ofertë 1,633,000 lekë pa TVSH. 2. “E. T.” SHPK me ofertë 1,490,000 lekë pa TVSH.		
Kualifikuar 1 operator ekonomikë. Skualifikuar 1 operator ekonomikë.		
Kontrata nr. 1218/6 Prot., datë 01.06.2017, me vlerë 1,959,600 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: A.R. deri më datë 25.05.2017. V.C. pas datës 25.05.2017. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 708/11218/11 Prot., datë 01.06.2017.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit) dhe për hartimin e specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 564/1, datë 10.03.2017: A., K. Ç. dhe A. N. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave sipas Urdhrit nr. 859/1, datë 18.04.2017: R. Ç., S. A. dhe Dh.K. Komisioni i monitorimit të kontratës, Urdhri nr. 1218/7, datë 01.06.2017: A. D., K. Ç. dhe A.N.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 564/8, datë 20.03.2017. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 1218/3, datë 01.06.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 1218/8, datë 01.06.2017. Ankesa: Ka.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e sektorit së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

OE M.T. SHPK, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 46453209, datë 31.05.2017, me vlerë 195,960 lekë.

Kontrata nr. 1218/6 Prot., datë 01.06.2017, me vlerë 1,959,600 lekë me TVSH, me afat 3 muaj, është nënshkruar nga znj. V.C. për AK dhe z. E.K. për kontraktorin M. T. SHPK.

III.6.17.4. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Transport dhe Asgjësim i mbetjeve spitalore”, viti 2017, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 708/5, datë 20.06.2017	E.Sh., mjekësi, kryetar,	O.G., juriste,
Vlera e përlogaritur e kontratës 3,731,320 lekë pa TVSH.	A.Xh., jurist,	A.H., inxhinierë mjedisi,
Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike.	B.K., marketing.	M.L., ekonomiste.
	Urdhri Nr. 708/8 Prot., datë	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Hapja e ofertave datë 24.07.2017.	20.06.2017.	
OE fitues "M.T." SHPK me ofertë: Loti 1: 3,681,320 lekë pa TVSH. Loti 2: 50,000 lekë pa Tvsh. Zbritja nga fondi limit 0 lekë pa TVSH.		
Kanë marrë pjesë në tender 1 operator ekonomikë.		
Kualifikuar 1 operator ekonomikë. Skualifikuar 0 operatorë ekonomikë.		
Kontrata nr. 708/16 Prot., datë 07.08.2017, me vlerë 4,477,584 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: V.C. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 708/11 Prot., datë 03.08.2017.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit) dhe për hartimin e specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 708/1, datë 03.04.2017: R. Ç., K. Ç. dhe A.N. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave sipas Urdhrit nr. 1386/1, datë 28.06.2017: A. D., D.J. dhe R.K. Komisioni i monitorimit të kontratës, Urdhri nr. 1614, datë 07.08.2017: R.Ç., K.Ç. dhe A. N.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 708/7, datë 20.06.2017. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 708/13, datë 04.08.2017. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 1614/1, datë 07.08.2017. Ankesa: Ka.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e sektorit së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

OE M.T.SHPK, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 46454811, datë 07.08.2017, me vlerë 447,758.40 lekë.

Kontrata nr. 708/16, datë 07.08.2017, me vlerë 4,477,584 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2017, është nënshkruar nga znj. V.C. për AK dhe z. A.P. për kontraktorin M.T. SHPK.

III.6.17.5. Në procedurën e prokurimit me objekt: "Asgjësimit i mbetjeve të rrezikshme", viti 2018, zhvilluar me procedurë "Negocim pa shpallje paraprake", shtesë 20% të kontratës nr. 708/16, datë 07.08.2017.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e sektorit së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Kontrata nr. 47/2 Prot., datë 10.01.2018, me vlerë 852,444 lekë me tvsh, është nënshkruar nga A.R. për AK dhe z. A.P. për kontraktorin M.T. SHPK.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

OE M.T.SHPK ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 71466704, datë 09.01.2018, me vlerë 85,244.40 lekë.

Me Urdhrin e titullarit të AK nr. 47/3, datë 10.01.2018, është ngritur grupi për monitorimin e kontratës, i përbërë nga:

1. A.D.,
2. A.N. dhe
3. K. Ç.

III.6.17.6. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Transport dhe Asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, viti 2018, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
Urdhër Prokurimi Nr. 61/3, datë 30.03.2018 Vlera e përlogaritur e kontratës 6,583,120 lekë pa TVSH. Procedurë “Kërkesë për Propozim” me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 13.04.2018.		
OE fitues “M.T.” SHPK me ofertë 6,583,120 lekë pa Tvsh. Zbritja nga fondi limit 0 lekë pa TVSH. Kanë marrë pjesë në tender 2 operator ekonomikë. 1. OE “M.T.” SHPK me ofertë 6,583,120 lekë pa Tvsh. 2. OE “E.R.” SHPK me ofertë 8,315,520 lekë pa Tvsh.	G.K., ekonomist, kryetar, H.P., inxhinier mjedisi, B.K., marketing. Urdhri Nr. 61/6 Prot., datë 30.03.2018.	V.C., ekonomiste, O.G., juriste, A.H., inxhinier mjedisi.
Kualifikuar 1 operator ekonomikë. Skualifikuar 1 operator ekonomikë.		
Kontrata nr. 61/16 Prot., datë 26.04.2018, me vlerë 7,899,744 lekë me TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: A.R. Raporti përmbledhës, miratuar Nr. 61/11 Prot., datë 23.04.2018.	Grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së kontratës (vlerës së fondit limit) dhe për hartimin e specifikimeve teknike, sipas Urdhrit nr. 61/1, datë 24.01.2018: A. D., R. Ç. dhe L. S. Komisioni i monitorimit të kontratës, Urdhri nr. 61/17, datë 26.04.2018: A.D., R. Ç. dhe L. S.	Formulari i Njoftimit të Kontratës nr. 61/5, datë 30.03.2018. Formulari i Njoftimit të Fituesit nr. 61/13, datë 24.04.2018. Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 61/18, datë 26.04.2018. Ankesa: Nuk ka.

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e sektorit së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

OE M. T.SHPK, ka paraqitur formularin e sigurimit të kontratës nr. 30908496, datë 25.04.2018, me vlerë 789,974.4 lekë.

Kontrata nr. 61/16 Prot., datë 26.04.2018, me vlerë 7,899,744 lekë me tvsh, me afat deri më 31.12.2018, është nënshkruar nga z. G.K. (me autorizim të titullarit të AK) për AK dhe z. A.K. për kontraktorin M. T. SHPK.

Nga auditimi i zbatimit të këtyre kontratave, u konstatua se:

Për periudhën objekt auditimi, janë realizuar gjithsej 6 kontrata për asgjësim të mbetjeve spitalore, për vlerën totale 20,904,861.60 lekë, më hollësisht sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Kontrata	Lloji i procedurës	Vlera me tvsh
1	Nr. 707/2 Prot., datë 29.04.2016	Kërkesë për propozim	4,762,908.00
2	Nr. 59/6 Prot., datë 11.01.2017	Negocim 20%	952,581.60
3	Nr. 1218/6 Prot., datë 01.06.2017	Kërkesë për propozim	1,959,600.00
4	Nr. 708/16, datë 07.08.2017	Kërkesë për propozim	4,477,584.00
5	Nr. 47/2 Prot., datë 10.01.2018	Negocim 20%	852,444.00
6	Nr. 61/16 Prot., datë 26.04.2018	Kërkesë për propozim	7,899,744.00
7	Shuma		20,904,861.60

Në lidhje me këto kontrata konstatohet se:

-Nga grupet e monitorimit të kontratave, janë ndjekur procedurat për peshimin e mbetjeve spitalore, para dorëzimit tek kontraktori, por nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme për verifikimin nëse këto mbetje janë asgjësuar apo jo, në kundërshtim me kushtet e kontratës, si dhe në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 8, e cila përcakton se: “Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe **deri tek asgjësimi i tyre**”.

-Në kontratat e nënshkruara, është prokuruar shërbimi i asgjësimit për mbetjet me kod 18 01 01 “Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)”, 18 01 02 “Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)”, 18 01 03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkohet trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet”, si dhe 18 01 07 “Kimikate të tjera nga ato të përmendura në 18 01 06”. Por nga verifikimi i listës së mbetjeve spitalore të rrezikshme spitalore të prodhuara nga SRD, konstatohet se për periudhën 2016-2018, janë prodhuar gjithsej 373 kg mbetje të krijuara nga pavioni i Paliativit, mbetje të cilat sipas VKM nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, janë me kod 18 01 08 “Medikamente citostatika dhe citotoksike”, e si të tilla janë mbetje shumë të rrezikshme dhe toksike, të cilat SRD i ka trajtuar si mbetjet e tjera spitalore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 5, e cila përcakton se: “5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për:

- grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor;
- ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;

d) shpenzimet e transportit, asgjësimin ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi, për të ndërmarrë këto veprimtari;

e) të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimin të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.”, pika 8, e cila përcakton se: “Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre”, si dhe pika 8.1, e cila përcakton se: “Çdo prodhues ndan që në burim elementet e rrezikshme nga ato të parrezikshme të mbetjeve spitalore, sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore dhe i magazinon ato të ndara”.

Në lidhje me mbetjet spitalore, përveç parregullsive financiare dhe ligjore të konstatuara në kryerjen e këtij shërbimi, duhet të merren parasysh dhe pasojat mjedisore dhe shëndetësore që mund të vijnë si pasojë e mos ndjekjes nga SRD të procedurave ligjore rigorozë në trajtimin e të mbetjeve të rrezikshme citostatike dhe citotoksike.

Për pasojë, grupi i auditimit **nuk mund të shprehet mbi saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë** e kryerjes së shërbimit të asgjësimin të mbetjeve spitalore, për 6 kontratat e lidhura për periudhën 2016-2018, me vlerë 20,904,861.60 lekë. Në mungesë të dokumentacionit të duhur ligjor dhe financiar, që do provonte kryerjen e këtij shërbimi nga OE të kontraktuar nga SRD, **vlera 20,904,861.60 lekë**, përbën një shpenzim të pa argumentuar dhe të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës.

Dokumentacioni i mbajtur nga SRD në lidhje me këto procedura, **nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, e për pasojë nuk mund të quhen dokumente financiare**, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26, e cila përcakton se: ““Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkaktun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36, e cila përcakton se: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve”.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 654/4, datë 06.06.2019, dërguar nga përgjegjësja e sektorit të mjedisit, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron, e për pasojë nuk merret parasysh në hartimin e këtij Raport Përfundimtar Auditimi, me arsyet si më poshtë vijon:

Së pari, pretendimi juaj mbi asgjësimin e mbetjeve nuk qëndron, për arsye se dokumentacioni



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

i mbajtur nga kontraktori, Spitali Durrës dhe Inspektorati Qëndror i Pyjeve dhe Ujrave, është një dokumentacion ligjor i domosdoshëm për transferimin/transportin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, por që nuk provon asgjësimin e mbetjeve spitalore në kuptim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

III.6.18. Dokumentacioni ligjor, financiar dhe teknik i zbatimit të procedurave të prokurimit të zhvilluar me objekt “Blerje Oksigjen Lëng për Spitalin Rajonal Durrës”.

III.6.18.1. Në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje Oksigjen Lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, viti 2017, zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.

Të dhëna mbi tenderin	Kontratat	Formularët e Njoftimit të Kontratës
Urdhër Prokurimi Nr. 102, datë 11.01.2017		
Vlera e përlogaritur e kontratës 163,236,826 lekë pa TVSH.		
Procedurë “E Hapur me mjete elektronike”, zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.		
BOE fitues “G.G.T.” SHPK dhe “M.A.” SHPK me ofertë 163,236,360 lekë pa TVSH. Zbritja nga fondi limit 466 lekë pa TVSH.		Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar nr. 432/1, datë 23.02.2017.
OE i caktuar për zbatimin e kontratës për SRD është “M. A.” SHPK.		
Kontrata nr. 433, datë 23.02.2017, me vlerë 17,113,600 lekë pa TVSH.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: A.R.	Grupi i punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e kontratës sipas Urdhrit nr. 433/1, datë 23.02.2017: A. M., E. D. dhe G.S.	

Dosja për këtë procedurë prokurimi nuk është e arkivuar, por mbahet në zyrat e drejtorisë së prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me anë të shkresës nr. 102/7, datë 16.02.2017, Ministri i Shëndetësisë ka dërguar dokumentacionin për lidhjen e kontratës së furnizimit me oksigjen lëng për përdorim mjekësor.

Kontrata nr. 433, datë 23.02.2017 “Blerje Oksigjen lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, me vlerë 17,113,600 lekë pa tvsh (përfshirë nga tvsh), me afat deri më datë 31.12.2017, është nënshkruar për AK nga z. A.R. dhe për BOE G.G.T. SHPK dhe M.A.SHPK nga z. B. H. dhe z. V. V.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

BOE G.G.T.SHPK dhe M.A.SHPK, ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës nr. 46451579, datë 21.02.2017, me vlerë 1,711,360 lekë, me afat deri në zbatimin e plotë të kontratës.

Me anë të Urdhrit nr. 433/1, datë 23.02.2017, titullari i AK ka ngritur grupin e punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave objekt i kësaj kontrate të përbërë nga znj. A. M., kryetare, znj. E.Da. dhe znj. G. S., anëtare.

Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate, u konstatua se:

Me anë të 41 faturave tatimore, OE M.A.SHPK, i caktuar për zbatimin e kësaj kontrate sipas marrëveshjes së bashkimit të OE, ka sjellë në ambientet e Spitalit Rajonal Durrës sasinë prej 122,210 litra oksigjen të lëngshëm.

Por sipas Aneksit nr. 2, të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017, sasia e kontraktuar është 122,240 litra oksigjen të lëngshëm. Nuk konstatohet arsyeja e mos dorëzimit të sasisë së kontraktuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60.

Për pasojë AK, duhet të konfiskonte formularin e sigurimit të kontratës nr. 46451579, datë 21.02.2017, me vlerë **1,711,360 lekë**, si dhe të njoftonte APP për mos realizimin e kësaj kontrate nga ky OE.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave objekt i kësaj kontrate, sipas Urdhrit nr. 433/1, datë 23.02.2017.

Në lidhje me sasinë, konstatohet se kontraktori M.A.SHPK, e sjell sasinë në kilogramë, sasia e cila për këtë kontratë është 139,442 kg ose 122,210 litra. Më pas sasia e sjellë në kilogramë, është konvertuar në litra nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe OE M.A. SHPK, sipas koeficientit 1.141 kg/lt.

Por sipas Aneksit nr. 2, të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017, koeficienti i konvertimit është 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), e si i tillë ky është koeficienti me të cilin duhej të përdorej nga kontraktori M.A.SHPK.

Nëse bëhen rilogaritjet me koeficientin 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), atëherë për sasinë 139,442 kg, sasia reale në litra e furnizuar nga kontraktori do jetë 104,294 lt oksigjen të lëngshëm.

Si konkluzion, nga përdorimi i koeficientit në kundërshtim me atë të përcaktuar në kontratë, kontraktori M.A. SHPK **ka sjellë më pak 17,916 litra oksigjen të lëngshëm** (122,210 lt – 104,294 lt), ose në vlerën **2,508,184 lekë** (e konvertuar me çmimin 140 lekë/lt), **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave objekt i kësaj kontrate, sipas Urdhrit nr. 433/1, datë 23.02.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

III.6.18.2. Në procedurën e zhvilluar me objekt “Blerje Oksigjen Lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, viti 2018, Marrëveshje Kuadër - zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë.

Marrëveshja Kuadër (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara) nr. 911/10, datë 23.04.2018, është nënshkruar në Ministrinë e Shëndetësisë, me BOE G.G.T. SHPK dhe M.A. SHPK.

Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje Kuadër, AK ka lidhur Kontratën nr. 1 të Furnizimit nr. 1198/8, datë 11.05.2018, me vlerë 20,056,800 lekë pa tvsh (përfshirë nga tvsh), me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, për sasinë 146,400 litra oksigjen të lëngshëm.

Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate, u konstatua se:

Me anë të 38 faturave tatimore, OE M.A.SHPK, i caktuar për zbatimin e kësaj kontrate sipas marrëveshjes së bashkimit të OE, ka sjellë në ambientet e Spitalit Rajonal Durrës sasinë prej 133,555 litra oksigjen të lëngshëm.

Në lidhje me sasinë, konstatohet se kontraktori M.A. SHPK, e sjell sasinë në kilogramë, sasia e cila për këtë kontratë është 152,386 kg, deri më 31.12.2018. Më pas sasia e sjellë në kilogramë, është konvertuar në litra nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe OE M. A. SHPK, sipas koeficientit 1.141 kg/lit.

Duke qenë se në Kontratën nr. 1 të Furnizimit nr. 1198/8, datë 11.05.2018, nuk përcaktohej koeficienti i konvertimit nga kilogramë në litra që do përdoret, grupi i auditimit i referohet koeficientit 1,337 g/lit (1.337 kg/lit), të përdorur në kontratën nr. 433, datë 23.02.2017.

Për pasojë, nëse bëhen rrillogaritjet me koeficientin 1,337 g/lit (1.337 kg/lit), atëherë për sasinë 152,386 kg, sasia reale në litra e furnizuar nga kontraktori do jetë 113,976 litra oksigjen të lëngshëm.

Si konkluzion, nga përdorimi i koeficientit të pamiruar, kontraktori M.A. SHPK **ka sjellë më pak 19,579 litra oksigjen të lëngshëm** (133,555 litra – 113,976 litra), ose në vlerën - **2,682,288 lekë** (e konvertuar me çmimin 137 lekë/lit), **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VI, nenet 59 dhe 60, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pikat 3 dhe 4.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës për monitorimin, marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave objekt i kësaj kontrate.



III.7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

III.7.1. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël të vitit 2015

Për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla për vitin 2015, nga Titullari i AK është ngritur komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 43 prot, datë 12.01.2015 dhe përbëhej nga:

1. M.Xh. kryetare,
2. Dh. K. dhe
3. E.K. anëtarë.

Në përgjithësi procedurat e blerjeve me vlerë të vogël, janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore, përveç rasteve të shënuara më poshtë.

-Në disa raste u konstatuan vonesa të dorëzimit të mallrave të prokuruarra, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 2,936 lekë, për SRD.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

Grupi i auditimit përzgjedhi për të audituar disa praktika me blerje me vlerë të vogël, nisur nga vlerat më të larta të realizimit, nga ku u konstatua se:

1. Blerje Fotokopje.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 744, datë 27.04.2015, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “furnizim vendosje sensor letre si dhe shërbim me fotokopjen canon IR-2318”, me vlerë fondi limit 10000 lekë pa tvsh.

Në këtë procedurë është shpallur fitues A.-C., i cili është renditur i dyti, kjo për arsye të tërheqjes së OE R. C., i renditur i pari.

-Procesverbali i datës 27.04.2015, është në konflikt me procesverbalin e datës 25.04.2015.

-Procesverbali i datës 25.04.2015, ka konflikt me datat, për arsye se pretendohet se 1 ditë më vonë fotokopja i është dorëzuar OE.

2. Blerje shtypshkrime.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1813, datë 09.10.2015, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “furnizim vendosje sensor letre si dhe shërbim me fotokopjen canon IR-2318”, me vlerë fondi limit 10000 lekë pa tvsh.

3. Blerje materiale hidraulike.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 367, datë 12.02.2015, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “blerje materiale hidraulike, dyer, durali, aksesor dhe vegla pune”, me vlerë fondi limit 550,800 lekë pa tvsh.

-Malli është sjellë 1 ditë me vonesë, për pasojë duhej llogaritur **penaliteti në vlerën 2,203 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik**. Në kundërshtim me nenin 5, të kontratës nr. 367/4, datë 25.03.2015.

4. Blerje pjesë dhe mirëmbajtje ashensorësh.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 374, datë 13.02.2015, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “blerje pjesë dhe shërbimin e ashensorëve”, me vlerë fondi limit 567,00 lekë pa tvsh.

5. Blerje pjesë dhe shërbime në lavatriçe.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 415, datë 24.02.2015, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “Blerje pjesë dhe shërbimin në lavatriçet industriale”, me vlerë fondi limit 781,60 lekë pa tvsh.

-Malli është sjellë 1 ditë me vonesë, për pasojë duhej llogaritur **penaliteti në vlerën 733 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik**. Në kundërshtim me nenin 5, të kontratës nr. 367/4, datë 25.03.2015.

6. Blerje pjesë dhe mirëmbajtje për sistemin e kondicionimit dhe dhoma frigoriferike.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 806, datë 24.04.2015, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “Blerje pjesë dhe mirëmbajtje për sistemin e kondicionimit dhe dhoma frigoriferike”, me vlerë fondi limit 638,890 lekë pa tvsh.

-Procesverbali i datës 15.06.2015 është në konflikt me procesverbalin e datës 7.12.2015.

Vlera 67,200 lekë është faturuar në datë 15.06.2015 dhe është kryer në datë 7.12.2015, me një vonesë prej 12 ditësh me një vlerë 632,268 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 49 dhe 50.

Në përgjigje të observacionit të dërguar me shkresën nr. 1247, datë 26.06.2019, protokolluar në KLSH me nr. 1419/5, datë 01.07.2019, dërguar nga M.Xh. dhe Dh. K., në lidhje me Masën Organizative nr. 3, sqarojmë se observacioni juaj nuk qëndron, për arsye se:

Së pari, pretendimi se malli ka ardhur sipas nenit 3 të kontratës, nuk qëndron për arsye se në nenin 3 përcaktohet që malli duhet të lëvrohet brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, gjë që nuk ka ndodhur, pasi fatura tatimore nr. 77, datë 15.06.2015, me vlerë 699,468, provon të kundërtën (40 ditë pas nënshkrimit të kontratës nga 30 ditë që duhej).

7. Blerje Programi Financiar.

Me kërkesën nr. 992 Prot datë 02.06.2015 nga sektori i financës pranë SRD, është kërkuar të blihet dhe të instalohet një program financiar ku të mbulojë plotësisht nevojat e kontabilitetit. Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1130, datë 11.06.2015 është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël “blerje dhe instalim i programit financiar” me vlerë fondi limit 100,000 lekë pa tvsh.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi testoi tregun mori treguesit për çmimet e blerje/shërbimeve dhe punëve të cilat janë objekt i urdhrin të prokurimit, konkretisht si më poshtë:

1. Gj.K. sh.p.k me vlerë 158,333 lekë pa tvsh
2. I. S. D. sh.p.k me vlerë 100,000 lekë pa tvsh dhe
3. A. sh.p.k me vlerë 175,000 lekë pa tvsh.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi shqyrtoi treguesit e cmimeve të paraqitura si më sipër, bazuar në kriterin e cmimit më të ulët, vendosi të përcaktojë si fitues operatorin ekonomik I.S. D. me vlerë 100,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1130/3, datë 24.06.2015 midis “I.S.D”sh.p.k dhe Autoritetit Kontraktor të SRD ku objekt i kësaj kontrate është “Blerje, instalim dhe mirëmbajtje programi financiar” me afat përfundimtar 31.12.2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me urdhër nr. 1972, datë 30.10.2015 titullari i Autoritetit Kontraktor ka përcaktuar personin e dedikuar që ka realizuar lidhjet me stafin e I.S. znj.T.Z.

Ky urdhër i është bërë me dije drejtorit të Shërbimeve Administrative dhe Shefit të Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Me procesverbalin e datës 31.12.2015 komisioni i blerjeve të vogla dhe inxhinieri i IT, Sektori i Pagave dhe Financa kanë deklaruar se shërbimi për implementimin e programit është kryer sipas specifikimeve teknike

Nuk vërtetohet ndjekja e trajnimeve për asimilimin dhe përvetësimin e programit financiar nga sektorët përkatës në kundërshtim me nenin 2 të kontratës me nr. 1130/3, datë 24.06.2015 e cila thotë “Duhet të bëhet trajnimi dhe instruktimi i specialistëve për njohjen dhe përdorimin e programit të vendosur”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

III.7.2. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël të vitit 2016

Për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla për vitin 2016, nga Titullari i AK është ngritur komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 1418 prot, datë 11.07.2016 dhe përbëhej nga:

4. V.C. kryetare,
5. O.M. dhe
6. K.S.anëtare

Me Urdhrin nr. 1418/1, datë 14.11.2016, është ndryshuar komisioni me përbërje si më poshtë:

1. V.C. kryetare
2. O.G.dhe
3. A.H. anëtare.

Grupi i auditimit përzgjedhi për të audituar disa praktika me blerje me vlerë të vogël, nisur nga vlerat më të larta të realizimit, nga ku u konstatua se:

1. Blerje Kompresorë ajri për Spitalin Rajonal Durrës.

Me Urdhrin nr 2573, datë 21.12.2016 me qëllim hartimin e specifikimeve teknike për procedurën me vlerë të vogël me objekt “blerje kompresorë ajri për Spitalin Rajonal Durrës” është ngritur komisioni përkatës.

Bazuar në procesverbalin me nr. 2573/4, datë 27.12.2016 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 309,442 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 2753/5, datë 27.12.2016, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “ blerje kompresorë ajri për Spitalin Rajonal Durrës ”, me vlerë fondi limit 309,442 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 2573/7, datë 27.12.2016 pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “Sh. K.” me ofertë 295,000 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 2573/10, datë 30.12.2016 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “Sh. K.” me ofertë 295,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 2573/11 më datë 30.12.2016 me fond limit 309,442 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr 2573/12, datë 30.12.2016 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

2. Blerje kompjuterash për mjekët e spitaleve që lëshojnë receta dhe farmacitë e spitaleve.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 2545/5, datë 27.12.2016, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “blerjen e kompjuterave(laptop) për mjekët e spitaleve që lëshojnë receta dhe farmacitë e spitaleve”, me vlerë fondi limit 750,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin e datës 28.12.2016, anëtarët e komisionit kanë shpallur fituese ofertën e operatorit ekonomik “E.I.”, me vlerë 379,800 lekë pa Tvsh.

Me procesverbalin e datës 29.12.2016, për shkak të tërheqjes së ofertuesuesit të renditur në vend të parë, në bazë të Nenit 40 pika 5 të VKM 914 datë 29.12.2014, Udhëzimi Nr 1 dt 21.04.2016, pika 3 Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të vogël dhe shpall fitues ofertën e operatorit ekonomik i renditur i dyti “Gj.C.” me vlerë 430,000 lekë pa tvsh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me procesverbalin e datës 30.12.2016 pas skualifikimit të operatorit të renditur i dyti, për mungesë dokumentacioni është shpallur fitues operatori i tretë “R.C.” me fond limit 482,900 lekë pa tvsh në listën e ofertave

Kontrata është lidhur me nr. 2545/13 më datë 30.12.2016 me fond limit 750,000 lekë pa tvsh. Sigurimi i kontratës është kryer një ditë me vonesë nga lidhja e kontratës datë 30.12.2016 në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014”, i ndryshuar, neni 24, pika 1, e cila përcakton se: “Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës.”.

Me Urdhrin nr 2545/13, datë 30.12.2016 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

3. Riparim i dyerve në pavionin pranim –urgjencës.

Me Urdhrin nr 1738/1, datë 29.08.2016 me qëllim hartimin e specifikimeve teknike për procedurën me vlerë të vogël me objekt “riparim i dyerve në pavionin pranim –urgjencës për Spitalin Rajonal Durrës” është ngritur komisioni përkatës.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1788/3, datë 12.12.2016, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “Riparim i dyerve në pavion pranim-urgjence”, me vlerë fondi limit 364,500 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1788/7, datë 15.12.2016 pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “S.” me ofertë 235,000 lekë pa tvsh.

Në vendimin e datës 15.12.2016 pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike nga ana e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël titullari i autoritetit kontraktor miratoi propozimin e komisionit dhe shpall fitues operatorin ekonomik “S.” me cmimin më të ulët 235,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1788/10 më datë 19.12.2016 me fond limit 364,500, lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr 1788/11, datë 19.12.2016 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të shërbimit.

4. Blerje pjesë ndërrim për kaldajat.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 2438/4, datë 30.11.2016, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “blerje pjesë ndërrimi për kaldajat”, me vlerë fondi limit 329,300 lekë pa tvsh.

Në datën 01.12.2016 në Spitalin Rajonal Durrës nga Komisioni i Blerjeve së prokurimit me vlerë u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Sipas vlerësimit të Komisionit të Blerjeve të Vogla oferta me cmim më të ulët është e OE “A.” me ofertë 294,800 lekë pa tvsh.

Me vendimin e datës 02.12.2016 titullari i autoritetit kontraktor miratoi propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël operatorin ekonomik “A.”.

Kontrata është lidhur me nr. 2438/10 më datë 05.12.2016 me fond limit 329,300, lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr 2438/11, datë 05.12.2016 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

5. Blerje pjesë dhe shërbimi në ashensorë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 844/1, datë 05.05.2016, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “blerje pjesë dhe shërbimi në ashensorë”, me vlerë fondi limit 518,200 lekë pa tvsh. Autoriteti kontraktor ka zhvilluar ftesën për ofertë me nr. 844/4 në datë 18.05.2016.

Me proceverbalin nr. 1 nga Komisioni i blerjeve të vogla u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës me objekt “blerje pjesë për ashensorët si dhe shërbimet në 4 ashensorët”, ku morën pjesë operatorët ekonomik me ofertat përkatëse:

- B.M. me ofertë 449,500 lekë pa tvsh
- H.K. me ofertë 450,000 lekë pa tvsh
- H.E. C. me ofertë 480,000 lekë pa tvsh
- A.I. me ofertë 500,000 lekë pa tvsh
- F. me ofertë 517,000 lekë pa tvsh.

Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët ishte e operatorit B.M. Në bazë të vlerësimit të komisionit me blerje të vogla, titullari i autoritetit kontraktor shpall fitues të procedurës B.M. me ofertë 449,500 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr 2, datë 20.05.2016 Komisioni i blerjeve të vogla shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë H.K. me ofertë 450,000 lekë pa tvsh pasi operatori i parë tërhiqet nga prokurimi.

Kontrata me nr. 844/5 është lidhur më datë 23.05.2016.

Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim i shërbimit.

6. Materiale të shkarkimeve të veprimtarisë së spitalit në ujë ajër akustikë.

Me Urdhrin nr 754/1, datë 08.04.2016 me qëllim hartimin e specifikimeve teknike për procedurën me vlerë të vogël me objekt “materiale të shkarkimeve të veprimtarisë së spitalit në ujë ajër akustikë” për Spitalin Rajonal Durrës është ngritur komisioni përkatës shoqëruar me një relacion teknik mbi nevojën e mallit.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1645, datë 08.08.2016, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “materiale të shkarkimeve të veprimtarisë së spitalit në ujë ajër akustikë”, me vlerë fondi limit 219,000lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1645/2, datë 09.08.2016 pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “G.A.” me ofertë 182,000 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 1645/2 të datës 09.08.2016 titullari i autoritetit kontraktor miratoi propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël ku në bazë të këtij vlerësimi oferta me cmim më të ulët është oferta e operatorit ekonomik “G.A.” me ofertë 182,000 lekë pa Tvsh.

Kontrata me nr. 1645/5 është lidhur më datë 15.08.2016.

Me Urdhrin nr 1645/3, datë 09.08.2016 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të shërbimit.

7. Blerje materiale hidraulike.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 2091, datë 11.10.2016, është hapur procedura me blerje me vlerë të vogël me objekt “blerje materiale hidraulike ”me vlerë fondi limit 531,700 lekë pa tvsh.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me vendimin nr. 2091/4 të datës 13.10.2016 titullari i autoritetit kontraktor miratoi propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël ku në bazë të këtij vlerësimi oferta me cmim më të ulët është oferta e operatorit ekonomik “D.I.” me ofertë 389,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 2091/5 datë 14.10.2016 për shkak të mosparaqitjes së ofertuesit i renditur në vënd të parë, në bazë të Nenit 40 pika 5 të VKM 914 dat 29.12.2014, Udhëzmi nr 3 dt 27.01.2015, pika 5 Udhëzimi Nr 1 dt 21.04.2016, pika 3 Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël përzgjedh ofertuesen M.B. e renditur e dyta në listën e ofertave të operatorëve ekonomik, si fituese.

Me procesverbalin nr. 2091/6 datë 17.10.2016 për shkak të mosparaqitjes së ofertuesit i renditur në vënd të dytë, në bazë të Nenit 40 pika 5 të VKM 914 dat 29.12.2014, Udhëzmi nr 3 dt 27.01.2015, pika 5 Udhëzimi Nr 1 dt 21.04.2016, pika 3 Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël përzgjedh ofertuesin A. V. renditur i dyti në listën e ofertave të operatorëve ekonomik, si fitues.

Me procesverbalin nr. 2091/7 datë 18.10.2016 për shkak të mosparaqitjes së ofertuesit i renditur në vënd të tretë, në bazë të Nenit 40 pika 5 të VKM 914 dat 29.12.2014, Udhëzmi nr 3 dt 27.01.2015, pika 5 Udhëzimi Nr 1 dt 21.04.2016, pika 3 Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël përzgjedh ofertuesin E.L. renditur i katërti në listën e ofertave të operatorëve ekonomik, si fitues me ofertë 435,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 2091/10, më datë 26.10.2016 me fond limit 531,700 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr 56/1, datë 11.01.2016 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

8. Programi financiar.

Spitali Rajonal Durrës ka lidhur kontratën me nr. 1130/3, datë 24.06.2015, me Operatorin Ekonomik I.S. D. sh.p.k për përfitimin e programit financiar Financa 5.

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2016 nuk ka asnjë dokumentacion mbi përdorimin e këtij programi financiar, edhe pse për këtë periudhë është paguar vlera 100,000 lekë për mirëmbajtjen e këtij programi. Gjithashtu edhe nga komunikimet verbale me specialistet e financës u pranua që në këtë periudhë programi nuk është përdorur programi financiar.

Për pasojë vlera 100,000 lekë pa TVSH, përbën një shpenzim të paargumentuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

III.7.3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël të vitit 2017

Për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla për vitin 2017, nga Titullari i AK është ngritur komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 245/1prot, datë 24.05.2017 dhe përbëhej nga:

1. O.G. kryetare,
2. M. L.dhe
3. A. H. anëtare.

Në përgjithësi procedurat e blerjeve me vlerë të vogël, janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore, përveç rasteve të shënuara më poshtë.

-Për grup mallrat e ngjashme në blerjet me vlera të vogla është tejkaluar limiti ligjor prej 800,000 lekë. Për pasojë duhet të ishin zhvilluar procedurat përkatëse të prokurimit.

Nga verifikimi i mallrave e shërbimeve të prokuruar dhe kategorizimi i tyre, rezultoi se për të njëjtin grupmalli, është tejkaluar limit ligjor prej 800,000 lekë, më hollësisht sipas tabelës së mëposhtme:

Grup-Malli	Vlera e prokuruar (pa tvsh)
Shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e kondicionimit dhe ventilimit, pompave qarkulluese të ujit të Spitalit Rajonal Durrës	618,800
Shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e: kabinat elektrike, gjeneratorëve, kompresorë ajri, pompa vakumi	181,500
Shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e: kabinat elektrike, gjeneratorëve, kompresorë ajri, pompa vakumi	100,000
Shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e: kabinat elektrike, gjeneratorëve, kompresorë ajri, pompa vakumi	105,000
Blerje shtypshkrime për Spitalin Rajonal Durrës	708,000
Blerje bileta parkimi (shtypshkrime)për Spitalin Rajonal Durrës	91,000
Blerje shtypshkrime për Spitalin Rajonal Durrës	381,700
Shuma	2,186,000

Siç konstatohet dhe sipas tabelës së mësipërme, për vitin 2017, është tejkaluar limit ligjor për prokurimet e grupmallrit të “Shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e kondicionimit dhe ventilimit, pompave qarkulluese të ujit të Spitalit Rajonal Durrës”, (618,800 + 181,500 + 100,000 + 105,000 = 1,005,300 lekë), dhe “Blerje shtypshkrime për Spitalin Rajonal Durrës” (708,000 + 91,000 + 381,700 = 1,180,700) në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 28, pika 2, e cila përcakton se: “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

prokurimit publik”, i ndryshuar, Udhëzimin e APP-së nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar, pika 3, e cila përcakton se: “*Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash kryerjen e shërbimeve apo puneve të ngjashme që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve dhe nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave normale të prokurimit, duke prokuruar në këtë formë dhe brenda kësaj vlere, të ndarë nga njëri tjetri, mallra apo shërbime që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre apo për shkak të funksionit kryesor*”. ***Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.***

Grupi i auditimit përzgjedhi për të audituar disa praktika me blerje me vlerë të vogël, nisur nga vlerat më të larta të realizimit, nga ku u konstatua se:

1. Blerje shërbim të mirëmbajtjes së ashensorëve.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 791/5, datë 04.05.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Blerje shërbim të mirëmbajtjes së ashensorëve” me fond limit 272,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin e datës 08.05.2017, anëtarët e komisionit kanë shpallur fituese ofertën e operatorit ekonomik “G. C. G.”, me vlerë 199,500 lekë pa tvsh. Me vendimin e datës 08.05.2017, titullari i autoritetit kontraktor miraton propozimin e komisionit të blerjeve të vogla dhe shpall fitues OE “G.C. G.”.

Me procesverbalin e datës 09.05.2017, ky komision vendosi s`kualifikimin e operatorit “G.C. G.”, me arsyetimin se nuk është paraqitur brenda afateve të përcaktuara, vërtetuar kjo dhe me komunikimet përkatëse, si dhe vendosi shpalljen fituese të ofertës së operatorit ekonomik “A.” me vlerë 249,800 lekë pa tvsh.p

Me procesverbalin e datës 10.05.2017, ky komision vendosi kualifikimin e operatorit të tretë “O.Q.” me vlerë 249,994 lekë pa tvsh, pasi operatori i dytë u tërhoq nga procedura me blerje të vogël.

Me procesverbalin e datës 11.05.2017, ky komision vendosi kualifikimin e operatorit të katërt “H.K.” me vlerë 250,000 lekë pa tvsh, pasi operatori i tretë u tërhoq nga procedura me blerje të vogël. Me vendimin e datës 12.05.2017 titullari i autoritetit kontraktor miraton propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël sipas procesverbalit dhe dhe shpall fitues OE “H.K.”Nga dokumentacioni i operatorit fitues “H. K.” u konstatua se mungonte fatura tatimore në kontratën e ngjashme. Gjithashtu kontrata nuk ishte e firmosur nga të dyja palët.

Mungonin sigurimet shoqërore të inxhinierëve të lidhur në kontratë ndryshe nga çfarë është përcaktuar nga autoriteti kontraktor referuar detyrimeve që duhet të përmbushi operatori fitues i procedurës.

2. Materiale për shërbimin maksilo-facial për Spitalin Rajonal Durrës.

Me nr. 903/1, datë 25.04.2017 është ngritur urdhri i brendshëm nga titullari i autoritetit kontraktor për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “materiale për shërbimin maksilo-facial” për Spitalin Rajonal Durrës.

Me Urdhër Prokurimi nr. 1217/1, datë 31.05.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “materiale për shërbimin maksilo-facial” me fond limit 404,400 lekë pa tvsh. Testimi i tregut është kryer dhe kanë kaluar jo më shumë se 12 ditë, për pasojë nuk është e nevojshme ritestimi i tregut, kështu që nuk evidentohen ndryshime në cmimet e tregut për këtë shërbim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 1217/2, datë 31.05.2017 është ngritur grupi i punës për vlerësimin e dokumentave dhe mostrave të dorëzuar për procedurën e prokurimit.

Me procesverbalin e datës 02.06.2017 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku mori pjesë vetëm një operator ekonomik, “M.” me ofertën 399,999 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 1217/7, datë 02.06.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “M.” me ofertën 399,999 lekë pa tvsh. Pasi u vlerësuan dokumentat teknike të operatorit ekonomik nga komisioni përkatës, me nr. 1217/10, datë 05.06.2017 është lidhur kontrata.

Me Urdhrin nr 1217/11, datë 05.06.2017 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të shërbimit.

3. Blerje pjesë ndërrimi për kaldajat.

Me Urdhrin nr 1586/1, datë 01.08.2017 me qëllim hartimin e specifikimeve teknike për procedurën me vlerë të vogël me objekt “blerje pjesë ndërrimi për kaldajat” është ngritur komisioni përkatës.

Bazuar në procesverbalin me nr. 1586/4, datë 23.11.2017 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 432,600 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 2348/2, datë 01.12.2017 pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i prokurimeve me vlera të vogla konstatoi se operatorët e renditur, i treti “D. Xh.” dhe OE i renditur i katërti “T.K.” kanë ofertuar me vlera të barabarta me vlerë 420,000 lekë pa tvsh. Gjithashtu dhe operatorët e renditur i pesti “M. – M.” dhe operatori i renditur i gjashti “D.&K.” kanë ofertuar me vlera të barabarta me vlerë 422,000 lekë pa tvsh. Për këtë arsye komisioni i prokurimeve me vlera të vogla nuk e mbylli vlerësimin, por zhvilloi shorteun më datë 04.12.2017 sipas udhëzimit nr. 1. Në këtë datë nuk u paraqit asnjë nga operatorët e ftuar në hedhjen e shortit, si rezultat komisioni i blerjeve të vogla shpall fitues të procedurës operatorin ekonomik operatorin “A.” me ofertë 387,000 lekë pa tvsh

Me vendimin nr. 2348/5, datë 04.12.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “A.” me ofertën 387,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 2348/8 më datë 04.12.2017 me fond limit 432,600 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr 2348/9, datë 05.12.2017 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

4. Blerje materiale pastrimi.

Me Urdhrin nr 1489, datë 12.07.2017 me qëllim hartimin e specifikimeve teknike për procedurën me vlerë të vogël me objekt “blerje materiale pastrimi” për Spitalin Rajonal Durrës është ngritur komisioni përkatës shoqëruar me një relacion teknik mbi nevojën e mallit. Me nr. 1489/1, datë 13.07.2017 sektori i hotelerisë dhe i shërbimeve mjedisore kanë kërkuar vazhdimisht blerje materiale pastrimi sipas specifikimeve teknike përkatëse të bashkangjitura. Bazuar në procesverbalin me nr. 1489/2, datë 13.07.2017 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 549,244 lekë pa tvsh. Me Urdhër Prokurimin nr. 1489/3, datë 13.07.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “blerje materiale pastrimi” për Spitalin Rajonal Durrës.

Me procesverbalin e datës 18.07.2017 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku mori pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “S.G.” me ofertë 98,000 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 1489/6, datë 18.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “S.G.” me ofertën 98,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1489/7, datë 18.07.2017 komisioni i blerjeve të vogla shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë “T. M. Ch. D.” me ofertë 169,169 lekë pa tvsh, pasi operatori i parë ka paraqitur njoftim për tërheqje.

Me vendimin nr. 1489/8, datë 18.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “T.M. Ch.D.” me ofertën 169,169 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1489/13 më datë 21.07.2017 me fond limit 549,244 lekë pa tvsh. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim i mallit.

5. Pajisje këmbimi për pajisje elektronike.

Me Urdhrin nr. 1857, datë 13.09.2017 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përcaktimin e specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël. Me nr. 653/2, datë 24.03.2017 është bërë kërkesa për blerje materiale për furnizimin e pajisjeve speciale. Me nr. 1856/1, datë 11.10.2017 komisioni i blerjeve të vogla, në bazë të vlerave të ofertuara kanë kryer testimin e tregut për cdo pajisje dhe kanë arritur në llogaritjen e fond limitit me vlerë 799,300 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 2189, datë 1.11.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “pajisje këmbimi për pajisje elektronike”, me vlerë fondi limit 799,300 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 2189/3, datës 03.11.2017 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku mori pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “B.P.” me ofertë 690,800 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 2189/4, datë 03.11.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “B.P.” me ofertën 98,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 2189/7 më datë 09.11.2017 me fond limit 799,300lekë pa tvsh. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim i mallit.

6. Blerje materiale elektrike.

Me Urdhrin nr. 851, datë 14.04.2017 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “blerje materiale elektrike”. Me nr. 851/1, datë 19.04.2017 është bërë kërkesa për “blerje materiale elektrike”.

Bazuar në procesverbalin me nr. 851/3, datë 27.04.2017 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 432,063 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 851/4, datë 02.05.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “blerje materiale elektrike”, me vlerë fondi limit 432,063 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 851/6, datës 04.05.2017 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku mori pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “T.P. shpk” me ofertë 373,222 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 851/7, datë 04.05.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “T.P. shpk” me ofertën 373,222 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 851/10 më datë 08.05.2017 me fond limit 432,063 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr. 851/11, datë 08.05.2017 është ngritur komisioni përkatës i marrjes në dorëzim i mallit.

7. Shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e kondicionimit dhe ventilimit, pompave qarkulluese të ujit.

Me Urdhrin nr. 1212/1, datë 05.06.2017 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e kondicionimit dhe ventilimit, pompave qarkulluese të ujit”. Me nr. 851/1, datë 19.04.2017 është bërë kërkesa për “blerje materiale elektrike”.

Bazuar në procesverbalin me nr. 1214/4, datë 30.06.2017 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 618,800 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1605/2, datë 04.08.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “shërbime dhe blerje pjesë për sistemin e kondicionimit dhe ventilimit, pompave qarkulluese të ujit”, me vlerë fondi limit 618,800 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1605/4, datës 08.08.2017 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku mori pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “Altec shpk” me ofertë 540,000 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 1605/5, datë 08.08.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “A.shpk” me ofertën 540,000lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1605/6 të datës 10.08.2017, ky komision skualifikoi operatorin e parë “Altec shpk”, pasi ky operator ekonomik u tërhoq nga procedura me blerje të vogël dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë “S.”.

Me vendimin nr. 1605/7, datë 10.08.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “S.” me ofertën 550,000lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1605/10 më datë 14.08.2017 me fond limit 618,800 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr. 1605/11, datë 14.08.2017 është ngritur komisioni përkatës i marrjes në dorëzim i mallit.

8. Blerje Alcool për Spitalin Rajonal Durrës.

Me Urdhrin nr. 1180, datë 26.05.2017 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “blerje Alcool për Spitalin Rajonal Durrës”.

Bazuar në procesverbalin me nr. 1180/3, datë 01.06.2017 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 708,000 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1449, datë 06.07.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “blerje Alcool për spitalin rajonal durrës”, me vlerë fondi limit 708,000 lekë pa tvsh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me procesverbalin nr. 14493/3, datës 10.07.2017 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku mori pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “F.” me ofertë 181,200 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 1449/4, datë 10.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “F.” me ofertën 708,000 lekë pa tvsh.

Nga raport vlerësimi me nr. 14496/6, datë 11.07.2017 i dokumentave të OE “F. shpk”, firma nuk plotësonte kriteret e kërkuara në përputhje me kërkesën e bërë sipas ftesës për ofertë.

Me procesverbalin nr. 1449/8 të datës 11.07.2017, ky komision skualifikoi operatorin e parë “F. shpk”, për mos plotësim të kriterëve dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë “P. P.”.

Me vendimin nr. 1449/9, datë 11.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “P. P.” me ofertën 192,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1449/10 të datës 12.07.2017, ky komision skualifikoi operatorin e dytë “P.P.”, pasi ky operator ekonomik u tërhoq nga procedura me blerje të vogël dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të tretë “I.”.

Me vendimin nr. 1449/11, datë 12.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “I.” me ofertën 302,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1449/12 të datës 13.07.2017, ky komision skualifikoi operatorin e tretë “I.”, për arsyen e mos paraqitjes pranë Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Durrës për dorëzimin e dokumentave dhe të mostrës së kërkuar sipas ftesës për ofertë dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të katërt “T.M. C. D.”.

Me vendimin nr. 1449/12, datë 13.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “T.M. C.D.” me ofertën 336,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1449/13 të datës 14.07.2017, ky komision skualifikoi operatorin e katërt “T.M. C.D.”, për arsyen e mos paraqitjes pranë Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Durrës për dorëzimin e dokumentave dhe të mostrës së kërkuar sipas ftesës për ofertë dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të pestë “C. P.”.

Me vendimin nr. 1449/13, datë 14.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “C. P.” me ofertën 360,000 lekë pa tvsh dhe 432,000 lekë me tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1449/17 më datë 18.07.2017 me fond limit 708,000 lekë pa tvsh

Me Urdhrin nr. 1449/18, datë 18.07.2017 është ngritur komisioni përkatës i marrjes në dorëzim i mallit.

9. Shërbim i mirëmbajtjes së Financës 5 për Spitalin Rajonal Durrës.

Me Urdhrin nr. 162/1, datë 20.02.2017 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “Shërbim i Mirëmbajtjes së Financës 5 për Spitalin Rajonal Durrës”.

Bazuar në procesverbalin me nr. 162/4, datë 02.03.2017 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 144,000 lekë pa tvsh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 162/5, datë 03.03.2017, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Shërbim i Mirëmbajtjes së Financës 5 për Spitalin Rajonal Durrës”, me vlerë fondi limit 144,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 162/7, të datës 06.03.2017 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “B.V.” me ofertë 130,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 162/8 të datës 09.03.2017, ky komision skualifikoi operatorin e parë “B.V.”, për arsyen e mos paraqitjes pranë Autoritetit Kontraktor Spitali Rajonal Durrës për dorëzimin e dokumentave sipas ftesës për ofertë dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë “I. S. D.”.

Me vendimin nr. 162/11, datë 10.03.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “I. S.D.” me ofertën 144,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 162/12 më datë 10.03.2017 me fond limit 144,000 lekë pa tvsh.

Nga praktika e dhënë mungonte sigurimi i kontratës.

Me Urdhrin nr. 162/14, datë 01.06.2017 është ngritur komisioni përkatës i marrjes në dorëzim të shërbimit.



III.7.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël të vitit 2016

Për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla për vitin 2018, nga Titullari i AK është ngritur komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 36 prot, datë 28.03.2018 dhe përbëhej nga:

1. V.C.kryetare, dhe
2. O.G.
3. A.H. anëtare.

Grupi i auditimit përzgjedhi për të audituar disa praktika me blerje me vlerë të vogël, nisur nga vlerat më të larta të realizimit, nga ku u konstatua se:

1. Blerje materiale për ndricim.

Me nr. 1098/1, date 09.05.2018 është ngritur urdhri i brendshëm nga titullari i autoritetit kontraktor për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “blerje materiale për ndricim” për Spitalin Rajonal Durrës.

Me Nr. 1098/2 datë 11.05.2018, në bazë të Urdhrit të brendshëm dt.09.05.2018 me Nr. 1098/1 Komisioni i blerjeve të vogla hartoi specifikimet teknike.

Bazuar në procesverbalin me nr. 1098/4, datë 24.05.2018 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 728,686.50 hlekë pa tvsh.

Me Urdhër Prokurimi nr. 1098/5, datë 24.05.2018, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “blerje materiale për ndricim” me fond limit 728,685.50 lekë pa tvsh. Testimi i tregut është kryer dhe kanë kaluar jo më shumë se 12 ditë, për pasojë nuk është e nevojshme ritestimi i tregut, kështu që nuk evidentohen ndryshime në cmimet e tregut për këtë shërbim.

Me procesverbalin me nr. 1098/7 të datës 28.05.2018 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku mori pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla konstatoi se operatorët e renditur i teti “A.K.M A.I. G.” dhe operatori i renditur i nënti “M.B.” kanë ofertuar me vlera të barabarta me vlerë 620,000 lekë pa tvsh. Për këtë arsye Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla nuk e mbylli vlerësimin, por i dërgoi njoftim nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik të APP-së të dy operatorëve për tu paraqitur në SRD më datë 29.05.2018 për të zhvilluar procedurën e hedhjes së shortit sipas Udhëzimit nr. 3. Të dy operatorët ekonomik nuk u paraqitën në ambientet e Spitalit Rajonal Durrës në orën dhe datën e përcaktuar në ftesën e hedhjes së shortit. Si rezultat i mosparaqitjes së operatorëve ekonomik në hedhjen e shortit, në klasifikim i pari do të renditet operatori ekonomik “T.P. SHPK” me ofertë 580,000 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 1098/9, datë 29.05.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “T.P. SHPK” me ofertën 580,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1098/11 më datë 30.05.2018 me fond limit 728,686.50 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin e datës 04.06.2018 u bë hyrja e materialeve të ndricimit në magazinë.

2. Blerje pjesë për sistemin e Kondicionimit, Ventilimit, Pompat e Qarkullimit të Ujit, Avolxhimi i elektromotorrëve të djegur.

Me Urdhër nr. 1505, datë 05.06.2018 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “Blerje pjesë për sistemin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kondicionimit, Ventilimit, Pompat e Qarkullimit të Ujit, Avolxhimi i elektromotorrëve të djegur”.

Me nr. 1505/2, datë 05.06.2018 u bë kërkesa për “Blerje pjesë për sistemin e Kondicionimit, Ventilimit, Pompat e Qarkullimit të Ujit, Avolxhimi i elektromotorrëve të djegur”.

Me Urdhër të brendshëm nr. 1505/3, datë 05.06.2018 u dërgua Kërkesa për Kuotim Operatorëve Ekonomik.

Bazuar në procesverbalin me nr. 1505/4, datë 25.06.2018 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 627,400 lekë pa tvsh.

Me Urdhër Prokurimi nr. 1505/5, datë 24.06.2018, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Blerje pjesë për sistemin e Kondicionimit, Ventilimit, Pompat e Qarkullimit të Ujit, Avolxhimi i elektromotorrëve të djegur”.

Me procesverbalin nr. 1505/7, datës 27.06.2018 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “Sh.K.” me ofertë 619,999 lekë pa tvsh.

Me nr. 1505/10, datë 28.06.2018 u bë raport vlerësimi i dokumentave të operatorit ekonomik fitues “Sh.K.”.

Kontrata është lidhur me nr. 1505/11 më datë 02.07.2018 me fond limit 627,400 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr1505/12, datë 02.07.2018 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

3. Blerje solucione dhe Materiale Pastrimi për Spitalin Rajonal Durrës.

Me Urdhrin nr. 941/1, datë 10.04.2018 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “Blerje solucione dhe Materiale Pastrimi për Spitalin Rajonal Durrës”.

Bazuar në procesverbalin me nr. 941/4, datë 11.07.2018 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 731,150 lekë pa tvsh.

Me Urdhër Prokurimi nr. 941/5, datë 11.07.2018, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Blerje solucione dhe Materiale Pastrimi për Spitalin Rajonal Durrës”.

Me procesverbalin nr. 941/7, i datës 13.07.2018 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “S.G.” me ofertë 480,500 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 941/8, datë 18.07.2017 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “S.G.” me ofertën 480,500 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 941/11 më datë 25.07.2018 me fond limit 731,150 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr. 941/12, datë 25.07.2018 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

4. Blerje sinjalistike për Spitalin Rajonal Durrës.

Me Urdhrin nr. 1263/1, datë 09.05.2018 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “Blerje sinjalistike për Spitalin Rajonal Durrës”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Bazuar në procesverbalin me nr. 1263/4, datë 28.05.2018 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 799,220 lekë pa tvsh.

Me Urdhër Prokurimi nr. 1263/5, datë 28.05.2018, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Blerje sinjalistikë për Spitalin Rajonal Durrës”.

Me procesverbalin nr. 1263/7, të datës 30.05.2018 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “Dh.L.” me ofertë 589,000 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 1263/7, datë 30.05.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “Dh.L.” me ofertën 480,500 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1263/8 të datës 01.06.2018, ky komision skualifikoi operatorin e parë “Dh.L.”, për arsyen se nuk është paraqitur brenda afateve kohore sipas ftesës për ofertë dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë “D. shpk”.

Me vendimin nr. 1263/9, datë 01.06.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “D. shpk” me ofertën 600,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1263/10 të datës 06.06.2018, ky komision skualifikoi operatorin e dytë “D.SHPK” për arsyen se u tërhequr nga procedura e prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të tretë “I.D.”.

Me vendimin nr. 1263/10, datë 06.06.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “I. D.” me ofertën 650,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1565 më datë 07.06.2018 me fond limit 799,220 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr1565/1, datë 07.06.2018 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

5. Blerje Mobilje për Ambjentet e Mamografisë dhe Arshivës së Spitalit Rajonal Durrës.

Me Urdhrin nr. 1121, datë 24.04.2018 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “Blerje Mobilje për Ambjentet e Mamografisë dhe Arshivës së Spitalit Rajonal Durrës”.

Me nr. 1121/1, datë 25.04.2018 janë dërguar specifikimet teknike të blerjeve të mobiljeve.

Bazuar në procesverbalin me nr. 1121/3, datë 12.07.2018 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 230,340 lekë pa tvsh.

Me Urdhër Prokurimi nr. 2063, datë 07.08.2018, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Blerje Mobilje për Ambjentet e Mamografisë dhe Arshivës së Spitalit Rajonal Durrës”.

Me procesverbalin nr. 2063/2, të datës 09.08.2018 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi oferta më e ulët është oferta e operatorit ekonomik “J.G.” me ofertë 175,000 lekë pa tvsh.

Me vendimin nr. 2063/3, datë 09.08.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “J.G.” me ofertën 175,000 lekë pa tvsh.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me procesverbalin nr. 2063/4 të datës 10.08.2018, ky komision skualifikoi operatorin e parë “J.G.”, për arsyen se është tërhequr nga procedura e prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë “T.-I.”.

Me vendimin nr. 2063/5, datë 10.08.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “T.-I.” me ofertën 189,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 2063/6 të datës 13.08.2018, ky komision skualifikoi operatorin e parë “T.-I.”, për arsyen se nuk ka njoftuar dhe nuk është paraqitur brenda afatave kohore sipas ftesës për ofertë dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të tretë “A.K.M A.I.G.”.

Me vendimin nr. 2063/7, datë 13.08.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “A.K.M A.I.G.” me ofertën 217,000 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 2063/10 më datë 22.08.2018 me fond limit 230,340 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr. 2063/11, datë 22.08.2018 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

6. Shërbim i Mirëmbajtjes së Financës 5.

Me Urdhrin nr. 938/1, datë 10.04.2018 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “Shërbim i Mirëmbajtjes së Financës 5 për Spitalin Rajonal Durrës”.

Me nr. 938/2, datë 12.04.2018 janë dërguar specifikimet teknike për Shërbimin e Mirëmbajtjes së Financës 5 për Spitalin Rajonal Durrës.

Bazuar në procesverbalin me nr. 938/4, datë 24.04.2018 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 115,200 lekë pa tvsh.

Me Urdhër Prokurimi nr. 1134/1, datë 26.04.2018, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Shërbim i Mirëmbajtjes së Financës 5 për Spitalin Rajonal Durrës”.

Me procesverbalin nr. 1134/3, të datës 30.04.2018 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi konstatoi se operatorët e renditur i teti “B.V.” dhe operatori i renditur i nënti “S.& S.” kanë ofertuar me vlera të barabarta me vlerë 98,000 lekë pa tvsh.

Për këtë arsye Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla nuk e mbylli vlerësimin, por i dërgoi njoftim dy operatorëve për tu paraqitur në SRD Më DATë 02.05.2018 për të zhvilluar procedurën e hedhjes së shortit sipas Udhëzimit nr. 3.

Sipas procesverbalit nr. 1134/4, datë 02.05.2018 mbi hedhjen e shortit nuk u paraqit asnjë nga operatorët e ftuar në hedhjen e shortit.

Bazuar në procesverbalin me nr. 1134/5, datë 02.05.2018 Komisioni i Blerjeve të Vogla shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të parë “B.V.”.

Me vendimin nr. 1134/6, datë 02.05.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “B.V.” me ofertën 98,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1134/7 të datës 03.05.2018, ky komision skualifikoi operatorin e parë “B.V.”, për arsyen se është tërhequr nga procedura e prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të dytë “S.& S.”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Me vendimin nr. 1134/8, datë 03.05.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “S.& S.” me ofertën 98,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1134/9 të datës 04.05.2018, ky komision skualifikoi operatorin e dytë “S.& S.”, për arsyen se është tërhequr nga procedura e prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të tretë “F.-L.”.

Me vendimin nr. 1134/10, datë 04.05.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “F.-L.” me ofertën 108,000 lekë pa tvsh.

Me procesverbalin nr. 1134/11 të datës 07.05.2018, ky komision skualifikoi operatorin e tretë “F.-L.”, për arsyen se është tërhequr nga procedura e prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues operatorin ekonomik të renditur në vend të katërt “I.S.D.”.

Me vendimin nr. 1134/12, datë 07.05.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “F.-L.” me ofertën 115,200 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1134/15 më datë 09.05.2018 me fond limit 115,200 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr. 1134/16, datë 09.05.2018 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.

7. Mirëmbajtja e traut të parkimit për Spitalin Rajonal Durrës.

Me nr. 940, datë 05.04.2018 është bërë kërkesa për fillim procedure për parkim nga përgjegjësi i sektorit të menaxhimit të teknologjisë.

Me Urdhrin nr. 940/1, datë 10.04.2018 është ngritur komisioni përkatës me qëllim përgatitjen specifikimeve teknike të procedurës me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtja e traut të parkimit për Spitalin Rajonal Durrës”.

Bazuar në procesverbalin me nr. 940/4, datë 19.06.2018 fond limiti për procedurën me vlerë të vogël është 214,260 lekë pa tvsh.

Me Urdhër Prokurimi nr. 940/5, datë 27.06.2018, Administratori i shoqërisë ka autorizuar procedurën e prokurimit “Mirëmbajtja e traut të parkimit për Spitalin Rajonal Durrës”.

Me procesverbalin nr. 940/7, të datës 29.06.2018 u bë hapja në mënyrë elektronike e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku morën pjesë disa operatorë ekonomik. Pas hapjes së ofertave në mënyrë elektronike, komisioni i blerjeve të vogla bëri vlerësimin e ofertave ku në bazë të këtij vlerësimi shpalli fitues operatorin ekonomik i renditur i pari “A. P.”.

Me vendimin nr. 940/8, datë 29.08.2018 titullari i autoriteti kontraktor ka miratuar propozimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël dhe shpall fitues OE “A. P.” me ofertën 213,700 lekë pa tvsh.

Kontrata është lidhur me nr. 1772 më datë 03.07.2018 me fond limit 214,260 lekë pa tvsh.

Me Urdhrin nr. 1772/1, datë 03.07.2018 është ngritur komisioni përkatës për marrjen në dorëzim të mallit.



III.8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore

1. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në lidhjen e kontratave të qiradhënies.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të procedurave ligjore në lidhjen e kontratave të qirasë, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë lidhur gjithsej 29 kontrata qiradhënie. Këto kontrata janë lidhur nga vetë spitali, duke qenë se janë për sipërfaqe më të vogël se 200 m². Kontratat e qiradhënies janë me afat 1 vjeçar, e si të tilla shumica e tyre janë ripërtëritëse çdo vit. Nga auditimi i këtyre kontratave, u konstatua se:

-Në të gjitha rastet, nuk konstatohet dokumentacioni i dhënies me qira të objektit.

-Në të gjitha rastet, nuk konstatohet dokumentacioni i marrjes me qira të objektit nga poseduesit.

-Për rilidhjen e kontratave të qirasë për vitin 2019, SRD është në pritje të miratimeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”.

Kriteri: VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”;

Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”.

Ndikimi/Efekti: Mos plotësim i dokumentacionit ligjor para lidhjes së kontratave të qiradhënies, duke vënë në risk zbatimin e tyre.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa që përpara lidhjes së kontratave të reja të qiradhënies, të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për ambientet e dhëna me qira nga Spitali dhe OE të interesuar për marrjen me qira të ambienteve të spitalit.

Vazhdimisht

2. Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në lidhjen e kontratave të qiradhënies.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të procedurave ligjore në zbatimin e kontratave të qirasë, u konstatua se:

Në kontratat e qiradhënies së sipërfaqeve të spitalit për vendosjen e makinave për vitin 2015 dhe 2016, konkretisht në kontratat nr. 452, datë 02.03.2015; nr. 346, datë 09.02.2015; nr. 394, datë 10.02.2016; dhe nr. 557, datë 03.03.2016; sipërfaqja e makinave është përlllogaritur 1 m²/makinetë, ndërsa në kontratat e vitit 2017 dhe 2018, sipërfaqja e përlllogaritur është 2 m²/makinetë. Kjo diferencë ka ardhur si pasojë e mos përlllogaritjes së sipërfaqes së plotë funksionale të nevojitur për funksionimin e një makinete, që është rregulluar në kontratat e qirasë të lidhura për periudhën 2017-2018. Por nga SRD nuk janë marrë masat për përlllogaritjen e vlerës së munguar për vitin 2015 dhe 2016, për hapësirën prej 1 m², të përdorur më tepër. Për pasojë për çdo kontratë janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 78,000 lekë. **Në total dëmi ekonomik për këto kontrata është në vlerën 312,000 lekë** (78,000 lekë * 4 kontrata).

Kriteri: VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”;

Ndikimi/Efekti: Mos plotësim i dokumentacionit ligjor para lidhjes së kontratave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

qiradhënies, duke vënë në risk zbatimin e tyre.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **312,000 lekë**, e konkretisht vlerës 156,000 lekë nga PF L.K.dhe vlerës 156,000 lekë nga OE C. P. SHPK, për arsye se këto vlera përbëjnë dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

3. Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e kontratës koncensionare.

Situata: Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate koncensionare, u konstatua se:

Kontrata pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”, nuk disponohet e plotë nga SRD, e për pasojë e bën të pamundur monitorimin e kësaj kontrate koncensionare, për arsye se mungojnë ose janë të paplota Aneksat e mëposhtme:

-Aneksi 4 - Klasat e kompleksitetit ose intensiteti i ndërhyrjes kirurgjikale, nuk është i firmosur nga asnjë palë, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 5 - Lista e asetëve që do të kthehen Autoritetit, nuk është i firmosur nga asnjë palë, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 6 - Kontrate për financimin e shërbimit: Kjo kontratë nuk ka datë, nuk është e firmosur dhe vulosur nga asnjë palë, por është thjesht një draft në rrugë elektronike, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 9 - Lista e çdo instrumenti me çmimet përkatëse, Aneksi 9 - Lista e çdo instrumenti me çmimet përkatëse.

Kriteri: Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Mungesa e besueshmërisë së dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar në rrugë elektronike nga MSHMS, përveçse e bën të pamundur monitorimin e kësaj kontrate koncensionare, por e vendos dhe Spitalin Durrës në kushte jo të favorshme ndaj Koncesionarit, si dhe **nuk japin besueshmërinë e plotë juridike**.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të plotë origjinal të për kontratën e Koncesionimit pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”.

Menjëherë

4. Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e kontratës koncensionare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Situata: Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate koncensionare, u konstatua se:

-Nisur nga fakti, që nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, Koncesionari OE S.S. SHPK, nuk i paguan Spitalit Rajonal Durrës shpenzime për energji elektrike, shpenzime për ujë dhe shpenzime për energji termike, përlllogaritja e zërave të mësipërme në vlerën e kostos, pjesë përbërëse e kontratës, është e pa argumentuar nga Koncesionari OE S.S.SHPK.

Për pasojë, vlera 7,706,844.40 lekë, e cila përfaqëson vlerën e elementëve të kostos të shënuar nga Koncesionari OE S.S. SHPK, elementë për të cilët shpenzimet përballohen nga Buxheti i Spitalit Rajonal Durrës, **përbën efekt financiar negativ për llogari të Buxhetit të Shtetit**

Sipas relacionit nr. 192, datë 23.01.2019, të përgatitur nga Dega Teknike e SRD, konstatohet se për periudhën 15.03.2018-31.12.2018, detyrimet për shpenzime për energji elektrike, janë në vlerë 3,660,537.6 lekë, ndërsa detyrimet për shpenzime për ujë janë në vlerën 817,756 lekë, detyrime të cilat i përkasin OE S.S. SHPK, por janë paguar nga buxheti i SRD.

Duke qenë se;

-Koncesionari në SRD nuk ka qendër Back-up, por vetëm magazina dhe Central Sterilizimi;

-Neni 19.5, i kontratës koncensionare datë 10.12.2015, përcakton se: “Në qendrat e Back-Up, përveç qendrës tek QSUT, Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime në ngarkim të Autoritetit”;

-Faqes nr. 5, të kontratës datë 10.12.2015, e cila në paragrafin e parë të saj përcakton se “Autoriteti”, për këtë kontratë është “Ministria e Shëndetësisë”;

-Për këtë kontratë koncensionare, në Spitalin Universitar të Traumës (sipas programit të auditimit nr. 68/1, dt. 23.01.2018, i ndryshuar), KLSH me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 54, nr. Prot. 68/6, datë 21.06.2018, pika D/4, shpenzimet e energjisë elektrike janë konstatuar shpenzime me pasojë efekt negativ financiar, për të cilat është rekomanduar që “SUT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 4,047,513 lekë si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për nënpikën 19.5.”. Në fakt situata paraqitet e njëjtë edhe pas konstatimit të KLSH dhe nga MSH (sot MSHBS), rezulton se nuk është marrë asnjë masë për të rinegociuar pikën 19.5 të kontratës.

Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga OE S.S. SHPK, **në vlerën 4,478,293.6 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për Buxhetin e SRD.**

Kriteri: Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;

Kontrata pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”.

Ndikimi/Efekt: Shpenzimet për energji elektrike dhe ujë kanë rënduar Buxhetin e Spitalit Durrës.

Rëndësia: E Lartë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

5. Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e kontratës koncesionare.

Situata: Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate koncesionare, u konstatua se:

Sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion, Koncesionari ka në përdorim ambiente me sipërfaqe totale 291 m². Këto sipërfaqe Koncesionari i ka përdorur për periudhën 15.03.2018 e në vazhdim, pa paguar qira për to.

Në lidhje nga sa më sipër, konstatohet se:

-Në faqen nr. 5, të kontratës datë 10.12.2015, në paragrafin e parë të saj përcaktohet se “**Autoriteti**”, për këtë kontratë është “**Ministria e Shëndetësisë**”;

-Neni 19.5, i kontratës koncesionare datë 10.12.2015, përcakton se: “*Në qendrat e Back-Up, përveç qendrës tek QSUT, Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime në ngarkim të Autoritetit*”;

-Në lidhje me ambientet të dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk janë ndjekur procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

-Në lidhje me ambientet të dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk janë mbajtur detyrime për qira për këto ambiente, duke qenë se SRD nuk është palë në këtë kontratë, por vetë Ministria. Detyrimi i qirasë për periudhën 15.03.2018-31.12.2018 (periudha objekt auditimi), për këto ambiente është në vlerën 1,382,250 lekë (9.5 muaj * 500 lekë/m² muaj * 291 m²). Çmimi 500 lekë/m² muaj, është marrë për bazë duke ndjekur të njëjtin standard për të cilin SRD ka aplikuar me kontratat e tjera të qiradhënies së ambienteve, lidhur për periudhën objekt auditimi. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

-Nuk lidhur kontrata qiraje në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

-Nuk konstatohet mënyra e dorëzimit të ambienteve nga SRD për Koncesionarin, në kushtet kur në datën e fillimit, SRD nuk dispononte dokumentacionin ligjor që vërtetonte këtë kontratë koncesionare. Kjo për arsye se SRD deri më datë 15.03.2018, dispononte vetëm kontratën koncesionare pa Anekset pjesë përbërëse, kontratë në të cilën nuk parashikohej në asnjë nen të saj përfshirja e Spitalit Rajonal Durrës në këtë kontratë koncesionimi.

Për pasojë, vlera 1,382,250 lekë, që përbën detyrimin për qiranë mujore për ambientet e dhëna në përdorim të Koncesionarit S.S. SHPK, përbën efekt financiar negativ. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”.

Kriteri: Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;

Kontrata pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”.

Ndikimi/Efekti: Përdorim i ambienteve të Spitalit Durrës nga Konkensionari pa paguar detyrimin e qirasë.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: SRD të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore **në vlerën 13,567,388 lekë** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5.

Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për rinegocimin e kontratës për pikën 19.5, për të gjitha spitalet e tjera të vendit, pjesë e kontratës koncensionare, ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë pjesë e Konkensionarit dhe jo buxheteve të spitaleve

Brenda datës 30.06.2019

6. Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e kontratës koncensionare.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se OE S.S. SHPK, nuk ka dorëzuar pranë SRD dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:

-Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese.

-Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore.

-Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore.

-Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë “Dokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshme”.

Kriteri: VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””;

VKM nr. 371, datë 11.06.2007.

Ndikimi/Efekti: Mos dorëzimi i dokumentacionit të mësipërm, do përbente risk të lartë për penalizim nga institucionet monitoruese, *për SRD në vlerat nga 500,000 – 1,500,000 lekë.*

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për plotësimin nga Konkensionari SaniService SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Menjëherë

7. Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e kontratës koncensionare.

Situata: Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S.S.SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate koncensionare, u konstatua se:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se data e instalimit të Konkensionarit në ambientet e SRD është data 15.03.2018, ndërsa data e fillimit të kontratës koncesionare është data 16.03.2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Sipas kontratës së lidhur, e konkretisht Aneksit 3 “Projekti Teknik”, Kapitulli 1-2 (2.3.1 *Projekti teknik Kap_1-2_Pershkrimi _Grafiku_Pjesa 1 nga 6*), punimet duhej të fillonin në fillim të vitit 2017 (viti i dytë, faqe 22).

Vonesa e pa argumentuar me 1 vit e fillimit të zbatimit të kësaj kontrate koncensionare, përbën rast të mos përmbushjes nga Koncensionari, sipas nenit 29 të kësaj kontrate.

Sipas Koncensionarit vonesa në fillimin e zbatimit të kësaj kontrate në Spitalin e Durrësit, ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të ndërhyrjeve kirurgjikale në qendrat spitalore të qytetit të Tiranës (në krahasim me ato të parashikuara në dokumentet e koncesionit), ku si pasojë ka qenë e nevojshme riprogramimi i kapaciteteve të qendrave të sterilizimit dhe Back-up spitalet e qytetit të Tiranës duke realizuar punime ndërtimi shtesë dhe furnizime me pajisje shtesë.

Kriteri: Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar; Kontrata pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”.

Ndikimi/Efekti: Fillim me 1 vit vonesë i kontratës koncensionare.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandimi: Nga SRD në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa që në të ardhmen të ndiqet me rigorozitet zbatimi i kontratës koncensionare me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”.

Menjëherë

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

III.8.1. Të ardhurat dytësore të spitalit

Spitali Rajonal Durrës, në përputhje me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, së bashku me aktet ligjore të dala në zbatim të këtij urdhri, ka përfituar të ardhura dytësore nga aktiviteti dytësor që kryen. Të ardhurat e përfituara nga aktiviteti që ka kryer, për periudhën 01.01.2015-31.12.2018, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Përshkrimi	Shuma 2015	Shuma 2016	Shuma 2017	Shuma 2018
Pathologjia	3,488,600	3,608,145	733,600	772,500
Ambulatori	3,100,100	10,800	1,193,900	937,700
Pediatria	111,900	0	380,700	272,500
Vertetime	30,200	0	46,450	51,500
Okulistika	174,400	0	290,300	286,000
Imazheria	9,206,990	10,168,045	1,994,700	124,500
Konsultori	890,800	430,500	310,600	216,600
Materniteti	1,594,000	647,300	545,500	707,600
Poliklinika	18,424,700	34,433,400	37,416,000	11,751,600
Dispanceria	36,500	104,710	110,500	35,700
Parkimi	739,800	1,301,400	4,886,616	5,440,066



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Qera Bankmat Credins	0	81,000	81,000	20,250
C.P.	851,992	384,900	512,724	294,420
M.T.	0	27,000	81,000	108,000
L.K.	204,144	58,500	99,000	90,000
Sh.SHPK	0	241,491	832,994	1,852,270
Sponsorizim	90,000	15,000	10,000	0
Derdhje per karte	0	0	12,000	0
Penalitet	0	106,695	595	0
Interesa	60,271	86,602	30,597	0
Kthim Dialize	0	0	20,954	0
Kthim Page	0	0	111,521	0
Shtrim i huaj	0	0	24,000	0
Abi Bank	0	0	78,300	156,600
Per sa derdh gabim	0	3,000	199,915	0
Pag Vertetim	0	0	0	600
pages gjobe	0	0	0	2,800
S.C.	0	0	0	726,000
Patenta	0	0	0	27,221,000
te tjera	0	0	0	10
garanci	0	19,500	0	0
qera	0	0	0	0
kamata	1,635,753	478,931	0	0
urdher zhdentim	53,350	271,124	0	0
bordero dialize	0	0	0	0
Hekurishte	0	0	0	0
urdher pagese	6,112	0	0	0
libreza sig.shoqe	2,600	0	0	0
sig kontrate GTS	134,000	0	0	0
tobias	1,152	0	0	0
Shuma	40,837,364	52,478,043	50,003,466	51,068,216

Për tarifatat e të ardhurave dytësore, Spitali Rajonal Durrës është bazuar në:

Qeratë e objekteve:

VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Tarifatat e Receptioneve:

Urdhri i Ministrisë nr. 3715/2 prot., datë 26.10.2009, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 01.11.1993 “Për përcaktimin e cmimeve në sistemin shëndetësor shtetëror, si dhe në Urdhrin nr.116, datë 30.03.1999 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore në institucionet shëndetësore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Tarifat e parkimit:

Tarifat e parkimit miratohen me vendime të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, i bazuar në nenet 8, 9 dhe 12 të Statutit të Spitalit Rajonal Durrës, të miratuar me VKM nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar, si dhe në Rregulloret e Spitalit Rajonal Durrës.

Konkretisht, për vitin e fundit 2018, tarifat e parkimit janë miratuar me Vendimin nr. 05, datë 19.03.2018, të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, protokolluar me nr. 778 prot., datë 19.03.2018.

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve:

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve miratohen me vendime të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, i bazuar në nenin 8, 9 dhe 12 të Statutit të Spitalit Rajonal Durrës, të miratuar me VKM nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit të Durrësit në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar, si dhe në Rregulloret e Spitalit Rajonal Durrës.

Konkretisht, për vitin e fundit 2018, tarifat për lëshimin e vërtetimeve janë miratuar me Vendimin nr.16, datë 19.03.2018, të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, protokolluar me nr.789 prot., datë 19.03.2018.

Përdorimi i të ardhurave dytësore, miratohet me Vendim të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, dhe përdoret kryesisht për artikujt e mëposhtëm:

- Artikulli 600: Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli (për punonjësit e traut të parkimit);
- Artikulli 601: Kontribute të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore (për punonjësit e traut të parkimit);
- Artikulli 602: Mallra e Shërbime të tjera;
- Artikulli 231: Investime, të cilat në vijim të Vendimit të Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, kërkohet edhe miratimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga parkimi dhe vërtetimet e ndryshme të lëshuara, të ardhura të cilat janë objekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, SRD ka aplikuar tatimin mbi vlerën e shtuar, si dhe i ka deklaruar në librat e shitjes përgjatë periudhës objekt auditimi. Në total tatimi mbi vlerën e shtuar, i paguar për periudhën objekt auditimi, është në vlerën 2,098,375 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

III.8.2. Të ardhurat nga qiratë

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për periudhën objekt auditimi (01.01.2015-31.12.2018), SRD ka lidhur kontratat e qirasë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Viti	Nr.prot	Datë	Sip/m ²	Çmimi Mujor (lekë/m ²)	Vlera mujore (lekë)	Destinacioni i perdorimit
1.1	C. P.shpk	2015	202	27/01/2015	81.9	350	28,665	Bar-bufe
1.2	C. P. shpk	2015	202	27/01/2015	6.0	70	420	Bar-bufe
2.1	Banka Credins SH.A	2015	235	02/02/2015	6.25	1,000	6,250	ATM
2.2	Banka Credins SH.A	2015	235	02/02/2015	2.5	200	500	ATM
3	C. P. shpk	2015	452	02/03/2015	13.0	500	6,500	Makineta
4	L. K. PF	2015	346	09/02/2015	13.0	500	6,500	Makineta
5.1	C. P. shpk	2016	208	28/01/2016	81.9	350	28,665	Bar-bufe
5.2	C. P.shpk	2016	208	28/01/2016	6.0	70	420	Bar-bufe
6	L. K. PF	2016	394	10/02/2016	13.0	500	6,500	Makineta
7	C. P. shpk	2016	557	03/03/2016	13.0	500	6,500	Makineta
8.1	Banka Credins SH.A	2016	741	01/04/2016	6.25	1,000	6,250	ATM
8.2	Banka Credins SH.A	2016	741	01/04/2016	2.50	200	500	ATM
9.1	C. P. shpk	2017	61/1	01/02/2017	81.9	350	28,665	Bar-bufe
9.2	C. P. shpk	2017	61/1	01/02/2017	6.0	70	420	Bar-bufe
10	L. K. PF	2017	221/1	11/02/2017	22.0	500	11,000	Makineta
11	C. P. shpk	2017	368/1	03/03/2017	28.0	500	14,000	Makineta
12.1	Banka Credins SH.A	2017	612/1	31/02/2017	6.25	1,000	6,250	ATM
12.2	Banka Credins SH.A	2017	612/1	31/02/2017	2.50	200	500	ATM
13	ABI Bank SH.A	2017	398/1	03/03/2017	8.7	1,000	8,700	ATM
14	S.C. shpk	2017	2399/1	14/12/2017	121.0	500	60,500	Depo Lavanterie
15	M.T. shpk	2017	2082/1	14/12/2017	18.0	500	9,000	ATM
16.1	Sh. shpk	2017	2361/1	15/12/2017	185.0	500	92,500	Guzhina
16.2	Sh.shpk	2017	2361/1	15/12/2017	1.0	42,697	42,697	Pajisjet
16.3	Sh. shpk	2017	2361/1	15/12/2017	4.0	500	2,000	Bombola e Gazit
17	L.K. PF	2018	389/1	12/02/2018	20.0	500	10,000	Makineta
18	C. P. shpk	2018	631/1	02/03/2018	28.0	500	14,000	Makineta
19	ABI Bank SH.A	2018	659/1	05/03/2018	8.7	1,000	8,700	ATM
20.1	Sh. shpk	2018	1801/2	01/08/2018	62.0	350	21,700	Guzhina
20.2	Sh. shpk	2018	1801/2	01/08/2018	1.0	1,203	1,203	Pajisjet

Nga auditimi i zbatimit të procedurave ligjore në lidhjen e këtyre kontratave të qirasë, u konstatua se:

-Në të gjitha rastet, nuk konstatohet dokumentacioni i dhënies me qira të objektit, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu II,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

pika 1, e cila përcakton se: “1. Institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka në administrim objektin që do jepet me qira ose enfiteozë, për të gjitha rastet, përgatit dokumentacionin, si vijon:

a) Propozimi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore për dhënien me qira ose enfiteozë të objektit, i cili përmban: propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira.

b) Vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues, Bordi drejtues, etj.).

c) Miratimin e organit të varësisë administrative.

d) Genplanin e objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore dhe nga organi i prefekturës në territorin e së cilës ndodhet pasuria, ku të jetë përcaktuar qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja funksionale (jo nën ndërtesë).

f) Konfirmim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone. Në rastet kur pasuria që jepet me qira ose enfiteozë është në administrim të shoqërive shtetërore, nuk është e nevojshme të kërkohet konfirmimi nga Agjencia e Kthimit e Kompensimit të Pronave.”, pikën 4, e cila përcakton se: “4. Për objektet e përcaktuara në shkronjën « b », të pikës 6, të kreut I, të këtij vendimi, pas përgatitjes së dokumentacionit, drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që ka në administrim pasurinë që do të jepet me qira ose enfiteozë e përcjell atë në organin që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, i cili me urdhër të titullarit të tij, fillon procedurat për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore.”.

-Në të gjitha rastet, nuk konstatohet dokumentacioni i marrjes me qira të objektit nga poseduesit, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu II, pika 7, e cila përcakton se: “7. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban:

a. Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore,

b. Plan biznesin, të detajuar për vënien me funksionim të objektit, ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen,

c. Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë,

ç. Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR.

d. NUIS-i dhe vërtetim nga Dega e Tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore.

dh. Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim.”

Në zbatim të Takimi Përfundimtar Ballafaques të datës 22.07.2019, janë sjellë dokumentet shtesë mbi miratimet e Ministrit të Shëndetësisë, për lidhjen e kontratave të qiradhënies, si më poshtë vijon:

-Shkresa e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 433/1, datë 24.01.2018;

-Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS nr. 86/1, datë 05.01.2018;

-Shkresa e Ministrit të MSHMS nr. 5157, datë 11.12.2017;

-Vendimi i Bordit Drejtues të SRD nr. 14, datë 19.03.2018;

-Shkresa e Ministrit të Shëndetësisë nr. 6929/1, datë 14.01.2015;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

- Vendimi i Bordit Drejtues nr. 20, datë 03.11.2017;
- Shkresa e Ministrit të Shëndetësisë nr. 5157, datë 11.12.2017;
- Vendimi i Bordit Drejtues nr. 03, datë 10.10.2016;
- Vendimi i Bordit Drejtues nr. 02, datë 10.10.2016;

Për sa më sipër, konsiderohet e ezauruar detyrimi ligjor me anë të të cilit kërkohet miratimi i Ministrisë të Shëndetësisë për lidhjen e kontratave të qiradhënies.

Me anë të Urdhrit nr. 101, datë 11.01.2018 “Për ngritjen e njësisë monitoruese të kontratave të qirasë”, Drejtori i SRD ka ngritur njësinë e monitorimit të kontratave të qirasë.

Në kontratat e qiradhënies së makinave për vitin 2015 dhe 2016, konkretisht në kontratat nr. 452, datë 02.03.2015; nr. 346, datë 09.02.2015; nr. 394, datë 10.02.2016; dhe nr. 557, datë 03.03.2016; sipërfaqja e makinave është përlllogaritur 1 m²/makinetë, ndërsa në kontratat e vitit 2017 dhe 2018, sipërfaqja e përlllogaritur është 2 m²/makinetë. Kjo diferencë ka ardhur si pasojë e mos përlllogaritjes së sipërfaqes së plotë funksionale të nevojitur për funksionimin e një makinete, që është rregulluar në kontratat e qirasë të lidhura për periudhën 2017-2018. Por nga SRD nuk janë marrë masat për përlllogaritjen e vlerës së munguar për vitin 2015 dhe 2016, për hapësirën prej 1 m², të përdorur më tepër. Për pasojë **për çdo kontratë janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 78,000 lekë** (1 m² * 500 lekë/ m² *12 muaj * 13 m²). **Në total dëmi ekonomik për këto kontrata është në vlerën 312,000 lekë** (78,000 lekë * 4 kontrata), vlerë e cila duhej kërkuar nga shoqëria C. P. SHPK në shumën 156,000 lekë dhe L. K. PF në shumën 156,000 lekë. Për sa më sipër mban përgjegjësi sektori teknik i spitalit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

III.8.3. Mbi zbatimin e kontratës pa numër protokoli, datë 10.12.2015, protokolluar në SRD me nr. 419, datë 08.02.2018, me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK.

Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokoli, datë 10.12.2015, me objekt “*Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale*”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrit të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK.

Kjo kontratë është protokolluar në SRD me nr. 419, datë 08.02.2018, e cila sipas deklarimeve verbale të stafit të SRD, është marrë dorazi nga Ministria e Shëndetësisë. Ndërsa Ankeset e kësaj kontrate, i janë dërguar SRD, në rrugë elektronike, me anë të e-mail-it të datës 05.07.2018.

Nga administrimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se SRD është njohur zyrtarisht me faktin e lidhjes së kësaj kontrate (por jo me kontratën), me anë të shkresës së Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSH nr. 199/14, datë 12.07.2017, protokolluar në SRD me nr. 1497, datë 13.07.2017, ku e njofton për fillimin e zbatimit të kontratës koncesionare, si dhe i kërkon SRD bashkëpunimin me kompaninë koncesionare për përcaktimin e ambienteve të nevojshme dhe krijimin e lehtësirave për zbatimin e kontratës. Në zbatim të shkresës së mësipërme, Drejtori i SRD, me urdhrin nr. 1497/1, datë 14.07.2017, ka ngritur grupin e punës për përcaktimin e ambienteve për zbatimin e kontratës koncesionare. Sipas këtij urdhri, grupi i punës duhet të marrë masa për përcaktimin e ambienteve që do merren në përdorim nga koncesionarë, duke hartuar një relacion deri më datë 20.07.2017. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet të jetë hartuar relacion në lidhje me këtë çështje.

Me shkresën nr. 275, datë 25.01.2018 “*Kërkesë për kopje të kontratës*”, drejtuar z. P. M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSHMS, Drejtori i SRD informon Ministrinë se janë krijuar ambientet për përdorim të koncesionarit S.S., por nuk disponohet kontrata koncesionare që e rregullon këtë marrëdhënie kontraktuale, e për këtë arsye i kërkon kopje të kësaj kontrate.

Me shkresën nr. 419/1, datë 12.02.2018 “*Kërkesë për dërgimin e kontratës financiare midis FSDKSH dhe S.S. me objekt për furnizimin e sterilizimit*”, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH z. E. A., Drejtori i SRD, i kërkon që: “*Meqënëse punimet për krijimin e ambienteve për shërbimin e sterilizimit janë në përfundim dhe Spitali Rajonal Durrës është në prag të fillimit të zbatimit të kësaj kontrate, ndërkohë që deri më tani nuk disponojmë dokumentacion/informacion për fillimin e këtij shërbimi dhe efekteve financiare që rrjedhin prej tij, kërkohet nga FSDKSH të na vihet në dispozicion sa më parë kontrata financiare dhe dokumentat e tjerë shoqëruese lidhur midis FSDKSH dhe Operatorit ekonomik S.S. SHPK*”.

Me anë të shkresës nr. 828/1, datë 13.03.2018, protokolluar në SRD me nr. 419/2, datë 20.03.2018, drejtuar Drejtorit të SRD, Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH z. E. A., ndër të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

tjera e informon se: “...Fondi ka lidhur kontratë për financimin e shërbimit për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale (aneksi 6 i kontratës). Shërbimet objekt i kontratës do të kryhen në mënyrë të integruar. Fondi, është i detyruar të respektojë në këto kushte finalizimin e shërbimit si dhe procedurat që kryhen midis Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare S.S. SHPK”.

Me anë të e-mail`it të datës 27.02.2018, protokolluar në SRD me nr. 589, datë 27.02.2018, z. P. M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSHMS, drejtuar SRD dhe për dijeni administratorin e OE S.S. SHPK, i kërkon lirimin e hapësirave të dakordësuara mes Drejtorisë së Spitalit dhe Drejtuesve të S.S. SHPK për garantimin e shërbimit. Ndër të tjera në këtë e-mail, përcakton se komunikimi i sipërcituar do përcillet dhe me shkresë zyrtare, shkresë e cila nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ka mbërritur pranë zyrave të spitalit.

Me anë të shkresës nr. N09/18, datë 05.03.2018, protokolluar në SRD me nr. 670, datë 06.03.2018, koncesionarë ndër të tjera kërkon që: “Shoqëria S.S.SHPK kërkon të marrë në përdorim për depozitimin e materialeve sterile dhe jo sterile, 2 dhoma në bllokun e kirurgjisë së programuar, 2 dhoma pranë shërbimit të obsetrik-gjinekologji dhe ashensorin që ndërlihd katin e I dhe II të Spitalit së bashku me hapësirat dhe ish dhomën e qëndrimit të afërmëve të pacientëve të identifikuar nga përfaqësuesit e shoqërisë S.S. dhe stafi i Spitalit Rajonal Durrës.

Ju lutem të zgjidhet problematika për depozitën e materialeve sterile të sallës së urgjencës ku do të vendosen Kitet dhe TNT sepse akoma nuk është marrë përgjigje nga ana juaj në lidhje me hapësirën që do i vihet në dispozicion shoqërisë S.S. SHPK.

Brenda datës 10 mars 2018 kërkojmë që hapësirat e lartpërmendura të jenë të lira në mënyrë që të organizohet sa më shpejt fillimi i shërbimit sipas kontratës.”.

Me anë të shkresës nr. 695, datë 08.03.2018, drejtuar nën Drejtorit Teknik të SRD z. G. K., Sektori Teknik, i parashtrajnë kërkesat e bëra në drejtim të koncesionarit për vendosjen e matësive të energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga ky OE.

Me anë të e-mail`it të datës 09.03.2018, drejtuar z. Petro Mersini me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSHMS, nga adresa SpitaliDurrës@shendetesia.gov.al, i kërkohet sqarim Ministrisë në lidhje me shpenzimet për energji elektrike dhe ujë, duke qenë se në nenin 2.7 të kontratës, termi “Autoritet” do të thotë Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e për pasojë këto shpenzime nuk duhet ti ngarkohen SRD për arsye se juridikisht nuk është Autoritet Kontraktor për këtë kontratë.

Me shkresën nr. 820, datë 23.03.2018 “Kërkesë për kopje të Anekseve të Kontratës”, drejtuar z. P.M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSHMS, Drejtori i SRD, e informon se disponon kontratën, por kuptimi dhe interpretimi i pikave të kontratës lidhet ngushtësisht me anekset pjesë përbërëse të saj, e për pasojë i kërkon ti vihen në dispozicion dhe këto anekse, e konkretisht:

- Aneksi 1-Kërkesat e Autoritetit,
- Aneksi 2-Oferta e Koncesionimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

- Aneksi 3-Projekti Teknik,
- Aneksi 4-Lista e Seteve Kirurgjikale dhe klasifikimi sipas shkallës së kompleksitetit të ndërhyrjes kirurgjikale,
- Aneksi 5-Lista e asetëve që transferohen në favor të Autoritetit,
- Aneksi 6-Kontrata e financimit me Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor,
- Ankesi 7-Akt Themelimi dhe Statut i Koncesionarit,
- Aneksi 8-Sigurimi i Kontratës,
- Aneksi 9-Lista e çdo instrumenti me çmimet përkatëse.

Me anë të shkresës nr. 820/1, datë 12.04.2018 *Kërkesë për kopje të Anekseve të Kontratës*”, drejtuar z. P. M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSHMS, Drejtori i SRD, ridërgon kërkesën për anekset e kësaj kontrate koncesionare.

Me anë të e-mailit datë 05.07.2018, drejtuar Spitaleve Rajonale, ndër to dhe Spitalit Durrës, z. P. M., ka dërguar materialet (Anekset) e koncesionit të sterilizimit.

Me përjashtim të Aneksit 2 “Oferta e Koncesionimit”, **të gjitha anekset e tjera janë të pafirmosura dhe pa vulosura, e për pasojë nuk japin besueshmërinë e plotë juridike.**

Me shkresën nr. N 11/18, datë 23.03.2018 “*Informacion*”, protokolluar në SRD me nr. 825, datë 26.03.2018, drejtuar drejtorit të SRD, Administratori i OE S.S. SHPK z. A. D., e njofton që: “*Më datë 15 mars 2018, ka filluar shërbimi pranë Spitalit Rajonal Durrës në bllokun operator Kirurgji e pranuar, Obstetrikë Gjinekologji Lindjet Natyrale, Abortarinë dhe Mikrokirurgji*”.

Drejtori i SRD, me shkresën nr. 825/1, datë 29.03.2018 “*Njoftim për fillimin e shërbimit në bllokun operator Kirurgji e pranuar, Obstetrikë Gjinekologji Lindjet Natyrale, Abortarinë dhe Mikrokirurgji*”, drejtuar z. A. K. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MSHMS, z. E. A. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i FSDKSH, si dhe për dijeni Ministrit të MSHMS, i njofton mbi fillimin e shërbimit në bllokun operator Kirurgji e pranuar, Obstetrikë Gjinekologji Lindjet Natyrale, Abortarinë dhe Mikrokirurgji, si dhe i dërgon bashkëngjitur shkresën nr. N 11/18, datë 23.03.2018 “*Informacion*”, të Administratorit të OE S.S. SHPK.

Drejtori i SRD, me anë të shkresës nr. 833, datë 26.03.2018 “*Kërkesë për vendosjen e matësve elektrikë dhe të ujit për ambientet në përdorim të koncesionarit, si dhe plotësim të dokumentacionit në zbatim të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe Ligjit nr. 9537, datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme” subjektit “S.S.” SHPK*”, drejtuar Administratorit të OE S.S. SHPK z. A. D. dhe për dijeni z. P. M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSHMS, i kërkon OE S.S. SHPK, pajisjen me matësa të energjisë elektrike dhe ujit, linjat e tyre të furnizimit, brenda datës 30.03.2018, si dhe kërkon që OE S.S. SHPK të dprëzojë në SRD brenda datës 13.04.2018:

1. Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese,
2. Planin për administrimin e mbetjeve spitalore,
3. Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, si dhe
4. Formularin e veçantë “Dokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshme”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Administratori i OE S.S. SHPK z. A.D., me shkresën nr. N 12/18, datë 30.03.2018 “*Kthim përgjigjë*”, protokolluar në SRD me nr. 833/1, datë 03.04.2018, drejtuar drejtorit të SRD dhe për dijeni z. P.M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Spitalor të MSHMS, ndër të tjera njofton se “*Bazuar në artikullin 19.5 të kontratës së lartpërmendur thuhet që: Në qendrat Back up, përveç Back Up të QSUT, Autoriteti i siguron koncesionarit energji elektrike, uj, avull, vepra civile etj. S.S. SHPK ka vendosur matësat e ujit dhe energjisë elektrike sipas kontratës në back-up të QSUT, në back-up e tjera janë në ngarkim të Autoritetit, referojuni projektit teknik në ankesin e kontratës.*”

Referuar administrimit të mbetjeve po Ju bashkëngjisim lejen mjedisore të datës 27.09.2016. Përsa i përket formularëve dhe regjistrimit të mbetjeve ju lutem referojuni projektit teknik dhe lejes bashkëngjitur. S.S. SHPK trajton vetëm mbetjet e derivuara nga shërbimi (material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale).”

Me anë të relacionit nr. 951, datë 06.04.2018 “*Relacion për monitorimin e ujit dhe energjisë elektrike*”, drejtuar zv. Drejtorit Ekonomik, njësia monitoruese e ngritur me Urdhrin e Drejtorit të SRD nr. 09, datë 15.01.2018, e përbërë nga A.D., A.K., N. M., R.P., Dh. K., E.P. dhe R.C., ndër të tjera, njofton se: “*Problem do të jetë konsumi i ujit dhe energjisë elektrike nga operatori privat S.S.SHPK i cili prej datës 15 mars ka filluar punë për sterilizimin e instrumentave kirurgjikalë. Operatori S.S. SHPK nuk ka vendosur sahatë matës për ujin dhe energjinë dhe sipas shkresës nr. 833/1, datë 30.03.2018 të protokolluar pranë nesh Koncesionari nuk do të vendosë matës uji dhe energjie elektrike pasi pretendon që konsumi i tij është në ngarkim të Spitalit Durrës. Gjithashtu me fillimin e koncesionarit ka funksionuar paralelisht edhe Autoklava e Spitalit për sterilizimin e instrumentave të Spitalit. Me vënien në funksion të Qendrës së Sterilizimit të Koncesionarit A. C. e Spitalit duhet të hiqet nga funksioni, pasi ajo konsumon 40 KË/orë energji elektrike.”*

Me anë të shkresës nr. 2028, datë 01.08.2018, drejtuar nën Drejtorit Ekonomik z. G. K., Dega Teknike e SRD i dërgon informacion mbi **konsumin e nergjisë elektrike për OE S.S. SHPK**, konsum i cili për periudhën 15.03.2018-01.08.2018, është në vlerën **2,247,437 lekë me tvsh**.

Drejtori i SRD, me anë të shkresës nr. 2490, datë 03.10.2018 “*Kërkesë për përcaktimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Kontratës së Koncesionit nr. 1440/40, datë 10.12.2015*”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të FSDKSH, Drejtorisë Rajonale Durrës të FSDKSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kërkon të udhëzohen në lidhje me **shpenzimet për energji elektrike dhe ujë të konsumuara nga OE S.S. SHPK, por që përballohen nga Buxheti i SRD, të cilat për periudhën 15.03.2018-31.12.2018, parashikohen në vlerën 5,225,000 lekë**.

Me shkresën nr. 4600/1, datë 18.10.2018 “*Mbi kërkesën për përcaktimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Kontratës së Koncesionit*”, protokolluar në SRD me nr. 2490/1, datë 24.10.2018, Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH znj. A. D., ndër të tjera informon se: “*...problemet që keni parashtruar janë pjesë e administrimit të brendshëm të spitalit. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, duhet të zbatoni kushtet e parashikuara në kontratën koncesionare me nr. 1440/40 prot., datë 10.12.2015...*”

Deri më datë 29.03.2019, datë në të cilën përfundon auditimi në terren, MSHMS, nuk ka kthyer përgjigje mbi shkresën nr. 2490, datë 03.10.2018 “*Kërkesë për përcaktimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Kontratës së Koncesionit nr. 1440/40, datë 10.12.2015*”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate koncesionare, konstatohet se:

Mbi hartimin dhe miratimin e kontratës:

Kontrata pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, nuk disponohet e plotë nga SRD, e për pasojë e bën të pamundur monitorimin e kësaj kontrate koncesionare, për arsye se mungojnë ose janë të paplota Aneksat e mëposhtme:

-Aneksi 4 - Klasat e kompleksitetit ose intensiteti i ndërhyrjes kirurgjikale, nuk është i firmosur nga asnjë palë, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 5 - Lista e asetëve që do të kthehen Autoritetit, nuk është i firmosur nga asnjë palë, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 6 - Kontrate për financimin e shërbimit: Kjo kontratë nuk ka datë, nuk është e firmosur dhe vulosur nga asnjë palë, por është thjesht një draft në rrugë elektronike, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 9 - Lista e çdo instrumenti me çmimet përkatëse, Aneksi 9 - Lista e çdo instrumenti me çmimet përkatëse.

Mungesa e besueshmërisë së dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar në rrugë elektronike nga MSHMS, përveçse e bën të pamundur monitorimin e kësaj kontrate koncesionare, por e vendos dhe Spitalin Durrës në kushte jo të favorshme ndaj Koncesionarit.

Mbi analizën e elementëve të kostos së kontratës koncesionare:

Sipas pasqyrës së veprimtarisë së aktivitetit të vitit 2018, dërguar pranë SRD nga Koncesionari OE S.S. SHPK, konstatohet se numri i ndërhyrjeve për vitin 2018, është **10,200 ndërhyrje** (8712 ndërhyrje kirurgjikale dhe 1488 ndërhyrje me avull), me një vlerë totale prej **174,129,370 lekë me tvsh** (sipas nenit 7 “Çmimet e kontratës” të kontratës së koncesionimit).

Në Aneksin 3 “Projekti Teknik”, Kapitulli 4-6 “Sistem informacioni projekt zbatimi”, 6.4 “Shpenzimet Operative”, ndër të tjera përcaktohet se:

“Shpenzimet e energjise elektrike bazohen në një kosto të llogaritur në mënyrë statistike për çdo ndërhyrje kirurgjikale, të barabarte me rreth 255 leke (1,85 EUR) në regjim pune (50K veprime kirurgjikale në vit).

Shpenzimet e ujit bazohen në një kosto të llogaritur rreth 103,5 leke (0,75 EUR) për ndërhyrje kirurgjikale.

Shpenzimet e energjise termike bazohen në një kosto për ndërhyrje të barabarte me rreth 235 leke (1,70 EUR).

Plan Biznesi vlerëson një rritje të kostove operative me 3,0% çdo vit”.

Nisur nga fakti, që nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, Koncesionari OE S.S. SHPK, nuk i paguan Spitalit Rajonal Durrës shpenzime për energji elektrike, shpenzime për ujë dhe shpenzime për energji termike, përlllogaritja e zërave të mësipërme në vlerën e koston, pjesë përbërëse e kontratës, është e pa argumentuar nga Koncesionari OE S.S. SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

E njëjta situatë është konstatuar nga KLSH, po për këtë kontratë koncensionare, edhe në Spitalin Universitar të Traumës (sipas programit të auditimit nr. 68/1, dt. 23.01.2018, i ndryshuar), ku nga KLSH me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 54, nr. Prot. 68/6, datë 21.06.2018, pika D/4, janë konstatuar shpenzime me pasojë efekt negativ financiar, për të cilat është rekomanduar që “SUT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 4,047,513 lekë si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ringocimin e kontratës për nënpikën 19.5.”. Në fakt situata paraqitet e njëjtë edhe pas konstatimit të KLSH dhe nga MSH (sot MSHBS) nuk është marrë masë për të ringociuar pikën 19.5 të kontratës.

Për pasojë, vlera 7,706,844.40 lekë, e cila përfaqëson vlerën e elementëve të koston të shënuar nga Koncensionari OE S.S. SHPK, elementë për të cilët shpenzimet përballohen nga Buxheti i Spitalit Rajonal Durrës, **përbën efekt financiar negativ për llogari të Buxhetit të Shtetit**, më hollësisht sipas tabelës së mëposhtme:

Lloji i shpenzimit	Çmimi pa TVSH Ofertë	Çmimi pa TVSH Viti I (2016)*	Çmimi pa TVSH Viti II (2017)*	Çmimi pa TVSH Viti III (2018)*	Çmimi me TVSH	Vlera me TVSH
Shpenzimet për energji elektrike për ndërhyrje	255.00	255.00	262.65	270.53	324.64	3,311,281.08
Shpenzimet për ujë për ndërhyrje	103.50	103.50	106.61	109.80	131.76	1,343,990.56
Shpenzimet për energji termike për ndërhyrje	235.00	235.00	242.05	249.31	299.17	3,051,572.76
Shuma						7,706,844.40

*Shënim: Në zbatim të Aneksit 3 “Projekti Teknik”, Kapitulli 4-6 “Sistem informacioni projekt zbatimi”, pika 6.4 “Shpenzimet Operative”, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Plan Biznesi vlerëson një rritje të kostove operative me 3,0% çdo vit”, kosto vjetore është llogaritur duke i shtuar 3% të vlerës së saj progresivisht për çdo vit duke filluar nga viti 2017, që është viti i dytë i zbatimit të kësaj kontrate koncensionare.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi drejtuesit e FSDKSH përgjatë vitit 2018, për mos ndjekjen e zbatimit të kësaj kontrate koncensionare.

Me anë të shkresës datë 28.02.2019 “Informacion mbi numrin e ndërhyrjeve kirurgjikale viti 2018”, i marrë nga drejtuesit e SRD, konstatohet se nga të dhënat që disponon spitali, numri i ndërhyrjeve me kompleksiteti të ulët ndryshon nga numri i ndërhyrjeve të raportuar nga Koncensionari. Konkretisht sipas të dhënave të SRD, numri i ndërhyrjeve me kompleksitet të ulët është 6,265 ndërsa sipas Koncensionarit është 6,766 ndërhyrje.

Gjithashtu, sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Spitali Durrës, me anë të shkresës datë 28.02.2019 “Informacion mbi numrin e ndërhyrjeve kirurgjikale viti 2018”, konstatohet se numri i ndërhyrjeve me kompleksitet të mesëm dhe të lartë, është më i lartë se numri i deklaruar nga Koncensionari, e konkretisht 184 më shumë për ndërhyrjet me kompleksitet të mesëm dhe 140 për ndërhyrjet me kompleksitet të lartë. Në këtë rast kemi një faturim me vlerë më të ulët nga Koncensionari S.S. SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Për mos zbatimin e kontratës koncesionare sipas kushteve të saj, *mban përgjegjësi Koncesionari OE S.S. SHPK.*

Fillimi i punimeve:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, e konkretisht:

-Shkresës nr. N 11/18, datë 23.03.2018 “*Informacion*”, protokolluar në SRD me nr. 825, datë 26.03.2018, drejtuar drejtorit të SRD, e dërguar nga Administratori i OE S.S. SHPK z. A. D., për fillimin e kontratës koncesionare;

-Shkresat e Shefave të shërbimeve pranë SRD, të cilët deklarojnë si datë fillimi për këtë kontratë datën 16.03.2018;

-Relacioneve të degës teknike mbi problematikat me shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm;

Konstatohet se data e instalimit të Koncesionarit në ambientet e SRD është data 15.03.2018, ndërsa data e fillimit të kontratës koncesionare është data 16.03.2018.

Sipas kontratës së lidhur, e konkretisht Aneksit 3 “*Projekti Teknik*”, Kapitulli 1-2 (2.3.1 *Projekti teknik Kap_1-2_Pershkrimi _Grafiku_Pjesa 1 nga 6*), punimet duhej të fillonin në fillim të vitit 2017 (viti i dytë, faqe 22).

Vonesa e pa argumentuar me 1 vit e fillimit të zbatimit të kësaj kontrate koncesionare, përbën rast të mos përmbushjes nga Koncesionari, sipas nenit 29 të kësaj kontrate.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi drejtuesit e FSDKSH përgjatë viteve 2017-2018, për mos ndjekjen e zbatimit të kësaj kontrate koncesionare.

Për mos zbatimin e kontratës koncesionare sipas kushteve të saj, *mban përgjegjësi Koncesionari OE S.S. SHPK.*

Në lidhje me shpenzimet për energji elektrike dhe ujë:

Sipas relacionit nr. 192, datë 23.01.2019, të përgatitur nga Dega Teknike e SRD, konstatohet se për periudhën 15.03.2018-31.12.2018, detyrimet për shpenzime për energji elektrike, janë në vlerë 3,660,537.6 lekë, ndërsa detyrimet për shpenzime për ujë janë në vlerën 817,756 lekë, detyrime të cilat i përkasin OE S.S. SHPK, por janë paguar nga buxheti i SRD.

Duke qenë se:

-Koncesionari në SRD nuk ka qendër Back-up, por vetëm magazina dhe Central Sterilizimi, fakt i cili konfirmohet dhe nga tabela e vendosur nga vetë koncesionari në hyrje të centralit;

-Neni 19.5, i kontratës koncesionare datë 10.12.2015, përcakton se: “*Në qendrat e Back-Up, përveç qendrës tek QSUT, Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime në ngarkim të Autoritetit*”;

-Faqes nr. 5, të kontratës datë 10.12.2015, e cila në paragrafin e parë të saj përcakton se “**Autoriteti**”, për këtë kontratë është “**Ministria e Shëndetësisë**”;

-E njëjta situatë është konstatuar nga KLSH, po për këtë kontratë koncesionare, edhe në Spitalin Universitar të Traumës (sipas programit të auditimit nr. 68/1, dt. 23.01.2018, i ndryshuar), ku nga KLSH me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 54, nr. Prot. 68/6, datë 21.06.2018, pika D/4, janë konstatuar shpenzime me pasojë efekt negativ financiar, për të cilat është rekomanduar që “*SUT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 4,047,513 lekë si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për nënplikën 19.5*”. Në fakt situata paraqitet e njëjtë edhe pas konstatimit të KLSH dhe nga MSH (sot MSHBS) nuk është marrë masë për të rinegociuar pikën 19.5 të kontratës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga OE S.S. SHPK, **në vlerën 4,478,293.6 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për llogari të Buxhetit të SRD.**

Shpenzimet e energjisë elektrike janë të matura me anë të matësit të vendosur nga përfaqësuesit e SRD për Centralin e përdorur nga Koncesionari OE S.S. SHPK. por për ambientet e tjera të përdorura nga koncesionari (ambientet për magazinim), këto shpenzime nuk janë llogaritur nga SRD, **e për pasojë vlera e shpenzimit të energjisë elektrike për këto ambiente, nuk është e mundur të llogaritet e plotë.**

Gjithashtu shpenzimet për ujë, nuk janë të matura me anë të matësit, por janë përlllogaritur për afërsisht, shpenzime të cilat sipas deklarimeve të përfaqësuesve të SRD, nuk janë reale.

Shpenzimet për qira:

Sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion, Koncesionari ka në përdorim ambientet e:

- Centralit kryesor me sipërfaqe 182.41 m²,
- Kirurgji kati i 1, me sipërfaqe 20.7 m²,
- Salla e Operimit me sipërfaqe 23.53 m²,
- Salla e Oper. Urgjencës me sipërfaqe 7.61 m²,
- Ambiente ndihmëse me sipërfaqe 22.2 m²,
- Materniteti kati 3, me sipërfaqe 10.33 m², si dhe
- Materniteti kati 2, me sipërfaqe 12.56 m².

Sipërfaqja totale në përdorim nga koncesionarë është **291 m²**. Këto sipërfaqe Koncesionari i **ka përdorur për periudhën 15.03.2018 e në vazhdim, pa paguar qira për to.**

Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare datë 10.12.2015, ndër të tjera përcaktohet se: *“Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsyë logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund ti lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar”.*

Në lidhje nga sa më sipër, konstatohet se:

-Në faqen nr. 5, të kontratës datë 10.12.2015, në paragrafin e parë të saj përcaktohet se **“Autoriteti”**, për këtë kontratë është **“Ministria e Shëndetësisë”**;

-Në lidhje me ambientet të dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk janë ndjekur procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar.

-Në lidhje me ambientet të dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk janë mbajtur detyrime për qira për këto ambiente, duke qenë se SRD nuk është palë në këtë kontratë, por vetë Ministria. Detyrimi i qirasë për periudhën 15.03.2018-31.12.2018 (periudha objekt auditimi), për këto ambiente është në vlerën 1,382,250 lekë (*9.5 muaj * 500 lekë/m² muaj * 291 m²*). Çmimi 500 lekë/m² muaj, është marrë për bazë duke ndjekur të njëjtin standard për të cilin SRD ka aplikuar me kontratat e tjera të qiradhënies së ambienteve, lidhur për periudhën objekt auditimi. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Nuk lidhur kontrata qiraje në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

-Nuk konstatohet mënyra e dorëzimit të ambienteve nga SRD për Koncesionarin, në kushtet kur në datën e fillimit, SRD nuk dispononte dokumentacionin ligjor që vërtetonte këtë kontratë koncesionare. Kjo për arsye se SRD deri më datë 15.03.2018, dispononte vetëm kontratën koncesionare pa Anekset pjesë përbërëse, kontratë në të cilën nuk parashikohej në asnjë nen të saj përfshirja e Spitalit Rajonal Durrës në këtë kontratë koncesionimi.

Për pasojë, vlera 1,382,250 lekë, që përbën detyrimin për qiranë mujore për ambientet e dhëna në përdorim të koncesionarit S.S. SHPK, përbën efekt financiar negativ. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”.

Mbetjet e rrezikshme:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se OE S.S. SHPK, nuk ka dorëzuar pranë SRD dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:

-Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 7.1.

-Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 7.2.

-Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010, Kreu III, pika 8.13 dhe Kreu VI, pika 12.2, gërma ç.

-Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë “Dokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshme”, në kundërshtim me VKM nr. 371, datë 11.06.2007.

Mos dorëzimi i dokumentacionit të mësipërm, do përbënte risk të lartë për penalizim nga institucionet monitoruese, *për SRD në vlerat nga 500,000 – 1,500,000 lekë.*



III.9. Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

1. Titulli i gjetjes: Për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga auditimi u konstatua se në Spitalin Rajonal Durrës, nuk janë implementuar plotësisht procedurat për respektimin e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga ana e subjektit nuk u paraqit asnjë dokument ligjor të nxjerrë nga Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2016 në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. U konstatua se grupet e menaxhimit strategjik janë ngritur rregullisht çdo vit por nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor që grupi i menaxhimit strategjik të ketë zhvilluar mbledhje për diskutimin e çdo komponenti për të zbatuar ligjin për Menaxhimin Strategjik dhe Financiar. U konstatua se nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave. Shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit nuk funksionojnë mirë si në mënyrë shkresore dhe elektronikisht, kjo gjë u konstatua edhe gjatë auditimit pasi departamentet nuk rakordonin në kohë me njëra tjetrën për paraqitjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar.

Kriteri: Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Shkaku: Mos implementimi plotësisht i procedurave për respektimin e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandimi: Nga Drejtoria Spitalit Rajonal Durrës, të merren masa për të implementuar sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim rritjen e kontrollit vertikal të SRD për dhënien e sigurisë së arsyeshme në veprimtarinë ekonomiko-financiare të tij.

2. Titulli i gjetjes: Mbi auditimin e brendshëm

Situata: Nga auditimi u konstatua se auditimi i brendshëm është krijuar më Urdhrin nr. 915 Prot., datë 29.04.2016 duke emëruar si specialiste të auditimit znj. L. K. Auditimi i brendshëm ka funksionuar në Spitalin Rajonal Durrës vetëm me 1 punonjës. Auditimi i brendshëm me një grup specialistesh ka zhvilluar auditim të përputhshmërisë në shërbimin spitalor (Pavionet e Pediatrisë, Urgjencës, Infektivitet të madh) mbi evidentimin e harxhimit të oksigjenit gaz për 3 furnizimet e fundit, Tetor-Nëntor 2016. U konstatua se nga mos plotësimi i kriterëve ligjorë, auditimi është kryer me grup pune të përbërë nga punonjës të brendshëm të SRD-së me në krye znj. K. në kundërshtim me ligjin për auditimin e brendshëm gjë e cila nuk siguron pavarësinë e plotë të auditimeve të kryera. U konstatua se deklaratat e pavarësisë për kryerjen e auditimit nuk janë plotësuar asnjëherë.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 3 ku ndër të tjera përcaktohet se: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Shkaku: Mos zbatimi i VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 3 ku ndër të tjera përcaktohet se: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa për plotësimin e zyrës së auditit të brendshëm, me qëllim dhënien e sigurisë objektive dhe për përmirësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Spitalit Rajonal Durrës.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

-Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i cili organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Spitali duhet të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me punëdhënësin me kodin e punës. Bazat ligjore të kodit të punës dhe dispozitave të tjera si, ligji për buxhetin e shtetit, ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, etj., lejon menaxherin e institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore, apo të rregullave të ndërmarrë hapat e duhura.

Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, eficiente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Në nenin 8 pika b të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” citohet: “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji*”. Nga auditimi rezulton se në Spitalin Rajonal Durrës është ngritur grupi i menaxhimit strategjik për të gjithë periudhën e auditimit me konkretisht për vitet 2015,2016,2017 dhe 2018.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Spitalin Rajonal Durrës, grupi i auditimit gjatë verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga auditimi u konstatua se në Spitalin Rajonal Durrës, *nuk janë implementuar plotësisht procedurat për respektimin e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.*

-Në nenin 8 pika b të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” citohet: “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: *b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji*". Nga auditimi rezulton se në Spitalin Rajonal Durrës janë ngritur grupet e menaxhimit strategjik gjatë viteve.

Për vitin 2015, me Urdhrin e titullarit të SRD-së me nr. 332 Prot., datë 11.02.2015 është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, i përbërë nga:

1. znj. A. F., Drejtor (Kryetare)
2. z. G. K., zv. Drejtor Teknik (anëtar)
3. z. A. P., zv. Drejtor Ekonomik (anëtar)
4. znj. F. R., zv. Drejtor i Edukimit në Vazhdim (anëtar)
5. znj. A.S., shef i sektorit të financës (anëtare)
6. znj. B.Ç., shef i sektorit të personelit (anëtare)
7. znj. V.Xh., shef i sektorit të prokurimeve (anëtare)

-Për vitin 2015, Grupi i Menaxhimit Strategjik me shkresën nr. 2156/2 Prot., datë 14.12.2015 i është drejtuar Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës për miratimin e Manualit për Menaxhimin e Riskut në SRD. Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës me vendimin nr. 2186 Prot., datë 17.12.2015, ka vendosur Miratimin e Manualit për Menaxhimin e Riskut.

Nuk u paraqit asnjë dokumentacion ligjor i propozuar apo i miratuar nga Ministria e Financave për të vërtetuar nëpunësin autorizues dhe nëpunësin zbatues për vitin 2015 në SRD.

-Për vitin 2016, me Urdhrin nr. 445 Prot., datë 17.02.2016, titullari ka miratuar grupin e menaxhimit strategjik, më pas me Urdhrin nr. 445/1 Prot., datë 23.09.2016 grupi i menaxhimit strategjik ka ndryshuar me ardhjen e titullarit të ri.

1. z. A.R., Drejtor (Kryetar)
2. z. E.Sh., zv. Drejtor i shërbimeve klinikave (anëtar)
3. znj. E.B., zv. Drejtore e shërbimeve administrative (anëtare)
4. znj. F.R., zv. Drejtore e edukimit në vazhdim (anëtare)
5. znj. L.B., përgjegjëse e sektorit të financës (anëtare)
6. znj. B.Ç., përgjegjëse sektori i burimeve njerëzore (anëtare)
7. znj. V.Ç., përgjegjëse sektori të planifikimeve dhe prokurimeve (anëtare)

-Nëpunësi autorizues për vitin 2016, referuar shkresës nr. 1052 prot datë 18.05.2016 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt "Kërkesë për autorizim firme të parë", dhe shkresës me nr. 7228/1 prot., datë 01.06.2016 të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Ministrisë së Financave drejtuar degës së thesarit "Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Spitalit Rajonal Durrës". Nëpunësi autorizues është caktuar z. A.R.

-Nëpunësi zbatues për vitin 2016, referuar shkresës nr. 1052 prot datë 18.05.2016 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me objekt "Kërkesë për autorizim firme të Nëpunësit Zbatues", dhe shkresës nr. 7228/1 prot., datë 01.06.2016 të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, drejtuar Degës së Thesarit, me objekt “Konfirmim i Nëpunësit Zbatues për Spitalin Rajonal Durrës”, është caktuar znj. L.B. me pozicion pune Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

-Me këtë urdhër është ngarkuar znj. V.Gj. (Juriste) për mbledhjen e materialit që do të përgatitet nga grupi i menaxhimit strategjik. Por nga ana e subjektit nuk u paraqit asnjë dokument ligjor të nxjerrë nga Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2016 në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Me Urdhrin nr. 810 Prot., datë 13.04.2017 është ngritur grupi i menaxhimit strategjik për vitin 2017 në përbërje si me poshtë:

1. z. A.R., Drejtor (Kryetar)
2. z. E.Sh., zv. Drejtor Teknik (Kordinator Risku)
3. znj. E.B., zv. Drejtor shërbimeve administrative (kordinator risku)
4. znj. F.R., zv. Drejtores e edukimit ne vazhdim (anëtare)
5. z. A.K., shef i deges teknike (anëtar)
6. znj. F.I., shefe e sektorit të kostos (anëtare)
7. znj. L.B., shefe e sektorit të financës (anëtare)
8. znj. B.Ç., shefe e burimeve njerëzore (anëtare)
9. znj. V.S., shefe e sektorit të hotelarisë (anëtare)
10. znj. V.C., shefe e sektorit të prokurimeve (anëtare)
11. znj. A.D., shefe e sektorit të mjedisit (anëtare)
12. z. H.P., shef i sektorit të menaxhimit të teknologjisë (anëtar)
13. znj. E.D., kryeinfurmjerja e përgjithshme (anëtare)
14. Shefave të shërbimeve (anëtarë).

-Nëpunësi autorizues për vitin 2017, referuar shkresës nr. 1119 prot datë 19.05.2017 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Kërkesë për autorizim firme të parë”, dhe shkresës me nr. 7381/1 prot., datë 01.06.2017 të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Ministrisë së Financave drejtuar degës së thesarit “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Spitalit Rajonal Durrës”. Nëpunësi autorizues është caktuar z. A.R.

-Nëpunësi zbatues për vitin 2017, referuar shkresës nr. 1119 prot datë 19.05.2017 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Kërkesë për autorizim firme të parë”, dhe shkresës me nr. 7381/1 prot., datë 01.06.2017 të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Ministrisë së Financave drejtuar degës së thesarit “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Spitalit Rajonal Durrës”. me objekt “Konfirmim i Nëpunësit Zbatues për Spitalin Rajonal Durrës”, është caktuar znj. I.V. me pozicion pune Shefe e Sektorit të Financës.

Nga ana e subjektit nuk u paraqit asnjë dokument ligjor të nxjerrë nga Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2017 në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Për vitin 2018, me Urdhrin nr. 1338 Prot., datë 15.05.2018, është ngritur grupi i menaxhimit strategjik për vitin 2018.

1. znj. N.J., Drejtor i SRD-së (Kryetare)
2. z. G.K., zv. Drejtor teknik (Kordinator risku)
3. z. G.K., zv. Drejtor i shërbimeve administrative (kordinator risku)
4. z. A.K., përgjegjës i degës teknike (anëtar)
5. znj. F.I., përgjegjëse e sektorit të kostos (anëtare)
6. znj. I.V., përgjegjëse e sektorit të financës (sekretare)
7. znj. B.Ç., përgjegjëse e burimeve njerëzore (anëtare)
8. znj. H.M., përgjegjëse e sektorit të hotelerisë (anëtare)
9. znj. A.D., përgjegjëse e sektorit të mjedisit (anëtare)
10. znj. V.Ç., përgjegjëse e sektorit të prokurimeve (anëtare)
11. znj. I.F., përgjegjës i sektorit të prokurimeve (anëtare)
12. znj. V.Gj., përgjegjëse e sektorit juridik (anëtare)
13. znj. E.D., kryeinfermiere e përgjithshme (anëtare)
14. Shefave të shërbimeve/Klinikave (anëtar)

-Nëpunësi autorizues për vitin 2017, referuar shkresës nr. 1119 prot datë 19.05.2017 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Kërkesë për autorizim firme të parë”, dhe shkresës me nr. 7381/1 prot., datë 01.06.2017 të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Ministrisë së Financave drejtuar degës së thesarit “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Spitalit Rajonal Durrës”. Nëpunësi autorizues është caktuar z. A.R. Nëpunësi autorizues ka ndryshuar referuar shkresës nr. 1188 prot datë 26.05.2017 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Kërkesë për autorizim firme të parë”, dhe shkresës me nr. 7780/1 prot., datë 08.06.2017 të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Ministrisë së Financave drejtuar degës së thesarit “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Spitalit Rajonal Durrës”. Nëpunësi autorizues është caktuar znj. Viola Cikalleshi. Nëpunësi autorizues ka ndryshuar referuar shkresës nr. 1520 prot datë 05.06.2018 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Kërkesë për autorizim firme të parë”, Nëpunësi autorizues është caktuar znj. N.J.

-Nëpunësi zbatues për vitin 2018, referuar shkresës nr. 1119 prot datë 19.05.2017 të Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, me objekt “Kërkesë për autorizim firme të parë”, dhe shkresës me nr. 7381/1 prot., datë 01.06.2017 të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Ministrisë së Financave drejtuar degës së thesarit “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Spitalit Rajonal Durrës”. me objekt “Konfirmim i Nëpunësit Zbatues për Spitalin Rajonal Durrës”, është caktuar znj. I.V. me pozicion pune Shefe e Sektorit të Financës. Gjithashtu edhe për vitin 2018 nëpunësi zbatues është znj. I.V.

U konstatua se grupi i menaxhimit strategjik për vitin 2018 ka nxjerrë manualin e menaxhimit të riskut për vitin 2018 me nr. 200/1 Prot., datë 18.04.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

U konstatua se grupet e menaxhimit strategjik janë ngritur rregullisht çdo vit por nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor që grupi i menaxhimit strategjik të ketë zhvilluar mbledhje për diskutimin e çdo komponenti për të zbatuar ligjin për Menaxhimin Strategjik dhe Financiar.

Në drejtim të Mjedisit të Kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është një element i rëndësishëm i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, etikën personale dhe profesionale, dhe mënyrën e organizimit të strukturës organizative të Spitalit Rajonal Durrës.

Me Vendimin Nr. 3 prot, datë 19.03.2018, të Bordit Drejtues të SRD-së është miratuar struktura organizative e Spitalit Rajonal Durrës. Struktura organizative ka pësuar ndryshime të miratuara nga Bordi Drejtues i SRD-së me vendimin nr. 29 Prot., datë 20.06.2018. Me vendimin e Bordit Drejtues nr. 31 Prot., datë 20.06.2018 është miratuar struktura organizative e SRD-së me një numër total prej 522 punonjësish.

U konstatua se Bordi Drejtues me vendimin nr. 2608 Prot., datë 18.10.2018, ka miratuar rregulloret e mëposhtme të SRD:

- Rregullorja e Funksionimit Teknik
- Rregullorja Ekonomiko-Financiare
- Rregullorja e Marrëdhënieve me Personelin
- Kriteret e vlerësimit të performancës në SRD
- Kodi i Etikës në SRD

Këto rregullore parashikojnë me hollësi të gjitha detyrat dhe funksionet e stafit të shoqërisë sipas strukturës aktuale të miratuar, konform Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se për përudhen 2015, 2016, dhe 2017 nuk ka pasur një rregullore për marrëdhëniet e punës me personelin të miratuar nga Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Durrës. Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikrat e ndjekura në lidhje me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës janë pjesë e rëndësishme e mjedisit të kontrollit për vitin 2018, ndiqen sipas rregullores për “*Marrëdhëniet e Punës me Personelin*” së miratuar nga bordi drejtues i Spitalit Rajonal Durrës e miratuar me vendimin nr. 2608 Prot., datë 18.10.2018.

U konstatua se ka vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që kryejnë ato por të firmosura nga përgjegjësit e departamenteve dhe jo nga titullari i SRD-së.

U konstatua se nga ana e SRD-së nuk ka një mjedis të kontrollit që të jetë me elementet e kontrollit siç janë:

- Kontrolllet Parandaluese
- Kontrollle zbuluese
- Kontrollle rregulluese



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Bazuar në Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” titullarët e sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Duhet theksuar se *nuk ka një rregullore të veçantë apo procedurë për implementimin e kërkesave të këtij ligji.*

Në drejtim të Menaxhimit të Riskut.

Ka të miratuar manualin e menaxhimit të riskut që të përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Në këtë kuadër është caktuar edhe koordinatori i riskut. Është krijuar një regjistër i ri për gjithë aktivitetin e Spitalit Rajonal Durrës për vitet 2015 dhe 2018 ku janë regjistruar dhe raportohen masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive, në shërbim të minimizimit të riskut të mashtrimeve dhe parregullsive.

-U konstatua se për vitet 2016 dhe 2017 nuk u paraqit asnjë dokumentacion ligjor ku të jetë krijuar një manual për menaxhimin e riskut. Për këtë periudhë nuk është miratuar asnjë strategji, e cila duhet përditësuar çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nëpunësi autorizues duhet të analizojë dhe përditësojë kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Në Drejtim të Aktiviteteve të Kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për të arritur objektivat e institucionit. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues. Në lidhje me aktivitetet e kontrollit, është e rëndësishme një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve, vendosja e rregullave të brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli, etj.

Nga auditimi u konstatua se nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara në nenin 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 e 6 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “Deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave”.

Në drejtim të Monitorimit dhe Verifikimit.

Sistemet e kontrollit të brendshëm duhen monitoruar për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës në kohë. Monitorimi kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura ose duke i kombinuar të dyja. Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm duhet të dallohet qartë nga verifikimi dhe monitorimi i operacioneve të institucionit.

-U konstatua se nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

Në Drejtim të Informimit dhe Komunikimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Informimi dhe komunikimi janë thelbësore për zbatimin e të gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm. U konstatua se sistemi i Informacionit dhe Komunikimit nuk ka funksionuar me një rregullore specifike për shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pasi nga ana e subjektit nuk u paraqit asnjë dokumentacion ligjor në drejtimin e informacionit dhe komunikimit. Mbi këtë kuadër shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit nuk funksionojnë mirë si në mënyrë shkresore dhe elektronikisht, kjo gjë u konstatua edhe gjatë auditimit pasi departamentet nuk rakordonin në kohë me njëra tjetrën për paraqitjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar.

Mbi auditimin e brendshëm:

Nga auditimi u konstatua se auditimi i brendshëm është krijuar më Urdhrin nr. 915 Prot., datë 29.04.2016 duke emëruar si specialiste e lartë auditimi znj. L.K. Auditimi i brendshëm ka funksionuar në Spitalin Rajonal Durrës vetëm me 1 punonjës. Ekzistenca e vetëm një punonjësi, i cili rezulton të jetë e çertifikuar si auditues i brendshëm, gjithashtu auditimi i brendshëm si strukturë është në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: “3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”. U konstatua se për vitin 2015, nuk ka pasur zyrë auditimi të brendshëm në Spitalin Rajonal Durrës në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

U konstatua se auditimi i brendshëm në Spitalin Rajonal Durrës për vitin 2016, në bashkëpunim me Titullarin e këtij institucioni z. A..në mbështetje të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, datë 29.09.2010, miratoi Planin e Punës për 6 mujorin e II-të të vitit 2016, me shkresën nr.1347 prot., datë 28.06.2016. Më konkretisht, rezulton se janë realizuar auditimet në subjektet e mëposhtme:

- Shërbimi Spitalor Farmacia
- Sektori Financës

Me urdhrin nr. 2429/2 prot., dt 25.11.2016, u auditua harxhimi i Oksigjenit Gaz për nevojat spitalore, për një periudhë kohore Shtator-Nëntor 2016.

U konstatua se auditimi i brendshëm me një grup specialistesh ka zhvilluar auditim të përputhshmërisë në shërbimin spitalor (Pavionet e Pediatrisë, Urgjencës, Infektivit të madh) mbi evidentimin e harxhimit të oksigjenit gaz për 3 furnizimet e fundit, Tetor-Nëntor 2016.

-Janë lënë këto rekomandime për përmirësimin e sistemit, më konkretisht 12 rekomandime me karakter organizativ për përmirësimin e sistemit, 4 janë rekomandime të zbatuara dhe 8 në proces zbatimi.

U konstatua se auditimi i brendshëm në Spitalin Rajonal Durrës për vitin 2017, në bashkëpunim me Titullarin e këtij institucioni Z. A.R., në mbështetje të Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, datë 29.09.2010, miratoi Planin e Punës për vitin 2017, me shkresën nr. 2157 prot, datë 20.10.2016. Konkretisht, rezulton se janë realizuar auditime në subjektet e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

- Shërbimi Spitalor Farmacia,
- Shërbimi Obsetrik-Gjinekologjik,
- Sektori Teknik dhe
- Sektori Burimeve Njerëzore.

Me urdhrin nr. 755 prot., datë 07.04.2017, u auditua mbi shpenzimet e karburantit për automjetet dhe gjeneratorët, zbatimi i normativave, dokumentacioni justifikues etj.

-Auditi i brendshëm ka audituar 4 subjekte dhe ka dhënë 13 rekomandime me karakter organizativ për përmirësimin e sistemit, 4 janë rekomandime të zbatuara dhe 9 në proces zbatimi.

U konstatua se auditimi i brendshëm në Spitalin Rajonal Durrës për vitin 2018, në bashkëpunim me Titullarin e këtij institucioni në mbështetje të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, miratoi Planin e Punës për vitin 2018, me shkresën nr. 2048/1 prot., datë 20.10.2017.

Konkretisht, rezulton se janë realizuar auditime në subjektet e mëposhtme:

- Shërbimi Spitalor Farmacia
- Shërbimi Kirurgjia
- Sektori i Financës
- Sektori Teknik

Në shërbimin e kirurgjisë u auditua me grup pune të përbërë mjekë, k/infermierë, farmacistë.

Auditimi i brendshëm ka audituar 4 subjekte dhe ka dhënë 15 rekomandime me karakter organizativ për përmirësimin e sistemit, 8 janë rekomandime të zbatuara dhe 7 në proces zbatimi.

U konstatua se nga mos plotësimi i kriterëve ligjorë, auditimi është kryer me grup pune të përbërë nga punonjës të brendshëm të SRD-së me në krye znj. K. në kundërshtim me ligjin për auditin e brendshëm.

U konstatua se deklaratat e pavarësisë për kryerjen e auditimit nuk janë plotësuar asnjëherë.



III.10. Përdorimi i regjistrit mbarëkombëtar të shëndetësisë elektronike

Titulli i gjetjes: Përdorim në nivele mjaft të ulta i sistemit të regjistrit elektronik

Situata: Në Spitalin Rajonal Durrës janë instaluar pajisjet për sistemin “E-health” në periudhën 09.02.2016 deri 13.10.2016, pajisje të cilat shërbejnë për të modernizuar dhe për të përmirësuar kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore (Pra u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Çka do të thotë që çdo qytetar që paraqitet në dyert e këtij spitali, ka të informatizuar të gjithë të dhënat e vizitës dhe përmbledhjen e daljes në çdo spital tjetër ku është vizituar apo kuruar).

Nga auditimi u konstatua se nga Spitali Rajonal Durrës nuk janë marrë masat e nevojshme për vënien në efikasitet të këtij projekti me kosto fillestare implementimi prej 13,995,000 euro për buxhetin e shtetit, me një kosto të drejtpërdrejtë për Spitalin Rajonal Durrës prej 33,708,767 lekë (pa llogaritur këtu koston e trajnimeve për stafin). Ky përfundim, nga ana e grupit të auditimit vjen si pasojë e konstatimit të hedhjes mjaft të ulët të të dhënave të pacientëve në regjistrin elektronik, në krahasim me regjistrat e mbajtur në mënyrë manuale, e shprehur në përqindje vetëm 0.87%% (4576 regjistrime në sistem nga 527127 regjistrime në regjistër).

Mos vënia plotësisht në punë e këtij sistemi me vlerë investimi 33,708,767 lekë për Spitalin Rajonal Durrës, nuk ka përmbushur objektivat e këtij investimi, që ka të bëjë me modernizimin dhe përmirësimin e kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore.

Kriteri: Projekti “Regjistrimi Elektronik Shëndetësor Kombëtar” me numër kontrate ALB2012 e-Health.

Ndikimi/efekti: Masat e marra për vënien në punë të këtij sistemi nuk kanë justifikuar kryerjen e këtij investimi.

Shkaku: Nuk janë hedhur të gjitha rekordet e regjistrave në sistemin elektronik

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të analizojë arsyet që kanë çuar në përdorimit në nivel kaq të ulët të sistemit të implementuar nga projektit “Regjistrimi Elektronik Shëndetësor Kombëtar”, vetëm 0.87%, nivel i cili nuk justifikon kryerjen e këtij investimi, si dhe të marrë masat e nevojshme për vënien në përdorim të këtij sistemi me qëllim përmbushjen e misionit të këtij projekti i cili i shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Në Spitalin Rajonal Durrës janë instaluar pajisjet për sistemin “E-health” në periudhën 09.02.2016 deri 13.10.2016, pajisje të cilat shërbejnë për të modernizuar dhe për të përmirësuar kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore (Pra u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Çka do të thotë që çdo qytetar që paraqitet në dyert e këtij spitali, ka të informatizuar të gjithë të dhënat e vizitës dhe përmbledhjen e daljes në çdo spital tjetër ku është vizituar apo kuruar).

Deri më datën 29.03.2019, datë në të cilën ka përfunduar auditimi, këto pajisje nuk janë vënë plotësisht në funksion.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Mos vënia plotësisht në punë e këtij sistemi me vlerë investimi **33,708,767 lekë** për Spitalin Rajonal Durrës, *nuk ka justifikuar kryerjen e këtij investimi*, që ka të bëjë me modernizimin dhe përmirësimin e kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore.

Në opinionin tonë:

Nga Spitali Rajonal Durrës nuk është trajtuar seriozisht implementimi i projektit “Shëndetësia elektronike”, duke mos e monitoruar pothuajse asnjëherë situatën dhe ecurinë e projektit, e cila është në një gjendje mjaft shqetësuese.

Këto pajisje janë përfituar nëpërmjet projektit “Regjistrimi Elektronik Shëndetësor Kombëtar” me numër kontrate ALB2012, miratuar me ligjin nr. 69/2014 datë 03.07.2014, ku është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë, marrëveshja e kredisë së eksportit si hua e butë me nr. 232,324 për një shumë maksimale prej 13,995,000 euro. Palët në këtë marrëveshje janë: Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave e cilësuar si “Huamarrës” dhe U. A. AG e cilësuar si “Huadhënës”.

Në zbatim të projektit “Regjistrimi Elektronik Shëndetësor Kombëtar” me numër kontrate ALB2012 e-Health, spitalet, ambulancat, urgjencat si dhe pavionet e tjera janë pajisur me pc dhe mjete të tjera elektronike me program të veçantë për regjistrimin elektronik të të dhënave të vizitave të pacientëve si dhe regjistrimin e daljes pasi pacienti merr diagnozën apo kurën. Ky program është parashikuar të përmirësojë vendimmarrjen mjekësore dhe koordinojë kujdesin ndaj pacientit; do të risi efikasitetin e sistemit, kontrollojë kostot, përmirësojë kujdesin shëndetësor. E-Health do të shërbejë si një aset në funksion të planit strategjik afatgjatë të vendit për modernizimin dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor.

Rekordi Elektronik Shëndetësor Kombëtar ruan të dhënat e pacientëve duke mundësuar përditësimin e tyre në kohë reale dhe do të sigurojë një akses të sigurt për profesionistët e kujdesit shëndetësor në të gjithë vendin. Ai lehtëson dhe siguron shkëmbimin në kohë reale të informacionit shëndetësor në të gjithë Shqipërinë.

Produktet qëllim i këtij projekti janë:

1. Rekorde elektronike mbarëkombëtare të krijuara
2. Informacion mjekësor i integruar në të gjithë ofertuesit
3. Pasja e një historiku mjekësor për çdo pacient

Në përfundim të projektit pritet që çdo individ në Shqipëri të ketë dosjen e tij elektronike shëndetësore të aksesueshme në mënyrë elektronike nga 79 institucionet shëndetësore në vend (spitale dhe poliklinika). Ky sistem do të lidhet me çdo sistem informatik tjetër shëndetësor që do të implementohet në vendin tonë, duke mundësuar kështu një dosje elektronike të plotë unike për çdo pacient.

Institucionet e parashikuara për tu përfshirë në këtë sistem janë të gjithë spitalet rajonale, spitalet e rretheve, spitalet universitare dhe të gjitha poliklinikat e rretheve, pra në total një numër rreth 79 institucione të ofrimit të kujdesit shëndetësor. Komponentët e projektit janë: Hardëare, Softëare dhe Licenca, Trajnime. Një nga këto site është edhe Spitali Rajonal Durrës. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Spitalit Rajonal Durrës, vlera e pajisjeve që janë dorëzuar në këtë spital është **33,708,767 lekë**.

Nga auditimi u konstatua se nga Spitali Rajonal Durrës nuk janë marrë masat e nevojshme për vënien në efikasitet të këtij projekti me kosto fillestare implementimi prej 13,995,000 euro për buxhetin e shtetit, me një kosto të drejtpërdrejtë për Spitalin Rajonal Durrës prej **33,708,767 lekë** (pa llogaritur këtu koston e trajnimeve për stafin). Ky përfundim, nga ana e grupit të auditimit vjen si pasojë e konstatimit të hedhjes mjaft të ulët të të dhënave të pacientëve në regjistrin elektronik, në krahasim me regjistrat e mbajtur në mënyrë manuale, e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

shprehur në përqindje vetëm 0.87%% (4576 regjistrime në sistem nga 527127 regjistrime në regjistër).

Më poshtë paraqiten të dhënat e hedhura në sistem dhe të dhënat e mbajtura në regjistrat të marra nga përfaqësuesit e statistikave të spitalit:

Viti	Të dhënat e rregjistrave fizik	Të dhënat elektronike	Në %
2017	266838	2718	1
2018	260289	1858	0.7
Total	527127	4576	0.87

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se në për vitin 2017 janë hedhur 2718 rekorde nga 266838 që duhet të ishin hedhur, ose 1 %. Për vitin 2018 janë hedhur 1858 rekorde nga 260289 ose 0.7 %. Pra konstatohet se përqindja e popullimit të këtij sistemi ka ardhur në ulje edhe pse normalisht duhet të kishim një tendence të kundërt.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 107/21 prot., datë 04.12.2015, rezultoi se:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 2 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 2 masa dhe nga këto masa, është zbatuar 1 masë dhe në proces 1 masë.
- b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 14 masa në vlerën 3,179,734 lekë nga të cilat janë pranuar plotësisht 14, nga të pranuarat, janë në proces 13 masa në vlerën 2,936,134 lekë dhe 1 masë në vlerën 243,600 lekë është zbatuar pjesërisht.
- c. Janë rekomanduar sipas Kodit të Punës 3 masa disiplinore, prej të cilave janë zbatuar 3 masa disiplinore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 6-13, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1-Rekomandimi: Nga Spitali Rajonal Durrës, të merren masa për kryerjen e një analize për evidentimin e përgjegjësive për mos realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i të KLSH-së të cilat kanë rezultuar në proces dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të tyre, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra si dhe zbatimi i tyre, rezultoi se:

-Bordi i Spitalit Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar pa Rregullore të brendshme në kundërshtim me nenin 12, pika (m) të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit të Durrësit në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”.

-Për vitin 2015, Bordi i Spitalit në vendimet e tij nuk pasqyron votat e bordit, konkretisht në çdo vendim bordi pasqyrohet firma e Kryetarit të Bordit, por nuk ka gjurmë vendimmarrje të gjithë anëtarëve të Bordit, në kundërshtim me nenin 9 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, përcaktuar në VKM nr. 237, datë 12.04.2006.

-Për periudhën objekt auditimi, nuk konstatohet të ketë një kontratë midis titullarit dhe Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës ku të përcaktohen objektivat specifike dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të SRD, në kundërshtim me nenin 13 të statutit të Spitalit Rajonal Durrës, i cili përcaktohet në VKM nr. 237, datë 12.04.2006 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1-Rekomandimi: Bordi i Spitalit të marrë masat për hartimin e një rregullore mbi funksionimin e Bordit të Spitalit Rajonal Durrës ku të përcaktohen qartë detyrat, modalitetet e mbledhjeve dhe qartësia e diskutimeve mbi vendimmarrjen e këtij organi kolegjal, në përputhje me statutin e SRD, si dhe të merren masa për hartimin e një kontrate apo rregulloreje, ku të përcaktohen objektivat specifike me detyrat dhe përgjegjësitë midis Bordit Drejtues dhe titullarit të SRD.

Brenda datës 31.12.2019

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në Spitalin Rajonal Durrës, *nuk janë implementuar plotësisht procedurat për respektimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga ana e subjektit nuk u paraqit asnjë dokument ligjor të nxjerrë nga Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2016 në kundërshtim me ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Grupet e menaxhimit strategjik janë ngritur rregullisht çdo vit por nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor që grupi i menaxhimit strategjik të ketë zhvilluar mbledhje për diskutimin e çdo komponenti për të zbatuar ligjin për Menaxhimin Strategjik dhe Financiar. Pra rezulton se Grupet e menaxhimit strategjik, janë formale.

-Nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave. Shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit nuk funksionojnë mirë si në mënyrë shkresore dhe elektronikisht, kjo gjë rezultoi edhe gjatë auditimit pasi departamentet nuk rakordonin në kohë me njëra tjetrën për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar brenda afateve të përcaktuara më parë.

-Nga auditimi në lidhje me funksionimin e auditit të brendshëm, rezultoi se audit i brendshëm është krijuar më Urdhrin nr. 915 Prot., datë 29.04.2016, duke funksionuar me vetëm 1 punonjës. Nga mos plotësimi i kriterëve ligjore për numrin e njësisë së auditit të brendshëm, audit i brendshëm është kryer me grup pune të përbërë nga punonjës të brendshëm të SRD-së, ku kanë zhvilluar auditim të përputhshmërisë në shërbimin spitalor (Pavionet e Pediatriisë, Urgjencës, Infektivit të madh). Kryerja e auditit të brendshëm me punonjës jashtë strukturës së AB, është kryer në kundërshtim me ligjin për auditin e brendshëm, për arsye se nuk siguron pavarësinë e plotë të auditimeve të kryera, si dhe nuk rezulton të jenë plotësuar deklaratat e pavarësisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 139-147, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1-Rekomandimi: Nga Drejtoria Spitalit Rajonal Durrës, të merren masa për të implementuar sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim rritjen e kontrollit vertikal të SRD për dhënien e sigurisë së arsyeshme në veprimtarinë ekonomiko-financiare të tij.

Vazhdimisht

3.2-Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa për plotësimin e zyrës së auditit të brendshëm, me qëllim dhënien e sigurisë objektive dhe për përmirësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Spitalit Rajonal Durrës.

Brenda datës 30.06.2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave me bankë për muajt mars, gusht dhe dhjetor, të viteve 2015 – 2018, rezultuan praktika të cilat nuk disponojnë dokumentacionin e plotë justifikues, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36. Saktësisht:

-Për vitet 2016-2017 janë kryer tërheqje për pagesa ndaj dhuruesve të gjakut, si dhe tërheqje për mbulimin e shpenzimeve të transportit të sëmurëve me dializë, por bashkëlidhur mandatit nuk është dokumentacioni i nevojshëm justifikues.

-Në praktikat e likuidimit të pagesave ndaj OE për kontratën me objekt: “Blerje oksigjeni gaz për SRD”, rezultoi se mungon kërkesa e Autoritetit Kontraktor për lëvrimin e mallit, duke mos dhënë siguri mbi zbatimin me korrektësi të kontratës nga operatori ekonomik, në kundërshtim me nenin 18.3 të kontratës të furnizimit ku citohet se lëvrimi do të bëhet me kërkesë të AK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Në datën 06.03.2017, është akorduar pagesë në vlerën bruto 57,860 lekë për punonjësen S.K. Nga të cilat vlera neto 50,338 lekë dhe tatim në burim 7,522 lekë. Konstatohet se për këtë shpërblim nuk janë mbajtur sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu për këtë pagesë nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1-Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masa që në të ardhmen praktikat e pagesave që kryhen në bankë, të plotësohen me dokumentacionin e plotë justifikues me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme në kryerjen me korrektësi të transaksioneve.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Përgjegjësja e Financës, njëkohësisht nëpunëse zbatuese në Spitalin Rajonal Durrës, ka qenë pjesë e komisioneve të vlerësimit të ofertave, njësi prokurimi dhe/ose komision për përcaktimin e fondit limit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, gërmat a dhe e (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1-Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës në vijimësi të marrë masa për mos përcaktimin e nëpunësit zbatues/përgjegjës e financës në komisione të vlerësimit të ofertave, njësi prokurimi, komisione të përcaktimit të fondit limit si dhe në çdo grup pune, i cili më pas është objekt i verifikimit nga vetë përgjegjësi i financës. Ky veprim do të shërbejë për uljen e riskut e mungesës së kontrollit mbi transaksionet e Spitalit Rajonal Durrës, si dhe për dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi kontrollin vertikal.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i **20 dosjeve të personelit të Spitalit Rajonal Durrës**, konstatohet se në përgjithësi ka mangësi dokumentacioni referuar kontratave të punës të cilat në **11 dosje** mungojnë, në kundërshtim me nenin 13 dhe 21 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i ndryshuar. Gjithashtu në 11 dosje nuk konstatohet noterizimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e SRD dhe në dosje ndodhet vetëm kopja e certifikatave të kualifikimit, si rrjedhojë regjistrat themeltarë të shoqërisë nuk janë të plotësuar me të dhënat identifikuese të punonjësve, data e fillimit të punës, arsimi profesional, kurset e ndryshme të kryera, paga mujore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1-Rekomandimi: Nga sektori i burimeve njerëzore të Spitalit Rajonal Durrës të merren masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të dhënat identifikuese të punonjësve, data e fillimit të punës, arsimi profesional, kurset e ndryshme të kryera, paga mujore dhe noterizimi i certifikatave dhe trajnimeve të ndryshme kualifikuese.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Nëntor-Dhjetor 2016, Janar-Dhjetor 2017, Janar-Maj 2018, për 20 mjekë pediatër të angazhuar me kohë të pjesshme në Spitalin Rajonal Durrës, janë paguar në total me pagë bruto në vlerën 728,992 lekë, me pagë neto total në vlerën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

619,643 lekë dhe është mbajtur tatimi në burim në vlerën totale 109,349 lekë. Për këto pagesa nuk janë llogaritur sigurimet shoqërore, në kundërshtim me nenin 6 i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1-Rekomandimi: Nga drejtoria dhe sektori i financës të merren masa për llogaritjen e sigurimeve shoqërore për punonjësit me kohë të pjesshme që kanë punuar pranë Spitalit Rajonal Durrës në periudhat e sipërcituara, duke i identifikuar rast pas rasti, në bazë të kontratave të përkohshme që këto punonjës lidhin me SRD.

Brenda datës 31.12.2019

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2015, rezultoi se llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, ka gjendje vlerën 1,016,375 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat u mbahen operatorëve ekonomik si garanci për kontratat e nënshkruara. Kjo shumë rezulton ende e pa tërhequr, edhe pse nga verifikimi analitik i kësaj llogarie, kjo vlerë i përket viteve 2006, 2007 dhe 2011. Nga Spitali Rajonal Durrës edhe pse kanë kaluar disa vite, nuk janë marrë masat e nevojshme për sistemimin e vlerës 1,016,375 lekë nga kjo llogari, pasi garancia duhet të shlyhet ndaj operatorëve ekonomik ose të kalojë në favor të autoritetit kontraktor me përfundimin e afatit të garancisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1-Rekomandimi: Titullari i Spitalit Rajonal Durrës dhe Bordi Drejtues të marrin masa për rialokimin e vlerës 1,016,375 lekë, e cila ka mbetur në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar”, pasi periudha e garancisë për këto raste ka përfunduar.

Brenda datës 31.12.2019

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pronave të Spitalit Rajonal Durrës, rezultoi se në aktivet e SRD figurojnë 8 godina dhe disponohet edhe një pjesë të godinës së ish-befotrofit pa qenë në inventarin e objekteve. Shumica e godinave janë të ndërtuara para vitit 1990 dhe si pasojë në ZRPP Durrës, ka mungesa të theksuara të dokumentacionit teknik mbi sipërfaqet e ndërtimit të tyre. Nga ana e strukturave drejtuese të SRD nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për pajisjen me të gjithë dokumentacionin hipotekor të saktë të Spitalit Rajonal Durrës, veprim i cili mbart risk potencial në cënimin e pronës publike që administrohet nga ky spital (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1-Rekomandimi: Titullari i Spitalit Rajonal Durrës të marrë masat e nevojshme për përfundimin e regjistrimit të pronave në ZRPP me qëllim pajisjen me dokumentacionin e plotë hipotekor, me qëllim përcaktimin e saktë të vlerës së aktiveve të spitalit.

Brenda datës 31.12.2019

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në magazinën e farmacisë së spitalit u gjendën 7 flakona Dopaminë 50 mg/10ml (*medikament i cili kategorizohet si drogë e fortë*), të bërë hyrje me fletë hyrje nr. 364, datë 02.11.2018, të cilët janë kaluar nga Spitali i Përmetit, për shkak të tepërive të këtij të fundit. Këto flakona kanë datë skadence 11/2018, pra në momentin e hyrjes, kanë qenë të skaduara. Këto flakona janë bërë dalje me fletëdalje nr. 6579, datë 12.11.2018, sasia 5 copë, dhe nr. 6663, datë 16.11.2018, sasia 2 copë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Aktualisht, edhe pse në gjendja kontabël është zero, gjendja fizike e tyre është 7, të cilat janë të skaduara.

Grupi i auditimit e vlerëson këtë situatë me risk mjaft të lartë, për arsye se:

-Janë bërë hyrje medikamente të skaduara, madje në këtë rast kemi të bëjmë me medikamente të rëndësishme të lartë.

-Janë kryer veprime kontabël në mënyrë të pa argumentuara, pasi këto flakona vazhdojnë të jenë në magazinën e spitalit, madje në gjendje të skaduara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 “Për Miratimin E Rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”” (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1-Rekomandimi: Titullari i Spitalit Rajonal Durrës të analizojë situatën e krijuar në lidhje me barnat e rëndësishme të lartë, të vlerësojë arsyet duke nxjerrë përgjegjësitë individuale si dhe marrë masat e nevojshme administrative.

Brenda datës 31.12.2019

11.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit të kontratave, rezultoi se:

Spitali Rajonal Durrës për periudhën 01.01.2015-31.12.2018, ka zhvilluar gjithsej 309 procedura prokurimi me vlerë 1,518,599 mijë lekë.

Nga 309 procedura të zhvilluara, 238 procedura (**77% të tyre**) janë zhvilluar ana nga Ministria e Shëndetësisë, si Blerje e Përqendruar dhe/ose Marrëveshje Kuadër, ndërsa 71 procedura janë zhvilluar nga Spitali Durrës.

Nga këto procedura janë përzgjedhur për tu audituar, 37 procedura (**52% ndaj totalit**) prokurimi me vlerë 299,898 mijë lekë.

Nga auditimi rezultuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të tenderimit, zhvillimit të procedurave të tenderimit dhe zbatimit të kontratave, kryesisht si më poshtë vijon:

-Dosjet e procedurave të zhvilluara nuk janë të arkivuara, por mbahen në zyrat e sektorit të prokurimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13.

-Nuk janë kryer trajnime të stafit që bëjnë pjesë e komisioneve të caktuara në procedurat e prokurimeve publike, çka ka rezultuar në mos kuptimin e plotë të legjislacionit të prokurimit publik nga këta punonjës, kryesisht stafi mjekësor.

-Në të gjitha rastet e audituara nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në procedurën e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Peditrisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me vlerë kontrate 166,660,826.5 lekë pa TVSH, përlllogaritja e vlerës së kontratës është kryer në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 28.

-Në 3 raste janë vendosur kërkesa dhe kriteret për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26.

-Në 2 raste, procesi i vlerësimit është kryer në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

-Në 2 raste, Raporti Përmbledhës është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 68.

-Në 1 rast, formulari i njoftimit të nënshkrimit të kontratës, është dërguar 9 muaj me vonë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 25, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.2. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës” me vlerë kontrate 166,660,826.5 lekë pa TVSH, rezultoi se Formulari i paraqitur me nr. 1 “Oferta ekonomike”, është përcaktuar se vlera e pajisjeve pa tvsh është 56,450,298 lekë, tatimi në vlerën e shtuar në vlerën 11,290,059.6 lekë, dhe shuma totale në vlerën 67,740,357.6 lekë. Pra B. E.-A.SHPK & V. K.SHPK & M. SHPK, ka ofertuar pajisjet me tvsh në vlerën 11,290,059.6 lekë, e cila në rast kualifikimi do përbënte dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit, e për pasojë oferta me të drejtë nuk duhej kualifikuar, edhe pse ky fakt nuk është përmendur në argumentet me anë të të cilave KVO e ka skualifikuar këtë OE.

Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës” me vlerë kontrate 166,660,826.5 lekë pa TVSH, në vlerën e përllogaritur të kontratës është vendosur vlera e TVSH së pajisjeve në shumën 17,659,428 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, kreu I, germa A. Duke qenë se në procedurën e prokurimit është përdorur vlera pa TVSH, nuk ka patur efekte financiare nga kjo përllogaritje (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1-Rekomandimi: Nga titullari i AK, të merren masa për kryerjen e trajnimeve të nevojshme për punonjësit që janë pjesë të komisioneve të procedurave të prokurimit publik, me qëllim sigurimin e një procesi sa më transparent në përmbushje të qëllimit të LPP.

Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave ligjore në lidhjen e kontratave të qirasë, rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë lidhur gjithsej 29 kontrata qiradhënie. Këto kontrata janë lidhur nga vetë spitali, duke qenë se janë për sipërfaqe më të vogël se 200 m². Kontratat e qiradhënies janë me afat 1 vjeçar, e si të tilla shumica e tyre janë ripërtëritë çdo vit. Nga auditimi i këtyre kontratave, rezultoi se:

-Në të gjitha rastet, nuk konstatohet dokumentacioni i dhënies me qira të objektit.

-Në të gjitha rastet, nuk konstatohet dokumentacioni i marrjes me qira të objektit nga poseduesit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu II, pika 1 dhe pika 7 dhe Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 119-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1-Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, të merren masa që përpara lidhjes së kontratave të reja të qiradhënies, të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për ambientet e dhëna me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

qira nga Spitali dhe Operatorët Ekonomikë të interesuar për marrjen me qira të ambienteve të spitalit.

Vazhdimisht

13. Gjetje nga auditimi: Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrisë të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate koncesionare, rezultoi se:

Kontrata pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, nuk disponohet e plotë nga SRD, e për pasojë e bën të pamundur monitorimin e kësaj kontrate koncesionare, për arsye se mungojnë ose janë të paplota Aneksët e mëposhtme:

-Aneksi 4 - Klasat e kompleksitetit ose intensiteti i ndërhyrjes kirurgjikale, nuk është i firmosur nga asnjë palë, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 5 - Lista e aseteve që do të kthehen Autoritetit, nuk është i firmosur nga asnjë palë, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 6 - Kontrate për financimin e shërbimit: Kjo kontratë nuk ka datë, nuk është e firmosur dhe vulosur nga asnjë palë, por është thjesht një draft në rrugë elektronike, e për pasojë nuk ka fuqi juridike si dokument.

-Aneksi 9 - Lista e çdo instrumenti me çmimet përkatëse, Aneksi 9 - Lista e çdo instrumenti me çmimet përkatëse (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 119-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1-Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të plotë origjinal të kontratës e Koncesionimit pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”.

Brenda datës 31.12.2019

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se OE S.S. SHPK, nuk ka dorëzuar pranë SRD dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:

-Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese.

-Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore.

-Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore.

-Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë “Dokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshme”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”” dhe VKM nr. 371, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

11.06.2007 (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 119-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1-Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës, të merren masa për plotësimin nga Koncensionari S.S. SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Brenda datës 31.12.2019

15. Gjetje nga auditimi: Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokollit, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrisë të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate koncesionare, rezultoi se:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se data e instalimit të Koncensionarit në ambientet e SRD është data 15.03.2018, ndërsa data e fillimit të kontratës koncesionare është data 16.03.2018.

Sipas kontratës së lidhur, e konkretisht Aneksit 3 “Projekti Teknik”, Kapitulli 1-2 (2.3.1 Projekti teknik Kap_1-2_Përshkrimi _Grafiku_Pjesa 1 nga 6), punimet duhej të fillonin në fillim të vitit 2017 (viti i dytë, faqe 22).

Vonesa e pa argumentuar me 1 vit e fillimit të zbatimit të kësaj kontrate koncesionare, përbën rast të mos përmbushjes së kushteve të kontratës nga Koncensionari, sipas nenit 29 të kësaj kontrate.

Sipas Koncensionarit vonesa në fillimin e zbatimit të kësaj kontrate në Spitalin e Durrësit, ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të ndërhyrjeve kirurgjikale në qendrat spitalore të qytetit të Tiranës (në krahasim me ato të parashikuara në dokumentet e koncesionit), ku si pasojë ka qenë e nevojshme riprogramimi i kapaciteteve të qendrave të sterilizimit dhe Back-up spitalet e qytetit të Tiranës duke realizuar punime ndërtimi shtesë dhe furnizime me pajisje shtesë (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 119-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1-Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa për kryerjen e një analize, ku të përcaktohen arsyet, shkaqet, pasojat, si dhe të nxirren përgjegjësitë për vonesën e pa argumentuar të fillimit të zbatimit të kësaj kontrate koncesionare.

Vazhdimisht

16. Gjetje nga auditimi: Në Spitalin Rajonal Durrës janë instaluar pajisjet për sistemin “E-health” në periudhën 09.02.2016 deri 13.10.2016, pajisje të cilat shërbejnë për të modernizuar dhe për të përmirësuar kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore.

Nga auditimi rezultoi se nga Spitali Rajonal Durrës nuk janë marrë masat e nevojshme për vënien në efikasitet të këtij projekti me kosto fillestare implementimi prej 13,995,000 euro për buxhetin e shtetit, me një kosto të drejtpërdrejtë për Spitalin Rajonal Durrës prej 33,708,767 lekë (pa llogaritur këtu koston e trajnimeve për stafin). Ky përfundim, nga ana e grupit të auditimit vjen si pasojë e mos funksionimit me efikasitet të procesit të regjistrimit të të dhënave të pacientëve në regjistrin elektronik, në krahasim me regjistrat e mbajtur në mënyrë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

manuale, e shprehur në përqindje vetëm 0.87%% (4576 regjistrime në sistem nga 527127 regjistrime në regjistër).

Mos vënia plotësisht në punë e këtij sistemi me vlerë investimi 33,708,767 lekë për Spitalin Rajonal Durrës, nuk ka përmbushur objektivat e këtij investimi, që ka të bëjë me modernizimin dhe përmirësimin e kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor dhe shkëmbimit të informacioneve shëndetësore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 148-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1-Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Rajonal Durrës të analizojë arsyet që kanë çuar në mos përdorimin e plotë të sistemit të implementuar nga projekti “Regjistrimi Elektronik Shëndetësor Kombëtar” dhe të raportohet pranë MSHMS, si dhe të marrë masat e nevojshme për vënien në përdorim të këtij sistemi me qëllim përmbushjen e misionit të këtij projekti i cili i shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Brenda datës 31.12.2019 dhe Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje aksesore dhe riparim aparaturash mjekësore në lote për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratës nr. 1502/18 prot, datë 13.11.2017, lidhur me OE B. A. SHPK rezultoi se, shërbimi është realizuar me 7 ditë me vonesë, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej 132,492 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1-Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 132,492 lekë nga operatori ekonomik “B. A. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje aksesore dhe riparim aparaturash mjekësore në lote për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratës nr. 1502/13 prot, datë 09.11.2017, lidhur me OE F. SHPK, rezultoi se, mallrat nuk janë lëvruar brenda afateve të përcaktuara në kontratë, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej 243,368 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit nga SRD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1-Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 243,368 lekë nga operatori ekonomik “F. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje medikamente mjekësore për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratave nr. 989/2 prot, nr. 992/2 prot, dhe nr. 787/3 prot, datë 08.05.2017, lidhur me OE E. SHPK, rezulton se, dorëzimi i mallrave është realizuar me vonesë, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën prej 117,465 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit nga SRD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1-Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 117,465 lekë nga operatori ekonomik “E. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje medikamente mjekësore për Spitalin Rajonal Durrës”, sipas kontratave nr. 991/4 prot, dhe nr. 815/3 prot, datë 09.05.2017, lidhur me OE A. SHPK, konstatohet se, dorëzimi i mallrave është realizuar me vonesë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej 48,079 lekë për SRD, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës dhe mos mbajtjes së penaltetit nga SRD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1-Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 48,079 lekë nga operatori ekonomik “A. shpk” shpk. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatet maksimale të realizimit të kontratës.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me konsumin e karburantit për Gjeneratorin e Kirurgjisë për vitet periudhën 01.01.2015-31.12.2018, rezultoi se normativa e konsumit të karburantit për gjeneratorin e kirurgjisë, për vitet 2015-2017, është 48.6 litër/orë punë, ndërsa për vitin 2018, është 27.4, vlerë e cila është në përputhje me normativën e parashikuar në katalogun e gjeneratorit. Përlllogaritja e normativës në kundërshtim me katalogun, ka sjellë një rritje të pa argumentuar të sasisë së karburantit të konsumuar për këtë gjenerator me 4,770 litra naftë, e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale 788,773.6 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD. Gjithashtu, sipas Relacionit nr. 316, datë 30.01.2018, të Degës Teknike, në bashkëpunim me OSHEE SHA, ka përcaktuar se për vitin 2017, koha reale e ndërprerjes së energjisë elektrike është 33 orë, dhe jo 90 orë sa është pasqyruar në pasqyrat e konsumit vjetor të karburantit. Për pasojë është rritur në mënyrë të pa argumentuar koha e punës së gjeneratorit me 57 orë, dhe natyrshëm dhe sasia e konsumuar të karburantit me 2,770.2 litra naftë, e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale 478,413.5 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1-Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën 1,267,187.10 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në menaxhimin e konsumit të karburantit për gjeneratorin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Kirurgjisë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse për arkëtimin e kësaj shume, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me konsumin e karburantit për Gjeneratorin e Maternitetit për vitet periudhën 01.01.2015-31.12.2018, rezultoi se normativa e konsumit të karburantit për gjeneratorin e maternitetit, për vitet 2015-2018, ka pësuar ndryshime çdo vit, duke filluar nga normativa më e lartë 47 litra/orë punë dhe deri te normativa më e ulët në 32.7 litra/orë punë. Kjo nënkupton një përlllogaritje jo të saktë të kryer nga ana e grupeve të punës përkatëse, duke e rritur në mënyrë të pa argumentuar këtë normativë.

Grupi i auditimit në këtë rast ka marrë për bazë normativën e vitit 2016, e cila është normativa më e ulët e përlllogaritur. Në rast rillogaritje të konsumit real të periudhës 2015-2018, duke përdorur normativën e vitit 2016, konstatohet se ka një rritje të pa argumentuar të sasisë së karburantit të konsumuar për këtë gjenerator me 714.3 litra naftë, e cila e përkthyer me çmimin mesatar të karburantit për secilin vit, arrin në vlerën totale 111,564 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të SRD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1-Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën 111,564 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në menaxhimin e konsumit të karburantit për gjeneratorin e Kirurgjisë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse për arkëtimin e kësaj shume, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në magazinën e farmacisë së spitalit, rezultoi se:

-Në 3 raste kishte teprica në sasi të medikamenteve.

-Në 5 raste kishte mangësi në sasi të medikamenteve në vlerën 84,006 lekë (nga të cilat 3 medikamente konsiderohen si drogë e fortë).

Diferencat e rezultuara janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 89. Për pasojë vlera 84,006 lekë, që përbën vlerën e medikamenteve të munguara, përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 37-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1-Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën 84,006 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me diferencat e rezultuara në sasi fizike dhe kontabile të medikamenteve në Farmacinë e Spitalit Rajonal Durrës, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse për arkëtimin e kësaj shume, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës (Marrëveshjes Kuadër) nr. 1830, datë 05.09.2016 “Për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë së Spitalit Rajonal Durrës”, rezultoi se:

-Sipas kontratës së nënshkruar, afati i dorëzimit është brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, pra data e fundit e dorëzimit është data 16.03.2017. Për faturat nr. 501330, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

21.03.2017 dhe nr. 501337, datë 21.03.2017, afati i dorëzimit ka kaluar me 5 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar në vlerën 69,248 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

-Për faturën tatimore nr. 501360, datë 28.03.2017, me vlerë 68,630 lekë, afati i dorëzimit ka kaluar me 12 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar në vlerën 84,759 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

-Për faturën tatimore nr. 6541502505, datë 10.04.2018, me vlerë 610,590 lekë, afati i dorëzimit ka kaluar me 2 ditë, e për pasojë AK duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzim të vonuar në vlerën 4,885 lekë ($610,590 * 2 \text{ ditë} * 4/1000$), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1-Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 158,892 lekë, nga BOE T. SHPK dhe L. SHPK, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës (Marrëveshjes Kuadër) nr. 1830, datë 05.09.2016 “Për furnizimin me materiale mjekësore për shërbimin e ortopedisë së Spitalit Rajonal Durrës”, rezultoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, e konkretisht procesverbaleve të marrjes në dorëzim, në mungesë të verifikimit fizik të mallrave, për arsye se nga deklarimi verbal i drejtuesve të spitalit dhe drejtuesve të shërbimit të ortopedisë, këto materiale janë konsumuar të gjitha, konstatohet se për materialin e mjekimit “Cementi kockorë”, të sjellë me anë të faturës tatimore nr. 6541502505, datë 10.04.2018, me vlerë 68,630 lekë dhe me anë të faturës tatimore nr. 6541502143, datë 31.10.2017, me vlerë 68,630 lekë, origjina e këtij materiali është Fabrika M. në Poloni, ndërsa sipas kontratës duhej të ishte fabrika B., Zvicër.

Si rezultat i kësaj, arrihet në përfundimin se BOE T. SHPK dhe L. SHPK, nuk ka sjellë materialet në përputhje me kontratën e nënshkruar, e për pasojë vlera e materialit të mjekimit “Cementi kockorë” në shumën 137,260 lekë, përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1-Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 137,260 lekë, nga BOE T. SHPK dhe L. SHPK, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 911/7, datë 14.06.2017 “Blerje medikamente”, rezultoi se:

-Nga verifikimi i faturave tatimore dhe kontratës së lidhur, konstatohet se për faturën tatimore nr. 2172, datë 28.06.2017, me vlerë 19,200 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 40,800 lekë, e në fakt është sasia e mallit me vlerë 21,600 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore të datës 01.12.2017, pra 156 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

për dorëzimin e vonuar të mallrave, në vlerën 15,912 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit.

-Ndërsa për faturën tatimore nr. 3063, datë 28.09.2017, me vlerë 6,000 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 40,800 lekë, por është sjellë më pak në vlerën 34,800 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore të datës 01.12.2017, pra 140 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, në vlerën 14,280 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1-Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 30,192 lekë, nga OE I. SHPK, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 770/7, datë 05.05.2017 “Blerje medikamente”, lidhur me OE F. SHPK, rezultoi se:

-Për faturën tatimore nr. 8492, datë 27.06.2017, me vlerë 222,000 lekë, në zbatim të kontratës malli i sjellë duhej të ishte 20% e kontratës ose në vlerën 398,000 lekë, e në fakt është sjellë me vlerë 176,000 lekë. Pjesa e mbetur e mallit të kontraktuar është sjellë me anë të faturës tatimore nr. 3076, datë 11.07.2017, pra 37 ditë me vonesë. Për pasojë SRD duhej të llogariste dëmet e likuidueshme për dorëzimin e vonuar të mallrave, në vlerën 36,815 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1-Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 36,815 lekë, nga OE F. SHPK, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

12.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017 “Blerje Oksigjen lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, lidhur me OE M..SHPK, rezultoi se:

Me anë të 41 faturave tatimore, OE M. A. SHPK, i caktuar për zbatimin e kësaj kontrate sipas marrëveshjes së bashkimit të OE, ka sjellë në ambientet e Spitalit Rajonal Durrës sasinë prej 122,210 litra oksigjen të lëngshëm. Por sipas Aneksit nr. 2, të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017, sasia e kontraktuar është 122,240 litra oksigjen të lëngshëm. Nuk konstatohet arsyeja e mos dorëzimit të sasisë së kontraktuar, si dhe nga AK nuk janë marrë masa për konfiskimin e sigurimit të kontratës dhe njoftimin në APP për mos zbatimin e kontratës nga ky BOE. Për pasojë AK, duhet të konfiskonte sigurimin e kontratës nr. 46451579, datë 21.02.2017, me vlerë 1,711,360 lekë, si dhe të njoftonte APP për mos realizimin e kësaj kontrate nga ky OE (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017 “Blerje Oksigjen lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, rezultoi se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Në lidhje me sasinë, konstatohet se kontraktori M. A. SHPK, e sjell sasinë në kilogramë, sasia e cila për këtë kontratë është 139,442 kg ose 122,210 litra. Më pas sasia e sjellë në kilogramë, është konvertuar në litra nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe OE M. A. SHPK, sipas koeficientit 1.141 kg/lt. Por sipas Aneksit nr. 2, të kontratës nr. 433, datë 23.02.2017, koeficienti i konvertimit është 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), e si i tillë ky është koeficienti me të cilin duhej të përdorej nga kontraktori M. A. SHPK.

Nëse bëhen rilogaritjet me koeficientin 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), atëherë për sasinë 139,442 kg, sasia reale në litra e furnizuar nga kontraktori do jetë 104,294 lt oksigjen të lëngshëm.

Si konkluzion, nga përdorimi i koeficientit në kundërshtim me atë të përcaktuar në kontratë, kontraktori M. A. SHPK ka sjellë më pak 17,916 litra oksigjen të lëngshëm (122,210 lt – 104,294 lt), ose në vlerën 2,508,184 lekë (e konvertuar me çmimin 140 lekë/lt), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës (Marrëveshjes Kuadër) nr. 911/10, datë 23.04.2018 “Blerje Oksigjen lëng për Spitalin Rajonal Durrës”, rezultoi se:

Në lidhje me sasinë, konstatohet se kontraktori M. A. SHPK, e sjell sasinë në kilogramë, sasia e cila për këtë kontratë është 152,386 kg, deri më 31.12.2018. Më pas sasia e sjellë në kilogramë, është konvertuar në litra nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe OE M. A. SHPK, sipas koeficientit 1.141 kg/lt. Duke qenë se në Kontratën nr. 1 të Furnizimit nr. 1198/8, datë 11.05.2018, nuk përcaktohej koeficienti i konvertimit nga kilogramë në litra që do përdoret, grupi i auditimit i referohet koeficientit 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), të përdorur në kontratën nr. 433, datë 23.02.2017.

Për pasojë, nëse bëhen rilogaritjet me koeficientin 1,337 g/lt (1.337 kg/lt), atëherë për sasinë 152,386 kg, sasia reale në litra e furnizuar nga kontraktori do jetë 113,976 lt oksigjen të lëngshëm.

Si konkluzion, nga përdorimi i koeficientit të pamiratur, kontraktori M. A. SHPK ka sjellë më pak 19,579 litra oksigjen të lëngshëm (133,555 lt – 113,976 lt), ose në vlerën -2,682,288 lekë (e konvertuar me çmimin 137 lekë/lt), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për llogari të Buxhetit të Shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1-Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit dhe Sektori Juridik, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 5,190,472 lekë, nga OE M.A. SHPK, për arsye se kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

12.2-Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik, të merren masat për konfiskimin e sigurimit të kontratës nr. 46451579, datë 21.02.2017, me vlerë 1,711,360 lekë nga OE M. A. SHPK, si dhe të përcillet në APP informacioni mbi zbatimin e kësaj kontrate.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave ligjore në zbatimin e kontratave të qirasë, rezultoi se:

Në kontratat e qiradhënies së sipërfaqeve të spitalit për vendosjen e makinave për vitin 2015 dhe 2016, konkretisht në kontratat nr. 452, datë 02.03.2015; nr. 346, datë 09.02.2015;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

nr. 394, datë 10.02.2016; dhe nr. 557, datë 03.03.2016; sipërfaqja e makineteve është përlllogaritur 1 m²/makinetë, ndërsa në kontratat e vitit 2017 dhe 2018, sipërfaqja e përlllogaritur është 2 m²/makinetë. Kjo diferencë ka ardhur si pasojë e mos përlllogaritjes së sipërfaqes së plotë funksionale të nevojitur për funksionimin e një makinete, që është rregulluar në kontratat e qirasë të lidhura për periudhën 2017-2018. Por nga SRD nuk janë marrë masat për përlllogaritjen e vlerës së munguar për vitin 2015 dhe 2016, për hapësirën prej 1 m², të përdorur më tepër. Për pasojë për çdo kontratë janë shkaktuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik në vlerën 78,000 lekë. Në total dëmi ekonomik për këto kontrata është në vlerën 312,000 lekë (78,000 lekë * 4 kontrata) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 119-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

13.1-Rekomandimi: Nga Drejtori dhe Sektori Juridik i Spitalit, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 312,000 lekë, e konkretisht vlerës 156,000 lekë nga PF L. K. dhe vlerës 156,000 lekë nga OE C. P. SHPK, për arsye se këto vlera përbëjnë dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave me bankë, rezultuan dy raste të përfitimit të shërbimeve nga operatorë ekonomik privat, të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, veprime në kundërshtim me Nenin 4 “Fusha e zbatimit” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Saktësisht:

a) Aktmarrëveshja e datës 24.01.2014, me vlerë 456,000 lekë, lidhur me OE “D.” Shpk, për shtimin e afatit me 1 vit të kontratës fillestare me nr. 88/1 prot, datë 24.01.2013, me objekt “Për shërbimin e mirëmbajtjes, asistencës dhe upgrade të sistemit software financiar (AF2000) për periudhën 3 mujore 25 tetor 2014 – 24 janar 2015”.

b) Spitali Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi ka përfituar shërbim ndaj A. për përdorimin e telefonave fiks. Në total SRD ka paguar për këtë shërbim vlerën 2,477,920 lekë në favor të OE A. Për këtë shërbim nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Pagesa kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1-Rekomandimi: Drejtori i Spitalit, të marrë masa për evidentimin e të gjitha rasteve të cilat janë objekt i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi. Sipas rastit, kur është e mundur të marrë masa për ndalimin e marrjes së shërbimit duke iu nënshtruar procedurës së prokurimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Durrës për periudhën objekt auditimi rezultoi se është penalizuar me kamatë për pagesën me vonesë të faturës së Ujësjetllës Kanalizimeve në vlerën 533,484 lekë. Për këto kamatëvonesa nuk ka asnjë relacion shpjegues për arsyen e pagesës me vonesë që kanë detyruar institucionin të paguajë kamat vonesa në favor të UKD.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Vlera 533,484 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e SRD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1-Rekomandimi: Drejtoria e Financës në vijimësi të marrë masa për pagesën e faturave të ujit brenda datës 25 të çdo muaji me qëllim shmangien e akumulimit të kamatëvonesave e si rrjedhim shtimin e detyrimeve të Spitalit Rajonal Durrës.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2015-31.12.2018, rezultoi se janë ndërprerë marrëdhëniet për 264 punonjës të spitalit, për arsye të ndryshme (*ndryshime strukturore, dalje në pension, dorëheqje, përfundim kontrate, largime nga detyra, etj.*). Në lidhje me largimet nga detyra të punonjësve të Spitalit Rajonal Durrës, rezultoi se nuk është bërë një analizë për arsyet e lëvizjeve të personelit. Nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se këto largime janë kryer bazuar në vjetërsinë në punë apo vlerësimeve periodike të punonjësve. Si rezultat i kësaj, për periudhën objekt auditimi, kundër vendimeve për largim nga puna, 29 punonjës i janë drejtuar gjykatave për ankimimin e ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës. Nga këto, 18 procese gjyqësore janë në proces shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Apelit, 5 raste janë fituar nga Spitali Rajonal Durrës, dhe për 6 raste në vlerën 7,849,110 lekë, procesi ka përfunduar në favor të punonjësve. Shuma totale e kërkuar për tu dëmshpërblyer nga Spitali Rajonal Durrës, për çështjet gjyqësore në proces, është në vlerën 28,908,874 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 18-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1-Rekomandimi: Nga Drejtori i Spitalit të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për Institucionin, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

4.1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratën pa numër protokolli, datë 10.12.2015, me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, me afat 10 vjeçar, lidhur ndërmjet Ministrisë të Shëndetësisë dhe OE S.S. SHPK. Nga auditimi i zbatimit të kësaj kontrate koncesionare, rezultoi se nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, Koncesionari OE S.S. SHPK, nuk i paguan Spitalit Rajonal Durrës shpenzime për energji elektrike, shpenzime për ujë dhe shpenzime për energji termike, përllogaritja e zërave të mësipërme në vlerën e koston, paguhet nga SRD.

Për pasojë, vlera 7,706,844.40 lekë, e cila përfaqëson vlerën e elementëve të koston të shënuar nga Koncesionari OE S.S. SHPK, elementë për të cilët shpenzimet përballohen nga Buxheti i Spitalit Rajonal Durrës, përbën efekt financiar negativ për llogarinë të Buxhetit të Shtetit.

Sipas relacionit nr. 192, datë 23.01.2019, të përgatitur nga Dega Teknike e SRD, konstatohet se për periudhën 15.03.2018-31.12.2018, detyrimet për shpenzime për energji elektrike, janë në vlerë 3,660,537.6 lekë, ndërsa detyrimet për shpenzime për ujë janë në vlerën 817,756 lekë, detyrime të cilat i përkasin OE S.S. SHPK, por janë paguar nga buxheti i SRD.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

Duke qenë se;

-Koncesionari në SRD nuk ka qendër Back-up, por vetëm magazina dhe Central Sterilizimi;
-Neni 19.5, i kontratës koncesionare datë 10.12.2015, përcakton se: “Në qendrat e Back-Up, përveç qendrës tek QSUT, Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime në ngarkim të Autoritetit”;
-Faqes nr. 5, të kontratës datë 10.12.2015, e cila në paragrafin e parë të saj përcakton se “Autoriteti”, për këtë kontratë është “Ministria e Shëndetësisë”;
Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga OE S.S. SHPK, në vlerën 4,478,293.6 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për Buxhetin e SRD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 119-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion, Koncesionari ka në përdorim ambiente me sipërfaqe totale 291 m². Këto sipërfaqe Koncesionari i ka përdorur për periudhën 15.03.2018 e në vazhdim, pa paguar qira për to.

Në lidhje nga sa më sipër, rezultoi se:

-Në faqen nr. 5, të kontratës datë 10.12.2015, në paragrafin e parë të saj përcaktohet se “Autoriteti”, për këtë kontratë është “Ministria e Shëndetësisë”;

-Neni 19.5, i kontratës koncesionare datë 10.12.2015, përcakton se: “Në qendrat e Back-Up, përveç qendrës tek QSUT, Autoriteti i siguron Koncesionarit energji elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime në ngarkim të Autoritetit”;

-Në lidhje me ambientet të dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk janë ndjekur procedurat ligjore në zbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

-Në lidhje me ambientet të dhëna në përdorim të Koncesionarit, nuk janë mbajtur detyrime për qira për këto ambiente, duke qenë se SRD nuk është palë në këtë kontratë, por vetë Ministria. Detyrimi i qirasë për periudhën 15.03.2018-31.12.2018 (periudha objekt auditimi), për këto ambiente është në vlerën 1,382,250 lekë ($9.5 \text{ muaj} * 500 \text{ lekë/m}^2 \text{ muaj} * 291 \text{ m}^2$). Çmimi 500 lekë/m² muaj, është marrë për bazë duke ndjekur të njëjtin standard për të cilin SRD ka aplikuar me kontratat e tjera të qiradhënies së ambienteve, lidhur për periudhën objekt auditimi. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

-Nuk lidhur kontrata qiraje në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

-Nuk konstatohet mënyra e dorëzimit të ambienteve nga SRD për Koncesionarin, në kushtet kur në datën e fillimit, SRD nuk dispononte dokumentacionin ligjor që vërtetonte këtë kontratë koncesionare. Kjo për arsye se SRD deri më datë 15.03.2018, dispononte vetëm kontratën koncesionare pa Anekset pjesë përbërëse, kontratë në të cilën nuk parashikohej në asnjë nen të saj përfshirja e Spitalit Rajonal Durrës në këtë kontratë koncesionimi.

Për pasojë, vlera 1,382,250 lekë, që përbën detyrimin për qiranë mujore për ambientet e dhëna në përdorim të Koncesionarit S.S. SHPK, përbën efekt financiar negativ. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 119-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

4.1-Rekomandimi: SRD të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 13,567,388 lekë si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5.

Menjëherë

4.2-Rekomandimi: Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të merren masa për rinegocimin e kontratës për pikën 19.5, për të gjitha spitalet e tjera të vendit, pjesë e kontratës koncensionare, ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë pjesë e Koncensionarit dhe jo buxheteve të spitaleve.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave me objekt “Asgjësimit i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, për periudhën objekt auditimi, rezultoi se:

Për periudhën objekt auditimi, janë realizuar gjithsej 6 kontrata për asgjësimit të mbetjeve spitalore, për vlerën totale 20,904,861.60 lekë. Në lidhje me këto kontrata konstatohet se:

-Nga grupet e monitorimit të kontratave, janë ndjekur procedurat për peshimin e mbetjeve spitalore, para dorëzimit tek kontraktori, por nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme për verifikimin nëse këto mbetje janë asgjësuar apo jo, në kundërshtim me kushtet e kontratës.

-Në kontratat e nënshkruara, është prokuruar shërbimi i asgjësimit për mbetjet me kod 18 01 01 “Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)”, 18 01 02 “Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)”, 18 01 03 “Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet”, si dhe 18 01 07 “Kimikate të tjera nga ato të përmendura në 18 01 06”. Por nga verifikimi i listës së mbetjeve spitalore të rrezikshme spitalore të prodhuara nga SRD, konstatohet se për periudhën 2016-2018, janë prodhuar gjithsej 373 kg mbetje të krijuara nga pavioni i Paliativit, mbetje të cilat sipas VKM nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, janë me kod 18 01 08 “Medikamente citostatika dhe citotoksike”, e si të tilla janë mbetje shumë të rrezikshme dhe toksike, të cilat SRD i ka trajtuar si mbetjet e tjera spitalore.

Në lidhje me mbetjet spitalore, përveç parregullsive financiare dhe ligjore të rezultuara në kryerjen e këtij shërbimi, duhet të merren parasysh dhe pasojat mjedisore dhe shëndetësore që mund të vijnë si pasojë e mos ndjekjes nga SRD të procedurave ligjore rigorozë në trajtimin e të mbetjeve të rrezikshme citostatike dhe citotoksike.

Dokumentacioni i mbajtur nga SRD në lidhje me këto procedura, nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, e për pasojë nuk mund të quhen dokumente financiare.

Për pasojë, grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e kryerjes së shërbimit të asgjësimit të mbetjeve spitalore, për 6 kontratat e lidhura për periudhën 2016-2018, me vlerë 20,904,861.60 lekë. Në mungesë të dokumentacionit të duhur ligjor dhe financiar, që do provonte kryerjen e këtij shërbimi nga OE të kontraktuar nga SRD, vlera 20,904,861.60 lekë, përbën një shpenzim të pa argumentuar dhe të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 52-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1-Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të shqyrtojë vlerën 20,904,861.60 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e rezultuara në zbatimin e procedurave të prokurimit me objekt “Asgjësimit i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, si dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

vlerë përbën një shpenzim të pa argumentuar dhe të pa justifikuar me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë



IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Spitali Rajonal Durrës është i organizuar si person juridik publik, në kuptimin të nenit 25, të Kodit Civil, me qendër në Durrës. Spitali si institucion i shërbimit shëndetësor publik, është jo fitimprurës dhe e ushtron veprimtarinë e tij sipas ligjit bazë të shërbimit shëndetësor, si edhe të ligjit të shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë. Spitali Rajonal Durrës drejtohet nga Bordi i Spitalit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit. Bordi është organi më i lartë ekzekutiv i spitalit. Spitali Rajonal Durrës organizohet dhe funksionon në bazë të Statutit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 23.10.2000 “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e Spitalit Rajonal Durrës në Skemën e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se në përgjithësi Spitali Rajonal Durrës ka funksionuar në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Por nga auditimi u konstatuan mangësi të cilat kryesisht janë në lidhje me:

- Miratimin e Rregullores mbi funksionimin e Bordit;
- Lidhjen e një kontrate midis Drejtorit dhe Bordit Drejtues të SRD;
- Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Ngritjen dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm;
- Zbatimin e ligjit në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik;
- Monitorimin e zbatimit të kontratave të prokurimeve publike;
- Zbatimin e kontratës koncensionare lidhur me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”;
- Ndjekjen e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës;
- Ndjekjen e procedurave ligjore në konsumin e karburantit;
- Ndjekjen e procedurave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave të qirasë etj.;

Nga mangësitë e mësipërme ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 9,592 mijë lekë, vlerë e cila është nën vlerën 17,501,539 lekë të materialitetit, e për pasojë nuk janë materiale.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë janë: ISSAI 4000¹, ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së” dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë për veprimtarinë ekonomiko-financiare të Spitalit Rajonal Durrës.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë). Auditimi është kryer në bazë risku dhe ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh dhe të

¹ ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me pasqyrave financiare çështje të veçanta.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

njëpasnjëshëm, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e njësisë së zbatimit të projektit pranë këtij institucioni, gjatë periudhave ushtrimore nga data 01.01.2015 deri më datë 31.12.2018.

Opinion i kualifikuar.

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë Spitalit Rajonal Durrës, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, por janë të përhapura.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti – Spitali Rajonal Durrës, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), rezultuan devijime në:

-Funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Njësisë së Auditit të Brendshëm;

-Miratimin e Rregullores mbi funksionimin e Bordit;

-Lidhjen e një kontrate midis Drejtorit dhe Bordit Drejtues të SRD;

-Zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si nuk është argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, janë vendosur kriteret për kualifikim në kundërshtim me LPP, vlera e kontratës është përlogaritur në kundërshtim me LPP, etj.;

-Monitorimin e zbatimit të kontratave të prokurimeve publike;

-Zbatimin e kontratës koncensionare lidhur me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, si vonesa e pa argumentuar me 1 vit e fillimit të zbatimit të kësaj kontrate koncensionare, mos dorëzimin e dokumentacionit të administrimit të mbetjeve të rrezikshme, nuk është qartësuar në kontratë pagesa e shpenzimeve të energjisë elektrike, ujë, avull, qira;

-Ndjekjen e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ku është shkaktuar efekt financiar negativ në vlerën 7,849,110 lekë, si dhe efekt të pritshëm për tu paguar në vlerën 28,908,874 lekë;

-Ndjekjen e procedurave ligjore në konsumin e karburantit;

-Ndjekjen e procedurave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave të qirasë etj.;

Nga mangësitë e mësipërme ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 9,592 mijë lekë dhe efekt financiar negativ në vlerën 51,438 mijë lekë.

GRUPI I AUDITIMIT

A. G.

J. ZH.

B.D.

A.R.

M. B.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT